

Konventa e 2 korrikut 2019 për njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore të huaja në çështjet civile ose tregtare

Raport shpjegues

në bashkëpunim me



Implemented by



**Projekti: "Fondi i Hapur Rajonal
për Evropën Juglindore – Reforma
Ligjore (2007-2021)"**

Raport shpjegues

për

Konventën e 2 korrikut 2019 për njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore të huaja në çështjet civile ose tregtare

(Konventa e Gjykimeve e HCCH-së e vitit 2019)

nga

Francisco Garcimartin

Geneviève Saumier

Publikuar nga:

Konferenca e Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private (HCCH)

Zyra e përhershme
Churchillplein 6b
2517 JW Hagë
Hollandë

Përkthimi i mbështetur nga:

**Deutsche Gesellschaft für
Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH**

Zyra të regjistruara
Bonn dhe Eschborn, Gjermani

Fondi i Hapur Rajonal për Evropën Juglindore – Reforma Ligjore
Zmaja od Bosne 7-7a
Importanne Centar O3/IV
71 000 Sarajevë
Bosnje dhe Hercegovinë

Shënim për mosmbajtje përgjegjësie: Ky është një përkthim jozyrtar i Raportit Shpjegues mbi Konventën e Gjykimeve të HCCH-së të vitit 2019 në [shqip] mbështetur nga Fondi i Hapur Rajonal për Evropën Jug-Lindore - Reforma Ligjore (ORF LR) në bashkëpunim me Zyrën e Përhershme të Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private (HCCH). ORF LR zbatohet nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ). Versioni origjinal në anglisht dhe frëngjisht i botimit zyrtar mund të gjendet në faqen e internetit të HCCH (www.hcch.net).

PARATHËNIE

Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), Fondi i Hapur Rajonal për Evropën Juglindore – Reforma Ligjore, në emër të Ministrisë për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim të Gjermanisë, mbështet ministritë e drejtësisë dhe dhomat përkatëse të përmbauesve në Evropën Juglindore (EJL) për nxitjen e shkëmbimit të njohurive dhe përdorimin e praktikave të mira, me qëllim përmirësimin e kushteve për zbatimin ndërkufitar të vendimeve gjyqësore. GIZ, në bashkëpunim me Konferencën e Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private (HCCH), kërkon të asistojë vendet e EJL-ësë në promovimin e *Konventës së HCCH-ësë, të datës 2 korrik 2019, për Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve të Huaja Gjyqësore për Çështje Civile ose Tregtare* (Konventa).

Me qëllim zvogëlimin e dallimeve dhe arritjen e një ndryshimi të qenësishëm, Konventa mund të shërbejë për rritjen e bashkëpunimit gjyqësor për çështje civile ose tregtare në EJL. Kjo realizohet përmes sigurimit të kuadrit përkatës ligjor për ndërtimin e urave midis sistemeve përkatëse gjyqësore, duke kapërcyer vështirësi që ndeshen nga ndryshimet në sistemet ligjore përkatëse. Si e tillë, Konventa do të shërbejë për rritjen e sigurisë juridike dhe parashikueshmërisë, si dhe përmirësimin e efikasitetit, ndërsa do të ulen kostot e tregtisë ndërkombëtare dhe lehtësohet zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërkufitare. Tregtia dhe investimet në rajonin e EJL-ësë dhe më gjerë do të përfitojnë nga pakësimi ndjeshëm i kohës dhe përpjekjeve lidhur me njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore për çështje civile ose tregtare dhe rritja ndjeshëm e parashikueshmërisë së rezultatit përfundimtar.

Duke patur parasysh ndryshimet midis sistemeve ligjore në EJL (përmbarimi gjyqësor, përmbarimi publik dhe privat, etj.), është prioritet nxitja e këtij kuadri të ri ligjor global dhe zbatimi i tij. Njohja dhe zbatimi i parashikueshëm dhe i bazuar në rregulla, i vendimeve gjyqësore në EJL është me rëndësi thelbësore për funksionimin e gjyqësorit dhe, nga ana tjetër, për besimin e qytetarëve tek sundimi i ligjit. Forcimi i bashkëpunimit rajonal, në EJL, në kontekstin e bashkëpunimit gjyqësor ndërkufitar dhe rajonal për çështje civile ose tregtare do të shërbejë gjithashtu për përmirësimin e kushteve kuadër për një veprimtari më të koordinuar ekonomike rajonale.

Ky botim përmban tekstin e Konventës për Vendimet Gjyqësore të HCCH-ësë 2019, Raportin Shpjegues, të hartuar nga bashkë-Raporterët dhe Formularin e Rekomanduar. Qëllimi i këtij botimi është që të mbështesë palët përkatëse të interesuara, në EJL, për ta kuptuar më mirë Konventën, dhe t'i asistojë ata për vënien në veprim, zbatimin dhe interpretimin uniform të saj.

Dr. Christophe Bernasconi
Sekretar i Përgjithshëm, HCCH

Dr. Veronika Efremova
Menaxhere e Projektit, GIZ

Përshkrim

Konventa	7
Formulari i rekomanduar	25
Raporti i hartuar nga garacimartin-Saumier	33

Konventa

KONVENTA PËR NJOHJEN DHE ZBATIMIN E VENDIMEVE GJYQËSORE TË HUAJA NË ÇËSHTJET CIVILE OSE TREGTARE

Palët Kontraktuese të kësaj Konvente, duke synuar promovimin e qasjes së efektshme në drejtësi për të gjithë dhe lehtësimin e tregtisë dhe investimeve shumëpalëshe, të bazuara në rregulla, si dhe të lëvizjes, nëpërmjet bashkëpunimit gjyqësor, duke besuar se ky bashkëpunim mund të rritet me krijimin e një grupi të unifikuar rregullash themelore për njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore të huaja në çështjet civile ose tregtare, me qëllim lehtësimin e njohjes dhe zbatimit të efektshëm të këtyre vendimeve gjyqësore, duke qenë të bindura se ky bashkëpunim i shtuar gjyqësor kërkon, në veçanti, një regjim juridik ndërkombëtar që ofron parashikueshmëri dhe siguri më të madhe në lidhje me qarkullimin global të vendimeve gjyqësore të huaja, dhe që është bashkëplotësues me *Konventën e datës 30 qershor 2005 për Marrëveshjet për Zgjedhjen e Gjykatës*, kanë vendosur të nënshkruajnë Konventën për këtë qëllim dhe kanë rënë dakord për dispozitat e mëposhtme:

KAPITULLI I – FUSHA E VEPRIMIT DHE PËRKUFIZIMET

Neni 1

Fusha e veprimit

1. Kjo Konventë zbatohet për njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore në çështjet civile ose tregtare. Fusha e veprimit të saj nuk shtrihet në mënyrë të veçantë tek çështjet e të ardhurave, çështjet doganore ose çështjet administrative.
2. Kjo Konventë zbatohet për njohjen dhe zbatimin në një shtet palë të kësaj Konvente të vendimit gjyqësor të dhënë nga gjykata e një tjetër shteti palë.

Neni 2

Përjashtimet nga fusha e veprimit

1. Kjo Konventë nuk zbatohet për çështjet e mëposhtme:
 - (a) statusi dhe zotësia juridike e personave fizikë;
 - (b) detyrimet e mbajtjes;
 - (c) çështjet e tjera të së drejtës familjare, përfshirë regjimet pasurore martesore dhe të drejtat ose detyrimet e tjera, që lindin nga martesë apo marrëdhëniet e ngjashme;
 - (d) testamentet dhe trashëgimia;
 - (e) paaftësia paguese, përbërja, vendimet e institucioneve financiare në rast procesi falimentar të menjëhershëm dhe çështjet e ngjashme;
 - (f) transporti i udhëtarëve dhe i mallrave;

- (g) ndotja detare ndërkufitare, ndotja detare në zonat përtej juridiksionit kombëtar, ndotja detare nga anijet, kufizimi i përgjegjësisë për pretendimet detare dhe mesatarja e përgjithshme;
 - (h) përgjegjësia për dëmet bërthamore;
 - (i) vlefshmëria, pavlefshmëria, shpërbërja e personave juridikë ose e shoqatave të personave fizikë ose juridikë, si dhe vlefshmëria e vendimeve të organeve të tyre;
 - (j) vlefshmëria e regjistrimeve në regjistrat publikë;
 - (k) shpifja;
 - (l) privatësia;
 - (m) pronësia intelektuale;
 - (n) veprimtaritë e forcave të armatosura, përfshirë veprimtaritë e personelit të tyre gjatë ushtrimit të detyrave të tyre zyrtare;
 - (o) veprimtaritë ligjzbatuese, përfshirë veprimtaritë e personelit ligjzbatues gjatë ushtrimit të detyrave të tyre zyrtare;
 - (p) çështjet anti-trust (çështjet e konkurrencës), përveç rasteve kur vendimi gjyqësor bazohet në veprime që përbëjnë marrëveshje kundër-konkurrese ose praktikë të bashkërenduar mes konkurrentëve aktualë ose potencialë për të përcaktuar çmimet, për të bërë oferta të manipuluar, për të vendosur kufizime të produkteve ose kuota, ose për të ndarë tregjet duke caktuar konsumatorët, furnitorët, territoret ose linjat e tregtisë, dhe kur edhe këto veprime edhe efekti i tyre kanë ndodhur në shtetin e origjinës;
 - (q) ristrukturimi i borxhit shtetëror nëpërmjet masave të njëanshme të shtetit.
2. Vendimi gjyqësor nuk përjashtohet nga fusha e veprimit të kësaj Konvente, kur një çështje për të cilën kjo Konventë nuk zbatohet, është ngritur thjesht si pyetje paraprake gjatë procedurës që çoi në vendimin gjyqësor, dhe jo si objekt i procedurës. Në veçanti, vetë fakti që një çështje e tillë është ngritur nga mbrojtja, nuk e përjashton vendimin gjyqësor nga Konventa, nëse kjo çështje nuk ka qenë objekt i procedimit.
 3. Kjo Konventë nuk zbatohet në rastin e arbitrazhit dhe procedimeve përkatëse.
 4. Vendimi gjyqësor nuk përjashtohet nga fusha e veprimit të kësaj Konvente për faktin e thjeshtë se shteti, ku përfshihet qeveria, agjencia qeveritare ose çdo person që vepron për shtetin, ka qenë palë në procedim.
 5. Asgjë në këtë Konventë nuk prek privilegjet dhe imunitetet e shteteve ose organizatave ndërkombëtare, në lidhje me to dhe pronën e tyre.

Neni 3 *Përkufizimet*

1. Në këtë Konventë:
 - (a) “i paditur” do të thotë person ndaj të cilit është paraqitur padi ose kundërpadi në shtetin e origjinës;

- (b) “vendim gjyqësor” do të thotë çdo vendim i gjykimit në themel, të dhënë nga gjykata, pa marrë parasysh emërtimin e vendimit, përfshirë një dekret apo një urdhër, dhe përcaktimi i kostove ose i shpenzimeve të procedurës nga gjykata (përfshirë zyrtari i gjykatës), me kusht që përcaktimi të ketë të bëjë me vendimin e gjykimit në themel, i cili mund të njihet ose zbatohet sipas kësaj Konvente. Masa e përkohshme e mbrojtjes nuk është vendim gjyqësor.
2. Subjekti juridik ose personi i ndryshëm nga personi fizik konsiderohet se është banor me vendqëndrim të rregullt në një shtet:
- (a) ku ka selinë ligjore;
 - (b) sipas ligjit të të cilit është themeluar ose formuar;
 - (c) ku ka administratën qendrore; ose
 - (d) ku ka vendin kryesor të ushtrimit të aktivitetit.

KAPITULLI II - NJOHJA DHE ZBATIMI

Neni 4

Dispozita të përgjithshme

1. Vendimi gjyqësor i dhënë nga gjykata e një Shteti Kontraktues (shteti i origjinës) njihet dhe zbatohet në Shtetin Kontraktues tjetër (Shteti i kërkuar) në përputhje me dispozitat e këtij Kapitulli. Njohja ose zbatimi mund të refuzohet vetëm për arsyt e bazuara, të specifikuara në këtë Konventë.
2. Në Shtetin e kërkuar nuk bëhet rishikimi i vendimit gjyqësor për gjykimin në themel. Mund të bëhet vetëm një vlerësim i nevojshëm për zbatimin e kësaj Konvente.
3. Vendimi gjyqësor njihet vetëm nëse ai ka hyrë në fuqi në shtetin e origjinës dhe zbatohet vetëm nëse ai është i zbatueshëm në shtetin e origjinës.
4. Njohja ose zbatimi mund të shtyhet ose të refuzohet nëse vendimi gjyqësor i përmendur në paragrafin 3, është objekt rishikimi në shtetin e origjinës, ose nëse nuk ka skaduar afati kohor për të kërkuar rishikim të zakonshëm. Refuzimi nuk parandalon paraqitjen e një kërkesë tjetër për njohjen ose zbatimin e vendimit gjyqësor.

Neni 5

Bazat për njohje dhe zbatim

1. Vendimi gjyqësor është i përshtatshëm për njohje dhe zbatim nëse plotësohet një nga kushtet, si më poshtë:

- (a) personi ndaj të cilit kërkohet njohja ose zbatimi ishte banor me vendqëndrim të rregullt në shtetin e origjinës, në kohën, kur ai person u bë palë në procedurë në gjykatën e origjinës;
- (b) personi fizik ndaj të cilit kërkohet njohja ose zbatimi kishte vendin kryesor të ushtrimit të aktivitetit në shtetin e origjinës, në kohën kur personi u bë palë në procedurë në gjykatën e origjinës dhe padia, mbi të cilën bazohet vendimi gjyqësor, lindi si pasojë e aktiviteteve të këtij biznesi;
- (c) personi ndaj të cilit kërkohet njohja ose zbatimi është personi që e ka paraqitur padinë, të ndryshme nga kundërpadia, mbi të cilën bazohet vendimi gjyqësor;
- (d) i padituri zotëronte një degë, agjenci ose ndërmarrje tjetër pa personalitet juridik të veçantë, në shtetin e origjinës, në kohën kur personi u bë palë në procedurë në gjykatën e origjinës, dhe padia mbi të cilën bazohet vendimi gjyqësor lindi si pasojë e aktiviteteve të asaj dege, agjencie ose ndërmarrjeje;
- (e) i padituri kishte dhënë pëlqimin shprehimisht për juridiksionin e gjykatës së origjinës, gjatë procedurës në të cilën u dha vendimi gjyqësor;
- (f) i padituri kishte argumentuar çështjen në themel para gjykatës së origjinës, pa kontestuar juridiksionin, brenda afatit të parashikuar me ligj në shtetin e origjinës, përveç nëse është e qartë se kundërshtimi i juridiksionit ose i ushtrimit të juridiksionit nuk do të kishte funksionuar sipas atij ligji;
- (g) vendimi gjyqësor shprehet për një detyrim kontraktues dhe u dha nga gjykata e shtetit në të cilën ndodhi, ose do të duhej të kishte ndodhur, përmbushja e këtij detyrimi, në përputhje me:
 - (i) marrëveshjen mes palëve; ose
 - (ii) ligjin e zbatueshëm për kontratën, në mungesë të marrëveshjes për vendin e zbatimit të tij,
 me përjashtim të rastit kur aktivitetet e të paditurit në lidhje me transaksionin, nuk përbënin në mënyrë të qartë një lidhje të qëllimshme dhe thelbësore me atë shtet;
- (h) vendimi gjyqësor shprehet për kontratën e qirasë së pronës së paluajtshme (qiramarrjen) dhe u dha nga gjykata e shtetit në të cilin ndodhet prona;
- (i) vendimi gjyqësor shprehet kundër të paditurit për detyrimin kontraktor, të garantuar nga e drejta e përdorimit, *in rem*, të një prone të paluajtshme të marrë me qira nga i padituri, që ndodhet në shtetin e origjinës, nëse padia lidhur me kontratën është paraqitur së bashku me padinë ndaj të njëjtit të paditur në lidhje me atë të drejtë përdorimi, *in rem*;
- (j) vendimi gjyqësor shprehet për detyrimin jokontraktor që lind nga vdekja, dëmtimi fizik, dëmi ose humbja e pasurisë së patundshme, si dhe nga veprimi ose mosveprimi që shkaktoi drejtpërdrejt këtë lloj dëmi për shtetin e origjinës, pavarësisht se ku ka ndodhur ai dëm;
- (k) vendimi gjyqësor ka të bëjë me vlefshmërinë, ndërtimin, efektet, administrimin ose variacionet e instrumentit të trustit, të krijuar vullnetarisht dhe të dëshmuar me shkrim, dhe –
 - (i) në kohën e fillimit të procedurës, shteti i origjinës ishte përcaktuar në instrumentin e trustit si shteti, në gjykatat e të cilit do të zgjidheshin mosmarrëveshjet në lidhje me çështje të tilla; ose

- (ii) në kohën e fillimit të procedurës, shteti i origjinës ishte përcaktuar shprehimisht ose në mënyrë të nënkuptuar në instrumentin e trustit si shteti në të cilin ndodhet vendi kryesor i administrimit të trustit.

Ky nën-paragraf zbatohet vetëm për vendimet gjyqësore që kanë të bëjnë me aspektet e brendshme të një trusti mes personave, që janë ose ishin të inkuadruar brenda marrëdhënieve të trustit;

- (l) vendimi gjyqësor shprehet për kundërpadinë:
 - (i) në masën që ishte në favor të kundërpaditësit, me kushtin që kundërpadia të paraqitej për të njëjtin transaksion ose të njëjtën ngjarje si edhe padia; ose
 - (ii) në masën që ishte kundër kundërpaditësit, me përjashtim të rastit kur ligji i shtetit të origjinës kërkonte që kundërpadia të paraqitej për të shmangur prekluzivitetin;
 - (m) vendimi gjyqësor u dha nga gjykata e përcaktuar në një marrëveshje të lidhur ose të dokumentuar me shkrim ose me anë të ndonjë mjeti tjetër të komunikimit, që e bën informacionin të arritshëm në mënyrë që të jetë i përdorshëm për referim të mëvonshëm, të ndryshme nga një marrëveshje ekskluzive për zgjedhjen e gjykatës. Për qëllimet e këtij nën-paragrafi, “marrëveshje ekskluzive për zgjedhjen e gjykatës” do të thotë një marrëveshje e lidhur nga dy a më shumë palë, që përcakton, me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që kanë lindur ose që mund të lindin në lidhje me një marrëdhënie të veçantë juridike, gjykatat e një shteti ose një a më shumë gjykata specifike të një shteti, duke përjashtuar juridiksionin e gjykatave të tjera.
2. Nëse kërkohet njohja ose zbatimi ndaj një personi fizik që vepron kryesisht për qëllime personale, familjare ose shtëpiake (pra, konsumator) për çështje që lidhen me një kontratë shit-blerje, ose ndaj një punonjësi për çështje që lidhen me kontratën e tij të punës –
- (a) paragrafi 1(e) zbatohet vetëm nëse palët kanë shprehur pëlqimin e tyre, me gojë ose me shkrim, pranë gjykatës;
 - (b) pikat (f), (g) dhe (m) të paragrafit 1 nuk zbatohen.
3. Paragrafi 1 nuk zbatohet për vendimin gjyqësor që shprehet për kontratën e qirasë së banimit në pronë të paluajtshme (qiramarrjen) ose shprehet për regjistrimin e pronës së paluajtshme. Vendimi gjyqësor i tillë është i pranueshëm për njohjen dhe zbatimin vetëm nëse është dhënë nga gjykata e shtetit ku ndodhet prona.

Neni 6

Baza ekskluzive për njohjen dhe zbatimin

Pavarësisht nga neni 5, vendimi gjyqësor që shprehet për të drejtat e përdorimit, *in rem* të pronës së paluajtshme njihet dhe zbatohet nëse dhe vetëm kur prona ndodhet në shtetin e origjinës.

Neni 7
Refuzimi i njohjes dhe zbatimit

1. Njohja ose zbatimi mund të refuzohet nëse –
 - (a) dokumenti me të cilin u fillua procedura, ose një dokument ekuivalent, përfshirë kërkesë-padinë që jep elementet thelbësore të padisë –
 - (i) nuk i është bërë e ditur të paditurit përmes njoftimit në kohë të mjaftueshme dhe në mënyrën që do t’ia mundësonte palës së paditur që të merrte masa për mbrojtje, përveç nëse i padituri është paraqitur në gjykatë dhe ka dhënë argumentet e veta pa kontestuar njoftimin në gjykatën e origjinës, me kushtin që ligji i shtetit të origjinës ka lejuar që njoftimi të kundërshtohet; ose
 - (ii) i është bërë e ditur të paditurit përmes njoftimit në Shtetin e kërkuar në formën që nuk përputhet me parimet themelore të Shtetit të kërkuar sa i takon dorëzimit të dokumenteve;
 - (b) vendimi gjyqësor u mor me mashtrim;
 - (c) njohja ose zbatimi është dukshëm në mospërputhje me politikën publike të Shtetit të kërkuar, përfshirë situatat kur procedurat specifike që çuan te vendimi gjyqësor, ishin në mospërputhje me parimet themelore të korrektësisë procedurale të atij shteti, si dhe me situata që kanë të bëjnë me cenimet e sigurisë ose sovranitetit të tij;
 - (d) procedurat në gjykatën e origjinës ishin në kundërshtim me marrëveshjen, ose përcaktimin e bërë në instrumentin e trustit, sipas të cilit vendimi për mosmarrëveshjen në fjalë do të merrej nga një gjykatë të një shteti të ndryshëm nga shteti i origjinës;
 - (e) vendimi gjyqësor është në mospërputhje me vendimin gjyqësor të dhënë nga gjykata e Shtetit të kërkuar në mosmarrëveshjen mes të njëjtave palë; ose
 - (f) vendimi gjyqësor është në mospërputhje me vendimin gjyqësor të mëparshëm të dhënë nga gjykata e një shteti tjetër mes të njëjtave palë, për të njëjtën çështje lëndore, me kushtin që vendimi gjyqësor i mëparshëm plotëson kushtet e nevojshme për njohjen e tij në Shtetin e kërkuar.
2. Njohja ose zbatimi mund të shtyhet ose të refuzohet nëse procedurat mes të njëjtave palë, për të njëjtën çështje lëndore, janë në pritje për shqyrtim para një gjykate të Shtetit të kërkuar, kur:
 - (a) gjykata e Shtetit të kërkuar e kishte marrë juridiksionin para gjykatës së origjinës; dhe
 - (b) ekziston një lidhje e ngushtë mes mosmarrëveshjes dhe Shtetit të kërkuar.

Refuzimi sipas këtij paragrafi nuk parandalon paraqitjen e mëvonshme të kërkesës për njohjen ose zbatimin e vendimit gjyqësor.

Neni 8
Çështje paraprake

1. Vendimi për çështje paraprake nuk njihet ose nuk zbatohet sipas kësaj Konvente nëse vendimi lidhet me një çështje për të cilën kjo Konventë nuk zbatohet, ose me një çështje të përmendur në nenin 6, për të cilën vendosi një gjykatë e një shteti të ndryshëm nga shteti i përmendur në atë nen.
2. Njohja ose zbatimi i një vendimi gjyqësor mund të refuzohet nëse, dhe deri në masën që, vendimi gjyqësor është bazuar në një vendim lidhur me një çështje për të cilën kjo Konventë nuk zbatohet, ose lidhur me një çështje, që përmendet në nenin 6, për të cilën vendosi/ka vendosur një gjykatë e një shteti të ndryshëm nga shteti i përmendur në atë nen.

Neni 9
Veçimi

Njohja ose zbatimi i pjesës së vendimit gjyqësor që mund të veçohet, miratohet kur bëhet kërkesë për njohjen ose zbatimin e asaj pjese, ose kur vetëm një pjesë e vendimit gjyqësor mund të njihet ose të zbatohet sipas kësaj Konvente.

Neni 10
Dëmshpërblimi

1. Njohja ose zbatimi i një vendimi gjyqësor mund të refuzohet nëse, dhe deri në masën që, vendimi gjyqësor cakton dëmshpërblimin, përfshirë dëmshpërblimin me vlerë më të madhe se dëmi i shkaktuar, i cili ka karakter ndëshkues, që nuk e kompenson palën për humbjen ose dëmin e pësuar në të vërtetë.
2. Gjykata, të cilës i është drejtuar pala, merr parasysh nëse, dhe deri në çfarë mase, dëmshpërblimi i caktuar nga gjykata e origjinës, shërben për të mbuluar kostot dhe shpenzimet në lidhje me procedurat.

Neni 11
Marrëveshjet me ndërmjetësim (transactions judiciaires)

Marrëveshjet me ndërmjetësim (*transactions judiciaires*) që i ka miratuar gjykata e Shtetit Kontraktues, ose të cilat janë lidhur gjatë zhvillimit të procedurës para gjykatës së Shtetit Kontraktues, dhe që janë të zbatueshme në të njëjtën mënyrë si vendimi gjyqësor në shtetin e origjinës, zbatohen sipas kësaj Konvente, në të njëjtën mënyrë si vendimi gjyqësor.

Neni 12

Dokumentet që duhet të paraqiten

1. Pala që kërkon njohje ose që paraqet kërkesë për zbatim, paraqet dokumentet e mëposhtme:
 - (a) kopje të plotë dhe të noterizuar të vendimit gjyqësor;
 - (b) nëse vendimi gjyqësor është dhënë në mungesë, origjinali ose kopje e noterizuar e dokumentit, që përcakton se dokumenti me të cilin ka filluar procedura, ose dokumenti i njëvlershëm, i është bërë i ditur përmes njoftimit palës që nuk ka qenë e pranishme në gjykim;
 - (c) çdo dokument i nevojshëm për të vërtetuar se vendimi gjyqësor ka hyrë në fuqi ose, në rastet kur gjen zbatim, është i zbatueshëm në shtetin e origjinës;
 - (d) në rastin e përmendur në nenin 11, vërtetimi i gjykatës (lëshuar dhe nga një zyrtar) së shtetit të origjinës ku deklarohet se marrëveshja me ndërmjetësim, ose një pjesë e saj, është e zbatueshme në të njëjtën mënyrë si vendimi gjyqësor në shtetin e origjinës.
2. Nëse kushtet e vendimit gjyqësor nuk lejojnë që gjykata, së cilës i është drejtuar pala, të verifikojë nëse janë përmbushur kushtet e këtij Kapitulli, ajo gjykatë mund të kërkojë çdo dokument të nevojshëm.
3. Kërkesa për njohjen ose zbatimin mund të shoqërohet me dokumentin që ka të bëjë me vendimin gjyqësor, të nxjerrë nga gjykata (lëshuar dhe nga një zyrtar) e shtetit të origjinës, në formën e rekomanduar dhe të botuar nga Konferenca e Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private.
4. Nëse dokumentet e përmendura në këtë nen nuk janë në një gjuhë zyrtare të Shtetit të kërkuar, ato shoqërohen me përkthimin e noterizuar në një gjuhë zyrtare, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligjin e Shtetit të kërkuar.

Neni 13

Procedura

1. Procedura për njohjen, deklarimin e zbatueshmërisë ose regjistrimin për zbatim, dhe zbatimin e vendimit gjyqësor rregullohet nga ligji i Shtetit të kërkuar, përveç rasteve kur në këtë Konventë parashikohet ndryshe. Gjykata e Shtetit të kërkuar vepron me shpejtësi.
2. Gjykata e Shtetit të kërkuar nuk e refuzon njohjen ose zbatimin e vendimit gjyqësor sipas kësaj Konvente, me arsyetimin se njohja ose zbatimi do të duhet të kërkohej në një shtet tjetër.

Neni 14

Kostot e procedurës

1. Asnjë garanci, obligacion ose depozitë, sido që të përshkruhet, nuk kërkohet nga një palë që aplikon në një Shtet Kontraktues për zbatimin e vendimit gjyqësor, të dhënë nga gjykata e një Shteti tjetër Kontraktues me arsyetimin e vetëm se pala e tillë është shtetase e huaj, ose nuk është me vendbanim ose me vendqëndrim në shtetin në të cilin kërkohet zbatimi.
2. Urdhri për pagesën e kostove ose shpenzimeve të procedurës, i lëshuar në Shtetin Kontraktues ndaj çdo personi të përjashtuar nga kërkesat për garancinë, dorëzaninë ose depozitën, në bazë të paragrafit 1 ose në bazë të ligjit të shtetit ku janë filluar procedurat, bëhet i zbatueshëm në çdo Shtet Kontraktues tjetër, me paraqitjen e kërkesës nga personi që ka të drejtë të përfitojë nga urdhri.
3. Shteti mund të deklarojë se nuk e zbaton paragrafin 1 ose të përcaktojë përmes një deklarimi se cila nga gjykatat e tij nuk e zbaton paragrafin 1.

Neni 15

Njohja dhe zbatimi sipas ligjit të brendshëm

Në varësi të nenit 6, kjo Konventë nuk parandalon njohjen ose zbatimin e vendimeve gjyqësore sipas ligjit të brendshëm.

KAPITULLI III – KLAUZOLA TË PËRGJITHSHME

Neni 16

Dispozita kalimtare

Kjo Konventë zbatohet për njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore nëse, në kohën kur filluan procedurat në shtetin e origjinës, Konventa kishte hyrë në fuqi mes atij shteti dhe Shtetit të kërkuar.

Neni 17

Deklarimet që kufizojnë njohjen dhe zbatimin

Një shtet mund të deklarojë se gjykatat e tij mund të refuzojnë të njohin ose të zbatojnë një vendim gjyqësor, të dhënë nga një gjykatë e një Shteti Kontraktues tjetër, nëse palët kanë qenë me vendqëndrim të rregullt në Shtetin e kërkuar, dhe marrëdhëniet e palëve dhe të gjithë elementet e tjera të rëndësishme për mosmarrëveshjen, të ndryshme nga vendndodhja e gjykatës së origjinës, kanë qenë të lidhura vetëm me Shtetin e kërkuar.

Neni 18

Deklarimet lidhur me çështje specifike

1. Kur një shtet ka interes të fortë për të mos e zbatuar këtë Konventë për një çështje specifike, ai shtet mund të deklarojë se nuk do ta zbatojë Konventën për atë çështje. Shteti që bën një deklaram të tillë siguron që deklarimi nuk është më i gjerë sesa është e nevojshme dhe që çështja specifike e përjashtuar, është përkufizuar qartë dhe me përpikëri.
2. Në lidhje me atë çështje, Konventa nuk aplikohet:
 - (a) në Shtetin Kontraktues që ka bërë deklaramin;
 - (b) në Shtetet Kontraktuese të tjera, ku kërkohet njohja ose zbatimi i vendimit gjyqësor, të dhënë nga një gjykatë e një Shteti Kontraktues që ka bërë deklaramin.

Neni 19

Deklarimet në lidhje me vendimet gjyqësore që i përkasin shtetit

1. Një shtet mund të deklarojë se nuk e zbaton këtë Konventë për vendimet gjyqësore që lindin nga procedurat në të cilat është palë cilado nga palët e mëposhtme:
 - (a) ai shtet, ose personi fizik që vepron për atë shtet; ose
 - (b) një agjenci qeveritare e atij shteti, ose një person fizik që vepron për një agjenci të tillë qeveritare.

Shteti që bën një deklaram të tillë siguron që deklarimi nuk është më i gjerë sesa është e nevojshme dhe që përjashtimi nga fusha e veprimit është përkufizuar qartë dhe me përpikëri. Deklarimi nuk bën dallimin midis vendimeve gjyqësore kur shteti, një agjenci qeveritare e atij shteti ose një person fizik që vepron për cilindo prej tyre, është i paditur ose paditës në procedurat para gjykatës së origjinës.

2. Njohja ose zbatimi i një vendimi gjyqësor, të dhënë nga një gjykatë e një shteti që ka bërë deklaramin, në pajtim me paragrafin 1, mund të refuzohet nëse vendimi gjyqësor ka lindur si pasojë e procedurave në të cilat është palë qoftë shteti që ka bërë deklaramin, ose Shteti i kërkuar, një nga agjencitë e tyre qeveritare ose një person fizik që vepron për cilindo prej tyre, në të njëjtën masë, siç specifikohet në deklaram.

Neni 20

Interpretimi i unifikuar

Në interpretimin e kësaj Konvente i kushtohet vëmendje karakterit të saj ndërkombëtar dhe nevojës për të nxitur unifikimin në zbatimin e saj.

Neni 21

Rishikimi i funksionimit të Konventës

Sekretari i Përgjithshëm i Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private organizon rishikimin në intervale të rregullta të funksionimit të kësaj Konvente, përfshirë çdo deklaram, dhe i raporton Këshillit për Çështjet e Përgjithshme dhe Politikat.

Neni 22

Sistemet ligjore të paunifikuara

1. Në lidhje me Shtetin Kontraktues në të cilin zbatohen dy ose më shumë sisteme ligjore në njësi të ndryshme territoriale lidhur me çdo çështje që trajtohet në këtë Konventë:
 - (a) çdo referim ndaj ligjit ose procedurës së një shteti interpretohet se i referohet, kur është e përshtatshme, ligjit ose procedurës në fuqi, në njësinë territoriale përkatëse;
 - (b) çdo referim ndaj gjykatës ose gjykatave të një shteti interpretohet se i referohet, kur është e përshtatshme, gjykatës ose gjykatave në njësinë territoriale përkatëse;
 - (c) çdo referim ndaj lidhjes me një shtet interpretohet se i referohet, kur është e përshtatshme, lidhjes me njësinë territoriale përkatëse;
 - (d) çdo referim ndaj një faktori të lidhjes në raport me një shtet interpretohet se i referohet, kur është e përshtatshme, atij faktori të lidhjes në raport me njësinë territoriale përkatëse.
2. Pavarësisht nga paragrafi 1, një Shtet Kontraktues me dy ose më shumë njësi territoriale, në të cilat aplikohen sisteme të ndryshme ligjore, nuk është i detyruar ta zbatojë këtë Konventë për situatat që kanë të bëjnë vetëm me këto njësi territoriale të ndryshme.
3. Gjykata në një njësi territoriale të një Shteti Kontraktues me dy ose më shumë njësi territoriale, në të cilat zbatohen sisteme të ndryshme ligjore, nuk është e detyruar të njohë ose të zbatojë vendimin gjyqësor të një Shteti Kontraktues tjetër vetëm për arsye se vendimi gjyqësor është njohur ose zbatuar në njësinë tjetër territoriale të të njëjtit Shtet Kontraktues sipas kësaj Konvente.
4. Ky nen nuk zbatohet për Organizatat Rajonale të Integritimit Ekonomik.

Neni 23

Marrëdhënia me instrumentet e tjera ndërkombëtare

1. Kjo Konventë interpretohet aq sa është e mundur në mënyrë që të jetë në përputhje me traktatet e tjera në fuqi për Shtetet Kontraktuese, pavarësisht nëse janë lidhur përpara ose pas kësaj Konvente.

2. Kjo Konventë nuk ndikon në zbatimin nga ana e një Shteti Kontraktues të një traktati që është lidhur përpara kësaj Konvente.
3. Kjo Konventë nuk ndikon në zbatimin nga ana e një Shteti Kontraktues të një traktati që është lidhur pas kësaj Konvente në lidhje me njohjen ose zbatimin e vendimit gjyqësor, të dhënë nga një gjykatë e një Shteti Kontraktues që është gjithashtu palë e atij traktati. Asgjë në traktatin tjetër nuk ndikon në detyrimet, sipas nenit 6, ndaj Shteteve Kontraktuese që nuk janë palë të atij traktati.
4. Kjo Konventë nuk ndikon në zbatimin e rregullave të Organizatës Rajonale të Integritit Ekonomik, që është palë e kësaj Konvente për sa i përket njohjes ose zbatimit të një vendimi gjyqësor, të dhënë nga një gjykatë e një Shteti Kontraktues që është gjithashtu shtet anëtar i Organizatës Rajonale të Integritit Ekonomik kur:
 - (a) rregullat u janë miratuar përpara nënshkrimit të kësaj Konvente; ose
 - (b) rregullat u janë miratuar pas nënshkrimit të kësaj Konvente, në masën që ato nuk ndikojnë në detyrimet, sipas nenit 6, ndaj Shteteve Kontraktuese që nuk janë shtete anëtare të Organizatës Rajonale të Integritit Ekonomik.

KAPITULLI IV - KLAUZOLAT PËRFUNDIMTARE

Neni 24

Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim nga të gjitha shtetet.
2. Kjo Konventë është subjekt i ratifikimit, pranimit ose miratimit nga shtetet nënshkruese.
3. Kjo Konventë është e hapur për aderim nga të gjitha shtetet.
4. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit depozitohen pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Vendeve të Ulëta, që është Depozitari i Konventës.

Neni 25

Deklarimet në lidhje me sistemet ligjore të paunifikuara

1. Nëse një shtet ka dy ose më shumë njësi territoriale, në të cilat zbatohen sisteme të ndryshme ligjore në lidhje me çështjet e trajtuara në këtë Konventë, ai mund të deklarojë se fusha e veprimit të Konventës shtrihet në të gjitha njësitë e tij territoriale, ose vetëm në një a më shumë prej tyre. Një deklaram i tillë thekson shprehimisht njësitë territoriale në të cilat zbatohet Konventa.

2. Nëse një shtet nuk bën asnjë deklaram sipas këtij neni, fusha e veprimit të Konventës shtrihet në të gjitha njësitë territoriale të atij shteti.
3. Ky nen nuk zbatohet për organizatat rajonale të integritit ekonomik.

Neni 26

Organizatat Rajonale të Integritit Ekonomik

1. Organizata Rajonale e Integritit Ekonomik, e cila përbëhet vetëm nga shtete sovrane dhe ka kompetencë mbi disa ose mbi të gjitha çështjet e rregulluara me këtë Konventë, mund të nënshkruajë, pranojë, miratojë ose aderojë në këtë Konventë. Në këtë rast, Organizata Rajonale e Integritit Ekonomik ka të drejtat dhe detyrimet e një Shteti Kontraktues, në masën që Organizata ka kompetencë mbi çështjet e rregulluara me këtë Konventë.
2. Në momentin e nënshkrimit, pranimit, miratimit ose aderimit, Organizata Rajonale e Integritit Ekonomik njofton me shkrim Depozitarin për çështjet që rregullohen me këtë Konventë në lidhje me kompetencat që shtetet anëtare i kanë transferuar kësaj Organizate. Organizata njofton menjëherë me shkrim Depozitarin, për çdo ndryshim në kompetencat e saj, siç specifikohet në njoftimin më të fundit, të dhënë sipas këtij paragrafi.
3. Për qëllimet e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, çdo instrument i depozituar nga një organizatë rajonale e integritit ekonomik nuk llogaritet nëse Organizata Rajonale e Integritit Ekonomik nuk deklaron në përputhje me nenin 27(1) se shtetet anëtare të saj nuk do të jenë palë në këtë Konventë.
4. Çdo referim ndaj një "Shteti Kontraktues" ose "Shteti" në këtë Konventë zbatohet në mënyrë të barabartë, kur është e përshtatshme, për Organizatën Rajonale të Integritit Ekonomik.

Neni 27

Organizata Rajonale e Integritit Ekonomik si palë kontraktuese pa shtetet anëtare të saj

1. Në momentin e nënshkrimit, pranimit, miratimit ose aderimit, një organizatë rajonale e integritit ekonomik mund të deklarojë se ushtron kompetencën mbi të gjitha çështjet e rregulluara me këtë Konventë dhe se shtetet anëtare të saj nuk do të jenë palë në këtë Konventë, por do të kenë detyrime si pasojë e nënshkrimit, pranimit, miratimit ose aderimit të Organizatës.
2. Në rast të deklarimit të bërë nga një organizatë rajonale e integritit ekonomik në përputhje me paragrafin 1, çdo referim ndaj një "Shteti Kontraktues" ose një "Shteti" në këtë Konventë zbatohet në mënyrë të barabartë, kur është e përshtatshme, për shtetet anëtare të Organizatës.

Neni 28
Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit, në përfundim të periudhës gjatë së cilës mund të jetë bërë njoftimi, në përputhje me nenin 29(2) që ka të bëjë me shtetin e dytë që ka depozituar instrumentin e tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, të përmendur në nenin 24.
2. Pas kësaj kjo Konventë hyn në fuqi:
 - (a) për çdo shtet që në vijim do të ratifikojë, pranojë, miratojë ose aderojë në të, në ditën e parë të muajit në përfundim të periudhës gjatë së cilës mund të bëhen njoftimet, në përputhje me nenin 29(2) që ka të bëjë me atë shtet;
 - (b) për njësinë territoriale në të cilën është shtrirë fusha e veprimit të kësaj Konvente, në përputhje me nenin 25, pasi Konventa të ketë hyrë në fuqi për shtetin që bën deklarin, në ditën e parë të muajit në përfundim të tre muajve, pas njoftimit të deklarin të referuar në atë nen.

Neni 29
Vendosja e marrëdhënieve në përputhje me Konventën

1. Kjo Konventë do jetë e zbatueshme nga të dy Shtetet Kontraktuese përveç rasteve kur njëri prej tyre ka njoftuar Depozitarin në lidhje me shtetin tjetër, në përputhje me paragrafin 2 ose 3 Në mungesë të një njoftimi të tillë, Konventa ka efekt mes dy Shteteve Kontraktuese nga dita e parë e muajit, në përfundim të periudhës gjatë së cilës mund të bëhen njoftimet.
2. Një shtet kontraktues mund të njoftojë Depozitarin, brenda 12 muajve nga data e njoftimit nga Depozitari, që përmendet në nenin 32(a), se ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi i një shteti tjetër nuk ka efekt për vendosjen e marrëdhënieve mes të dy shteteve në përputhje me këtë Konventë.
3. Një shtet mund të njoftojë Depozitarin, me depozitimin e instrumentit të tij në përputhje me nenin 24(4), se ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi i tij nuk ka efekt për vendosjen e marrëdhënieve me një Shtet Kontraktues në përputhje me këtë Konventë.
4. Një Shtet Kontraktues mund të tërheqë në çdo kohë njoftimin që ka bërë sipas paragrafit 2 ose 3. Një tërheqje e tillë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit, në përfundim të tre muajve nga data e njoftimit.

Neni 30
Deklarimet

1. Deklarimet e përmendura në nenet 14, 17, 18, 19 dhe 25 mund të bëhen me nënshkrimin, ratifikimin, pranimin, miratimin ose aderimin, ose në çdo kohë pas kësaj, dhe mund të modifikohen ose të tërhiqen në çdo kohë.
2. Deklarimet, modifikimet dhe tërheqjet i njoftohen Depozitarit.
3. Deklarimi i bërë në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit hyn në fuqi njëkohësisht me hyrjen në fuqi të kësaj Konvente për shtetin në fjalë.
4. Deklarimi i bërë në një kohë të mëvonshme, dhe çdo modifikim ose tërheqje e deklaramit, hyn në fuqi në ditën e parë të muajit, në përfundim të tre muajve, pas datës në të cilën njoftimi pranohet nga Depozitari.
5. Deklarimi i bërë në një kohë të mëvonshme, dhe çdo modifikim ose tërheqje e deklaramit, nuk zbatohen për vendime gjyqësore që rezultojnë nga procedura, që tashmë kanë filluar pranë gjykatës së origjinës, kur deklarata hyn në fuqi.

Neni 31
Denoncimi

1. Një shteti kontraktues i kësaj Konvente mund ta denoncojë atë përmes njoftimit me shkrim, drejtuar Depozitarit. Denoncimi mund të kufizohet në njësi të caktuara territoriale të një sistemi ligjor të paunifikuar, për të cilin zbatohet kjo Konventë.
2. Denoncimi hyn në fuqi në ditën e parë të muajit, në përfundim të 12 muajve, pas datës në të cilën njoftimi merret nga Depozitari. Kur në njoftim specifikohet një periudhë më e gjatë derisa denoncimi të hyjë në fuqi, denoncimi hyn në fuqi në përfundim të kësaj periudhe, pas datës në të cilën njoftimi merret nga Depozitari.

Neni 32
Njoftimet nga Depozitari

Depozitari njofton Anëtarët e Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private, shtetet tjera dhe organizatat rajonale të integritit ekonomik që kanë nënshkruar, ratifikuar, pranuar, miratuar ose aderuar në këtë Konventë në përputhje me nenet 24, 26 dhe 27 për sa më poshtë:

- (a) nënshkrimet, ratifikimet, pranimet, miratimet dhe aderimet e përmendura në nenet 24, 26 dhe 27;
- (b) datën në të cilën kjo Konventë hyn në fuqi sipas nenit 28;

- (c) njoftimet, deklaratimet, modifikimet dhe tërheqjet e përmendura në nenet 26, 27, 29 dhe 30; dhe
- (d) denoncimet e përmendura në nenin 31.

Duke dëshmuar si më sipër, personat e autorizuar në mënyrë të rregullt, e nënshkruan këtë Konventë.

Hartuar në Hagë, më 2 korrik 2019, në gjuhën angleze dhe frënge, ku të dy tekstet janë njëjloj autentike, në një kopje të vetme, e cila depozitohet në arkivat e Qeverisë së Mbretërisë së Vendeve të Ulëta, që i dërgon nëpërmjet kanaleve diplomatike një kopje të noterizuar secilit anëtar të Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private, në kohën e Sesionit të 22-të dhe secilit shtet tjetër që ka marrë pjesë në atë Sesion.

Formulari i rekomanduar

FORMULARI I REKOMANDUAR
SIPAS
KONVENTËS SË 2 KORRIKUT PËR NJOHJEN DHE ZBATIMIN E VENDIMEVE TË HUAJA NË
ÇËSHTJE CIVILE APO TREGTARE
("KONVENTA")

Formulari i rekomanduar që përmban informacion mbi ekzistencën, nxjerrjen dhe përmbajtjen e një vendimi të dhënë nga një gjykatë e origjinës për qëllimet e njohjes dhe ekzekutimit në një Shteti tjetër Kontraktues sipas Konventës *

1. HOLLËSI RRETH GJYKATËS SË ORIGINËS

Emri i Gjykatës
 Qyteti (dhe shteti/provinca, nëse është e zbatueshme)
 Vendi

2. REFERENCA E ÇËSHTJES NË GJYKATËN E ORIGINËS/NUMRI I ÇËSHTJES NË LISTËN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

3. PALËT

3.1 Informacioni kontaktues i paditësit (paditësve)

Paditësi(paditësit):
 Adresa:
 Telefoni:
 Faksi (nëse përdoret):
 Email (nëse përdoret):.....

3.2 Informacioni i kontaktit të të paditurit(paditurve)

I padituri(të paditurit):
 Adresa:.....
 Telefoni:
 Faksi (nëse përdoret):
 Email (nëse përdoret):.....

[®] Përcaktimi përfundimtar për të parë nëse ka një detyrim sipas Konventës, duhet të merret në bazë të dispozitave të Konventës.

4. VENDIMI

4.1 Procesi gjyqësor ka nisur (neni 16)më (d/m/v)

4.2 Vendimi (Neni 3(1)(b)) është dhënë më (d/m/v)

4.3 Vendimi është dhënë në mungesë (Neni 12(1)(b)):

- PO
 JO

5. EFEKTI I VENDIMIT

5.1 Ky vendim ka efekt në shtetin e origjinës (Neni 12(1)(c)):

- PO (Neni 4(3)) JO
 PO, por vetëm pjesa në vazhdim:
 Nuk mund ta konfirmoj

5.2 Ky vendim është i ekzekutueshëm në shtetin e origjinës 12(1)(c):

- PO (Neni 4(3)) JO
 PO, por vetëm pjesa në vazhdim:
 Nuk mund ta konfirmoj

5.3 Kur ka më shumë se një person që gjendet përgjegjës, ky vendim është e ekzekutueshëm ndaj:

- Të gjithë atyre
 Personit (personave) të mëposhtëm

5.4 Ky vendim (ose një pjesë e tij) është aktualisht objekt shqyrtimi në shtetin e origjinës:

- PO (ju lutem përcaktoni natyrën dhe statusin e një shqyrtimi të tillë) (Neni 4(4)):
 JO
 Nuk mund ta konfirmoj

5.5 Afati kohor për të kërkuar një shqyrtim të zakonshëm të këtij vendimi ka kaluar:

- PO (Neni 4(4)) JO
 Nuk mund ta konfirmoj

6. ZGJIDHJA GJYQËSORE (*transaction judiciaire*) DHE PASOJA E ZGJIDHJES GJYQËSORE, KUR PËRDORET

- 6.1 Zgjidhja gjyqësore (Neni 11) është miratuar nga gjykata, apo është arritur gjatë procesit gjyqësor përpara gjykatës më (*d/m/v*)
- 6.2 Kjo zgjidhje gjyqësore është e ekzekutueshme në të njëjtën mënyrë si një vendim gjyqësor në shtetin e origjinës (Neni 11)
- PO
- PO, por vetëm pjesa në vazhdim:
- JO
- Nuk mund të konfirmoj

7. DETYRIMET QË VENDOSEN NGA VENDIMI (OSE ZGJIDHJA GJYQËSORE, KUR ZBATOHET)

Sipas vendimit të dhënë nga gjykata (Neni 3(1)(b)) (ose kur zbatohet, zgjidhja gjyqësore miratohet nga gjykata apo arrihet gjatë një procesi gjyqësor përpara gjykatës (Neni 11)),

- 7.1 Shuma e mëposhtme e parave duhet paguar:
- Të paguhet nga:
- T'i paguhet:
- Kur zbatohet, ju lutem tregoni çdo kategori përkatëse kompensimi, përfshirë ato që janë kompensime shembullore apo ndëshkuese; monedha e kompensimit; dhe çdo afat i përcaktuar për pagimin e shumës së vendosur, si data dhe shuma e çdo kësti:
-
- 7.2 Ndhima jo-monetare e mëposhtme duhet të jepet:
- 7.3 Shpenzimet e mëposhtme të lidhura me procesin gjyqësor (Neni 3(1)(b)) duhen paguar:.....
- Ju lutem përcaktoni, nëse zbatohet, çdo shumë (të gjitha shumat) të përfshirë në një vendim kompensuese monetar, por që nuk përmendet shprehimisht që jepet/ka për qëllim të mbulojë kostot dhe shpenzimet e lidhura me një proces gjyqësor:
- të paguhet nga:
- t'i paguhet:
- 7.4 Duhet paguar interesi i mëposhtëm:
- të paguhet nga:
- t'i paguhet:

Ju lutem, përcaktoni normën (normat) e interesit; pjesën (pjesët) e shumës së vendosur, përfshirë pjesën që përcakton kostot dhe shpenzimet, nëse përdoret, për të cilën zbatohet interesi; datën që nga dhe deri kur përlogaritet interesi; dhe çdo informacion tjetër të mëtejshëm lidhur me interesin që do të ndihmonte gjykatën e drejtuar.

7.5 Kur më shumë se një person është shpallur përgjegjës për të njëjtin pretendim, e gjithë shuma mund të merret nga çdonjëri prej tyre.

PO (ju lutem, përcaktoni se për cilën kërkesë (pjesë të kërkesës) kjo zbatohet për vendimin për dëmshpërblim në para, interesin, kostot dhe shpenzimet, sipas rastit, dhe shumës përkatëse):

.....

JO

8. **NDONJË INFORMACION TJETËR ME RËNDËSI**

9. Sot mëtë, 20..... në

10. Nënshkrimi dhe / ose vula e gjykatës apo punonjësit të gjykatës:

11. **HOLLËSI RRETH KONTAKTIT**

PERSONI I KONTAKTIT NË GJYKATËN E ORIGINËS:

TEL.:

FAKS:

EMAIL:

GJUHA (GJUHËT) E KOMUNIKIMIT ME PERSONIN E KONTAKTIT:

* * * * *

Vini re: në përputhje me nenin 12 të Konventës, palët që kërkojnë njohje apo ekzekutim sipas Konventës duhet të paraqesin:

- Një kopje të plotë dhe të vërtetuar të vendimit (Neni 12(1)(a));
- Kur vendimi është dhënë në mungesë, origjinalin apo një kopje të certifikuar të një dokumenti, i cili përcakton se dokumenti në bazë të të cilit ka nisur procesi gjyqësor, ose një dokument i barasvlershëm, i është bërë i njohur palës që nuk është paraqitur (Neni 12(1)(b));
- çdo dokument të nevojshëm për të provuar se vendimi ka efekt, apo, sipas rastit, është i ekzekutueshëm në shtetin e origjinës (Neni 12(1)(c));
- Në rastin e përmendur në nenin 11 të Konventës, një certifikatë a një gjykatë (përfshirë të një punonjësi të gjykatës) të shtetit të origjinës, e cila deklaron se zgjidhja gjyqësore apo pjesë e saj është e ekzekutueshme në të njëjtën mënyrë si edhe një vendim në shtetin e origjinës (Neni 12(1)(d));
- Kur dokumentet e bashkëlidhura më lart nuk janë në gjuhën zyrtare të shtetit të kërkuar, pala që kërkon njohjen apo që ka bërë kërkesë për ekzekutimin e vendimit gjyqësor duhet të paraqet një përkthim të legalizuar në një gjuhë zyrtare të shtetit të kërkuar, përveç kur ligji i shtetit të kërkuar e parashikon ndryshe (Neni 12(4)).

Raportu i hartuar nga garacimartin-Saumier

Tabela e Përmbajtjes

PJESA I. PARATHËNIE	37
PJESA II. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM – FUSHA E VEPRIMIT, NDËRTIMI DHE PËRSHKRIMI I KONVENTËS.....	42
PJESA III. KOMENTE NEN PËR NEN	45
KAPITULLI I – FUSHA E VEPRIMIT DHE PËRKUFIZIMET	45
Neni 1– Fusha e veprimit	45
Neni 2 – Përjashtimet nga fusha e veprimit	50
Neni 3 – Përkufizimet.....	71
KAPITULLI II – NJOHJA DHE ZBATIMI	78
Neni 4 – Dispozita të përgjithshme.....	78
Neni 5 – Bazat për njohje apo zbatim.....	87
Neni 6 – Baza ekskluzive për njohjen dhe zbatimin.....	118
Neni 7 – Refuzimi i njohjes dhe zbatimit	122
Neni 8 – Çështje paraprake.....	136
Neni 9 – Veçimi	141
Neni 10 – Dëmshpërblimi	142
Neni 11 – Marrëveshjet me ndërmjetësim (transaksions judiciaires).....	145
Neni 12 – Dokumentet që duhet të paraqiten	147
Neni 13 – Procedura	151
Neni 14 – Kostot e procedurës	155
Neni 15 – Njohja dhe zbatimi sipas të ligjit të brendshëm	158
KAPITULLI III – KLAUZOLA TË PËRGJITHSHME	159
Neni 16 – Dispozita kalimtare	159
Neni 17 – Deklarimet që kufizojnë njohjen dhe zbatimin	160
Neni 18 – Deklarimet lidhur me çështje specifike	162
Neni 19 – Deklarimet në lidhje me vendimet gjyqësore që i përkasin shtetit	165
Neni 20 – Interpretimi i unifikuar	169
Neni 21 – Rishikimi i funksionimit të Konventës	170
Neni 22 – Sistemet ligjore të paunifikuara	171
Neni 23 – Marrëdhënia me instrumentet e tjera ndërkombëtare	176

KAPITULLI IV – KLAUZOLAT PËRFUNDIMTARE	183
Neni 24 – Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi	183
Neni 25 – Deklarimet në lidhje me sistemet ligjore të paunifikuara	185
Neni 26 – Organizatat Rajonale të Integrimit Ekonomik	187
Neni 27 – Organizata Rajonale e Integrimit Ekonomik si palë kontraktuese pa shtetet anëtare të saj.....	189
Neni 28 – Hyrja në fuqi	190
Neni 29 – Vendosja e marrëdhënieve në përputhje me Konventën	194
Neni 30 – Deklarimet	198
Neni 31 – Denoncimi.....	200
Neni 32 – Njoftimet nga Depozitari	201

PJESA I. PARATHËNIE

Miratimi i Konventës

1. Teksti i Konventës u hartua në sesionin e njëzetë e dytë të Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private (më poshtë, “KHDNP”) nga Komisioni I i saj për Vendimet Gjyqësore nga data 18 qershor deri në 2 korrik 2019. Akti përfundimtar u miratua nga Seanca Plenare më 2 korrik 2019 dhe Konventa u hap për nënshkrim në po atë datë.¹

Nëpunësit e sesionit njëzetë e dy

2. Nëpunësit në sesionin njëzetë e dy ishin: Kryetari, zoti Paul Vlas (Holanda); nënkryetarët, zoti Pieter André Stemmet (Afrika e Jugut), zoti Hong Xu (Republika Popullore e Kinës), zoti Andreas Stein (European Union), zoti Mikhail L. Galperin (Federata Ruse), zoti Paul Herrup (Shtetet e Bashkuara të Amerikës) dhe zoti Marcos Dotta Salgueiro (Uruguai); Kryetari i komisionit I për vendimet z. David Goddard (Zelanda e Re); nënkryetarët e komisionit I për vendimet gjyqësore, zoti Boni de M. Soares (Brazil), zonja Kathryn Sabo (Kanada), zonja Tonje Meinich (Norvegji) dhe zonja Elizabeth Pangalangan (Filipinet); *bashkëraportuesit*, zonja Geneviève Saumier (Kanada) dhe zoti Francisco Garcimartín (Spanjë); dhe Kryetari i Komitetit Hartues, zoti Fausto Pocar (Itali). Byroja e Përhershme, kryesuar nga zoti Christophe Bernasconi, Sekretar i Përgjithshëm, ofroi ndihmë gjatë gjithë sesionit.

Zanafilla e Konventës

3. Zanafilla e Konventës daton në vitin 1992 kur u bë një propozim për të punuar për hartimin e rregullave të njëjta si për juridiksionin e gjykatave, ashtu dhe për njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore në çështjet ndërgjyqësore për lëndë civile dhe tregtare. Progresi i bërë nga viti 1992 deri në 2001 ka rezultuar në një projekt Konventë për këto dy fusha.² Megjithatë, në përfundim të pjesës së parë të Sesionit të

¹ Uruguai është vendi i parë nënshkrues, pasi e ka nënshkruar Konventën në datën e miratimit të saj. Në kohën e shkrimit, Ukraina gjithashtu e nënshkroi Konventën më 4 mars 2020. Tabela e statusit të Konventës gjendet në faqen e internetit të KHDNP-së në < www.KHDNP.net > tek “Vendime gjyqësore”.

² “Projekti paraprak i Konventës për Juridiksionin e Vendimeve gjyqësore të huaja në lëndë civile dhe tregtare, miratuar nga komisioni i Posaçëm në bazë të raportit të Peter Nygh & Fausto Pocar”, Dok. paraprak, nr. 11 i gushtit 2000, hartuar në vëmendje të Sesionit të nëntëmbëdhjetë të qershorit 2001, në punimet e Sesionit të njëzetë, Vëllimi II, *Vendime gjyqësore*, Cambridge – Antwerp – Portland, Intersentia, 2013, f. 191-313 (më poshtë, “Raporti “Nygh/Pocar”). Raporti Nygh/Pocar gjendet në faqen e internetit të KHDNP-së në < www.KHDNP.net > tek “Vendime gjyqësore”.

Nëntëmbëdhjetë në 2001, nuk ishte arritur ende konsensus për një numër çështjesh të rëndësishme.³

4. Atëherë, KHDNP-ja vendosi të shqyrtonte veçan ato fusha për të cilat mund të arrihej një instrument me bazë konsensusi. Kjo shpuri në përgatitjen e një instrumenti më të ngushtë, i kufizuar në veçanti ekskluzive të marrëveshjeve midis gjykatave, duke përfshirë rregullat juridiksionale dhe një regjim për njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore. Kjo punë, e cila u bë nga viti 2002 deri në 2005, përfundoi me miratimin e Konventës *KHDNP të 30 qershorit 2005 për Marrëveshjen për Zgjedhjen e Gjykatave* (më poshtë, "KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatave"),⁴ e cila synonte të arrinte efikasitet në marrëveshjet për Zgjedhjen e Gjykatave në lëndë civile dhe tregtare. Ajo hyri në fuqi më 1 tetor 2015.⁵
5. Në vitin 2011, KHDNP-ja pranoi të rishqyrtonte realizueshmërinë e një instrumenti global për çështje që lidheshin me juridiksionin dhe njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore në lëndë civile dhe tregtare. Në prill 2012, një Grup Ekspertësh erdhi në përfundimin se duhej bërë një punë e mëtejshme lidhur me proceset gjyqësore ndërkufitare, me kusht që të përmbushnin nevojat reale dhe praktike që nuk plotësoheshin nga instrumentet ekzistuese dhe kornizat institucionale. Grupet e ekspertëve po ashtu përcaktuan se ishte thelbësore të bëhej punë e mëtejshme për të identifikuar hendeqet në kornizën ekzistuese për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkufitare me rëndësi praktike të veçantë. KHDNP-ja pastaj ra dakord që puna të vazhdonte dhe ngriti një Grup Pune për të përgatitur propozimet për njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore në lëndë civile dhe tregtare.⁶ Që nga viti 2013,

³ Shih, "Disa reflektime rreth gjendjes aktuale të negociatave për Projektin e Vendimeve gjyqësore në kuadër të Programit të punës së ardhshme të konferencës", Dok. paraprak nr. 16 i shkurtit 2002, tek *Punimet e Sesionit të nëntëmbëdhjetë, Vëllimi I, Miscellaneous affairs (Çështje të ndryshme)* Koninklijke Brill NV, 2008, f. 429 dhe 431, para. 5.

⁴ Më shumë informacion rreth zanafillës së KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës, gjendet në "Raportin shpjegues nga Trevor Hartley dhe Masato Dogauchi" (më poshtë "Raporti Hartley/Dogauchi"). Shih, Punimet e Sesionit të njëzetë, Vëllimi III, *Marrëveshje për Zgjedhjen e Gjykatës – Marrëveshjet për Zgjedhjen e Gjykatave*, Antwerp – Oxford – Portland, Intersentia, 2010, f. 785 dhe 787. Raporti Hartley/Dogauchi gjendet në faqen e internetit të KHDNP-së në < www.KHDNP.net > tek "Choice of Court – Zgjedhja e gjykatës".

⁵ Në kohën e shkrimit, Meksika, Bashkimi Evropian, Singapori dhe Mali i Zi, janë Palë kontraktuese të Konventës. Konventa u nënshkrua gjithashtu edhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës më 19 janar 2009, nga Ukraina më 21 mars 2016, nga Republika Popullore e Kinës më 12 shtator 2017 dhe nga Republika e Maqedonisë së Veriut më 9 dhjetor 2019. Tabela e statusit të Konventës gjendet në faqen e internetit të KHDNP < www.KHDNP.net > tek "Zgjedhja e Seksionit të gjykatës".

⁶ KHDNP-ja gjithashtu ngriti një Grup ekspertësh për të studiuar dhe diskutuar më tej nevojën dhe realizueshmërinë e përfshirjes së parashikimeve në lidhje me juridiksionin. Në shkurt 2013, Grupi i Punës dhe Grupi i Ekspertëve u mblodhën secili në Hagë ku vendosën të shqyrtonin nëse puna e Grupit të Ekspertëve për juridiksionin dhe e Grupit të Punës për njohjen dhe zbatimin e vendimeve mund të ecnin njëkohësisht. Pas diskutimeve të zgjeruara, u rekomandua që veprimtaria e Grupit të Punës duhet të avancohet më shpejt dhe që diskutimet e Grupit të Ekspertëve duhej të rifillojnë një fazë të mëvonshme. Grupi i Ekspertëve u mblodh për herë të tretë nga data 18 dhe 21 shkurt 2020 dhe rekomandoi që Këshilli për Çështjet e Përgjithshme dhe të Politikave i KHDNP-së (më poshtë, "KÇPP-ja") të vazhdonte punën. Në takimin e tij në 2020, KÇPP-ja caktoi dy takime të tjera të Grupit të Ekspertëve që do të mbaheshin përpara takimit të KÇPP-së të vitit 2021.

Grupi i Punës u mbledh pesë herë për të përgatitur një projekt tekst me dispozitat bazë për lehtësimin e qarkullimit global të vendimeve gjyqësore.

6. Grupi i Punës e përfundoi punën e tij për projekt tekstin e propozuar të një Konvente për njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore në lëndë civile dhe tregtare në takimin e tij të pestë, në tetor 2015. KHDNP-ja pastaj thirri katër takime të Komisionit të Posaçëm për të çuar përpara punën për këtë projekt Konventë. Takimi i parë u bë në qershor 2016 dhe doli me një projekt Konventë paraprake 2016, e cila u botua si Dokument pune nr. 76, i rishikuar.⁷ Në Takimin e Dytë në shkurt 2017, Komisioni i Posaçëm i rishqyrtoi të gjitha dispozitat e Projekt Konventës paraprake të 2016 dhe diskutoi klauzolat e përgjithshme dhe përfundimtare, duke nxjerrë një projekt konventë të rishikuar (më poshtë “Projekt Konventa e shkurtit 2017”), botuar si Dokument pune nr. 170, i rishikuar.⁸ Në Takimin e Tretë të tij në nëntor 2017, Komisioni i Posaçëm rishikoi dhe diskutoi çështjet në kllapa katrore të pasqyruara në Kapitujt I dhe II të projekt Konventës së shkurtit 2017, duke përfshirë një diskutim të hollësishëm mbi çështje të lidhura me pronësinë intelektuale dhe klauzolat e përgjithshme dhe të fundit. Ky takim doli me një projekt të rishikuar të Konventës (më poshtë, “Projekt Konventa e nëntorit 2017”), botuar si Dokument pune nr. 236, i rishikuar.⁹ Në maj 2018, Komisioni i Posaçëm u takua për herë të katërt për të diskutuar çështjet që dolën nga Takimi i Tretë, duke dalë me projekt Konventën e 2018-s (më poshtë, Projekt Konventa 2018”), e cila u botua si Dokument pune nr. 262, i rishikuar.¹⁰ Projekt Konventa 2018 ishte baza e tekstit të shqyrtuar në sesionin njëzetë e dy të qershorit dhe korrikut 2019, ku u miratua teksti përfundimtar i Konventës më 2 korrik 2019.¹¹

Falënderime

7. Ky Raport shpjegues (më poshtë, “Raporti”) u përgatit nga Francisco Garcimartín¹² dhe Geneviève Saumier,¹³ bashkëraportuesit e caktuar nga Takimi i Parë i Komisionit të Posaçëm. Qëllimi i Raportit është të ndihmojë në interpretimin e Konventës në dritën e karakterit ndërkombëtar të saj dhe nevojës për promovimin e ekzekutimit të njëtrajtshëm të saj në praktikë, duke dhënë një shpjegim për

⁷ Dok. pune nr. 76, Rishikuar në qershor 2016, i “Projekt Konventës paraprake 2016” të qershorit 2016 (Komisioni i Posaçëm për Njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja gjyqësore (1-9 qershor 2016)).

⁸ Dok. pune nr. 170, Rishikuar në shkurt 2017, i “Projekt Konventës së shkurtit 2017” (Komisioni i Posaçëm për Njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja gjyqësore (16-24 shkurt 2017)).

⁹ Dok. pune nr. 236, Rishikuar në nëntor 2017, i “Projekt Konventës së nëntorit 2017” (Komisioni i Posaçëm për Njohjen dhe zbatimin e Vendimeve të Huaja Gjyqësore (13-17 nëntor 2017)).

¹⁰ Dok. pune nr. 262, rishikim i majit 2018, “Projekt Konventa e 2018” (Komisioni i Posaçëm për Njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja gjyqësore (24-29 maj 2018)).

¹¹ Të gjitha dokumentet e lidhura me Konventën gjenden në faqen e internetit të KHDNP-së < www.KHDNP.net > tek “Vendimet gjyqësore”.

¹² Profesor, Universidad Autónoma de Madrid (Spanjë).

¹³ Profesor dhe kryetari Peter M. Laing, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti McGill (Kanada).

secilën prej dispozitave dhe shembujve të saj, sipas rastit.¹⁴ *Bashkëraportuesit* janë përpjekur të pasqyrojnë diskutimet dhe, sipas rastit, konsensusin e arritur gjatë Komisionit I për Vendimet gjyqësore të Sesionit të njëzetëedytë të vitit 2019. Kur dispozitat nuk diskutohen shprehimisht në Komision, Raporti përpiqet të pasqyrojë diskutimet e mbajtura dhe, sipas rastit, konsensusin e arritur gjatë takimeve të mëparshme të Komisionit të Posaçëm.¹⁵ Formulimi i Raportit nisi pas përfundimit të takimit të parë të Komisionit të Posaçëm. Delegacionet u ftuan të shqyrtojnë Raportin në faza të ndryshme të hartimit të tij. *Bashkëraportuesit* u përpoqën të merrnin në konsideratë mendimet e delegacioneve përpara se t'i jepnin Raportit dorën e fundit dhe përpara se t'ua dorëzonin atë delegacioneve për procedurën e miratimit të heshtur. Ndryshe nga teksti i Konventës, Raporti nuk ka natyrë detyruese.

8. *Bashkë-raportuesit* dëshirojnë t'i shprehin falënderimet e tyre të singërta zonjës Ning Zhao, punonjëse e lartë ligjore në Byronë e Përhershme të KHDNP-së, për kontributin e saj të pazëvendësueshëm në punën e tyre. Gjithashtu, ata duan të shprehin mirënjohjen e tyre për mbështetjen e dhënë nga zonja Marta Pertegás (ish anëtare e Byrosë së Përhershme; Sekretare e Parë gjatë Takimit të parë dhe të dytë të Komisionit të Posaçëm) dhe zotit João Ribeiro-Bidaoui (Sekretar i parë që nga Sesioni njëzetë e dy). Një falënderim të veçantë i shprehin gjithashtu edhe zonjës Lydie de Loof, formuluese grafike/nëpunëse e botimeve në Byronë e Përhershme të KHDNP-së, për kontributin e saj të jashtëzakonshëm në versionin në frëngjisht të këtij Raporti. Së fundi, ata dëshirojnë të falënderojnë delegacionet për komentet e bëra për projektet e mëparshme të Raportit. Këto komente kanë qenë një ndihmë e madhe dhe kanë kontribuar ndjeshëm në versionin e fundit.

Terminologjia

Terminologjia e mëposhtme është përdorur në Konventë:

“Gjykata e origjinës”: gjykata e cila ka dhënë vendimin;

“Shteti i origjinës”: shteti në të cilën është vendosur gjykata e origjinës;

“Gjykata e kërkuar”: gjykata të cilës i kërkohet të njohë apo zbatojë vendimin gjyqësor;

“Shteti i kërkuar”: shteti ku ndodhet gjykata të cilës i drejtohet.

¹⁴ Shih, Neni 32 i Konventës së Vjenës së 23 majit 1969 për *Të drejtën e Traktateve* (më poshtë, “Konventa e Vjenës e vitit 1969”).

¹⁵ Në ato të pakta raste kur disa çështje interpretimi nuk janë trajtuar shprehimisht qoftë në Komisionin e Posaçëm apo në komisionin për Vendimet gjyqësore të Sesionit të njëzetëedytë, bashkëraportuesit e kanë vënë këtë në dukje.

Struktura e Raportit

9. Raporti ka tri pjesë, duke përfshirë pjesën aktuale (Pjesa I). Pjesa II (“Vështrim i përgjithshëm”) shpjegon qëllimin, ndërtimin dhe strukturën e Konventës, duke theksuar funksionin e dispozitave të ndryshme dhe mënyrën se si ato lidhen me njëra tjetrën. Pjesa III (“Komenti nen për nen”) analizon secilin nen më vete për të sqaruar kuptimin e tij.

Shembuj

10. Në shembujt e dhënë, supozohet (përveç se kur deklarohet e kundërta) se Konventa është në fuqi dhe se Shtetet e përmendura janë palë në të.

PJESA II. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM – Fusha e veprimit, ndërtimi dhe përshkrimi i Konventës

11. Konventa është një instrument i të drejtës ndërkombëtare private për lëndë civile dhe tregtare. Ajo trajton një nga tri fushat klasike të së drejtës ndërkombëtare private, konkretisht, njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja gjyqësore. Duke bërë këtë, ajo avancohet nga qëllimet kryesore të së drejtës ndërkombëtare private: bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar, me idenë e rritjes së parashikueshmërisë dhe drejtësisë në marrëdhëniet juridike ndërkufitare në lëndët civile apo tregtare. Konventa nuk trajton dy fushat e tjera tradicionale të së drejtës ndërkombëtare private, që lidhen me juridiksionin e gjykatës për të gjykuar mosmarrëveshje në çështje ndërkufitare dhe rregullat që përcaktojnë ligjin e zbatueshëm në rastin e çështjeve të tilla. Këto çështje nuk preken nga Konventa.
12. **Fusha e veprimit.** Kjo Konventë kërkon të promovojë qasjen në drejtësi në shkallë globale nëpërmjet rritjes së bashkëpunimit gjyqësor, që do të pakësojë risqet dhe kostot e lidhura me marrëdhëniet juridike ndërkufitare dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Si rrjedhojë, zbatimi i Konventës duhet të lehtësojë tregtinë shumëpalëshe të bazuar në rregulla, si dhe investimet dhe lëvizshmërinë.
13. Këto qëllime do të avancohen në një numër mënyrash.
14. Së pari dhe më e rëndësishmja, Konventa ofron një kuadër për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja gjyqësore në të gjitha Shtetet kontraktuese (“Shtetet”),¹⁶ duke rritur kështu efektivitetin në praktikë të këtyre vendimeve gjyqësore. Qasja në drejtësi dështon kur një palë e dëmtuar merr një vendim i cili nuk mund të zbatohet në praktikë për shkak se pala tjetër apo pasuritë e palës tjetër janë në një Shtet ku vendimi nuk është lehtësisht i zbatueshëm.
15. Së dyti, Konventa do ta pakësojë nevojën për përsëritjen e procesit në dy a më shumë Shtete; një vendim që përcakton një të drejtë në një Shtet, do të jetë efektiv në Shtete të tjera, pa pasur nevojë të rigjykohet themeli i kërkesë padisë.
16. Së treti, Konventa do të ulë kostot dhe kohën e përfutimit të njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore; qasja në drejtësi në praktikë do të jetë më e shpejtë dhe me kosto më të pakët.
17. Së katërti, Konventa do të përmirësojë parashikueshmërinë e ligjit; individët dhe bizneset¹⁷ do të jenë në gjendje të përcaktojnë më me lehtësi rrethanat në të cilat vendimet gjyqësore do të qarkullojnë midis Shteteve.

¹⁶ Për thjeshtësi, termi “Shtete” përdoret në këtë Raport për t’iu referuar “Shteteve kontraktuese”. Dallimi midis Shteteve kontraktuese dhe jo kontraktuese është bërë kur është me rëndësi.

¹⁷ Versioni në anglisht përdor “biznese” ndërsa versioni në frëngjisht përdor “professionnel” si emër dhe mbiemër.

18. Së pesti, ajo do t'u mundësojë kërkuesve të bëjnë zgjedhje të informuara për vendin ku duan ta sjellin procesin, duke marrë parasysh mundësitë për ekzekutimin e vendimit që do të marrë në Shtete të tjera dhe nevojën për të siguruar drejtësi për të paditurit.
19. Në një botë të globalizuar dhe të ndërlidhur, me një rritje të vazhdueshme të lëvizjes së njerëzve, informacionit dhe pasurive nga një kufi në tjetrin, rëndësia praktike e arritjes së këtyre qëllimeve është e vetëkuptueshme. Potenciali i Konventës për t'i arritur këto qëllime është i madh.
20. **Lidhja me Konventën e 2005-s për Zgjedhjen e Gjykatës.** KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës, ndjek të njëjtat objektiva, duke u mundësuar palëve të bien dakord për gjykatën që do të dëgjojë kërkesat e tyre dhe parashikimin e njohjes dhe ekzekutimit të një vendimi të dhënë nga gjykata e zgjedhur.¹⁸ Por, në shumë raste, nuk ka një zgjedhje ekskluzive të gjykatës së rënë dakord midis palëve në një mosmarrëveshje. Kjo Konventë kërkon të rrisë përfitimet e një qasjeje më të madhe në drejtësi dhe të uljes së kostove dhe risqeve në marrëdhëniet ndërkufitare, duke përfshirë një gamë më të gjerë çështjesh gjyqësore. Ajo synon të plotësojë KHDNP-në e 2005 për Zgjedhjen e Gjykatës.
21. **Përshkrimi.** Konventa është hartuar me qëllimin për të ofruar një sistem efektiv dhe efikas për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja gjyqësore në lëndë civile apo tregtare në rrethana kryesisht të padiskutueshme. Konventa parashikon njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore që plotësojnë kërkesa të caktuara (nenet 5 dhe 6) dhe përcakton shkaqet kur njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të tilla gjyqësore mund të refuzohet (neni 7).¹⁹ Për të lehtësuar qarkullimin e vendimeve gjyqësore, teksti i saj nuk i pengon Shtetet të njohin dhe ekzekutojnë vendimet gjyqësore në bazë të ligjeve të tyre të brendshme apo traktateve të tjera (nenet 15, 23), duke iu nënshtruar bazës ekskluzive për njohje dhe zbatim (Neni 6).
22. **Ndërtimi.** Konventa ndahet në katër kapituj. Kapitulli I trajton fushën e veprimit dhe përkufizimet. Fusha e veprimit të Konventës përfshin vendimet gjyqësore për lëndë civile apo tregtare (Neni 1), por përjashton disa çështje të caktuara nga fusha e veprimit të saj (Neni 2) ose për shkak se mbulohen nga instrumente të tjera, ose sepse konsensusi shumëpalësh për to nuk mund të arrihet me lehtësi. Neni 3 përcakton "vendimin gjyqësor" dhe "të paditurin", dhe se kur një person juridik konsiderohet se është banor me vendqëndrim të rregullt në një Shtet.
23. Kapitulli II përbën thelbin e Konventës. Neni i parë i tij përcakton parimin e përgjithshëm të qarkullimit të vendimeve gjyqësore midis Shteteve (Neni 4). Një

¹⁸ Më shumë informacion për KHDNP-në e 2005 për Zgjedhjen e Gjykatës gjendet në faqen e internetit të KHDNP-së. < www.KHDNP.net > tek "Zgjedhja e gjykatës".

¹⁹ Duhet pasur parasysh se teksti i Konventës zakonisht përdor shprehjen "njohja apo zbatimi" kur i referohet detyrimit pozitiv të parashikuar në nenin 4 dhe shprehjen "njohja apo zbatimi" kur i referohet mundësisë për të refuzuar përmbushjen e këtij detyrimi, p.sh., sipas nenit 7. Raporti shpjegues ndjek atë formulim, sipas rastit.

vendim gjyqësor i dhënë nga gjykata e një Shteti do të njihet dhe zbatohet në një Shtet tjetër në përputhje me dispozitat e Kapitullit II. Kriteri kryesor për qarkullim parashikohet në Nenin 5, i cili përcakton bazat për njohjen dhe zbatimin e një vendimi gjyqësor në formën e filtrave juridiksionalë përkundrejt të cilëve vendimi gjyqësor i një shteti të origjinës do të vlerësohet nga Shteti në të cilin kërkohet njohja apo zbatimi i atij vendimi. Këto shkaqe kufizohen vetëm nga filtri ekskluziv i Nenit 6. Kur një vendim gjyqësor plotëson kërkesat e neneve 4, 5 dhe 6, shkaqet për refuzimin e njohjes apo zbatimit të tij jepen në nenin 7.²⁰ Ky nen përcakton një listë shteruese të shkaqeve për refuzim të cilët lejojnë, por nuk kërkojnë, që Shteti i kërkuar të refuzojë njohjen apo zbatimin. Është me dobi të vihet në dukje menjëherë neni 15, i cili i rezervon të drejtën një Shteti të kërkuar për të njohur vendimet e huaja gjyqësore në bazë të ligjit të brendshëm (në varësi të nenit 6).

24. Kapitulli II gjithashtu trajton çështje specifike të interpretimit dhe zbatimit: çështje paraprake (Neni 8), veçimi (neni 9), dëmshpërblimi, përfshirë dëmshpërblimin ndëshkues (Neni 10), dhe marrëveshjet gjyqësore (Neni 11). Së fundmi, Kapitulli II trajton çështje procedurale për të lehtësuar qasjen në mekanizmin e Konventës: dokumentet që duhen paraqitur (Neni 12), procedurën (Neni 13) dhe kostot e procedurës gjyqësore (Neni 14).
25. Kapitulli III trajton klauzola të përgjithshme: dispozitat kalimtare (Neni 16), deklarime të lejueshme (nenet 17-19), interpretimi i njëjtë (Neni 20), sistemet ligjore të paunifikuara (Neni 22) dhe marrëdhënia me instrumentet e tjera (Neni 23).
26. Kapitulli IV jep klauzolat e fundit për procesin e bërjes Palë në Konventë (nenet 24-27), hyrja në fuqi (Neni 28), vendosja e marrëdhënieve të traktatit (Neni 29), procedura e deklarimeve (Neni 30), denoncimi (Neni 31) dhe njoftimet (Neni 32).

²⁰ Duhet të kihet parasysh se nenet 8(2) dhe 10 gjithashtu parashikojnë shkaqet për refuzim në rrethana specifike.

PJESA III. KOMENTE NEN PËR NEN

KAPITULLI I – FUSHA E VEPRIMIT DHE PËRKUFIZIMET

Neni 1

Fusha e veprimit

1. Kjo Konventë zbatohet për njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore në çështjet civile ose tregtare. Fusha e veprimit të saj nuk shtrihet në mënyrë të veçantë tek çështjet e të ardhurave, çështjet doganore ose çështjet administrative.
2. Kjo Konventë zbatohet për njohjen dhe zbatimin në një shtet palë të kësaj Konvente të vendimit gjyqësor të dhënë nga gjykata e një tjetër shteti palë.

27. Neni 1 trajton fushën e veprimit të Konventës, duke e përkufizuar atë në terma materiale dhe gjeografike. Paragrafi 1 përcakton fushën e veprimit material, duke parashikuar se Konventa përdoret për njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore në lëndë civile apo tregtare. Kjo dispozitë duhet lexuar së bashku me nenin 2(1), i cili i përjashton disa çështje të caktuara. (Shih gjithashtu nenet 18 dhe 19, të cilët i lejojnë Shtetet të bëjnë deklarime që kufizojnë fushën e veprimit të përdorimit të Konventës.) Paragrafi 2 trajton zbatimin gjeografik apo territorial të Konventës, duke parashikuar që ajo zbatohet për njohjen apo zbatimin nga një Shtet të një vendimi gjyqësor të dhënë nga gjykata e një Shteti tjetër.

Paragrafi 1 – Kjo Konventë zbatohet për njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore në çështjet civile ose tregtare. Fusha e veprimit të saj nuk shtrihet në mënyrë të veçantë tek çështjet e të ardhurave, çështjet doganore ose çështjet administrative

28. **Lëndët civile apo tregtare.** Konventa zbatohet për vendime gjyqësore në lëndë civile apo tregtare. Ajo nuk mbulon, në veçanti, lëndët që lidhen me të ardhurat, doganat apo çështjet administrative. Nëse një vendim gjyqësor lidhet me lëndë civile apo tregtare, kjo përcaktohet nga natyra e kërkesës apo padisë që i nënshtrohet vendimit gjyqësor. Natyra e gjykatës së Shtetit të origjinës ose thjesht fakti që një Shtet ka qenë palë në një proces nuk është faktor përcaktues.

29. Konventa zbatohet cilado qoftë natyra e gjykatës, *pra*, pavarësisht nga fakti nëse padia civile apo tregtare është sjellë përpara një gjykate civile, penale, administrative apo të punës.²¹ Kështu, për shembull, Konventa zbatohet në rastin e një vendimi gjyqësor për padi civile të ngritura përpara një gjykate penale kur gjykata ka juridiksion të dëgjojë lëndën sipas të drejtës së saj procedurale.
30. Zbatimi i Konventës nuk ndikohet nga natyra e palëve, *pra*, nga personat juridikë apo fizikë, privatë apo publikë. Sikurse tregohet në nenin 2(4), një vendim gjyqësor nuk përjashtohet nga fusha e veprimit të Konventës për faktin e thjeshtë se një Shtet – duke përfshirë edhe një qeveri, një agjenci shtetërore apo çdo person që vepron në emër të një Shteti – ka qenë palë në proces në Shtetin e origjinës (shih *infra*, komentari për nenin 2(4)).
31. Gjithashtu, përshkrimi i një padie nuk ndikohet thjesht nga fakti që kërkesa i transferohet një personi tjetër përmes transferimit, trashëgimisë, apo marrjes përsipër të detyrimit nga një person tjetër. Transferimi i një kërkesë nga një organ privat tek një Shtet nuk e përjashton një kërkesë padi nga të qenit civile apo tregtare. E njëjta gjë mund të thuhet edhe në rastet e zëvendësimit, *pra*, kur një agjenci shtetërore merr përsipër të drejtat e një pale private.
32. **Kuptimi autonom.** Konventa kërkon që gjykatat e Shtetit të kërkuar të vendosin nëse një vendim gjyqësor ka të bëjë me lëndë civile apo tregtare. Në bërjen e një përcaktimi të tillë, gjykatat duhet të marrin parasysh nevojën për të nxitur uniformitetin në ekzekutimin e Konventës. Po ashtu, koncepti i “lëndës civile apo tregtare”, sikundër çdo koncept tjetër juridik i përdorur në Konventë, duhet të përcaktohet në mënyrë autonome, *pra*, duke iu referuar fushës së veprimit të Konventës dhe karakterit ndërkombëtar të saj dhe jo duke iu referuar ligjit të brendshëm.²² Kjo kërkesë mbështet interpretimin dhe zbatimin uniform të Konventës (shih, *infra*, nenin 20). Gjithashtu, interpretimi i këtyre termave duhet të përdoret në mënyrë konsekuente në të gjitha instrumentet e tjera të KHDNP-së, në veçanti në KHDNP-në 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës.
33. Përdorimi i termave lëndë “civile” dhe “tregtare” bëhet kryesisht për ato sisteme ligjore kur termat “civile” dhe “tregtare” konsiderohen si kategori të veçanta dhe reciprokisht përjashtuese, ndonëse përdorimi i të dy termave nuk është i papajtueshëm me sistemet ligjore ku proceset tregtare janë një nënkategori e proceseve gjyqësore.²³ Ndonëse instrumente të tjera ndërkombëtare i kanë përdorur termat “lëndë civile dhe tregtare”,²⁴ Konventa ndjek KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës,

²¹ Shih “Shënim për nenin 1(1) të projekt Konventës paraprake të vitit 2016 dhe termin “lëndë civile apo tregtare”, hartuar nga *bashkë-raportuesit* e projekt Konventës dhe Byroja e Përhershme, Dok. paraprak nr. 4 i dhjetorit 2016 në vëmendje të Komisionit të Posaçëm, shkurt 2017 për njohjen apo zbatimin e vendimeve të huaja gjyqësore (më poshtë, “Dok. Paraprak nr. 4 i dhjetorit 2016”), para. 6.

²² Raporti Hartley/Dogauchi para. 49; Dok. paraprak nr. 4 i dhjetorit 2016, para. 5.

²³ Raporti Hartley/Dogauch, para. 49.

²⁴ Shih, Rregulloren (BE) nr. 1215/2012 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 12 dhjetorit 2012 për juridiksion dhe njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore në lëndë civile dhe tregtare (më poshtë,

dhe u referohet “lëndëve civile apo tregtare”. Të dyja këto alternativa duhet të konsiderohen të ndërkëmbeshme.

34. Koncepti i “lëndëve civile apo tregtare” përdoret në situata të ndryshme ku Shteti vepron në cilësinë e tij sovranë.²⁵ Ndryshe nga Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës e vitit 2005, Neni 1(1) sqaron se Konventa nuk përdoret, “[...] në veçanti, për të ardhurat, doganat apo për çështje administrative”. Kjo renditje nuk është shteruese dhe fushat e tjera të së drejtës publike, për shembull, lëndët kushtetuese dhe penale sigurisht përjashtohen nga fusha e veprimit të Konventës. Rënditja synon të lehtësojë zbatimin e Konventës në Shtetet kur nuk ka ndonjë dallim të përcaktuar midis të drejtës private dhe publike.²⁶ Termat e reja të përfshira në këtë Konventë nuk kanë për qëllim që të merren si largime nga KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës; të dy instrumentet duhet të interpretohen në të njëjtën mënyrë.
35. Një element kyç që dallon lëndët “civile ose tregtare” të së drejtës publike është nëse njëra nga palët ushtron të drejta qeverisëse apo sovranë që nuk i gëzojnë personat e zakonshëm.²⁷ Si rrjedhojë, është e nevojshme të identifikohet marrëdhënia juridike midis palëve në një mosmarrëveshje dhe të hulumtohet baza ligjore e padisë së ngritur përpara një gjykate të origjinës, për të përcaktuar nëse vendimi gjyqësor ka të bëjë me lëndë civile apo tregtare. Nëse aktpadia buron nga ushtrimi i të drejtave publike (duke përfshirë të drejta apo detyra rregullatore), Konventa nuk zbatohet. Një shembull tipik i së drejtës publike është aftësia për të ekzekutuar një kërkesëpadi me anë të një procesi administrativ, pa kërkuar veprimin e gjykatës. Kështu, për shembull, Konventa nuk zbatohet për urdhra të dhënë nga qeveritë apo agjencitë shtetërore si autoritetet shëndetësore apo të sigurisë, apo të mbikëqyrjes financiare, të cilat kërkojnë të sigurojnë përputhshmëri apo të parandalojnë mosrespektimin e kërkesave rregullatore.²⁸ Gjithashtu, ajo nuk zbatohet as për vendime gjyqësore lidhur me aktpadi që bëhen qoftë për të ekzekutuar apo për të apeluar urdhra të tillë. Konventa nuk zbatohet për padi të ngritura kundër zyrtarëve²⁹ që veprojnë në emër të Shtetit, apo që janë përgjegjës

“Brussels la Regulation” (“Brussels Rregullorja”), Neni 1.

²⁵ Raporti Hartley/Dogauch, para. 49; Dok. par. nr. 4 i dhjetorit 2016, para. 40.

²⁶ Shih, Raporti Nygh/Pocar, para. 23: “[...] shprehjet “lëndë civile” ose “e drejta civile” nuk janë terma teknike në vendet e të drejtës zakonore si Anglia dhe Republika e Irlandës dhe mund të kenë më shumë se një kuptim. Në një kuptim më të gjerë, ato përjashtojnë vetëm të drejtën penale. Në këtë bazë, e drejta kushtetuese, e drejta administrative dhe e drejta tatimore përfshihen në përshkrimin e “lëndëve civile”. Sigurisht ky nuk është qëllimi i projekt Konventës paraprake, e cila në fjalinë e dytë të paragrafit 1 shpjegon se si çështjet e të ardhurave, doganave ose ato me natyrë administrative nuk duhen konsideruar se futen në fushën e veprimit të “lëndëve civile dhe tregtare” (shënimet janë hequr). Ky sqarim u konsiderua i nevojshëm në KHDNP, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës e 2005: shih Raporti Hartley/Dogauch, para. 49, shënimi 73.

²⁷ Raporti Hartley/Dogauch, para. 85; Dok. paraprak nr. 4 i dhjetorit 2016, para. 40. Termat “të drejta sovranë”, “të drejta shtetërore” dhe “të drejtat publike” duhen konsideruar të barasvlershme për qëllimet e këtij raporti (Shih gjithashtu *infra*, para. 83 për një shtjellim të mëtejshëm të këtyre termave).

²⁸ Dok. paraprak nr. 4 i dhjetorit 2016, para. 41.

²⁹ Referencat ndaj “zyrtarëve” në këtë Raport u referohen si zyrtarëve aktualë, ashtu edhe atyre të

për akte të autoriteteve publike, duke përfshirë akte të zyrtarëve të emëruar publikisht që veprojnë në këtë cilësi.

36. Lëndët kriminale apo penale zakonisht janë shembuj që përfshijnë ushtrimin e kompetencave publike, të cilat si rrjedhojë përjashtohen nga fusha e veprimit të Konventës. Ky përjashtim mbulon ato padi përmes të cilave një Shtet apo autoritet publik kërkon të ndëshkojë një person për sjellje të parashikuar nga e drejta penale, duke përfshirë sanksione pasurore (por, shih *supra*, para. 29).
37. Nga ana tjetër, nëse asnjëra nga palët nuk ushtron kompetenca publike, Konventa zbatohet. Për shembull, ajo zbatohet për padi private për dëm të shkaktuar nga sjellja e pa përjashtuar anti-konkurrencë (shih *infra*, para. 69).³⁰ Në të njëjtën mënyrë, kur një agjenci shtetërore vepron në emër të palëve private të tilla si konsumatorët apo investitorët dhe nuk ushtron kompetenca shtetërore apo sovraane, Konventa zbatohet (shih *infra*, komentari për nenin 2(4)).
38. **Bashkimi i padive.** Parimi i veçimit zbatohet kur një vendim gjyqësor përfshin më shumë se një padi, një prej të cilave është “civile ose tregtare” dhe një tjetër që nuk është e tillë (shih *infra*, Neni 9). Konventa zbatohet vetëm për padi civile ose tregtare dhe jo për të tjera.

Paragrafi 2 – Kjo Konventë zbatohet për njohjen dhe zbatimin në një shtet palë të kësaj Konvente të vendimit gjyqësor të dhënë nga gjykata e një tjetër shteti palë

39. Paragrafi 2 përcakton zbatimin gjeografik apo territorial të Konventës: ai zbatohet për njohjen apo zbatimin në një Shtet të një vendimi gjyqësor dhënë nga një gjykatë e një Shteti tjetër. Sikundër Shteti i origjinës, që është Shteti në të cilin gjykata që jep vendimin ndodhet, edhe Shteti i kërkuar, duke qenë Shteti ku njohja apo ekzekutimi i atij vendimi kërkohet, duhet të jenë palë në Konventë (Neni 4(1)). Kjo dispozitë duhet lexuar me nenin 22 (“Sisteme ligjore të pa unifikuara”), dhe në veçanti, me nenin 29 (“Vendosja e marrëdhënieve në përputhje me Konventën”): Konventa zbatohet nëse si Shteti i origjinës, ashtu dhe Shteti i kërkuar janë palë të Konventës, dhe nëse asnjëri prej tyre nuk ka kundërshtuar vendosjen e marrëdhënieve me tjetrin sipas kësaj dispozite, *pra*, nëse Konventa ka efekt midis tyre.
40. **Koha përkatëse.** Koha përkatëse është data kur fillon procesi në Shtetin e origjinës. Konventa duhet të ketë efekt midis Shtetit të kërkuar dhe Shtetit të origjinës në atë moment, me qëllim që të zbatohet (shih *infra*, Neni 16).

mëparshëm.

³⁰ Dok. paraparak nr. 4 i dhjetorit 2016, para. 41.

41. **Përkufizimi i kohës kur fillon procesi.** Ndonëse Konventa i referohet “kohës kur fillon procesi” në disa dispozita (p.sh., Neni 5 (1)(k) ose 16), ajo nuk e përcakton këtë koncept. Nisja e procedurës fokusohet në përfundimin e aktit të parë procedural, i cili bëhet shkak për fillimin e procesit në Shtetin e origjinës, pra, depozitimi i dokumentit që bëhet shkas për nisjen e procesit në gjykatë, ose nëse ai dokument duhet të dorëzohet përpara depozitimit të padisë, marrja e tij nga autoriteti përgjegjës për shërbimin.³¹

³¹ Kjo përputhet me parimin e parashikueshmërisë së deklaruar në para. 17, 18 dhe 328.

Neni 2***Përfshirjet nga fusha e veprimit***

1. Kjo Konventë nuk zbatohet për çështjet e mëposhtme:
 - (a) statusi dhe zotësia juridike e personave fizikë;
 - (b) detyrimet e mbajtjes;
 - (c) çështjet e tjera të së drejtës familjare, përfshirë regjimet pasurore martesore dhe të drejtat ose detyrimet e tjera, që lindin nga martesa apo marrëdhëniet e ngjashme;
 - (d) testamentet dhe trashëgimia;
 - (e) paaftësia pague, përbërja, vendimet e institucioneve financiare në rast procesi falimenti të menjëhershëm dhe çështjet e ngjashme;
 - (f) transporti i udhëtarëve dhe i mallrave;
 - (g) ndotja detare ndërkufitare, ndotja detare në zonat përtej juridiksionit kombëtar, ndotja detare nga anijet, kufizimi i përgjegjësisë për pretendimet detare dhe mesatarja e përgjithshme;
 - (h) përgjegjësia për dëmet bërthamore;
 - (i) vlefshmëria, pavlefshmëria, shpërbërja e personave juridikë ose e shoqatave të personave fizikë ose juridikë, si dhe vlefshmëria e vendimeve të organeve të tyre;
 - (j) vlefshmëria e regjistrimeve në regjistrat publikë;
 - (k) shpifja;
 - (l) privatësia;
 - (m) pronësia intelektuale;
 - (n) veprimtaritë e forcave të armatosura, përfshirë veprimtaritë e personelit të tyre gjatë ushtrimit të detyrave të tyre zyrtare;
 - (o) veprimtaritë ligjzbatuese, përfshirë veprimtaritë e personelit ligjzbatues gjatë ushtrimit të detyrave të tyre zyrtare;
 - (p) çështjet anti-trust (çështjet e konkurrencës), përveç rasteve kur vendimi gjyqësor bazohet në veprime që përbëjnë marrëveshje kundër-konkurrese ose praktikë të bashkërenduar mes konkurrentëve aktualë ose potencialë për të përcaktuar çmimet, për të bërë oferta të manipuluar, për të vendosur kufizime të produkteve ose kuota, ose për të ndarë tregjet duke caktuar konsumatorët, furnitorët, territoret ose linjat e tregtisë, dhe kur edhe këto veprime edhe efekti i tyre kanë ndodhur në shtetin e origjinës;

(q) restrukturimi i borxhit shtetëror nëpërmjet masave të njëanshme të shtetit.

- 2. Vendimi gjyqësor nuk përjashtohet nga fusha e veprimit të kësaj Konvente, kur një çështje për të cilën kjo Konventë nuk zbatohet, është ngritur thjesht si pyetje paraprake gjatë procedurës që çoi në vendimin gjyqësor, dhe jo si objekt i procedurës. Në veçanti, vetë fakti që një çështje e tillë është ngritur nga mbrojtja, nuk e përjashton vendimin gjyqësor nga Konventa, nëse kjo çështje nuk ka qenë objekt i procedimit.**
- 3. Kjo Konventë nuk zbatohet në rastin e arbitrazhit dhe procedimeve përkatëse.**
- 4. Vendimi gjyqësor nuk përjashtohet nga fusha e veprimit të kësaj Konvente për faktin e thjeshtë se shteti, ku përfshihet qeveria, agjencia qeveritare ose çdo person që vepron për shtetin, ka qenë palë në procedim.**
- 5. Asgjë në këtë Konventë nuk prek privilegjet dhe imunitetet e shteteve ose organizatave ndërkombëtare, në lidhje me to dhe pronën e tyre.**

42. Neni 2 e shtjellon më tej në fushën e veprimit të Konventës të parashikuar në nenin 1(1). Së pari, ai përjashton disa çështje të caktuara (para. 1). Së dyti, ai parashikon që Konventa të zbatohet edhe nëse një çështje e përjashtuar nga fusha e veprimit të saj del si një çështje paraprake në procese në Shtetin e origjinës (para. 2). Së treti, ajo përmban një dispozitë specifike e cila përjashton proceset e arbitrazhit dhe të tjera të lidhura me të (para. 3). Së fundi, ajo parashikon se vetëm fakti që një Shtet apo organ shtetëror ka qenë palë në proces nuk e përjashton një vendim gjyqësor nga fusha e veprimit të Konventës, e cila nuk prek privilegjet dhe imunitetet që gëzojnë Shtetet ose organizatat ndërkombëtare (para. 4 dhe 5). Në zbatimin e këtyre dispozitave, gjykatat e Shtetit të kërkuar nuk janë të detyruara nga vendimi i gjykatave të Shtetit të origjinës lidhur me faktin nëse vendimi ka të bëjë me një çështje të përjashtuar.

Paragrafi 1 – Kjo Konventë nuk zbatohet për çështjet e mëposhtme:

43. Paragrafi 1 i nenit 2 rendit çështjet specifike të përjashtuara nga fusha e veprimit të Konventës. Gjithsesi, paragrafi 2 shpjegon se këto përjashtime zbatohen vetëm kur një

çështje e listuar ka qenë “fusha e veprimit” të procesit, dhe jo kur ka dalë si një çështje paraprake, sidomos, si një mënyrë për t’u mbrojtur (shih *infra*, para. 76).

44. **Baza logjike.** Në përgjithësi, baza logjike e përjashtimeve është se (i) çështja e listuar ndërkohë rregullohet nga instrumente të tjera ndërkombëtare, në veçanti, nga Konventa të tjera të KHDNP-së, dhe është gjykuar si e parapëlqyeshme që këto instrumente të veprojnë pa ndërhyrjen e Konventës,³² (ii) çështja e listuar është me ndjeshmëri të veçantë për shumë Shtete dhe do të ishte e vështirë të arrihej një pranim i gjerë lidhur me mënyrën se si Konventa duhet ta trajtojë atë, ose se (iii) është e parapëlqyeshme që një lëndë të renditet shprehimisht si e përjashtuar, për të shmangur çdo pasiguri të bazuar në një interpretim të ndryshim, sipas ligjit të brendshëm. Shumica e lëndëve të përmendura në listë janë të ngjashme me ato që përmbahen në dispozitën paralele të KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës, por ka dallime të rëndësishme. Fusha e veprimit e kësaj Konvente është më e gjerë se sa ai i KHDNP 2005 për Zgjedhjen e Gjykatës. Për shembull, ndryshe nga KHDNP 2005 për Zgjedhjen e Gjykatës, e cila kufizohet me transaksionet tregtare, kjo Konventë zbatohet për kontratat e punësimit dhe të konsumatorëve, për lëndime fizike, dëme ndaj pronës së paluajtshme, të drejtat sendore *in rem* dhe kontratat e qirasë për prona të patundshme dhe për çështje anti-trust (të konkurrencës).

Nënparagrafi (a) – statusi dhe zotësia juridike e personave fizikë;

45. Nënparagrafi (a) përjashton statusin dhe zotësinë juridike të personave fizikë nga fusha e veprimit të Konventës. Ky përjashtim përfshin vendime gjyqësore për divorcin, ndarjen me ligj, pavlefshmërinë e martesës, vendosjen apo kundërshtimin e marrëdhënieve prindër-fëmijë, adoptimin, heqjen e përgjegjësisë prindërore (emancipimin) dhe statusin dhe zotësinë e të miturve apo personave me paaftësi. Përjashtimi mbulon gjithashtu vendimet gjyqësore për kujdestarinë, për kujdestarinë e pronës apo masa të barasvlershme, si edhe masat për mbrojtjen e fëmijëve apo administrimin, ruajtjen apo disponimin e pronave të fëmijëve (Shih gjithashtu *infra*, para. 47).³³ Vendimet gjyqësore për emrin apo shtetësinë e personave fizikë gjithashtu mbulohen nga ky përjashtim. Detyrimet e mbajtjes dhe çështje të tjera familjare janë të përjashtuara sipas nënparagrafëve (b) dhe (c).

³² Raporti Hartley/Dogauch, para. 53.

³³ Raporti Nygh/Pocar, para. 30, shënimi 16. Përjashtimi i lëndëve sipas nën-paragrafit (a) duhet të jetë në përputhje me instrumente të tjera të KHDNP-së, në veçanti, në lidhje me: (i) përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve, me nenin 3 të KHDNP-së, *Konventa e 19 tetorit 1996 për Juridiksion, Ligji i zbatueshëm, Njohja, Ekzekutimi dhe Bashkëpunimi në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve* (më poshtë, “KHDNP 1996 Konventa për Mbrojtjen e Fëmijës”); dhe (ii) mbrojtja e të rriturve, me nenin 3 të KHDNP-së, *Konventa e 13 janarit 2000 për Mbrojtjen Ndërkombëtare të të Rriturve* (më pas, “KHDNP 2000, Konventa për Mbrojtjen e të Rriturve”).

Nënparagrafi (b) – detyrimet e mbajtjes;

46. Nënparagrafi (b) përjashton detyrimet e mbajtjes, që përfshijnë çdo detyrim për mbajtje që buron nga marrëdhëniet familjare, prindërit, martesë apo afërsia e gjakut.³⁴ Meqenëse detyrimet e mbajtjes dhe regjimet e pasurisë martesore janë të përjashtuara, nuk ka nevojë të vihet një kufi i saktë përkufizimi midis tyre.

Nënparagrafi (c) – çështjet e tjera të së drejtës familjare, përfshirë regjimet pasurore martesore dhe të drejtat ose detyrimet e tjera, që lindin nga martesë apo marrëdhëniet e ngjashme;

47. Nënparagrafi (c) përjashton regjimet e pasurisë martesore dhe të drejta apo detyrime të tjera që burojnë nga martesë apo nga marrëdhënie të ngjashme.³⁵ Sikundër te KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës, “pasuria martesore” përfshin të drejtat e posaçme që ka njëri nga bashkëshortët ndaj shtëpisë martesore në disa juridiksione.³⁶ Në përgjithësi, ky përjashtim mbulon vendimet gjyqësore për kërkesat midis bashkëshortëve – dhe në raste të veçanta, me palët e treta – gjatë apo pas prishjes së martesës dhe që prek të drejtat ndaj pasurisë që rrjedh nga marrëdhënia martesore. Përjashtimi përfshin të drejtat e administrimit dhe disponimit të pronës që u përket bashkëshortëve dhe marrëveshjet për pasuritë martesore me anë të së cilave bashkëshortët organizojnë regjimet e pasurive martesore. Nga ana tjetër, kërkesat e bashkëshortëve, që rrjedhin nga ligji i përgjithshëm për pronat, kontratat apo detyrimet jashtë kontraktuese nuk janë të përjashtuara nga fusha e veprimit të Konventës.³⁷ Termi “marrëdhënie të ngjashme” mbulon marrëdhëniet midis çifteve të pamartuara, p.sh., bashkëjetesën, në masën që ajo njihet me ligj.³⁸ Dikush mund të ketë mendime të ndryshme në lidhje me faktin se sa mbulohen çështje të tilla si përgjegjësia prindërore, kujdestaria apo e drejta e kontakteve me fëmijët (qasja) apo masat për mbrojtjen e fëmijëve nga nënparagrafi (a) (“statusi dhe zotësia ligjore e personave fizikë”) ose nga nënparagrafi (c) (“çështje të tjera familjare”).³⁹ Megjithatë, sikundër në rastin e nënparagrafit (b), nuk është nevojë të vihet një kufi i saktë përkufizues midis këtyre kategorive, sepse që të dyja janë të përjashtuara nga fusha e veprimit të Konventës.

³⁴ Shih, për detyrimet e mbajtjes, KHDNP, Konventa e 15 prillit lidhur me njohjen apo zbatimin e vendimeve për detyrimet e mbajtjes të fëmijëve; KHDNP, Konventa e 2 tetorit 1973 për njohjen apo zbatimin e vendimeve lidhur me detyrimet e mbajtjes; dhe KHDNP, Konventa e 23 nëntorit 2007 për marrjen ndërkombëtare të mbështetjes së fëmijës dhe forma të tjera të mbajtjes së familjes (më poshtë, “KHDNP 2007, Konventa për mbrojtjen e fëmijëve”).

³⁵ Shih KHDNP, Konventa e 14 marsit 1978 për të drejtën e zbatueshme në regjimet e pasurisë martesore.

³⁶ Raporti Hartley/Dogauch, para. 55.

³⁷ Raporti Nygh/Pocar, para. 35.

³⁸ *Po aty.*; Raporti Hartley/Dogauch, para. 55.

³⁹ Shih, Dok. pune nr. 242 të majit 2018, “Propozimi i delegacionit të Uruguait” (Komisioni i Posaçëm për Njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja gjyqësore (24-29 maj 2018)).

Nënparagrafi (d) – testamentet dhe trashëgimia;

48. Nënparagrafi (d) i përjashton testamentet dhe trashëgiminë nga fusha e veprimit të Konventës.⁴⁰ Përjashtimi i referohet trashëgimisë së pasurisë së një personi të vdekur dhe mbulon të gjitha format e transferimit të pasurisë, të drejtat dhe detyrimet për shkak të vdekjes, qoftë me anë të transferimit vullnetar në bazë të disponimit të pronës me vdekjen e dikujt, ose transferimit nëpërmes trashëgimisë pa testament. Përdorimi i fjalës “testament” thjesht tregon se çështjet që kanë lidhje me formën dhe vlefshmërinë materiale të disponimeve pas vdekjes janë të përjashtuara.⁴¹ Në lidhje me fondet e besimit të krijuara me anë të disponimeve me testament, vendimet gjyqësore për vlefshmërinë dhe interpretimin e testamenteve që krijojnë fonde besimi janë të përjashtuara. Ndërsa vendimet gjyqësore për pasuritë, administrimin apo kalimet e fondit të besimit nga një person tek tjetri që janë ose kanë qenë në marrëdhënien e besimit përfshihen.⁴²

Nënparagrafi (e) – paaftësia paguese, përbërja, vendimet e institucioneve financiare në rast procesi falimenti të menjëhershëm dhe çështjet e ngjashme;

49. Nënparagrafi (e) përjashton paaftësinë paguese, ristrukturimin, rimëkëmbjen dhe ndërhyrjet e jashtëzakonshme dhe çështjet e ngjashme. Termi “paaftësi paguese” mbulon falimentimin si të individëve ashtu edhe të personave juridikë. Ai përfshin mbylljen ose likuidimin e shoqërive në procese të paaftësisë paguese, ndërsa mbyllja apo likuidimi i shoqërive për shkaqe të tjera nga paaftësia paguese trajtohet nga nënparagrafi (i).⁴³ Termi “ristrukturim” u referohet proceseve ku debitori hyn në një marrëveshje me kreditorin për të ristrukturuar apo riorganizuar një shoqëri tregtare për parandalimin e likuidimit të saj. Këto marrëveshje zakonisht nënkuptojnë një moratorium të pagesës së borxhit dhe çlirimin nga një detyrim.⁴⁴ Megjithatë, rregullimet thjesht kontraktuese – *pra*, marrëveshjet vullnetare jashtë gjyqësore – nuk mbulohen nga përjashtimi. Termi “çështje të ngjashme” përdoret për të mbuluar një gamë të gjerë metodash të tjera me anë të së cilave personat pa aftësi paguese apo me probleme financiare ndihmohen për të rifituar aftësinë paguese duke vazhduar të tregtojnë.⁴⁵

⁴⁰ Shih. KHDNP, *Konventa e 5 tetorit 1961 për konfliktet e ligjeve që lidhen me formën e disponimit me testament*; KHDNP, *Konventa e 2 tetorit 1973 lidhur me Administrimin ndërkombëtar të pasurive të personave të vdekur*; KHDNP, *Konventa e 1 gushtit 1989 për ligjin e zbatueshëm për trashëgiminë e pasurive të personave të vdekur* (nuk ka hyrë ende në fuqi).

⁴¹ Raporti Nygh/Pocar, para. 36.

⁴² *Po aty*.

⁴³ *Po aty*, Raporti Hartley/Dogauch, para. 56.

⁴⁴ *Po aty*, kini parasysh se ka një dispozitë të veçantë për borxhin shtetëror në nenin 2(1)(q).

⁴⁵ Siç është Kapitulli 11 i Kodit të Falimentimit të Shteteve të Bashkuara. Shih, Raporti Hartley/Dogauch, para. 56. Disa procedura kombëtare mund të përfshihen në konceptin e “ristrukturimit”, ose tek “çështjet e ngjashme”, por meqenëse të dyja janë të përjashtuara nga fusha e veprimit të Konventës, dallimi këtu nuk ka rëndësi.

50. Termi “rimëkëmbja (ndërhyrja e jashtëzakonshme) e institucioneve financiare” nuk përfshihet në dispozitën paralele të KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës. Ky është një koncept relativisht i ri që i referohet kuadrit ligjor të miratuar në shumë juridiksione për të trajtuar riskun e dështimit të institucioneve financiare.⁴⁶ Ndërhyrja e jashtëzakonshme mund të përfshijë likuidimin dhe rimbursimin e depozituesve, transferimin apo shitjet e aktiveve dhe pasiveve, krijimin e përkohshëm të institucioneve urë, dhe zhvlerësimin apo kthimin e borxhit në kapital.⁴⁷ Pjesa më e madhe e këtyre masave janë jashtë fusha e veprimit të zbatimit të Konventës si çështje administrative dhe jo civile apo tregtare, por shumë delegacione në takimin e dytë të Komisionit të Posaçëm e morën në konsideratë nevojën për një referencë të shprehur ndaj kësaj kornize të re si të përshtatshme për të shmangur paqartësitë.⁴⁸
51. **Vendimet gjyqësore të lidhura me paaftësinë paguese.** Nënparagrafi (e) i përjashton vendimet gjyqësore që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me paaftësinë paguese.⁴⁹ Ky përjashtim zbatohet nëse e drejta apo detyrimi që ka qenë baza ligjore e padisë në Shtetin e origjinës është mbështetur në rregulla që lidhen konkretisht me procedura të paaftësisë paguese dhe jo në rregulla të përgjithshme të së drejtës civile apo tregtare. Nëse padia buron nga rregullat e paaftësisë paguese, përjashtimi nuk e lejon qarkullimin e vendimit sipas Konventës. Por, nëse padia buron nga e drejta civile apo tregtare, vendimi mund të qarkullohet (shih, megjithatë, *infra*, para. 53). Gjykatat e Shtetit të kërkuar mund të shqyrtojnë kriteret e mëposhtme për të vendosur nëse vendimi është mbështetur në rregullat e paaftësisë paguese: nëse vendimi është dhënë në apo pas datës së fillimit të procesit të paaftësisë paguese, nëse procesi nga i cili erdhi vendimi i ka shërbyer interesit të organit të përgjithshëm të kreditorëve dhe nëse procesi nga i cili rrodhi vendimi nuk do të ishte bërë i mundur po të mos kishte qenë paaftësia paguese e debitorit.⁵⁰ Pra, Konventa nuk zbatohet, për shembull, për vendime gjyqësore që fillojnë proceset e paaftësisë paguese, në lidhje me zhvillimin dhe mbylljen e tyre, miratimin e një plani ristrukturimi apo anulimin e transaksioneve që janë të dëmshme për organin e përgjithshëm të kreditorëve apo klasifikimin e kërkesave.⁵¹
52. Megjithatë, Konventa nuk zbatohet për vendime gjyqësore lidhur me padi që mbështeten në rregullat e përgjithshme të së drejtës civile apo tregtare, edhe kur padia është ngritur nga një person, apo kundër një personi që vepron si administrator i

⁴⁶ Korniza të tilla kombëtare janë ngritur pas udhëzimeve të dhëna nga Bordi i Stabilitetit Financiar, një organ ndërkombëtar i krijuar pas samitit të Londrës së G20 në prill 2009, i cili monitoron dhe jep rekomandime për sistemin financiar global.

⁴⁷ Shih, Bordi i Stabilitetit Financiar, *Veçoritë kyçe të regjimeve të efektshme të ndërhyrjeve të jashtëzakonshme në institucionet financiare*, 15 tetor 2014.

⁴⁸ Procesverbale të Komisionit të Posaçëm për njohjen apo zbatimin e vendimeve të huaja gjyqësore (16-24 shkurt 2017), procesverbali nr. 2, para. 30-50.

⁴⁹ Raporti Hartley/Dogauch, para. 57.

⁵⁰ Shih, Dok. pune nr. 104 i shkurtit 2017, “Propozimi i delegacionit të Bashkimit Evropian” (Komisioni i Posaçëm për Njohjen dhe zbatimin e Vendimeve të Huaja Gjyqësore (16-24 shkurt 2017)).

⁵¹ *Po aty*.

paaftësisë paguese në procesin e paaftësisë paguese të një pale. Kështu Konventa zbatohet për vendime gjyqësore lidhur me padi për përmbushjen e detyrimeve sipas një kontrate të lidhur nga debitori, apo për padi për dëmshpërblime jo kontraktuese.⁵² Për shembull, kur X-i bën një kontratë shitjeje me Y-in, dhe X-i pastaj deklaron falimentim në Shtetin A, Konventa zbatohet për çdo vendim kundër Y-së në lidhje me kryerjen e kontratës edhe kur padia është bërë nga personi i caktuar si administrator i paaftësisë paguese në falimentimin e X –it. Në të njëjtën mënyrë, Konventa zbatohet nëse një padi e tillë është ngritur nga Y-ja kundër X-it, duke vepruar përmes personit të caktuar si administratori i paaftësisë paguese në falimentimin e X -it.

53. Por, zbatimi i Konventës do të ketë efekt të kufizuar në rastet kur debitori objekt i vendimit është në proces paaftësie paguese. Këto janë procese kolektive që zakonisht nuk i lejojnë kreditorë të veçantë të ekzekutojnë kërkesat e tyre me anë të veprimeve të veçanta përmbartimore (ndryshe, nuk do të ishte i mundur administrimi me rregull dhe likuidimi i pasurisë apo riorganizimi i debitorit), dhe efekti i fillimit të procesit të paaftësisë paguese për ekzekutimin e padive individuale përmbartimore nuk rregullohet nga Konventa. Po kështu, nëse vendimi është i favorshëm për kundërpalën e debitorit në paaftësi paguese – Y-ja në shembullin e mësipërm – ekzekutimi i një vendimi mund të ndikohet nga procesi i paaftësisë paguese. Kreditori objekt i vendimit (Y) mund të kërkojë njohjen apo zbatimin e vendimit sipas Konventës në juridiksionin ku nis procesi i paaftësisë paguese – Shteti A në shembull – por do të marrë pagesën nëpërmjet procesit të paaftësisë paguese apo planit të riorganizimit. Në këtë kuptim, vendimi i huaj duhet të trajtohet në të njëjtën mënyrë si një vendim i brendshëm, por jo më mirë. Po ashtu, kreditori objekt i vendimit (Y) mund të kërkojë njohjen apo zbatimin e vendimit në Shtetet e tjera nga Shteti ku ka filluar procesi i paaftësisë paguese, por ekzekutimi i vendimit mund të preket nga fillimi i procesit të paaftësisë paguese, nëse procese të tilla njihen në Shtetin e kërkuar (sipas ligjit model të UNCITRAL-it apo ndryshe).

Nënparagrafi (f) – transporti i udhëtarëve dhe i mallrave;

54. Nënparagrafi (f) përjashton kontratat për transportin kombëtar apo ndërkombëtar të pasagjerëve ose mallrave, pavarësisht nga mjetet e transportit. Përjashtimi përfshin edhe transportin me det, tokë dhe ajër, apo kombinimin e të treve.⁵³ Transporti kombëtar apo ndërkombëtar i pasagjerëve ose mallrave u nënshtrohet një numër konventash të tjera të rëndësishme dhe ky përjashtim parandalon lindjen e konflikteve me këto instrumente. Gjithsesi, përjashtimi nuk kufizohet me kontratat tregtare për transportimin dhe, si pasojë, ai mbulon edhe kontratat me konsumatorët dhe kontratat midis jo profesionistëve, për shembull, Konventa nuk zbatohet për një vendim gjyqësor për lëndime personale të një pasagjeri të lënduar në një aksident, si pasojë e pakujdesisë së shoferit. Nga ana tjetër, ky përjashtim

⁵² Po aty, Raporti Hartley/Dogauch, para. 57.

⁵³ Raporti Hartley/Dogauch, para. 58.

nuk mbulon dëmshpërblimin e palëve të treta, pra, të një viktime në një aksident ku nuk ka qenë pasagjer. Ai nuk mbulon as kontratat komplekse që kombinojnë shërbimet turistike si transporti, strehimi dhe shërbime të tjera, ku vetëm transporti është objekti kryesor i kontratës.

Nënparagrafi (g) – ndotja detare ndërkufitare, ndotja detare në zonat përtej juridiksionit kombëtar, ndotja detare nga anijet, kufizimi i përgjegjësisë për pretendimet detare dhe mesatarja e përgjithshme;

55. Nënparagrafi (g) përjashton tri çështje detare: ndotjen detare në tri rrethana (transkufitare, përtej zonave të juridiksionit kombëtar dhe me burim anijet), kufizimin e përgjegjësisë për padi detare dhe mesataren e përgjithshme. Përjashtimi i çështjeve detare u fut nga KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës.⁵⁴ Lidhur me ndotjen detare, në veçanti, ka disa instrumente ndërkombëtare të lidhura me ndotjen detare që trajtojnë njohjen apo zbatimin e vendimeve të huaja gjyqësore; zbatimi i Konventës në këtë çështje mund të ishte bërë shkas për lindjen e problemeve në lidhje me marrëdhëniet midis instrumenteve ndërkombëtare.⁵⁵ Në Sesionin e njëzetë e dytë pati konsensus për ta kufizuar këtë përjashtim në tri kontekste të caktuara të renditura në nënparagrafin (g): ndotja detare transkufitare (pra, ndërkufitare), ndotja detare në zonat përtej juridiksionit kombëtar dhe ndotja detare me burim nga anijet.⁵⁶ Vendime të tjera gjyqësore që përfshijnë ndotjen detare futen në fushën e veprimit të Konventës. Ndryshe nga KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës, Konventa nuk e përjashton rimorkimin dhe shpëtimin emergjent /të anijeve/ meqenëse këto aspekte nuk mbulohej nga instrumente të tjera dhe sepse ka arsye të forta të nxitet ofrimi i këtyre shërbimeve, ndërsa mos kompensimi efikas i ofruesve mund të shpjerë në uljen e gatishmërisë për të marrë përsipër risqe dhe përballuar kostot e ofrimit të tyre.⁵⁷ Për më tepër,

⁵⁴ Shih, “Shënim për rishqyrtimin e ‘ndotjes detare dhe rimorkimin dhe shpëtimin emergjent’ sipas fushës së veprimit të projekt Konventës për njohjen apo zbatimin e vendimeve të huaja gjyqësore në lëndë civile apo tregtare”, Dok. par. Nr. 12 të qershorit 2019 në vëmendje të Sesionit njëzetë e dy për njohjen apo zbatimin e vendimeve të huaja gjyqësore (18 qershor – 2 korrik 2019) (i disponueshëm në faqen e internetit të KHDNP-së < www.KHDNP.net >, tek “Seksioni i Vendimeve gjyqësore”, pastaj “Puna përgatitore” dhe “Sesioni diplomatik i 22-të”) (më poshtë, “Dok. paraprak Nr. 12 i qershorit 2019”), para. 10.

⁵⁵ *Po aty*, para. 77.

⁵⁶ Këto terma dhe konkretisht “fushat e juridiksionit të brendshëm”, përdoren në instrumentet ndërkombëtare dhe dokumente të tjera që trajtojnë çështje detare dhe këtu janë përdorur për të ndihmuar në interpretimin e njëjtë të këtij përjashtimi nga fusha e veprimit të saj. Prandaj, një referencë e nevojshme për interpretimin e këtyre termave është drejta ndërkombëtare, në veçanti, *Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtën e Detit* (UNCLOS).

⁵⁷ Por, duke qenë se disa rimorkime apo shpëtime emergjente janë operacione të detyrueshme, që rregullohen nga apo kryhen sipas autoriteteve të Shteteve, disa vendime gjyqësore të caktuara nuk i përbushin kushtet për të qenë lëndë civile apo tregtare sipas nenit 1(1) të Konventës; shih, Dok. par. Nr. 12 të qershorit 2019, para. 76.

me kusht që t'i nënshtrohen kufizimit të përjashtimit të përgjegjësisë, çështje të tjera detare si sigurimi detar, hipotekat dhe dorëzanimet në ndërtimin e anijeve apo të anijeve gjithashtu janë përfshirë në fushën e veprimit të Konventës.⁵⁸

Nënparagrafi (h) – përgjegjësia për dëmet bërthamore;

56. Nënparagrafi (h) përjashton përgjegjësinë për dëmin bërthamor. Shpjegimi për këtë përjashtim në raportin Hartley/Dogauchi është se dëmi bërthamor është subjekt i konventave të ndryshme ndërkombëtare që parashikojnë se Shteti ku ka ndodhur aksidenti bërthamor ka juridiksion ekskluziv lidhur me paditë për dëmshpërblime për shkak të përgjegjësive që rezultojnë nga aksidenti.⁵⁹ Në disa raste, Neni 23 i Konventës mund t'u japë këtyre instrumenteve përparësi ndaj kësaj Konvente. Megjithatë, ka disa Shtete me stacione të energjisë bërthamore që nuk janë palë në asnjë nga konventat për përgjegjësinë bërthamore. Shtete të tilla mund të mos duan të njohin vendimet gjyqësore të dhëna në një Shtet tjetër për shkak të ndonjërit nga filtrat e parashikuara nga Neni 5 i Konventës. Atje ku operatorët e stacioneve të energjisë bërthamore përfitojnë nga përgjegjësia e kufizuar sipas ligjit të atij Shteti në fjalë, apo ku kompensimi për dëmet paguhet nga fondet publike, një procedurë e vetme kolektive në atë Shtet sipas rregullit të tij të brendshëm do të ishte e nevojshme për një zgjidhje të njëjtë të përgjegjësive dhe një shpërndarje të barabartë të një fondi të kufizuar midis viktimeve. Ky përjashtim trajton aksidentet bërthamore dhe si pasojë, nuk mbulon pretendimet mjekësore jashtë kontraktuese lidhur me mjekësinë bërthamore (duke përfshirë terapinë radioaktive për shembull).

Nënparagrafi (i) – vlefshmëria, pavlefshmëria, shpërbërja e personave juridikë ose e shoqatave të personave fizikë ose juridikë, si dhe vlefshmëria e vendimeve të organeve të tyre;

57. Nënparagrafi (i) përjashton vlefshmërinë, pavlefshmërinë apo shpërbërjen e personave juridikë, dhe vlefshmërinë e vendimeve të organeve të tyre. Përjashtimi gjithashtu përfshin “shoqatat e personave fizikë apo juridikë”, pra, subjektet pa personalitet ligjor. Këto çështje shpesh janë subjekt i juridiksionit ekskluziv i Shtetit ligji i të cilit zbatohet për ato subjekte, me qëllim që të shmangen forumet e shumta në këtë fushë dhe për të garantuar sigurinë ligjore.⁶⁰ Vendimet gjyqësore për këtë çështje janë të përjashtuara nga fusha e veprimit të Konventës, sepse ato zakonisht nuk njihen dhe ekzekutohen në Shtete të tjera.⁶¹ Përjashtimi mbulon vetëm vlefshmërinë, pavlefshmërinë apo shpërbërjen e personave juridikë dhe të

⁵⁸ Raporti Hartley/Dogauch, para. 59. Për një shpjegim të objektit të termave “kufizimi i përgjegjësive për padi detare”, shih, P. Schlosser, “Raport për Konventën e 9 tetorit 1978 për asocimin e Mbretërisë së Danimarkës, Irlandës dhe Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës së Veriut në Konventën për juridiksion dhe ekzekutimi e vendimeve gjyqësore në lëndë civile dhe tregtare dhe në Protokollin për interpretimin e saj nga Gjykata e Drejtësisë”, *Gazeta Zyrtare e Komuniteteve Evropiane*, 5.3.1979, nr. C 59/71, Luksemburg, 1979 (më poshtë, “Schlosser Raport”), para. 124-130.

⁵⁹ Raporti Hartley/Dogauch, para. 64 (shënimet janë hequr).

⁶⁰ Raporti Nygh/Pocar, para. 170.

⁶¹ Raporti Hartley/Dogauch, para. 70.

shoqatave, apo vlefshmërinë, apo pavlefshmërinë e vendimeve të organeve të tyre, pra, të mbledhjes së aksionarëve apo këshillit administrativ. Por, përjashtimi nuk mbulon vendime të tjera gjyqësore të lidhura me çështje të ligjit për shoqëritë tregtare, si vendimet gjyqësore për përgjegjësitë e administratorëve, kërkesat për pagesat e dividendëve apo pagesat për kontributet e anëtarëve. Natyrisht, çdo kontratë apo çështje jashtë kontraktuese që lidhet me veprimtaritë e një personi juridik apo shoqate mbetet brenda fushës së veprimit të Konventës.

Nënparagrafi (j) – vlefshmëria e regjistrimeve në regjistrat publikë;

58. Nënparagrafi (j) përjashton vlefshmërinë apo pavlefshmërinë e regjistrimeve në regjistrat publikë, duke përfshirë edhe regjistrat e kokës, regjistrat e pagesave të tokës dhe regjistrat tregtarë.⁶² Regjistrat publikë mbahen nga autoritetet publike dhe nënkuptojnë ushtrimin e një të drejte sovrane dhe paditë për vlefshmërinë e regjistrimeve zakonisht duhen bërë përpara autoriteteve publike që mbajnë atë regjistrë.⁶³ Kjo përfshin, për shembull, rastet kur regjistrimi refuzohet apo ndryshohet nga regjistruesi dhe kërkuesi e apelon vendimin. Një proces i tillë gjyqësor shpesh zhvillohet midis kërkuesit dhe regjistruesit. Si rrjedhojë, në parim, regjistrimet në regjistrat publikë janë çështje administrative jashtë fushës së veprimit të Konventës. Neni 2(1)(j) nuk lejon dyshime.
59. Megjithatë, përjashtimi nuk përfshin pasojat ligjore të regjistrimeve. Kështu për shembull, një kërkesëpadi kundër një pale të tretë blerës i pronave të patundshme bazuar në të drejtën e parablerjes të regjistruar në regjistrin e tokës nuk është e përjashtuar. Në të njëjtën mënyrë, një kërkesëpadi ndaj një personi privat bazuar në pavlefshmërinë e transferimit të pronësisë së një prone të patundshme të një të padituri po ashtu nuk është e përjashtuar, edhe nëse prona e të paditurit është e regjistruar në regjistrin e tokave. Ky vendim nuk është për “vlefshmërinë e regjistrimit” si i tillë, por në vlefshmërinë e titullit (*pra*, të kontratës) që u bë shkak për atë regjistrim.

Nënparagrafi (k) – shpifja;

60. Nënparagrafi (k) e përjashton shpifjen nga fusha e veprimit të Konventës. Shpifja është një çështje e ndjeshme për shumë Shtete, duke qenë se prek lirinë e shprehjes dhe si e tillë mund të ketë implikime kushtetuese. Përjashtimi mbulon shpifjen si nga persona fizikë edhe nga ata juridikë, dhe përfshin deklarata të bëra

⁶² Raporti Hartley/Dogauchi shpjegon se “disa njerëz nuk duhet ta shohin këtë si lëndë civile apo tregtare. Megjithatë, duke qenë se disa instrumente ndërkombëtare (për shembull, Neni 22(3) i Rregullores I të Brukselit) parashikojnë juridiksionin ekskluziv në procese që kanë si objekt vlefshmërinë e regjistrimeve të tilla, është menduar më mirë që të përjashtohen ato shprehimisht për të shmangur çdo dyshim.” *Po aty*, para. 82.

⁶³ Këta regjistra mundet gjithashtu të krijohen me traktate ndërkombëtare dhe gjithashtu të mbulohen nga ky përjashtim, për shembull, regjistrat e krijuar sipas Konventës së Keip Taunit për interesat ndërkombëtare në pajisjet e lëvizshme dhe protokollet e saj *UNIDROIT* (këto instrumente gjenden në < www.unidroit.org >).

me anë të mjeteve të komunikimeve publike të tilla si shtypi, radioja, televizioni apo interneti. Ky përjashtim gjithashtu mbulon rastet e përgojimeve dhe shpifjeve (*pra*, lajmet apo opinionet që cenojnë nderin apo reputacionin e një personi).

Nënparagrafi (I) – privatësia;

61. **Hyrja.** Nënparagrafi (I) e përjashton privatësinë. Sikundër edhe me shpifjen, privatësia përfshin një ekuilibër të brishtë midis të drejtave themelore ose kushtetuese, në veçanti, lirinë e shprehjes dhe është një çështje delikate për shumë shtete. Ndërsa kjo çështje mund të trajtohet rast pas rasti, me anë të përjashtimeve të politikës publike sipas nenit 7, është parapëlqyer të përjashtohet privatësia nga fusha e veprimit të Konventës. Ligji për privatësinë aktualisht është duke u ndryshuar shumë në shumë Shtete dhe fusha e veprimit dhe përkufizimi i tij ndryshon së tepërmi.⁶⁴ Teksti i Konventës shmang në këtë mënyrë përkufizimin e privatësisë.
62. **Fusha e veprimit i zbatimit.** Ky përjashtim zbatohet për nxjerrjen e informacionit në çfarëdo forme qoftë, duke përfshirë ndër të tjera, tekst, fotografi, regjistrime me zë apo me figurë. Përkufizimi bazë i privatësisë për qëllimet e këtij përjashtimi u referohet situatave që kanë të bëjnë me nxjerrjen e paautorizuar të një informacioni që lidhet me jetën private.⁶⁵ Një përkufizim i tillë e kufizon përjashtimin tek personat fizikë duke qenë se personat juridikë nuk kanë ndonjë “jetë private”. Ai përfshin përjashtimin e çdo vendimi për një kërkesë me bazë privatësinë nga një person fizik për kompensim për shkak të zbulimit të informacionit privat, ose për të parandaluar një zbulim të tillë informacioni. Ndonëse u arrit konsensus në lidhje me faktin që privatësia i përfshin raste të tilla, përjashtimi i privatësisë nuk kufizohet vetëm me këto situata. Në shqyrtimin e tyre nëse duhet që ky përjashtim të zbatohet në situata të tjera që përfshijnë privatësinë, gjykatat duhet të shqyrtojnë qëllimin e përjashtimit, duke marrë parasysh gjithashtu karakterin ndërkombëtar të Konventës dhe nevojën për nxitje të uniformitetit në zbatimin e saj, siç parashikohet nga neni 20.
63. **Mbrojtja e të dhënave.** U ra dakord për faktin që përjashtimi nuk përfshin as vendimet gjyqësore që janë dhënë për kontrata që përmbajnë të dhëna personale apo kërkojnë mbrojtjen e të dhënave personale në kontekste biznes me biznes, për shembull, një kontratë midis mbajtësit të dhënave personale dhe një ofruesi shërbimesh në lidhje me përdorimin e këtyre të dhënave.⁶⁶

⁶⁴ Shih, C. North, “Shënim për përjashtimin e mundshëm të çështjeve të privatësisë nga Konventa siç pasqyrohen në nenin 2(1)(k) të projekt Konventës së shkurtit 2017”, hartuar me ndihmën e Byrosë së Përhershme, Dok. paraprak nr. 8 i nëntorit 2017 në vëmendje të takimit të tretë të Komisionit të Posaçëm për njohjen apo zbatimin e vendimeve të huaja gjyqësore (13-17 nëntor 2017) (gjendet në faqen e internetit të KHDNP-së < www.KHDNP.net >, tek “Seksioni i vendimeve gjyqësore”, pastaj “Puna përgatitore” dhe “Takimet e Komisionit të Posaçëm”), para. 51.

⁶⁵ Shih, Procesverbalet e Sesionit të njëzetë e dytë për njohjen apo zbatimin e vendimeve të huaja gjyqësore (18 qershor – 2 korrik 2019), Procesverbalet nr. 5, para. 39-41 dhe 43.

⁶⁶ *Po aty*,, Procesverbali nr. 8, para 116-119.

Nënparagrafi (m) – pronësia intelektuale;

64. Nënparagrafi (m) e përjashton pronësinë intelektuale. Koncepti i pronësisë intelektuale përdoret në një kuptim të gjerë, duke mbuluar çështje që njihen në shkallë ndërkombëtare si pronësi intelektuale,⁶⁷ dhe çështje të tjera që nuk njihen ndërkombëtarisht si pronësi intelektuale, por që përfitojnë nga mbrojtje të barasvlershme sipas disa ligjeve të caktuara kombëtare, të tilla siç është aktualisht rasti me njohuritë tradicionale apo me shprehjet kulturore dhe burimet gjenetike. Në projekt Konventën e përgatitur nga Komisioni i Posaçëm i majit 2018, shprehja “çështje analoge” është përdorur për të kapur këtë kategori të fundit, për të siguruar trajtim të barabartë të vendimeve mbi pronësinë intelektuale, pavarësisht nëse është e njohur ndërkombëtarisht apo jo si e tillë. Megjithatë, gjatë sesionit të njëzetë e dytë u vendos të mos përfshihen “çështjet analoge” në tekstin e Konventës, duke qenë se kjo shprehje nuk gjendet në KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës, dhe në dritën e shqetësimeve të shprehura nga disa delegacione për paqartësinë e kësaj fraze. Vendimi për të përjashtuar frazën “çështjet analoge” nuk ka implikime për fushën e veprimit të përjashtimit të pronësisë intelektuale, i cili është përcaktuar gjerësisht, siç thuhet më lart.
65. Përjashtimi i pronësisë intelektuale mbulon, për shembull, vendimet gjyqësore për vlefshmërinë dhe regjistrimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, ekzistencën e të drejtës së autorit dhe të drejtat e lidhura dhe shkeljen e këtyre të drejtave. Megjithatë, në lidhje me kontratat që lidhen me të drejtat e pronësisë intelektuale, përjashtimi ka më shumë nuanca dhe varet nga fakti nëse mosmarrëveshja karakterizohet si kontraktuese. Kriteri përkatës për përcaktimin e fushës së veprimit të përjashtimit është nëse vendimi që duhet njohur dhe zbatuar është mbështetur kryesisht në ligjin e përgjithshëm të kontratave apo në ligjin për pronësinë intelektuale.⁶⁸ Nga njëra anë, ka vendime gjyqësore që janë qartësisht të përfshira në fushën e veprimit të Konventës, *për shembull*, një vendim gjyqësor për një marrëveshje për leje për një markë tregtare për përcaktimin e shpërblimeve përkatëse të autorit, ose një vendim gjyqësor për një kontratë shpërndarjeje, që përfshin një leje të së drejtës së pronësisë intelektuale që vendos për nën raportimin e shitjeve. Në raste të tilla, vendimi bazohet në ligjin e përgjithshëm të kontratave dhe vetëm indirekt lidhet me çështje të pronësisë intelektuale. Nga ana tjetër, ka vendime gjyqësore që janë qartësisht të përjashtuara nga fusha e veprimit të Konventës, *pra*, një vendim gjyqësor për një patentë standarde esenciale (PES)

⁶⁷ Shih, *për shembull*, Konventa e Parisit për Pronësinë Industriale, e rishikuar në Stokholm në 1967 (“Konventa e Parisit”), Konventa që themeloi Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale (“WIPO”) (e ndryshuar më 28 shtator 1979), *Marrëveshja* për aspektet e të drejtave të pronësisë intelektuale të lidhura me tregtinë (“TRIPS”), *Konventa e Bernës për mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike* (Konventa e Bernës), ose Traktati WIPO për të Drejtën e Autorit. Lidhur me të drejtat dhe çështjet e mbuluara nga këto instrumente, shih, në veçanti referencat në nenet 1 dhe 2 të TRIPS-it. Sigurisht kjo listë nuk është shteruese.

⁶⁸ Tri dokumentet e punës së paraqitura në Sesionin njëzetë e dy për këtë çështje kanë përdorur të njëjtën fjali për të përcaktuar objektin e këtij përjashtimi në mosmarrëveshjet kontraktuese: “një vendim gjyqësor është i përjashtuar nëse mosmarrëveshja karakterizohet më mirë si një çështje e pronësisë intelektuale dhe jo si një çështje kontraktuese”. (shih, Dokumente pune nr. 75, 80 dhe 84).

që përfshin detyrimin për një licencim të drejtë, të arsyeshëm dhe jo diskriminues (FRAND), ose një vendim gjyqësor që përcakton pronësinë e patentës së një shpikjeje të bërë gjatë marrëdhënies së punësimit. Në raste të tilla ku vendimi bazohet drejtpërdrejt në rregullat materiale që rregullojnë ligjin e pronësisë intelektuale, përkundrajt ligjit të përgjithshëm të kontratave Konventa nuk zbatohet. Midis këtyre dy grupeve, ka raste të vështira apo të papërcaktuara, *për shembull*, kur padia bazohet në ligjin e përgjithshëm të kontratave por çështja e pronësisë intelektuale ngrihet si mbrojtje. Në parim, këto vendime gjyqësore duhet të trajtohen rast pas rasti sipas kriterit të përgjithshëm; nëse mbrojtja është përjashtuar si pa themel apo e pavlerë, dhe si pasojë vendimi mbështetet në ligjin e përgjithshëm të kontratave, do të zbatohet Konventa. Nga ana tjetër, kur aspekti kontraktues ka qenë dytësor dhe vendimi është mbështetur kryesisht në çështje të pronësisë intelektuale, Konventa nuk zbatohet.

Nënparagrafi (n) – veprimtaritë e forcave të armatosura, përfshirë veprimtaritë e personelit të tyre gjatë ushtrimit të detyrave të tyre zyrtare;

66. Nënparagrafi (n) përjashton vendimet gjyqësore të lidhura me veprimtarinë e forcave të armatosura, duke përfshirë veprimtaritë e personelit të tyre gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare. Në parim, këto vendime gjyqësore do të jenë të përjashtuara sipas nenit 1(1), sepse ato nuk janë vendime gjyqësore për lëndë civile apo tregtare. Personat që kryejnë veprimtari të tilla mund gjithashtu të përfitojnë nga imuniteti juridiksional sipas të drejtës ndërkombëtare, që nuk preket nga Konventa (Neni 2(5); shih, *infra*, para. 85-89). Megjithatë, nuk ka përkufizime të njëjta apo standarde për *acta iure imperii* dhe *acta iure gestionis*, kështu që Shtetet mund të kenë mendime të ndryshme për këtë çështje. Ky përjashtim është përfshirë përkatësisht për të dhënë siguri më të madhe. Ai sqaron se veprimtaritë e forcave të armatosura janë gjithsesi jashtë fushës së veprimit të Konventës dhe se Shtetet nuk janë të detyruara të njohin apo ekzekutojnë vendimet gjyqësore për këto çështje, pavarësisht nëse këto veprimtari cilësohen si *acta iure imperii* në Shtetin e origjinës ose në Shtetin e kërkuar. Ky përjashtim gjithashtu siguron konsekuencë me traktate të tjera dypalëshe apo shumëpalëshe që parashikojnë mekanizma ekskluzivë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për disa padi sipas të drejtës private kundër forcave të armatosura (duke përfshirë edhe padi kontraktuese dhe jashtë kontraktuese).⁶⁹ Natyrisht, kjo dispozitë nuk duhet të interpretohet *a contrario, pra*, ajo nuk nënkupton që veprimtaritë e autoriteteve të tjera shtetërore të përfshihen në fushën e veprimit Konventës; për aq sa këto veprimtari nuk i plotësojnë kushtet për të qenë lëndë civile apo tregtare, ato do të jenë të përjashtuara sipas nenit 1(1).
67. Nënparagrafi (n) mbulon vendimet gjyqësore të lidhura me veprimtaritë e forcave të armatosura si të tilla, por ai përmend konkretisht se përfshin veprimtarinë e personelit të tyre “në ushtrimin e detyrave të tyre”. Kështu çdo vendim kundër (ose në favor të) forcave të armatosura është i përjashtuar, ndërsa një vendim gjyqësor

⁶⁹ Nëse një gjykatë në një Shtet i ka shpërfillur këto mekanizma dhe ka dhënë një vendim gjyqësor, kjo mund të bëhet shkas për bërjen e një kërkesë sipas Konventës për njohjen dhe zbatimin e një vendimi të tillë gjyqësor, i cili do të dëmtonte integritetin e këtyre traktateve bilaterale apo multilaterale.

që ka lidhje me personelin e tyre është i përjashtuar vetëm nëse jepet për një mosmarrëveshje që lind nga ushtrimi i detyrave të tyre zyrtare. Kështu për shembull, një vendim gjyqësor për një padi civile kundër një ushtari që vjen për shkak të veprimtarisë së tij personale, si blerja e një automjeti privat apo një aksidenti me makinë gjatë një udhëtimi për pushime, mbulohet nga Konventa. Nga ana tjetër, nëse aksidenti ndodh në kuadër të një stërvitjeje ushtarake, çdo vendim kundër një ushtari të veçantë do të jetë i përjashtuar. Termi “personel” mundet gjithashtu të përfshijë civilët e regjistruar apo të punësuar nga forcat e armatosura, *pra*, elementi i rëndësishëm është veprimtaria që ata kryejnë dhe jo statusi i punësimit të tyre.

Nënparagrafi (o) – veprimtaritë ligjzbatuese, përfshirë veprimtaritë e personelit ligjzbatues gjatë ushtrimit të detyrave të tyre zyrtare;

68. Nënparagrafi (o) përjashton vendimet gjyqësore të lidhura me veprimtarinë ligjzbatuese, duke përfshirë veprimtarinë e personelit ligjzbatues në ushtrimin e detyrave të tyre. Ky përjashtim është i lidhur ngushtë me përjashtimin e veprimtarive të forcave të armatosura në nënparagrafin (n) dhe ndjek të njëjtin formulim – por me një ndryshim të rëndësishëm. Për të shmangur mosmarrëveshje lidhur me përkufizimet nëse një agjenci është apo jo një subjekt ligjzbatues, përjashtimi i referohet “veprimtarisë ligjzbatuese” dhe jo një personi apo subjekti të tillë si forcat e armatosura. Përjashtimi si pasojë zakonisht mbulon organet që kryejnë veprimtari ligjzbatuese, të tilla si forca e policisë apo oficerët e kontrollit kufitar, duke përfshirë jo vetëm hetimet, arrestimet, etj., por gjithashtu edhe procedimet që bëhen në vazhden e tyre. Ai gjithashtu përfshin çdo veprimtari që ndërmerret në përputhje me traktatet për ndihmën e ndërsjellë ligjore apo traktatet e ekstradimit. Po ta lëmë mënjanë këtë dallim, të dy dispozitat e forcave ligjzbatuese dhe të forcave të armatosura, kanë më shumë elemente të përbashkëta. Sikundër në rastin e veprimtarive të forcave të armatosura, shumica e vendimeve gjyqësore lidhur me veprimtaritë ligjzbatuese nuk do të futeshin brenda fushës së veprimit “civil apo tregtar” të Konventës, por janë përcaktuar në nenin 2(1) për të trajtuar mospërputhjet e mundshme në interpretimin e *acta iure imperii* sipas ligjit të brendshëm. Termi “personel” përfshin çdo person që kryen veprimtari ligjzbatuese zyrtare, pavarësisht nga statusi i punësimit të tij. Dhe si në rastin e përjashtimit të veprimtarisë së forcave të armatosura sipas nën-paragrafit (n), ky përjashtim nuk ka implikime në rregullat për privilegjet dhe imunitetet, të cilat ruhen plotësisht sipas nenit 2(5).

Nënparagrafi (p) – çështjet anti-trust (çështjet e konkurrencës), përveç rasteve kur vendimi gjyqësor bazohet në veprime që përbëjnë marrëveshje kundër-konkurrese ose praktikë të bashkërenduar mes konkurrentëve aktualë ose potencialë për të përcaktuar çmimet, për të bërë oferta të manipuluar, për të vendosur kufizime të produkteve ose kuota, ose për të ndarë tregjet duke caktuar konsumatorët, furnitorët, territoret ose linjat e tregtisë, dhe kur edhe këto veprime edhe efekti i tyre kanë ndodhur në shtetin e origjinës;

69. Nënparagrafi (p) përjashton vendimet gjyqësore për çështje anti-trust (konkurrencën), por vetëm pjesërisht. Kufiri i këtij përjashtimi përcaktohet nga: (i) një element material (fusha e veprimit të Konventës përfshin shprehimisht

vetëm disa kategori të caktuara të sjelljes anti-trust); dhe (ii) Një faktor lidhës (Konventa zbatohet vetëm për ato kategori të sjelljes anti-trust ku ka një lidhje të caktuar me Shtetin e origjinës). Formulimi i këtij përjashtimi është kështu një kompromis midis qasjeve kundërtë. ⁷⁰ Nga njëra anë, disa delegacione ishin pro përfshirjes së kësaj çështjeje pa kufizime, duke argumentuar se ligjet bashkëkohore anti-trust përgjithësisht kanë të njëjtin objekt dhe në më të shumtën veçori të përbashkëta në nivel global dhe se Konventa do të mbulonte vetëm paditë private për ekzekutim, të cilat do të promovonin këto objekte, dhe jo paditë publike për ekzekutim apo urdhrat e autoriteteve anti-trust. Nga ana tjetër, një grup tjetër delegacionesh ishte pro përjashtimit të plotë të kësaj çështjeje. Këto delegacione argumentuan se ka një element të fortë interesi publik të përfshirë në këtë fushë – edhe në lidhje me paditë private – dhe mund të ishte e vështirë (ose madje edhe e papërshtatshme) të bëhej dallim midis ekzekutimit publik dhe privat, sidomos, por jo vetëm, lidhur me ato raste të paraqitura përpara autoriteteve publike. Ky grup ishte gjithashtu i shqetësuar për efektin e mundshëm jashtë-territorial: rregullat anti-trust (të konkurrencës) varen konkretisht nga juridiksioni dhe lejojnë që vendimet gjyqësore për këto lëndë, që qarkullojnë sipas Konventës, mund të shprijn në një efekt “valëzues”. Ky nënparagraf është formuluar si një kompromis i balancuar midis këtyre dy qasjeve.

70. Përjashtimi është shprehur si çështje “anti-trust (të konkurrencës)”, si në KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës (shih Neni 2(1)(h)), sepse terma të ndryshëm përdoren për sisteme ligjore të ndryshme për rregulla me përmbajtje të ngjashme materiale. Në Shtetet e Bashkuara, për shembull, termi standard është “ligji anti-trust”, ndërsa në Evropë përdoret “ligji i konkurrencës”. Prandaj, të dy termat përdoren në versionin anglisht të Konventës.
71. Në lidhje me fushën e veprimit material, nënparagrafi (p) i përjashton lëndët anti-trust (të konkurrencës), “përveç kur vendimi mbështetet në sjellje që përbëjnë marrëveshje anti-konkurrese apo praktika të bashkërenduara midis konkurrentëve aktualë apo potencialë për të fiksuar çmimet, për të bërë oferta mashtruese, vendosur kufizime në produkte apo kuota, apo për të ndarë tregjet, klientët, furnitorët, territoret apo linjat e tregtisë”. Ky formulim kërkon të përfshijë në fushën e veprimit të Konventës një shkelje të ligjit anti-trust (të konkurrencës) për të cilën duket se ka një konsensus global, *pra*, të ashtuquajturit “kartelet anti-konkurrencë”. Formulimi është frymëzuar nga Rekomandimi i OECD-së i vitit 1998,⁷¹ dhe sqaron se marrëveshjet anti-konkurrencë apo praktikrat e bashkërenduara midis “konkurrentëve potencialë” (*për shembull*, një marrëveshje

⁷⁰ Për një analizë të mëtejshme të mendimeve të ndryshme për këtë çështje, shih, “Raport i grupit V informal të punës – përjashtime të mundshme të çështjeve anti-trust (konkurrencës)”, Dok. paraprak nr. 6 i prillit 2019 në vëmendje të Sesionit njëzetë e dy për njohjen apo zbatimin e vendimeve të huaja gjyqësore (18 qershor – 2 korrik 2019).

⁷¹ Rekomandimi i Këshillit të OECD-së lidhur me veprim efikas kundër karteleve anti-konkurrencë, miratuar më 25 mars 1998; tani zëvendësuar nga Rekomandimi i Këshillit të OECD-së lidhur me veprime efikase kundër karteleve të tillë, miratuar më 2 korrik 2019 (më poshtë “rekomandimi i OECD-së i 2019”).

për të mos konkurruar apo për të mos hyrë në treg) janë përfshirë gjithashtu.⁷² Termi “praktikë e bashkërenduar” apo “veprime të bashkërenduara” përdoret rëndom në ligjin anti-trust (të konkurrencës) dhe u referohet veprimeve të përbashkëta midis ndërmarrjeve që nuk arrijnë fazën e një marrëveshjeje formale. Rekomandimi i OECD-së i 1998 është një burim i dobishëm udhëzues në interpretimin e kësaj dispozite që tregon, për shembull, se kufizimi i përjashtimit në nënparagrafin (p) nuk mbulon marrëveshjet, praktikat e bashkërenduara, ose rregullimet që janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me realizimin e ligjshëm të uljes së kostos apo efektivitetit të rritjes së produkteve.⁷³ Nga ana tjetër, Konventa nuk zbatohet për kategori të tjera të ligjit anti-trust (të konkurrencës), në veçanti, për ndalimet apo kufizimet e sjelljes së njëanshme të operatorëve të tregut (*për shembull*, abuzimi me pozitën sunduese), ose ndalimet e bashkimeve dhe përthithjeve që kufizojnë konkurrencën.

72. Për të trajtuar shqetësime lidhur me jashtë-territorialitetin, përfshirja e sjelljeve të renditura anti-konkurrencë në fushën e veprimit të Konventës kufizohet me rastet që kanë një lidhje të fortë me Shtetin e origjinës. Sipas fjalisë së fundit të nënparagrafit (p), Konventa zbatohet në rastet e sjelljeve të listuara anti-konkurrese, por vetëm “[...] kur sjellje të tilla dhe efektet e tyre kanë ndodhur në Shtetin e origjinës”. Në parim, termi “sjellje” u referohet marrëveshjes anti-konkurrese apo praktikave të bashkërenduara, të cilat duhet të kenë ndodhur në Shtetin e origjinës. Termi “efekt” i referohet efektit në treg në Shtetin e origjinës. Sjellja duhet të ketë ndodhur në Shtetin e origjinës dhe duhet të ketë ndikuar në tregun e atij Shteti, pavarësisht nga fakti se mund të ketë ndikuar edhe në tregje të tjera.⁷⁴ Kjo kërkesë për një lidhje me Shtetin e origjinës ka të bëjë vetëm me fushën e veprimit të Konventës. Edhe brenda fushës së veprimit, për të qarkulluar, një vendim gjyqësor duhet gjithashtu të plotësojë një nga filtrat juridiksionalë të parashikuar nga neni 5 (vini re, gjithsesi, filtri për veprime jo kontraktuese në nenin 5(1)(j) nuk mbulon thjesht dëmet financiare apo ekonomike).
73. Gjithsesi, meqenëse Konventa zbatohet vetëm për lëndë civile apo tregtare, çdo vendim që rezulton nga autoritetet anti-trust (të konkurrencës) që ushtrojnë kompetenca shtetërore apo sovrane është i përjashtuar (shih *supra*, para. 35). Nga ana tjetër, vendimet gjyqësore për padi kontraktuese apo jo kontraktuese përfshihen, pavarësisht nga natyra e palëve (shih *supra*, para 30 dhe 37, dhe *infra*, para. 82). Konteksti kontraktues përfshin, për shembull, rastet kur një person i cili është palë në një marrëveshje anti-konkurrencë përdor anulimin e kësaj marrëveshjeje, ose kur një blerës kërkon kthimin e vlerës dhe çmimeve jashtëzakonisht të larta që i ka paguar shitësit si rrjedhojë e faktit që ky i fundit është përfshirë në një marrëveshje për fiksimin e çmimit. Një shembull jo kontraktues do të ishte një padi

⁷² Fjalët “aktual ose potencial” gjithashtu janë shtuar në Rekomandimin e OECD-së së 2019.

⁷³ Shih Neni 2(b) i Rekomandimit të OECD-së i 1998 .

⁷⁴ Nëse vendimi mbulon efektet anti-konkurrencë në Shtete të tjera nga Shteti i origjinës, zbatimi i Konventës do të kufizohet në atë pjesë të vendimit që jepet për efektin që ka në Shtetin e origjinës, nëse ai është i ndashëm (shih, nenin 9).

nga një palë e tretë për kompensim si pasojë e fiksimit të çmimit apo një sjelljeje përjashtuese. Veprime të tilla përfshihen pavarësisht nëse mbështeten apo jo në një vendim të mëparshëm lidhur me një shkelje të ligjeve të konkurrencës nga një autoritet anti-trust (i konkurrencës) ose nga një gjykatë me kërkesë të autoritetit, *pra*, nëse ato paraqiten si veprime të veçara, apo si veprime të vazhdueshme.

Nënparagrafi (q) – ristrukturimi i borxhit shtetëror nëpërmjet masave të njëanshme të shtetit.

74. Nënparagrafi (q) përjashton ristrukturimin e borxhit shtetëror përmes masave të njëanshme shtetërore. Koncepti i “ristrukturimit të borxhit shtetëror” është marrë nga rezoluta e Kombeve të Bashkuara për këtë çështje, e cila njih të drejtën e një shteti sovran, në ushtrimin e të drejtës së tij për të vendosur, për të projektuar politikën makroekonomike të tij, duke përfshirë ristrukturimin e borxhit shtetëror.⁷⁵ Fjala “i njëanshëm” është përfshirë për të ngushtuar gamën e përjashtimit. Ajo mbulon masat për ristrukturimin e detyruar të borxhit të miratuar nga një shtet, *pra*, masat që nuk janë parashikuar në kushtet fillestare të huamarrjes dhe që janë miratuar pa apo kundër pëlqimit të investitorëve. Në një masë të madhe, masat e njëanshme të ristrukturimit të borxhit shtetëror dalin jashtë fushës së veprimit të Konventës, sipas nenit 1(1). Por, Sesioni njëzetë e dy e pa me vend të shtojë një përshkrim të shprehur të këtyre çështjeve për të parandaluar çdo keqinterpretim.⁷⁶

Paragrafi 2 – Vendimi gjyqësor nuk përjashtohet nga fusha e veprimit të kësaj Konvente, kur një çështje për të cilën kjo Konventë nuk zbatohet, është ngritur thjesht si pyetje paraprake gjatë procedurës që çoi në vendimin gjyqësor, dhe jo si objekt i procedurës. Në veçanti, vetë fakti që një çështje e tillë është ngritur nga mbrojtja, nuk e përjashton vendimin gjyqësor nga Konventa, nëse kjo çështje nuk ka qenë objekt i procedimit.

75. Çështjet paraprake janë çështje ligjore që duhen trajtuar përpara se të vendoset për kërkesën e paditësit, por që nuk janë objekti kryesor apo çështja kryesore e procesit.⁷⁷ Ky paragraf pranon faktin se çështjet ligjore të një vendimi gjyqësor mund të jenë të ndara nga njëra tjetra, por shqyrtohen njëra pas tjetrës, kur vendimi për çështjen kryesore bazohet në një vendim për një tjetër çështje paraprake. Për shembull, në një padi për dëmshpërblim për shkelje të një kontrate shitjesh (objekti kryesor), së

⁷⁵ Shih, Rezoluta e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme më 9 shtator 2014, 68/304, Drejt ngritjes së një kuadri ligjor multilateral për proceset e ristrukturimit të borxhit shtetëror; Rezoluta e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme më 29 dhjetor 2014, 69/247, Modalitetet për zbatimin e rezolutës 68/304; dhe Rezoluta e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme më 10 shtator 2015, 69/319, Parimet bazë të proceseve të ristrukturimit të borxhit shtetëror.

⁷⁶ Në fakt, karakterizimi i masave të ristrukturimit të borxhit shtetëror si “lëndë civile apo tregtare” është diskutuar në vendimet paraprake nga Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian (JEU). Shih, në veçanti, Vendimi i 15 nëntorit 2018, *Hellenische Republik kundër Leo Kuhn*, C-308/17, EU:C:2018:911.

⁷⁷ “Objekti” ka si qëllim çështjen me të cilën merret drejtpërdrejt procesi dhe që përcaktohet kryesisht nga kërkesa e paditësit. Shih, Raporti Hartley/Dogauch, para. 77 dhe 194. Termat “çështje të rastësishme” dhe “çështje kryesore” janë përdorur në Raportin Nygh/Pocar, para. 177.

pari, gjykata mund të duhet të vendosë për zotësinë e një pale për të lidhur një kontratë (çështja paraprake), ose në rastin e një padie që kërkon pagesën e dividendëve të një shoqërie tregtare (si objekti kryesor), gjykata mund të duhet të vendosë për vendimin e takimit të aksionarëve që miraton një pagesë të tillë (si një çështje paraprake). Çështjet paraprake zakonisht, por jo gjithnjë, paraqiten nga i padituri si një mënyrë për t'u mbrojtur. Sigurisht, çështja nëse vendimi i formës së prerë mund të kuptohet se varet nga përgjigja e çështjes paraprake mund të ngrihet, pavarësisht nga fakti nëse vendimi për një çështje të tillë paraprake është formalisht pjesë e vendimit të formës së prerë.

76. Paragrafi 2 parashikon se një vendim gjyqësor nuk përjashtohet nga fusha e veprimit të Konventës kur një nga çështjet e përjashtuara përfshihet thjesht si një çështje paraprake dhe në veçanti kur ajo del si një mënyrë për t'u mbrojtur. Kështu, zbatimi i Konventës përcaktohet nga objekti i procesit. Nëse objekti i procesit në gjykatën e origjinës hyn në fushën e veprimit Konventës, siç është rasti në shembujt e përmendur më lart, ky instrument zbatohet. Kjo dispozitë duhet interpretuar së bashku me nenin 8, i cili trajton pasojat e një vendimi për një çështje paraprake, duke përfshirë nëse një vendim gjyqësor që vendos për çështje të tilla mund të qarkullojë sipas Konventës (shih *infra*, para. 277-287).
77. Neni 2(2) i Konventës i referohet çdo çështjeje “për të cilën kjo Konventë nuk zbatohet”, që kap çështje të përjashtuara sipas nenit 1(1), nenit 2(1) ose nenit 18. Kështu, për shembull, një vendim gjyqësor për dëme kontraktuese i mbështetur në një gjetje se i padituri e ka pasur zotësinë e nevojshme për të kontraktuar – gjetje që ndryshe do të ishte një çështje e përjashtuar sipas nenit 2(1)(a) – nuk përjashtohet nga fusha e veprimit të Konventës, megjithëse njohja apo zbatimi i saj mund të refuzohet sipas nenit 8 (shih *infra*, para. 285-286).

Paragrafi 3 – Kjo Konventë nuk zbatohet në rastin e arbitrazhit dhe procedimeve përkatëse.

78. Paragrafi 3 përjashton procesin e arbitrazhit dhe procese të lidhura me të. Ky përjashtim duhet interpretuar në një kuptim të gjerë, për të mos lejuar që Konventa të ndërhyjë në arbitrazh dhe konventat ndërkombëtare për këtë temë, veçanërisht Konventa e Nju Jorkut e vitit 1958.⁷⁸ Përjashtimi mbulon si vendimet e arbitrazhit, ashtu edhe vendimet gjyqësore të lidhura me arbitrazhin. Për shembull, Konventa nuk zbatohet për njohjen apo zbatimin e vendimeve të arbitrazhit, ose për njohjen apo zbatimin e vendimeve gjyqësore që ndihmojnë procesin e arbitrazhit, *për shembull*, duke deklaruar nëse klauzola e arbitrazhit është e vlefshme, jovepruese apo e paaftë të zbatohet; duke i urdhëruar palët të vazhdojnë me procesin e arbitrazhit ose ta ndërpresin këtë proces; duke caktuar apo hequr gjykatësit arbitra; duke

⁷⁸ Konventa për njohjen apo zbatimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit, Nju Jork, 1958 (më poshtë, “Konventa e Nju Jorkut e vitit 1958”). Shih gjithashtu Raporti Hartley/Dogauch, para. 84.

caktuar vendin e arbitrazhit; ose duke zgatur afatin e dhënies së vendimeve.⁷⁹ Përrjashtimi gjithashtu mbulon vendimet gjyqësore që shpallin nëse një vendim arbitrazhi duhet njohur apo zbatuar, si edhe vendimet gjyqësore që e pushojnë, anulojnë apo ndryshojnë një vendim arbitrazhi.

79. Kur vendimi ka të bëjë me lëndë civile apo tregtare, përrjashtimi i procesit të arbitrazhit dhe proceseve të lidhura mund të ndikojë në zbatimin e neneve të tjera të Konventës si neni 4(1), i cili ka të bëjë me detyrimin për të njohur dhe zbatuar vendime gjyqësore të dhëna në një Shtet tjetër. Kështu, sipas paragrafit 3, përrjashtimi i procesit të arbitrazhit dhe proceseve të lidhura, Shteti i kërkuar mund të refuzojë, në bazë të ligjit të tij të brendshëm ose të instrumenteve të tjera ndërkombëtare, të njohë apo ekzekutojë një vendim gjyqësor të dhënë në një Shtet tjetër, nëse procedurat gjyqësore në Shtetin e origjinës kanë qenë në kundërshtim me një marrëveshje arbitrazhi, edhe Nëse gjykata e origjinës ka dhënë vendim për vlefshmërinë e marrëveshjes së arbitrazhit.⁸⁰ Meqenëse qëllimi i këtij përrjashtimi është të sigurojë që Konventa të mos ndërhyjë në arbitrazh, ajo kërkon që gjykata e Shtetit të kërkuar gjithashtu të mund të refuzojë të njohë apo ekzekutojë një vendim gjyqësor të dhënë, pavarësisht nga marrëveshja e arbitrazhit, edhe nëse vlefshmëria e kësaj marrëveshjeje nuk është trajtuar nga gjykata e origjinës, *për shembull*, nëse është një vendim në mungesë. Megjithatë, nëse i padituri ka dalë përpara gjykatës së origjinës dhe ka argumentuar themelin e çështjes, pa përdorur marrëveshjen e arbitrazhit vendimi në parim nuk do të ishte i përrjashtuar nga fusha e veprimtimit të Konventës, sipas kësaj dispozite.
80. Në të njëjtën mënyrë, Shteti i kërkuar mund të refuzojë, në bazë të ligjit të tij të brendshëm ose të instrumenteve të tjera ndërkombëtare, të njohë apo ekzekutojë një vendim gjyqësor të dhënë në një Shtet tjetër, nëse ai vendim është i papajtueshëm me një vendim arbitrazhi.
81. **Zgjidhja alternative e mosmarrëveshjeve.** Megjithatë, paragrafi 3 nuk i mbulon format e tjera të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve (ZAM), *për shembull*, pajtimin apo ndërhyrjen. Si rrjedhojë, fakti që procedurat gjyqësore në gjykatën e origjinës kanë qenë në kundërshtim me një marrëveshje për një mekanizëm të ZAM-së (si një alternativë ndaj apo përpara në procesi gjyqësor) nuk përbën bazë për njohje apo zbatim. Natyrisht, Konventa nuk zbatohet për njohjen apo zbatimin e zgjidhjeve alternative, duke qenë se ato nuk plotësojnë kushtet si “vendime gjyqësore” sipas nenit 3(1)(b) të Konventës, *pra*, ato nuk janë “vendime për themelin e një çështjeje dhënë nga një gjykatë” (që të kenë mundësi të quhen si “zgjidhje gjyqësore”, shih, *infra*, para.295-296).

⁷⁹ Raporti Hartley/Dogauch, para. 84.

⁸⁰ Duhet pasur parasysh se as neni 2(2) as neni 8(2) nuk kanë lidhje me këtë çështje. Këto dispozita u referohen “çështjeve” në kuptimin e subjekteve, ndërsa përrjashtimi i arbitrazhit ka një natyrë të ndryshme dhe përrfshihet në një dispozitë tjetër.

Paragrafi 4 – Vendimi gjyqësor nuk përjashtohet nga fusha e veprimit të kësaj Konvente për faktin e thjeshtë se shteti, ku përfshihet qeveria, agjencia qeveritare ose çdo person që vepron për shtetin, ka qenë palë në procedim.

82. Paragrafët 4 dhe 5 trajtojnë zbatimin e Konventës në mosmarrëveshje që përfshijnë Shtetet dhe organet e tjera shtetërore. Paragrafi 4 parashikon që thjesht fakti që një Shtet, duke përfshirë qeverinë, një agjenci shtetërore apo çdo person që vepron për një Shtet, ka qenë palë në një proces në Shtetin e origjinës nuk e përjashton një vendim gjyqësor nga fusha e veprimit të Konventës. Ky paragraf konfirmon se është natyra e një mosmarrëveshjeje, dhe jo natyra e palëve apo të gjykatave, që është përcaktuese (Neni 1(1): shih, *supra*, para. 28-30). Paragrafi 4 është kështu thjesht sqarues. Megjithatë, ai duhet interpretuar bashkë me nenin 19, i cili i lejon Shtetet të deklarojnë se nuk do ta zbatojnë Konventën për ato vendime gjyqësore në procese ku ato kanë qenë palë (shih *infra*, para. 343-351) dhe nenin 2(5), i cili mbron zbatimin e rregullave për privilegjet dhe imunitetet (shih *infra*, para. 86).
83. Pavarësisht nga deklaratimet sipas nenit 19, Konventa zbatohet kur një Shtet ose një agjenci shtetërore vepron si një person privat, *pra*, pa ushtruar të drejta sovrane dhe pavarësisht nëse subjekti publik është kreditori apo debitori për të cilin është dhënë vendimi. Ka tri kritere bazë që janë me rëndësi për të përcaktuar nëse Konventa zbatohet për mosmarrëveshje që përfshijnë Shtetet palë:
- “(i) sjellja mbi të cilën është bazuar padija është një sjellje në të cilën një person privat mund të përfshihet;
 - (ii) Dëmtimi i pretenduar mund të pësohet nga një person privat;
 - (iii) Përfitimi që kërkohet është i llojit të disponueshëm për personat privatë që kërkojnë një dëmshpërblim për të njëjtën dëmtim, si rrjedhojë e të njëjtës sjellje.”⁸¹
84. Ndryshe nga paragrafi 5, i cili ka të bëjë me privilegjet dhe imunitetet, kjo dispozitë nuk u referohet shprehimisht “organizatave ndërkombëtare”. Megjithatë, një vendim gjyqësor nuk është i përjashtuar thjesht nga fakti se një organizatë ndërkombëtare ka qenë palë në proces në masën që ka vepruar si një person privat.

Paragrafi 5 – Asgjë në këtë Konventë nuk prek privilegjet dhe imunitetet e shteteve ose organizatave ndërkombëtare, në lidhje me to dhe pronën e tyre.

85. Paragrafi 5 parashikon se asgjë në Konventë nuk i prek privilegjet dhe imunitetet e Shteteve apo organizatave ndërkombëtare, në lidhje me veten dhe pronat e tyre. Ai gjithashtu mbulon Zyrtarët e Shtetit, persona të tjerë që kanë të drejtë të gëzojnë imunitet diplomatik apo konsullor, dhe organet publike të tilla si bankat qendrore, në masën që ata gëzojnë privilegjet dhe imunitetet të cilave u referohet neni 2(5).⁸²

⁸¹ Dok. Paraprak, nr. 4 i dhjetorit 2016, para. 40.

⁸² Raporti Nygh/Pocar, para. 46.

86. Ky paragraf është një “klauzolë me efekt zero”, i synuar vetëm të parandalojë keqinterpretimin e paragrafit 4.⁸³ Ai nuk prek kuptimin apo fushën e veprimit të privilegjeve apo imuniteteve sipas të drejtës ndërkombëtare. Nuk ka implikime për pretendimet e një Shteti ndaj imunitetit juridiksional përpara një gjykate të origjinës, ose pretendimeve për imunitet juridiksional apo imunitet nga ekzekutimi në gjykatën e Shtetit të kërkuar.⁸⁴
87. Në parim, nuk ka konflikt midis fushës së veprimit të Konventës, siç përcaktohet në nenin 1(1), dhe privilegjeve dhe imuniteteve të Shteteve. Meqenëse këto privilegje dhe imunitete zakonisht lidhen me ushtrimin e autoritetit të një Shteti (*acta iure imperii*), situatat që përfshijnë privilegje dhe imunitete nuk bëhen shkas për vendime gjyqësore në lëndë civile apo tregtare. Po ashtu, kur një vendim gjyqësor është jashtë fushës së veprimit të Konventës sipas nenit 1(1), edhe nëse një Shtet heq dorë nga imuniteti i tij dhe i nënshtrohet juridiksionit të gjykatës së një Shteti të huaj, Konventa nuk zbatohet për njohjen apo zbatimin e atij vendimi.⁸⁵
88. Imunitetet e Shteteve dhe të organeve shtetërore mund të jenë me rëndësi në lëndë civile apo tregtare, *për shembull*, nëse imuniteti mbulon një padi jashtë kontraktuese kundër një përfaqësuesi diplomatik që buron nga *acta iure gestionis* (shih, neni 31 Konventës së 18 prillit 1961 për Marrëdhëniet Diplomatike). Në një rast të tillë, efekti i paragrafit 5 do të jenë që Konventa nuk zbatohet përveç se kur Shteti heq dorë nga imuniteti i tij dhe i dorëzohet juridiksionit të gjykatës së Shtetit të origjinës.⁸⁶ Edhe në një rast të tillë, asgjë në vetë Konventën nuk e prek përdorimin e imunitetit në Shtetin e kërkuar.
89. Megjithëse fusha e veprimit i privilegjeve dhe imuniteteve të Shteteve apo agjencive shtetërore përcaktohet nga e drejta ndërkombëtare publike, ai mund të specifikohet në legjislacionin e brendshëm në disa Shtete. Në këto raste, gjykatat i referohen legjislacionit përkatës kur zbatojnë paragrafin 5.

⁸³ Raporti Hartley/Dogauch, para. 87.

⁸⁴ Si pasojë, Konventa nuk ndërhyt në të drejtën e një Shteti për të përdorur privilegjet dhe imunitetet e tij përpara gjykatës së Shtetit të kërkuar si mbrojtje për të refuzuar njohjen apo zbatimin. Në një rast të tillë, meqë neni 2(5) është “një klauzolë me efekt zero”, nuk është nevoja të përdoret neni 7.

⁸⁵ Shih, Procesverbalet e Komisionit të Posaçëm për njohjen apo zbatimin e vendimeve të huaja gjyqësore (1-9 qershor 2016), Procesverbali nr. 8, para. 59.

⁸⁶ Dok. paraprak nr. 4 i dhjetorit 2016, para. 42.

Neni 3
Përkufizimet

1. **Në këtë Konventë:**
 - (a) **“i paditur”** do të thotë person ndaj të cilit është paraqitur padi ose kundërpadi në shtetin e origjinës;
 - (b) **“vendim gjyqësor”** do të thotë çdo vendim i gjykimit në themel, të dhënë nga gjykata, pa marrë parasysh emërtimin e vendimit, përfshirë një dekret apo një urdhër, dhe përcaktimi i kostove ose i shpenzimeve të procedurës nga gjykata (përfshirë zyrtari i gjykatës), me kusht që përcaktimi të ketë të bëjë me vendimin e gjykimit në themel, i cili mund të njihet ose zbatohet sipas kësaj Konvente. Masa e përkohshme e mbrojtjes nuk është vendim gjyqësor.

2. **Subjekti juridik ose personi i ndryshëm nga personi fizik konsiderohet se është banor me vendqëndrim të rregullt në një shtet:**
 - (a) **ku ka selinë ligjore;**
 - (b) **sipas ligjit të të cilit është themeluar ose formuar;**
 - (c) **ku ka administratën qendrore; ose**
 - (d) **ku ka vendin kryesor të ushtrimit të aktivitetit.**

90. Neni 3 përkufizon “të paditurin” dhe “vendimin” (para. 1) dhe specifikon se si të përcaktohet vendqëndrimi i rregullt i personave juridikë (para. 2), duke mbështetur interpretimin dhe zbatimin e njëjtë të Konventës (shih Neni 20).

Paragrafi 1 – Në këtë Konventë:

Nënparagrafi (a) – “i paditur” do të thotë person ndaj të cilit është paraqitur padi ose kundërpadi në shtetin e origjinës;

91. Termi “i paditur” përdoret në shumë dispozita të Konventës (neni 5(1)(d), (e), (f), (g), (i), neni 7(1)(a) dhe neni 19(1)). Neni 3(1)(a) e përkufizon “të paditurin” si personin ndaj të cilit është ngritur një padi apo kundërpadi në Shtetin e origjinës. Në kontekstin e kundërpadisë, termi i referohet paditësit fillestar apo çdo të padituri

tjetër në kundërpadi.⁸⁷ Në kontekstin e një padie të palës së tretë, *pra*, një padie të ngritur nga një i paditur për ta detyruar një palë të tretë të marrë pjesë në procedurat gjyqësore, “i padituri” duhet të interpretohet se i referohet palës së tretë kundër të cilës është ngritur kjo padi.

92. Për shkak se nënparagrafi (a) përqendrohet tek personi ndaj të cilit është *ngritur* padia apo kundërpadia, “i padituri” mund të jetë i ndryshëm nga personi kundër të cilit është dhënë vendimi. Madje “i padituri” mund të jetë gjithashtu i ndryshëm nga personi për të cilin kërkohet njohja apo zbatimi i vendimit në Shtetin e kërkuar (për raste të veçanta të marrjes përsipër të së drejtave (*subrogation*), transferimit të pasurisë apo trashëgimisë, shih *infra*, para. 144-146).

Nënparagrafi (b) – “vendim gjyqësor” do të thotë çdo vendim i gjykimit në themel, të dhënë nga gjykata, pa marrë parasysh emërtimin e vendimit, përfshirë një dekret apo një urdhër, dhe përcaktimi i kostove ose i shpenzimeve të procedurës nga gjykata (përfshirë zyrtari i gjykatës), me kusht që përcaktimi të ketë të bëjë me vendimin e gjykimit në themel, i cili mund të njihet ose zbatohet sipas kësaj Konvente. Masa e përkohshme e mbrojtjes nuk është vendim gjyqësor.

93. Pas KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës, nënparagrafi (b) e përkufizon “vendimin” si çdo vendim për themelin e çështjes, dhënë nga një gjykatë, duke përfshirë një vendim në mungesë, pavarësisht se si quhet ai vendim, si për shembull dekret, urdhër, etj. Një “vendim” përfshin përcaktimin e kostove apo shpenzimeve nga gjykata (duke përfshirë edhe nga një nëpunës i gjykatës), me kusht që përcaktimi të lidhet me një vendim për themel që mund të njihet apo zbatohet sipas Konventës. Gjithsesi, një masë e ndërmjetme mbrojtëse nuk është vendim gjyqësor për qëllimet e Konventës.
94. Ky përkufizim përmban dy elementë: vendimi duhet të jetë (i) “një vendim për themelin e çështjes” dhe (ii) i dhënë nga një “gjykatë”.
95. **Një vendim për themelin e çështjes.** “Një vendim për themel” nënkupton një lloj procesi gjyqësor me palë kundërshtarë në të cilën një gjykatë i jep zgjidhje një kërkesëpadie (për zgjidhje gjyqësore, shih, *infra*, Neni 11). Për aq sa vendimi përfshin zgjidhjen e një kërkesëpadie, ai përfshin vendime gjyqësore monetare dhe jo monetare, vendime gjyqësore të dhëna në mungesë (shih, gjithsesi, nenet 7(1) dhe 12(1)(b)),⁸⁸ dhe vendime gjyqësore për padi kolektive. Nga ana tjetër, vendimet procedurale (të ndryshme nga urdhrat që përcaktojnë kostot apo shpenzimet) janë të përjashtuara nga përkufizimi i vendimeve gjyqësore.⁸⁹ Pra, për shembull, vendimet që urdhërojnë publikimin e dokumenteve apo dëgjimin e një dëshmitari nuk janë vendime gjyqësore. Po ashtu, urdhrat *ex parte* për pagesa që kanë të bëjnë me kërkesa të pa kundërshtuara monetare, që mund të jepen nga një gjykatë në disa

⁸⁷ Termat “paditës” dhe “kërkues” janë të ndërkëmbyeshëm në këtë Raport.

⁸⁸ Vendimet gjyqësore në mungesë hyjnë në fushën e veprimit të Konventës, pavarësisht nga procesi me anë të të cilit është marrë vendimi, sipas ligjit të Shtetit të origjinës, duke përfshirë nëse vendimi është futur apo regjistruar nga një punonjës i gjykatës apo nga një gjyqtar.

⁸⁹ Raporti Hartley/Dogauch, para. 116.

juridiksione, nuk plotësojnë kushtet si vendime gjyqësore.⁹⁰ Së fundi, vendimet për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja gjyqësore apo të vendimeve të arbitrazhit të dhëna nga gjykatat e një Shteti nuk mund të njihen apo zbatohen në një Shtet tjetër sipas Konventës (*exequatur sur exequatur ne vaut*). Po ashtu, urdhrat përmbartimorë, si urdhrat për mbajtje të parave të borxhliut apo urdhrat për sekuestrim të pronës nuk plotësojnë kushtet si vendime gjyqësore.

96. **Vendimet gjyqësore jo monetare.** Vendimet gjyqësore që urdhërojnë një debitor të kryejë apo të mos kryejë një akt të caktuar, të tillë si sigurimi i padisë apo një urdhër për realizimin e një kontrate (vendime gjyqësore monetare apo jo monetare të formës së prerë) futen në fushën e veprimit Konventës. Në disa sisteme ligjore, vendimet gjyqësore jo monetare ndonjëherë përfshijnë penalitete pasurore (në frëngjisht, *astreintes*) për “të përforcuar” pjesën kryesore të vendimit. Vendime të tilla gjyqësore përmbajnë një detyrim parësor jo monetar – për të kryer apo mos kryer një akt – dhe një “penalitet” pasuror, si një detyrim dytësor të kushtëzuar, për të penguar mosrespektimin dhe për të nxitur respektimin e detyrimit. Regjimet juridike që rregullojnë penalitetet pasurore ndryshojnë shumë nga njëri tjetri.⁹¹
97. Përfshirja e këtyre penaliteteve “pasurore” u diskutua gjatë takimit të katërt të Komisionit të Posaçëm por nuk u arrit ndonjë përfundim përfundimtar.⁹² Tre faktorë mund të jenë me rëndësi për zbatimin e Konventës për këto penalitete pasurore. Në lidhje me këtë proces, në disa juridiksione këto penalitete urdhërohen nga gjykata që jep vendimin jo monetar, por në disa raste të tjera, ato urdhërohen nga një autoritet i ndryshëm në një procedurë të veçantë përmbartimore. Në lidhje me përmbajtjen e tyre, në disa raste, këto penalitete pasurore mund të jenë për një shumë fikse ose një penalitet periodik, *për shembull*, një shumë parash për çdo ditë vonesë.⁹³ Së fundi, në lidhje me përfituesin e urdhrit, në disa juridiksione këto penalitete pasurore u paguhen gjykatave ose autoriteteve të Shtetit (gjoha civile), por në raste të tjera, ato i paguhen kreditorit të vendimit edhe pse nuk janë realisht zhdëmtuese.⁹⁴ Sesioni njëzetë e dy nuk e diskutoi këtë çështje dhe si pasojë, kjo

⁹⁰ Disa Shtete kanë vendosur një procedurë të thjeshtuar për kërkesa të padiskutuara në para. Kjo procedurë bazohet në një urdhër fillestar për pagesa të nxjerrë nga gjykata në bazë të informacionit të dhënë nga kërkuesi, i cili i jep të paditurit opsionin e pagesës së shumës së dhënë kërkuesit, apo duke depozituar një deklaratë kundërshtuese. Nëse brenda një afati kohor të caktuar, nuk bëhet ndonjë deklaratë kundërshtuese, atëherë gjykata e konfirmon apo e deklaron urdhrin për pagesë të ekzekutueshme. Ky vendim i fundit hyn në fushën e veprimit Konventës.

⁹¹ Për diskutim, “Trajtimi i urdhrave për penalitete që vendosen për mosrespektimin e vendimeve gjyqësore jo monetare sipas projekt Konventës 2018”, Dok. paraprak nr. 3 i shkurtit 2019 në vëmendje të sesionit njëzetë e dy për njohjen apo zbatimin e vendimeve të huaja gjyqësore (18 qershor – 2 korrik 2019) (shih, rrugën e treguar në shënimin 54).

⁹² Shih, Procesverbalet e Komisionit të Posaçëm për njohjen apo zbatimin e vendimeve të huaja gjyqësore (24-29 Mund 2018), Procesverbali nr. 6, para. 42-51.

⁹³ Sipas “Bruksel Rregullorja”, për shembull, vendimet gjyqësore që urdhërojnë një pagesë si një formë penaliteti do të jenë të zbatueshme “vetëm nëse shumica e pagesës është përcaktuar në formë të prerë nga gjykata e origjinës” (shih Neni 55). Një rregull i ngjashëm gjendet në Konventën e 30 tetorit 2007 për juridiksion dhe njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore në lëndë civile dhe tregtare (më poshtë, “Konventa e Luganos e 2007”) (shih, neni 49).

⁹⁴ GJDEJ-ja ka ardhur në përfundim se Rregullorja 1 e Brukselit zbatohet për një penalitet pasuror që i

çështje ka mbetur e hapur për zhvillime të ardhshme nga gjykatat dhe studiuesit ligjorë.

98. **Vendimi për kostot.** Përkufizimi i vendimit në nënparagrafin (b) përfshin dy elementë shtesë. Së pari, përcaktimi i kostove apo shpenzimeve të një procesi nga një gjykatë,⁹⁵ duke përfshirë edhe nga një punonjës i gjykatës,⁹⁶ është gjithashtu një vendim gjyqësor për qëllimet e Konventës, me kusht që të lidhet me një vendim në themel, i cili mund të njihet dhe zbatohet sipas Konventës (shih gjithashtu, *infra*, neni 14(2)). Së dyti, përcaktimi i kostove mund të përfshihet në të njëjtin vendim, siç është ai në themel, ose në një vendim të veçantë. Në të dy rastet, njohja apo ekzekutimi sipas Konventës lidhet me vendimin në themel. Nëse vendimi në themel mund të mos njihet apo zbatohet sipas Konventës (për shembull, sepse është jashtë fushës së veprimit të saj, nuk i plotëson kushtet për njohje, apo sepse zbatohet një shkak për refuzim), atëherë edhe vendimi për kostot gjithashtu nuk do të njihet apo zbatohet. Me qëllim që përcaktimi i kostove të njihet dhe zbatohet, mjafton që vendimi për themelin e çështjes “të mund” të njihet apo ekzekutohet në Shtetin e kërkuar dhe jo që ndërkohë të jetë njohur dhe zbatuar. Edhe nëse, sipas një kushti të tillë, vendimi për kostot duhet të njihet dhe zbatohet sipas Konventës, zbatohet gjithashtu edhe neni 7. Pra, në raste të veçanta, vendimi për themelin e çështjes mund të njihet dhe zbatohet, por përcaktimi i kostove mund të mos njihet dhe zbatohet, për shembull, sepse mund të jetë marrë me mashtrim (shih, neni 7(1)(b)).
99. **Masat e përkohshme të mbrojtjes.** Nënparagrafi (b) parashikon se një masë e përkohshme mbrojtjeje nuk është një vendim gjyqësor për qëllimet e Konventës. “Masa e përkohshme e mbrojtjes” mbulon masat që u shërbejnë dy qëllimeve kryesore: ofrimit të një mjetei paraprak për sigurimin e pasurive të cilat duhet të shërbejnë si bazë për marrjen e një vendimi të formës së prerë, apo ruajtjes së *status quo*-së, në pritje të vendosjes së një çështjeje në gjykim.⁹⁷ Kështu, për shembull, një urdhër për ngrirjen e pasurive të një të padituri, një sigurim padie i përkohshëm, apo një urdhër i përkohshëm për pagesë mund të mos njihet apo zbatohet sipas Konventës. Por, ata gjithsesi mund të njihen dhe zbatohen sipas ligjit të brendshëm.
100. Nga kjo del se çdo urdhër për kosto që lidhen me masa të përkohshme mbrojtëse mund të mos njihet apo zbatohet, sepse masat e përkohshme mbrojtëse nuk pranohen për njohje apo zbatim.

duhet paguar Shtetit për aq sa lidhet me një mosmarrëveshje midis dy personave privatë (shih, GJED, Vendimi i 18 tetorit 2011, *Realchemie Nederldhe kundër Bayer*, C-406/09, EU:C:2011:668).

⁹⁵ Fjalët “i procesit” iu shtuan “kostove apo shpenzimeve” në versionin anglisht vetëm për të qenë në përputhje me versionin në frëngjisht të kësaj Konvente dhe të dispozitës ekuivalente në KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës. Kjo nuk prek interpretimin e “vendimit” sipas asnjërës prej këtyre konventave.

⁹⁶ Teksti në frëngjisht përdor shprehjen “une personne autorisée par le tribunal” [një person i autorizuar nga tribunali]. Ndryshe nga KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës, e cila i referohet “le greffier du tribunal”, Konventa përdor një term të ndryshëm për të përfshirë çdo punonjës të gjykatës që është i autorizuar në Shtetin e origjinës të përcaktojë kostot e procesit.

⁹⁷ Për përkufizimin e masave të përkohshme, shih, Raporti Nygh/Pocar, para. 178-180.

101. **Gjykata.** Me qëllim që një vendim për themelin e çështjes t'i plotësojë kushtet si vendim gjyqësor sipas nën-paragrafit (b), duhet të jetë dhënë nga një "gjykatë". Konventa nuk e përcakton "gjykatën". Në takimin e dytë të Komisionit të Posaçëm u propozua përkufizimi i mëposhtëm:

"gjykatë" do të thotë: (i) një tribunal që i përket gjyqësorit të një Shteti kontraktues në çdo shkallë, dhe

(ii) çdo tribunal tjetër i përhershëm që, sipas ligjit të një Shteti kontraktues, ushtron funksione juridiksionale për një subjekt të caktuar, sipas rregullave të paravendosura procedurale, duke qenë e pavarur dhe autonome."⁹⁸

102. Propozimi nuk u miratua sepse ishte e vështirë të artikulohej një përkufizim i saktë.⁹⁹ Në parim, termi "gjykatë" duhet të interpretohet në mënyrë autonome dhe u referohet autoriteteve ose organeve që janë pjesë e degës apo sistemit gjyqësor të një Shteti dhe që ushtron funksione gjyqësore. Ai nuk përfshin autoritetet administrative, noterët apo autoritetet jo shtetërore.

103. Konventa nuk shprehet gjithashtu as për të ashtuquajturën "gjykatë e përbashkët", ndonëse pati një diskutim të gjatë për këtë temë deri në sesionin njëzetë e dy. Një gjykatë e përbashkët i referohet një gjykate ku një grup shtetesh kanë transferuar apo deleguar të drejtat e tyre gjyqësore për një apo disa lëndë. Për shembull, gjykatat e përbashkëta janë ngritur për çështje të pronësisë intelektuale.¹⁰⁰ Përfshirja e pronësisë intelektuale nga fusha e veprimit të Konventës sipas nenit 2(1)(m) hoqi stimulim kryesor për përfshirjen e rregullave të posaçme për këto gjykata. Kjo nuk do të thotë që vendimet gjyqësore të dhëna nga një gjykatë e përbashkët që ushtron juridiksion për çështje të mbuluara nga Konventa të mos i plotësojnë kushtet për njohje apo zbatim. Vendime të tilla gjyqësore do të qarkullojnë nëse plotësohen kushtet sipas Konventës, duke përfshirë përkufizimin e vendimit në nenin 3 dhe treguesit e "gjykatës" të vënë në dukje në paragrafin e mëparshëm. Në rast se një vendim gjyqësor i një gjykate të përbashkët do të silllej për njohje apo zbatim, është detyrë e gjykatës së Shtetit të kërkuar të përcaktojë nëse kjo gjykatë mund të konsiderohet gjykatë e një Shteti kontraktues dhe, nëse po, si do të zbatohen filtrat e parashikuar nga nenet 5 dhe 6.¹⁰¹

⁹⁸ Dok. pune nr. 166 i shkurtit 2017, "Propozimi i delegacioneve i Ekuadorit dhe Uruguait" (Komisioni i Posaçëm për Njohjen dhe zbatimin e Vendimeve të Huaja Gjyqësore (16-24 shkurt 2017)). Shih, gjithashtu Dok. pune nr. 235 i nëntorit 2017, "Propozimi i delegacioneve të Ekuadorit dhe Uruguait" (Komisioni i Posaçëm për Njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja gjyqësore (13-17 nëntor 2017)).

⁹⁹ Shih, *Aide memoire i Kryetarit* të Komisionit të Posaçëm (Komisioni i Posaçëm për Njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja gjyqësore (16-24 shkurt 2017)), para. 21. Kjo vështirësi në përkufizim është hasur në konventa të tjera ndërkombëtare dhe ka rezultuar në mungesën e përgjithshme të një përkufizimi gjithëpërfshirës të termit "gjykatë" nga instrumente të tilla si KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës. Gjithashtu duhet vënë në dukje se në Takimin e Dytë të Komisionit të Posaçëm, ekspertët morën parasysh se një gjykatë mund të ketë karakteristika të mëtejshme; shih, Procesverbalet e Komisionit të Posaçëm për njohjen apo zbatimin e vendimeve të huaja gjyqësore (16-24 shkurt 2017), Procesverbalet nr. 11, para. 48-56.

¹⁰⁰ Shih, *për shembull*, Gjykata e Unifikuar e Patentave, Gjykata e Drejtësisë e Komunitetit të Andeve.

¹⁰¹ Një çështje për ta pasur parasysh është që gjykata e përbashkët në fjalë është e përbashkët vetëm

Paragrafi 2 – Subjekti juridik ose personi i ndryshëm nga personi fizik konsiderohet se është banor me vendqëndrim të rregullt në një shtet:

104. Paragrafi 2 trajton “vendqëndrimin e rregullt” të subjekteve apo personave të tjerë nga personat fizikë. Këto subjekte konsiderohen të jenë banorë të rregullt në Shtetin (i) ku ata kanë selinë e tyre ligjore, (ii) nën ligjin e të cilit ata janë themeluar apo krijuar, (iii) ku ata kanë administratën qendrore, ose (iv) ku kanë selinë kryesore të biznesit.¹⁰² Termi “banor me vendqëndrim të rregullt” përdoret në nenin 5(1)(a).¹⁰³
105. Kjo dispozitë zakonisht përdoret për korporatat, por ajo mbulon gjithashtu edhe personat juridikë dhe shoqatat apo subjektet e pa themeluara, *pra*, shoqatat e personave fizikë apo juridikë që nuk kanë personalitet ligjor por që kanë zotësi, sipas ligjit që i rregullon ata, të jenë palë në një procedurë gjyqësore.

Nënparagrafi (a) – ku ka selinë ligjore;

Nënparagrafi (b) – sipas ligjit të të cilit është themeluar ose formuar;

106. Termat “selia ligjore” dhe ligji sipas të cilit “subjekti është themeluar apo formuar” u referohen dy rrethanave të ndryshme ligjore. I pari është “vendqëndrimi” i subjektit, sikundër përcaktohet nga aktet nënligjore apo dokumente të tjera përbërëse. Termi më i afërt ekuivalent në ligjin anglez është “zyra e regjistruar”. Kjo e fundit i referohet ligjit të shtetit sipas të cilit subjekti është krijuar, *pra*, ligjit që e lindi atë dhe që e pajisi me personalitet ligjor apo zotësi procedurale.¹⁰⁴ Në praktikë, selia ligjore dhe vendi i themelimit zakonisht përkojnë në të njëjtin Shtet.

për një grup Shtetesh Kontraktuese. Përdorimi i filtrave nuk bëhet shkas për lindjen e vështirësive kur të gjitha Shtetet në emër të të cilave gjykatës e përbashkët ushtron juridiksion, janë Shtete kontraktuese. Nëse kjo nuk ndodh, mund të dalë problemi i përfitimit në mënyrë të njëanshme kur një Shtet jo kontraktues përfiton nga anëtarësia e tij në Gjykatën e përbashkët. Megjithatë, kur filtri i zbatueshëm sipas nenit 5 tregon një lidhje objektive territoriale me Shtetin e origjinës, ky risk mund të shmanget kur anëtarësia në gjykatën e përbashkët mund të përfshijë Shtete jo kontraktuese, duke pranuar vetëm ato vendime gjyqësore ku vërtetohet lidhja me një Shtet kontraktues. E vetmja qasje mund të përdoret nëse të gjithë janë Shtete kontraktuese por kur, lidhur me një apo më shumë prej këtyre shteteve, një Shtet i tretë kontraktues ka bërë një deklaratë sipas nenit 29. Si pjesë e diskutimeve të gjera për gjykatat e përbashkëta, është pranuar se kur një gjykatë i shërben më shumë se një Shteti, por ka vetëm funksione apeli, *për shembull*, Komiteti Gjyqësor i Këshillit Juridik (Privy Council), ajo është një gjykatë e një Shteti kontraktues në lidhje me çdo vendim që jepet në apel për një vendim të dhënë nga një gjykatë e një Shteti kontraktues.

¹⁰² Raporti Hartley/Dogauchi (para. 120-123) shpjegon logjikën mbi të cilën mbështeten këto kritere alternative. Vini re gjithashtu se Raporti Hartley/Dogauchi shpjegon që “Një Shtet ose një autoritet publik i një Shteti do të quhej banor vetëm në territorin e atij Shteti”, shih, vini re 148 e Raportit Hartley/Dogauch. E njëjta gjë vlen edhe për qëllimet e Konventës.

¹⁰³ Nenet 14 dhe 17 përdorin vetëm termin “banor” (pa asnjë cilësim) për të rritur fleksibilitetin e këtyre dy rregullave.

¹⁰⁴ Raporti Hartley/Dogauch, para. 120.

Nënparagrafi (c) – ku ka administratën qendrore; ose***Nënparagrafi (d) – ku ka vendin kryesor të ushtrimit të aktivitetit.***

107. Termat “administrata qendrore” dhe “vendi kryesor i biznesit” u referohen dy rrethanave të ndryshme faktike. I pari i referohet vendit ku kryen funksionet e zyrës qendrore, *pra*, ku merren vendimet më të rëndësishme për administrimin e subjektit. Termi ka të bëjë me “trurin” e subjektit. Ky i fundit i referohet qendrës kryesore të veprimtarisë ekonomike të subjektit.¹⁰⁵ Ai ka të bëjë me “muskujt” e subjektit. Për shembull, një shoqëri minierash mund t’i ketë zyrat qendrore të saj në Londër, por veprimtarinë minerare e kryen në Namibi.¹⁰⁶
108. Të dy nënparagrafët përdorin përemrin pronor “të tij” dhe si rrjedhojë u referohen administratës qendrore apo vendit kryesor të biznesit të subjektit apo personit të përmendur në krye të paragrafit 2, dhe jo filialit të tij, apo një subjekti tjetër me personalitet ligjor.
109. Katër kriteret e paragrafit 2 janë alternativa dhe midis tyre nuk ka hierarki. Gjithashtu, ato nuk përjashtojnë njëra-tjetrën. Nëse i padituri është banor i rregullt në dy apo më shumë shtete njëkohësisht, i padituri duhet të konsiderohet se është banor i rregullt në secilin prej tyre. Për shembull, nëse shoqëria X është e themeluar në Shtetin A, e ka administratën e saj qendrore në Shtetin B, dhe vendin kryesor të biznesit e ka në Shtetin C, një vendim gjyqësor kundër shoqërisë X i dhënë nga një gjykatë i secilit prej këtyre tre Shteteve do të i plotëson kushtet për njohje apo zbatim vendimi sipas nenit 5(1)(a).

¹⁰⁵ *Po aty.*

¹⁰⁶ *Po aty.*

KAPITULLI II – NJOHJA DHE ZBATIMI**Neni 4*****Dispozita të përgjithshme***

- 1. Vendimi gjyqësor i dhënë nga gjykata e një Shtet Kontraktues (shteti i origjinës) njihet dhe zbatohet në Shtetin Kontraktues tjetër (Shteti i kërkuar) në përputhje me dispozitat e këtij Kapitulli. Njohja ose zbatimi mund të refuzohet vetëm për arsye të bazuara, të specifikuara në këtë Konventë.**
- 2. Në Shtetin e kërkuar nuk behet rishikimi i vendimit gjyqësor për gjykimin në themel. Mund të bëhet vetëm një vlerësim i nevojshëm për zbatimin e kësaj Konvente.**
- 3. Vendimi gjyqësor njihet vetëm nëse ai ka hyrë në fuqi në shtetin e origjinës dhe zbatohet vetëm nëse ai është i zbatueshëm në shtetin e origjinës.**
- 4. Njohja ose zbatimi mund të shtyhet ose të refuzohet nëse vendimi gjyqësor i përmendur në paragrafin 3, është objekt rishikimi në shtetin e origjinës, ose nëse nuk ka skaduar afati kohor për të kërkuar rishikim të zakonshëm. Refuzimi nuk parandalon paraqitjen e një kërkesë tjetër për njohjen ose zbatimin e vendimit gjyqësor.**

110. Neni 4 vendos detyrimin e njohjes apo ekzekutimit të ndërsjellë të vendimeve gjyqësore midis Shteteve (para. 1), duke përcaktuar kushtet dhe pasojat e përgjithshme të atij detyrimi. Një vendim gjyqësor i dhënë në një Shtet tjetër do të njihet dhe zbatohet në Shtetin e kërkuar pa shqyrtuar themelin e atij vendimi (para. 2), por vetëm për atë që ka efekt dhe është i zbatueshëm në Shtetin e origjinës (para. 3). Së fundi, paragrafi 4 trajton ato çështje ku vendimi është subjekt shqyrtimi në Shtetin e origjinës, ose kur afati kohor për kërkimin e një shqyrtimi të tillë nuk ka kaluar.

Paragrafi 1 – Vendimi gjyqësor i dhënë nga gjykata e një Shtet Kontraktues (shteti i origjinës) njihet dhe zbatohet në Shtetin Kontraktues tjetër (Shteti i kërkuar) në përputhje me dispozitat e këtij Kapitulli. Njohja ose zbatimi mund të refuzohet vetëm për arsye të bazuara, të specifikuara në këtë Konventë.

111. Paragrafi 1 vendos detyrimin kryesor që Konventa u imponon Shteteve: njohjen e ndërsjellë apo zbatimin e vendimeve gjyqësore. Sipas kësaj dispozite, një vendim gjyqësor dhënë nga gjykata e një Shteti (Shteti i origjinës) do të njihet dhe zbatohet në një Shtet tjetër (Shteti i kërkuar) në përputhje me dispozitat e Kapitullit II. Ky detyrim presupozon tre kushte pozitive: (i) që vendimi të hyjë në fushën e veprimit zbatimit të Konventës (shih, nenet 1 dhe 2); (ii) që të ketë efekt dhe të jetë i zbatueshëm në Shtetin e origjinës (Neni 4(3)); dhe (iii) që i plotëson kushtet për njohje apo zbatim sipas nenit 5 ose 6.
112. Fjalja e dytë e paragrafit 1 parashikon që, nëse Konventa zbatohet, njohja apo ekzekutimi mund të refuzohen vetëm për shkaqet e përcaktuara në Konventë. Pra, nëse një vendim gjyqësor i plotëson kushtet për njohje apo zbatim në fushën e veprimit të Konventës dhe përmbushen kriteret e parashikuara në dispozitat e mëposhtme të Kapitullit II, një Shtet nuk ka të drejtë të refuzojë njohjen apo zbatimin për shkaqe të tjera sipas ligjit të brendshëm.
113. **Njohja.** Njohja zakonisht nënkupton që gjykata e kërkuar të bëjë të realizueshëm përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve ligjore të vendosura nga gjykata e origjinës. Për shembull, Nëse gjykata e origjinës ka vendosur që një paditës ka pasur (ose nuk ka pasur) një të drejtë të dhënë, gjykata e Shtetit të kërkuar do të pranonte se kështu është, *pra*, ajo duhet ta trajtojë atë të drejtë si ekzistuese (ose jo ekzistuese). Ose, Nëse gjykata e origjinës jep një vendim me shpallje për ekzistencën e një marrëdhënieje ligjore midis palëve, gjykata e Shtetit të kërkuar e pranon atë vendim si një vendim që e vendos çështjen.¹⁰⁷ Një përcaktim i tillë i të drejtave ligjore është i detyrueshëm për palët në procese të mëvonshme gjyqësore. Kështu, nëse vendimi i huaj njihet, ai mund të përdoret, për shembull, për të parandaluar proceset midis të njëjtave palë me të njëjtin objekt padie (*res judicata* ose përjashtimi i gjykimit për herë të dytë i të njëjtës padi) në Shtetin e kërkuar dhe kreditori objekt i vendimit nuk do të kishte barrën e argumentimit të së njëjtës padi dy herë.
114. **Res judicata.** Variante të mëparshme të Konventës parashikonin se njohja e një vendimi gjyqësor do të kërkonte nga gjykata e Shtetit të kërkuar t'i jepte atij "të njëjtat efekte" që ai ka pasur në Shtetin e origjinës.¹⁰⁸ Ky formulim kërkonte që objekti i efektit *res judicata* të përcaktohej me ligjin e Shtetit të origjinës dhe jo me ligjin e Shtetit të kërkuar. E njëjta gjë zbatohet edhe në rastin e vendimeve me efekte të njëjta si ndalimi i gjykimit të një çështjeje të gjykuar për herë të dytë

¹⁰⁷ Raporti Hartley/Dogauch, para. 170.

¹⁰⁸ Sipas nenit 9 (fjalja e parë) e projekt Konventës së shkurtit 2017, "[një] vendimi të njohur apo ekzekutuar sipas kësaj Konvente i jepet i njëjti efekt që ka në Shtetin e origjinës".

(papranueshmëri e çështjes apo *collateral estoppel*). Kjo qasje është bazuar në të ashtuquajturën “doktrina e zgjerimit të efekteve”: *pra*, që njohja e një vendimi të huaj nënkupton *zgjerimin* e efekteve që një vendim i tillë ka sipas ligjit të Shtetit të origjinës dhe mosbarazimin e tij me një vendim të brendshëm të Shtetit të kërkuar.

115. Takimi i tretë i Komisionit të Posaçëm e hoqi këtë dispozitë, duke u nisur nga fakti që KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës, nuk flet për këtë çështje dhe disa delegacione shprehën shqetësim lidhur me pasojat e saj në praktikë, sidomos kur ligji i Shtetit të origjinës ndjek një qasje të gjerë ndaj zgjerimit të efekteve bazuar në doktrinën e mos gjykimit të së njëjtës lëndë dy herë ose të doktrinës *collateral estoppel*.¹⁰⁹ Por, Konventa nuk kërkon zbatimin e ligjit të Shtetit të kërkuar as për të përcaktuar efektet e një vendimi të huaj. Heshtja e Konventës për këtë çështje duhet interpretuar në përputhje me fushën e veprimit e saj. Detyrimi për të njohur një vendim të huaj sipas Konventës nënkupton që e njëjta padi apo shkak për padi nuk mund të rigjykohet në një Shtet tjetër. Kështu, nëse vendimi i huaj përcakton të drejta apo detyrime të pranuar në një padi, ato të drejta apo detyrime nuk mund të jenë subjekt i proceseve të mëtejshme ligjore në gjykatat e Shtetit të kërkuar.¹¹⁰
116. **Ekzekutimi ligjor.** Ekzekutim ligjor do të thotë zbatimin e procedurave ligjore nga gjykatat (apo çdo autoritet tjetër kompetent) e Shtetit të kërkuar, për të siguruar që debitori objekt i vendimit t’i bindet vendimit të dhënë nga gjykata e origjinës. Ekzekutimi ligjor zakonisht nevojitet kur vendimi i huaj thotë që një i paditur duhet të paguajë një shumë parash (vendim monetar), ose duhet të bëjë apo të mos bëjë diçka (sigurim padie), dhe nënkupton ushtrimin e të drejtës së forcës së Shtetit për të siguruar bindjen e dikujt. Kështu, nëse gjykata e origjinës vendos që i padituri duhet t’i paguajë paditësit 10.000 dollarë, gjykata e kërkuar duhet t’i japë mundësi kreditorit objekt i vendimit të përftojë paratë që i detyrohet debitori objekt i vendimit, përmes një procedure ekzekutimi dhe masave të ekzekutimit. Për shkak se kjo gjë do të ishte juridikisht e pambrojtshme, nëse i padituri nuk i detyrohej paditësit 10.000 dollarë, një vendim për ekzekutimin e një vendimi zakonisht presupozon njohjen e vendimit.¹¹¹ Ekzekutimi mund të jetë i nevojshëm gjithashtu në rastet e sigurimit të padisë nëpërmjet gjykatave të Shtetit të kërkuar, duke i kërkuar të paditurit të përmbushë detyrimet për të bërë apo mos bërë diçka që rrjedh nga vendimi (shih *supra*, para. 96-97).

¹⁰⁹ Shih, *Aide memoire* të Kryetarit të Komisionit të Posaçëm (Komisioni i Posaçëm për Njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja gjyqësore (13-17 nëntor 2017)), para. 33.

¹¹⁰ Shih, Procesverbalet e Komisionit të Posaçëm për njohjen apo zbatimin e vendimeve të huaja gjyqësore (13-17 Nëntor 2017), Procesverbali nr. 9, para. 28; dhe Dok. pune nr. 195 e tetorit 2017, “Propozimi i delegacionit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës” (Komisioni i Posaçëm për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja gjyqësore (13-17 nëntor 2017)). Raporti Hartley/Dogauchi e bën të qartë se njohja e vendimeve për çështje paraprake në bazë të doktrinave të tilla si ndalimi i gjykimit të së njëjtës çështje dy herë (estoppel, collateral estoppel ose përjashtimi i çështjes) nuk kërkohet nga Konventa, por mund të bëhet sipas ligjit të brendshëm, shih, para. 195.

¹¹¹ Për shkak se Konventa nuk zbatohet për masat e përkohshme mbrojtëse ose për detyrimet e mbajtjes (dhe çështje të tjera familjare), çdo kundërshtim i lidhur me mungesën e efektit të *res judicata* të një vendimi që ndryshe do të ishte i zbatueshëm, nuk lind. Shih, diskutimin për këtë çështje në Raportin Nygh/Pocar, para. 302-315.

117. Në ndryshim nga kjo, njohja e një vendimi nuk ka nevojë të shoqërohet apo të ndiqet nga zbatimi i tij.¹¹² Për shembull, nëse gjykata e origjinës ka vendosur që i padituri nuk i ka pasur borxh para paditësit, gjykata e Shtetit të kërkuar vetëm mund ta njohë këtë konstatim dhe të pushojë çdo kërkesë të mëvonshme për të njëjtën çështje.
118. **Përshtatja e mjeteve ligjore. Projektet e mëparshme** të Konventës përmbanin një rregull për përshtatjen e mjeteve ligjore.¹¹³ Takimi i tretë i Komisionit të Posaçëm vendosi ta fshijë këtë dispozitë duke qenë se KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës, nuk fliste për këtë çështje. Kjo heshtje duhej si pasojë të interpretohej në të njëjtën mënyrë si edhe në KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës. Sipas Raportit Hartley/Dogauchi (para. 89):

“Konventa nuk i kërkon një Shteti kontraktues të japë një zgjidhje që nuk është e disponueshme në ligjin e tij, edhe kur kërkohet të ekzekutojë një vendim të huaj i cili është dhënë në bazë të një mjeti të tillë ligjor. Shtetet kontraktuese nuk janë të detyruara të krijojnë mjete të tjera ligjore për qëllimet e Konventës. Megjithatë, ato duhet të zbatojnë masat e disponueshme të ekzekutimit sipas ligjit të tyre të brendshëm, për t’i dhënë vendimit të huaj sa më shumë efekt që të jetë e mundur.”

Paragrafi 2 – Në Shtetin e kërkuar nuk bëhet rishikimi i vendimit gjyqësor për gjykimin në themel. Mund të bëhet vetëm një vlerësim i nevojshëm për zbatimin e kësaj Konvente.

119. Një gjykatë që vendos njohjen dhe zbatimin e një vendimi gjyqësor nuk ka të drejtë të shqyrtojë themelin e vendimit të dhënë nga gjykata e origjinës. Kjo do të thotë se, nëse një vendim gjyqësor përmbush kriteret e përcaktuara nga Konventa për njohje apo zbatim, vendimi nuk rimerret më për gjykim në Shtetin e kërkuar. Ky rregull është një përfundim i nevojshëm i parimit të njohjes së ndërsjellë të vendimeve gjyqësore; qëllimi i Konventës do të ngushtohej nëse gjykata e Shtetit të kërkuar do të mund të shqyrtonte bazën faktike apo ligjore mbi të cilën gjykata e origjinës ka arritur të marrë vendimin e saj. Një rrethanë e tillë do të nënkuptonte që palët mund të jenë të detyruara të rinisin procesin ligjor të së njëjtës çështje në Shtetin e kërkuar.¹¹⁴ Po ashtu, si një çështje e përgjithshme, gjykata e kërkuar nuk duhet të marrë në shqyrtim korrektesën materiale të atij vendimi: ajo nuk mund të refuzojë njohjen apo zbatimin nëse mendon se një çështje fakti apo ligji është vendosur gabim. Gjithashtu, gjykata e kërkuar nuk mund ta refuzojë njohjen apo zbatimin për shkak se ka një mospërputhje midis ligjit të zbatuar nga gjykata e origjinës dhe ligjit që do të ishte zbatuar nga gjykata e kërkuar.

¹¹² *Po aty.*

¹¹³ Sipas nenit 9 (fjalë e dytë) të projekt Konventës së shkurtit 2017, “Nëse vendimi parashikon ndihmë që nuk gjendet në ligjin e Shtetit të kërkuar, ajo ndihmë, me sa është e mundur, do të përshtatet me efekte të barasvlershme, por që nuk i tejkalojnë efektet e saj sipas ligjit të Shtetit të origjinës.”

¹¹⁴ Raporti Nygh/Pocar, para. 347.

120. **Dallimet nga formulimet e KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës.** Ka disa ndryshime midis formulimit të nenit 4(2) të Konventës dhe dispozitës paralele të KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës (Neni 8(2)).¹¹⁵ Ndryshimi i parë është thjesht një ndryshim në strukturën e fjalisë së parë, pa pasur për qëllim të ndryshojë thelbin e saj, që thekson rëndësinë parësore që ka parimi i “mos shqyrtimit të themelit të çështjes”. Ndryshimi i dytë është përdorimi i dy termave të dallueshme në Konventë – “konsideratë” dhe “shqyrtim” – për të shtuar saktësinë dhe shmangur keqinterpretimin. Gjithashtu, referenca ndaj “Konventës” dhe jo “këtij kapitulli” sqaron se çdo konsideratë lidhur me fushën e veprimit të Konventës, sipas nenit 1 ose 2, mbulohet nga neni 4(2).
121. Ndryshimi i fundit është material. Neni 8(2) i KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës, parashikon se gjykata e Shtetit të kërkuar është e detyruar nga gjetjet e faktit në bazë të të cilave gjykata e origjinës e ka mbështetur juridiksionin e saj, përveç kur është dhënë vendim në mungesë. Kjo dispozitë zbatohet vetëm për “juridiksionin” sipas KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës, *pra*, kur gjykata e origjinës e bazon juridiksionin e vet në një marrëveshje për Zgjedhjen e Gjykatës. Një dispozitë e tillë ka kuptim kur instrumenti vendos rregulla të harmonizuara për juridiksionin e drejtpërdrejtë. Megjithatë, kjo Konventë, përmban vetëm rregulla për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja gjyqësore dhe jo rregulla të drejtpërdrejta për juridiksionin. Takimi i parë i Komisionit të Posaçëm si rrjedhojë erdhi në përfundimin se ishte më mirë të mos përfshihej një kushtëzim i tillë në nenin që trajton shqyrtimin e themelit të një çështjeje.¹¹⁶
122. **Konsideratë e kufizuar rreptësisht.** Paragrafi 2 njeh që, ndonëse parimi parësor është që nuk lejohet shqyrtimi i një vendimi të huaj në themel, zbatimi i Konventës mund të kërkonte marrjen në konsideratë të çështjeve ligjore apo faktike të lidhura me procese të huaja apo vendime të huaja. Ky paragraf është formuluar që ta kufizojë rreptësisht një konsideratë të tillë, duke siguruar respektimin e detyrimit parësor për të mos shqyrtuar themelin e vendimit të huaj.
123. Sipas nenit 5, për shembull, gjykata e kërkuar duhet të vendosë nëse vendimi i plotëson kushtet për njohje apo zbatim në bazë të lidhjes së padisë, e cila u bë shkak për dhënien e vendimit, me Shtetin e origjinës. Ky përcaktim duhet të kërkojë identifikimin e bazave ligjore apo faktike të lidhjes me Shtetin e origjinës. Për shembull, zbatimi i nenit 5(1)(a) mund të kërkojë që gjykata e kërkuar të marrë në konsideratë faktet përkatëse për të përcaktuar se ku një person juridik e ka pasur vendqëndrimin e tij të rregullt (Neni 3(2)) në kohën që personi është bërë palë në proces në Shtetin e origjinës. Pavarësisht nga ajo që gjykata e origjinës mund të ketë deklaruar në lidhje me atë çështje, nëse ka qenë apo jo me rëndësi, gjykata e

¹¹⁵ Ajo dispozitë lexon: “Pa cenuar një shqyrtim të tillë, për aq sa mund të jetë i nevojshëm për zbatimin e dispozitave të këtij Kapitulli, nuk duhet të shqyrtohet themeli i një vendimi të dhënë nga gjykata e origjinës. Gjykata e kërkuar nuk është e detyruar nga konstatimet e faktit mbi të cilat gjykata e origjinës e ka bazuar juridiksionin e vet, përveç kur është dhënë vendimi në mungesë.”

¹¹⁶ Procesverbalet e Komisionit të Posaçëm për njohjen apo zbatimin e vendimeve të huaja gjyqësore (1-9 qershor 2016), Procesverbalet nr. 3, para. 4-16, dhe Procesverbalet nr. 13, para. 3 dhe 4.

Shtetit të kërkuar bën përcaktimet e veta për qëllimet e zbatimit të Konventës. Ndërsa kjo nuk duhet të kuptohet si shqyrtim në themel,¹¹⁷ neni 4(2), gjithsesi ajo nënkupton kujdesin që duhet treguar në një ushtrim të tillë, për të mos krijuar përshtypjen e atakimit të vendimit të huaj dhe si pasojë duhet të kufizohet në atë që është rreptësisht e nevojshme për zbatimin e duhur të Konventës. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për marrjen në konsideratë të paragrafëve të tjerë të nenit 5 dhe të dispozitave të tjera të Kapitullit II, në veçanti, të nenit 7 (“refuzimi i njohjes apo ekzekutimit”), ose të nenit 10 (“kompensimi”), si edhe të dispozitave të Kapitullit I, në veçanti, nenit 1 (“civile or tregtare”) dhe nenit 2 (“përrjashtimet nga fusha e veprimit”).

Paragrafi 3 – Vendimi gjyqësor njihet vetëm nëse ai ka hyrë në fuqi në shtetin e origjinës dhe zbatohet vetëm nëse ai është i zbatueshëm në shtetin e origjinës.

124. Detyrimi për të njohur dhe zbatuar kërkon që vendimit të huaj t’i jepet autoriteti dhe efektiviteti që i jepet në Shtetin e origjinës në sistemet gjyqësore dhe përmbartimore të Shtetit të kërkuar. Paragrafi 3 përmban deduksionin e këtij parimi: një vendim gjyqësor do të njihet vetëm nëse ka efekt në Shtetin e origjinës dhe do të ekzekutohet vetëm nëse ai është i zbatueshëm në Shtetin e origjinës.
125. Paragrafi 3 afirmon se një vendim gjyqësor do të njihet vetëm nëse ka efekt në Shtetin e origjinës.¹¹⁸ Të ketë efekt do të thotë që vendimi të jetë ligjërishit i vlefshëm dhe funksional. Kështu, nëse vendimi nuk ka efekt në Shtetin e origjinës, sipas Konventës, ai nuk duhet njohur në asnjë Shtet tjetër. Për më tepër, nëse vendimi pushon së pasuri efekt në Shtetin e origjinës, sipas Konventës, që nga ai çast, ai nuk duhet të njihet në Shtete të tjera.
126. Po ashtu, nëse vendimi nuk është i zbatueshëm në Shtetin e origjinës, ai nuk duhet të zbatohet si në vende të tjera, sipas Konventës. Ka mundësi që një vendim gjyqësor të ketë efekt në Shtetin e origjinës pa qenë i zbatueshëm aty, për shembull, sepse zbatueshmëria e tij është pezulluar për shkak të pritjes së përfundimit të apelit (ose në mungesë ose me urdhër të gjykatës). Për më tepër, një vendim gjyqësor që nuk është më i zbatueshëm në Shtetin e origjinës – për shkak, për shembull, se është kthyer mbrapsht në apel, ose për shkak se afati i parashkrimit të ekzekutimit të tij në Shtetin e origjinës ka përfunduar (shih, *infra*, para. 310) – sipas Konventës, nuk duhet që pas atij afati, ai të jetë i zbatueshëm në një Shtet tjetër.¹¹⁹

¹¹⁷ Kjo ndodh pavarësisht nëse gjykata e kërkuar vjen apo jo në një përfundim të ndryshëm nga ai i nxjerrë shprehimisht në vendimin e huaj. Në fakt, gjykata e kërkuar mund të nxjerrë një përfundim të ndryshëm, por kjo lidhet vetëm me zbatimin prej saj të Konventës për qëllimin e vetëm të njohjes apo ekzekutimit të vendimit dhe nuk duhet interpretuar si një shqyrtim i arsytimit apo përfundimit të nxjerrë nga gjykata e huaj në vendimin e saj për themelin e çështjes.

¹¹⁸ Raporti Nygh/Pocar, para. 302-315.

¹¹⁹ *Po aty*.

Paragrafi 4 – Njohja ose zbatimi mund të shtyhet ose të refuzohet nëse vendimi gjyqësor i përmendur në paragrafin 3, është objekt rishikimi në shtetin e origjinës, ose nëse nuk ka skaduar afati kohor për të kërkuar rishikim të zakonshëm. Refuzimi nuk parandalon paraqitjen e një kërkesë tjetër për njohjen ose zbatimin e vendimit gjyqësor.

127. Paragrafi 4 trajton vendimet gjyqësore që i nënshtrohen shqyrtimit (si për shembull, në apel) në Shtetin e origjinës, ose kur afati kohor për kërkimin e shqyrtimit të zakonshëm nuk ka mbaruar. Në këto situata specifike, gjykata nuk është e detyruar të njohë apo ekzekutojë vendimin. Përkundrazi, paragrafi 4 lejon mundësinë që gjykata e kërkuar ta shtyjë vendimin e saj, ose të refuzojë njohjen apo zbatimin. Paragrafi 4 zbatohet për vendimet gjyqësore “të përmendura në paragrafin 3”.
128. **Arsyeja logjike.** Ndikimi i mekanizmit të shqyrtimit apo të apelit në efektivitetin apo zbatueshmërinë e vendimeve gjyqësore ndryshon nga një sistem ligjor në tjetrin dhe nuk ka një qëndrim të njëjtë për faktin se kur një vendim merr efektin e *res judicata* ose “autorité de chose jugée”. Në të drejtën anglo-saksone, *res judicata* zakonisht ndodh kur një vendim i formës së prerë jepet për çështje midis palëve të cilat nuk mund të rikonsiderohen edhe një herë nga e njëjta gjykatë në proces të zakonshëm, edhe pse vendimi potencialisht apo konkretisht mund të jetë subjekt i apelit nga një gjykatë më e lartë. Në ndryshim nga kjo, shumë, nëse jo shumica, nga sistemet e së drejtës civile janë të mendimit se një vendim gjyqësor nuk e ka statusin e *res judicata* ose “autorité de chose jugée” deri sa vendimi nuk është më subjekt i formave të zakonshme të shqyrtimit.¹²⁰ E njëjta gjë vlen edhe për ekzekutimin gjyqësor. Në disa juridiksione, një vendim gjyqësor është i zbatueshëm edhe nëse ai i nënshtrohet apelit të një gjykate më të lartë. Në juridiksione të tjera, një vendim gjyqësor bëhet i zbatueshëm vetëm nëse afati kohor për kërkimin e shqyrtimit të zakonshëm ka përfunduar.
129. Po ashtu, Konventa nuk kërkon që vendimi të jetë “i formës së prerë dhe përfundimtar”, sepse nuk ka një përkufizim të njëjtë të këtij statusi. Përkundrazi, sipas paragrafit 3, mjafton që vendimi të ketë efekt ose të jetë i zbatueshëm sipas ligjit të Shtetit të origjinës. Kjo nënkupton që një vendim gjyqësor mund të njihet dhe zbatohet sipas Konventës edhe kur mund të mos konsiderohet si i formës së prerë në Shtetin e origjinës ose sipas ligjit të Shtetit të kërkuar. Kjo zgjidhje mbron interesat e kreditorit objekt i vendimit dhe thjeshton zbatimin e Konventës për atë sa konceptet e “vendimit të formës së prerë dhe përfundimtar” ose “me efekt *res judicata*” nuk kanë të njëjtin kuptim.¹²¹ Por, mungesa e një kërkesë që një vendim gjyqësor të jetë i formës së prerë dhe përfundimtar mund të rezultojë që një vendim gjyqësor, që ndërkohë është njohur dhe zbatuar në Shtetin e kërkuar, më vonë të kthehet mbrapsht ose të anulohet në Shtetin e origjinës.¹²² Paragrafi 4 e

¹²⁰ *Po aty*, para. 304.

¹²¹ *Po aty*, para. 306-311.

¹²² Raporti Hartley/Dogauch, para. 174. Konventa nuk trajton çështjen se si të shfuqizohet një vendim i huaj që është ekzekutuar ndërkohë në Shtetin e kërkuar, por që më vonë anulohet apo ndryshohet në Shtetin e origjinës. Kjo çështje është diskutuar gjerë e gjatë në Takimin e Parë dhe të Dytë të Komisionit të Posaçëm ku u rrahën zgjidhje të ndryshme. Shih, procesverbalet e Komisionit të

trajton këtë problem duke parashikuar një përjashtim për detyrimin e njohjes dhe ekzekutimit të një vendimi gjyqësor, i cili zbatohet kur ka një apel në pritje ose kur koha për kërkimin e shqyrtimit të zakonshëm nuk ka mbaruar.

130. **Shqyrtimi në Shtetin e origjinës dhe afati kohor i papërfunduar për shqyrtim.** Gjykata e Shtetit të kërkuar nuk është e detyruar të miratojë njohjen apo zbatimin, nëse vendimi është objekt shqyrtimi në Shtetin e origjinës ose afati kohor për kërkimin e shqyrtimit të zakonshëm nuk ka përfunduar. Të jesh “objekt shqyrtimi” nënkupton që procedurat për shqyrtimin e vendimit të jenë ndërkohë në pritje në Shtetin e origjinës. Mos përfundimi i afatit kohor për kërkimin e shqyrtimit të zakonshëm nënkupton që shqyrtimi i vendimit nuk është kërkuar, por që mundet ende të kërkohet. Kjo frazë zbatohet vetëm për *shqyrtimin e zakonshëm*.¹²³ Konventa nuk e përkufizon “shqyrtimin e zakonshëm”. Në parim, ai përfshin çdo shqyrtim që: (i) mund të rezultojë në ndryshim të vendimit; (ii) është pjesë e rrugës normale të një padie dhe si rrjedhojë, është një hap që çdo palë pritet në mënyrë të arsyeshme ta ndjekë; dhe (iii) sipas ligjit të Shtetit të origjinës, mund të ndodhë vetëm përpara përfundimit të një periudhe kohe, që zakonisht fillon ose në datën e vendimit ose datën e njoftimit të debitorit objekt i vendimit për vendimin.
131. **Shtyrja e vendimit.** Kur kushtet e parashikuara në paragrafin 4 plotësohen, Konventa parashikon që njohja dhe ekzekutimi i vendimeve mund të shtyhet. Në këtë rast, procedura e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve ndalohet ose pezullohet deri sa vendoset shqyrtimi apo sa të ketë mbaruar afati kohor për kërkimin e tij. Kjo dispozitë nuk e pengon gjykatën e kërkuar nga dhënia e masave mbrojtëse sipas ligjit të saj të brendshëm gjatë kohës që procedura është pezulluar, për të siguruar ekzekutimin e vendimit në të ardhmen.
132. **Refuzimi i njohjes apo ekzekutimit.** Paragrafi 4 gjithashtu lejon edhe refuzimin e njohjes apo ekzekutimit deri sa të vendoset shqyrtimi ose afati kohor për kërkimin e tij të ketë përfunduar. Në parim, kjo dispozitë parashikon refuzimin e njohjes apo ekzekutimit mbështetur vetëm në faktin se një shqyrtim është në proces në Shtetin e origjinës, ose afati kohor për kërkimin e shqyrtimit të zakonshëm nuk ka përfunduar. Për këtë arsye, paragrafi sqaron se refuzimi nuk e pengon bërjen e një kërkesë më vonë për njohje apo zbatim. Këtu, refuzim do të thotë hedhje poshtë pa paragjykim.¹²⁴ Kjo dispozitë nuk e pengon gjykatën e kërkuar që të miratojë masa mbrojtëse në bazë të ligjit të saj të brendshëm, ndërsa vendimi mbetet objekt shqyrtimi në Shtetin e origjinës, ose ndërsa koha për kërkimin e një shqyrtimi të tillë nuk ka përfunduar ende, për të siguruar ekzekutimin e vendimit në të ardhmen.

Posaçëm për njohjen apo zbatimin e vendimeve të huaja gjyqësore (1-9 qershor 2016), Procesverbali nr. 2, para. 48, Procesverbali nr. 3, para. 51-66, Procesverbali nr. 6, para. 41-49; Procesverbalet e Komisionit të Posaçëm për njohjen apo zbatimin e vendimeve të huaja gjyqësore (16-24 shkurt 2017), Procesverbali nr. 4, para. 76-82, Procesverbali nr. 10, para. 6-8. Së fundi, Takimi i dytë i Komisionit të Posaçëm e konsideroi të pëlqyeshme t’ia linte këtë çështje ligjit procedural të Shtetit të kërkuar.

¹²³ Për ndryshimin midis shqyrtimit “të zakonshëm” dhe “të jashtëzakonshëm”, shih Raporti Hartley/Dogauch, para. 173, shënimi 209.

¹²⁴ Raporti Hartley/Dogauch, para. 174.

Por, që vendimi të marrë formë të prerë, kreditori objekt i vendimit mund të kërkojë përsëri njohjen apo zbatimin e tij. Natyrisht, njohja apo ekzekutimi përsëri mund të mos miratohet për shkaqe të tjera, *për shembull*, sepse vendimi nuk i plotëson kushtet për njohje apo zbatim sipas nenit 5 ose 6 të Konventës. Një vendim nga gjykata e kërkuar për të mos pranuar njohjen apo zbatimin për shkaqe të tilla do ta pengojë një kërkesë më vonë për njohje apo zbatim në Shtetin e kërkuar.

133. **Miratimi i njohjes apo ekzekutimit.** Asgjë në nenin 4(4) nuk e ndalon njohjen apo zbatimin e vendimit të huaj në Shtetin e kërkuar.¹²⁵ Kjo mundësi tregohet nga përdorimi i “mund” në vend të “duhet të” në nenin 4(4). Në disa sisteme ligjore, kjo fjalë do të ishte e mjaftueshme për t’i dhënë mundësi gjykata të ushtronte të drejtën e saj për ta shtyrë apo refuzuar njohjen. Në sistemet ligjore ku kjo nuk ndodh, ndërkohë rregullat e brendshme për zbatimin e traktateve mund të parashikojnë, apo legjislacioni i brendshëm mund të përshtatet për të përcaktuar, nëse pranimi i njohjes apo ekzekutimit është ende i mundshëm dhe, nëse jo, cili nga të dy opsionet e nenit 4(4) është i disponueshëm.¹²⁶ Njohja apo ekzekutimi gjithashtu mund të bëhen objekt i dispozitës së sigurisë, kur janë të përshtatshme dhe të disponueshme sipas ligjit të brendshëm, për të kompensuar debitorin objekt të vendimit, nëse vendimi eventualisht anulohet apo ndryshohet pas procesit të shqyrtimit në Shtetin e origjinës.

¹²⁵ *Po aty*, para. 173.

¹²⁶ Kjo pasqyron një parim të përgjithshëm të së drejtës së traktateve, e cila lidhet gjithashtu me nenet 7 (shih *infra*, para. 245), 8(2) dhe 10.

Neni 5***Bazat për njohje apo zbatim***

1. Vendimi gjyqësor është i përshtatshëm për njohje dhe zbatim nëse plotësohet një nga kushtet, si më poshtë:
 - (a) personi ndaj të cilit kërkohet njohja ose zbatimi ishte banor me vendqëndrim të rregullt në shtetin e origjinës, në kohën, kur ai person u bë palë në procedurë në gjykatën e origjinës;
 - (b) personi fizik ndaj të cilit kërkohet njohja ose zbatimi kishte vendin kryesor të ushtrimit të aktivitetit në shtetin e origjinës, në kohën kur personi u bë palë në procedurë në gjykatën e origjinës dhe padia, mbi të cilën bazohet vendimi gjyqësor, lindi si pasojë e aktiviteteve të këtij biznesi;
 - (c) personi ndaj të cilit kërkohet njohja ose zbatimi është personi që e ka paraqitur padinë, të ndryshme nga kundërpadia, mbi të cilën bazohet vendimi gjyqësor;
 - (d) i padituri zotëronte një degë, agjenci ose ndërmarrje tjetër pa personalitet juridik të veçantë, në shtetin e origjinës, në kohën kur personi u bë palë në procedurë në gjykatën e origjinës, dhe padia mbi të cilën bazohet vendimi gjyqësor lindi si pasojë e aktiviteteve të asaj dege, agjencie ose ndërmarrjeje;
 - (e) i padituri kishte dhënë pëlqimin shprehimisht për juridiksionin e gjykatës së origjinës, gjatë procedurës në të cilën u dha vendimi gjyqësor;
 - (f) i padituri kishte argumentuar çështjen në themel para gjykatës së origjinës, pa kontestuar juridiksionin, brenda afatit të parashikuar me ligj në shtetin e origjinës, përveç nëse është e qartë se kundërshtimi i juridiksionit ose i ushtrimit të juridiksionit nuk do të kishte funksionuar sipas atij ligji;
 - (g) vendimi gjyqësor shprehet për një detyrim kontraktues dhe u dha nga gjykata e shtetit në të cilën ndodhi, ose do të duhej të kishte ndodhur, përmbushja e këtij detyrimi, në përputhje me:
 - (i) marrëveshjen mes palëve; ose
 - (ii) ligjin e zbatueshëm për kontratën, në mungesë të marrëveshjes për vendin e zbatimit të tij, me përjashtim të rastit kur aktivitetet e të paditurit në lidhje me transaksionin, nuk përbënin në mënyrë të qartë një lidhje të qëllimshme dhe thelbësore me atë shtet;

- (h) vendimi gjyqësor shprehet për kontratën e qirasë së pronës së paluajtshme (qiramarrjen) dhe u dha nga gjykata e shtetit në të cilin ndodhet prona;
- (i) vendimi gjyqësor shprehet kundër të paditurit për detyrimin kontraktor, të garantuar nga e drejta e përdorimit, *in rem*, të një prone të paluajtshme të marrë me qira nga i padituri, që ndodhet në shtetin e origjinës, nëse padia lidhur me kontratën është paraqitur së bashku me padinë ndaj të njëjtit të paditur në lidhje me atë të drejtë përdorimi, *in rem*;
- (j) vendimi gjyqësor shprehet për detyrimin jokontraktor që lind nga vdekja, dëmtimi fizik, dëmi ose humbja e pasurisë së patundshme, si dhe nga veprimi ose mosveprimi që shkaktoi drejtpërdrejt këtë lloj dëmi për shtetin e origjinës, pavarësisht se ku ka ndodhur ai dëm;
- (k) vendimi gjyqësor ka të bëjë me vlefshmërinë, ndërtimin, efektet, administrimin ose variacionet e instrumentit të trustit, të krijuar vullnetarisht dhe të dëshmuar me shkrim, dhe –
 - (i) në kohën e fillimit të procedurës, shteti i origjinës ishte përcaktuar në instrumentin e trustit si shteti, në gjykatat e të cilit do të zgjidheshin mosmarrëveshjet në lidhje me çështje të tilla; ose
 - (ii) në kohën e fillimit të procedurës, shteti i origjinës ishte përcaktuar shprehimisht ose në mënyrë të nënkuptuar në instrumentin e trustit si shteti në të cilin ndodhet vendi kryesor i administrimit të trustit.

Ky nën-paragraf zbatohet vetëm për vendimet gjyqësore që kanë të bëjnë me aspektet e brendshme të një trusti mes personave, që janë ose ishin të inkuadruar brenda marrëdhënieve të trustit;
- (l) vendimi gjyqësor shprehet për kundërpadinë:
 - (i) në masën që ishte në favor të kundërpaditësit, me kushtin që kundërpadia të paraqitej për të njëjtin transaksion ose të njëjtën ngjarje si edhe padia; ose
 - (ii) në masën që ishte kundër kundërpaditësit, me përjashtim të rastit kur ligji i shtetit të origjinës kërkonte që kundërpadia të paraqitej për të shmangur prekluzivitetin;

(m) vendimi gjyqësor u dha nga gjykata e përcaktuar në një marrëveshje të lidhur ose të dokumentuar me shkrim ose me anë të ndonjë mjeti tjetër të komunikimit, që e bën informacionin të arritshëm në mënyrë që të jetë i përdorshëm për referim të mëvonshëm, të ndryshme nga një marrëveshje ekskluzive për zgjedhjen e gjykatës. Për qëllimet e këtij nën-paragrafi, “marrëveshje ekskluzive për zgjedhjen e gjykatës” do të thotë një marrëveshje e lidhur nga dy a më shumë palë, që përcakton, me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që kanë lindur ose që mund të lindin në lidhje me një marrëdhënie të veçantë juridike, gjykatat e një shteti ose një a më shumë gjykata specifike të një shteti, duke përjashtuar juridiksionin e gjykatave të tjera.

2. Nëse kërkohet njohja ose zbatimi ndaj një personi fizik që vepron kryesisht për qëllime personale, familjare ose shtëpiake (pra, konsumator) për çështje që lidhen me një kontratë shitblerje, ose ndaj një punonjësi për çështje që lidhen me kontratën e tij të punës –
 - (a) paragrafi 1(e) zbatohet vetëm nëse palët kanë shprehur pëlqimin e tyre, me gojë ose me shkrim, pranë gjykatës;
 - (b) pikat (f), (g) dhe (m) të paragrafit 1 nuk zbatohen.
3. Paragrafi 1 nuk zbatohet për vendimin gjyqësor që shprehet për kontratën e qirasë së banimit në pronë të paluajtshme (qiramarrjen) ose shprehet për regjistrimin e pronës së paluajtshme. Vendimi gjyqësor i tillë është i pranueshëm për njohjen dhe zbatimin vetëm nëse është dhënë nga gjykata e shtetit ku ndodhet prona.

134. Neni 5 është një dispozitë qendrore e Konventës. Ai identifikon lidhjet me Shtetin e origjinës që konsiderohen të mjaftueshme (“filtrat juridiksionalë”) që vendimi të njihet dhe ekzekutohet sipas Konventës, siç parashikohet në nenin 4. Përveç filtrit ekskluziv në nenin 6, neni 5 jep një listë të filtrave juridiksionalë që vënë në lëvizje parimin e njohjes së ndërsjellë të mishëruar në Konventë. Por gjithsesi Shtetet mund t’i njohin vendimet e huaja gjyqësore në bazë të filtrave të tjerë sipas ligjit të brendshëm, sipas nenit 15, por vetëm filtrat e shënuara në nenet 5 dhe 6 krijojnë detyrime sipas Konventës. Si i tillë, neni 5 përcakton perimetrin e “vendimeve gjyqësore të pranueshme”, pra, vendimet gjyqësore që mund të qarkullojnë sipas Konventës.

135. **Juridiksioni i drejtpërdrejt përkundrejt atij të tërthortë.** Në disa shtete, filtrat e listuar në nenin 5 përshkruhen si baza juridiksionale të tërthorta, duke i dalluar ata nga rregullat që përcaktojnë juridiksionin e gjykatës së Shtetit të origjinës sipas ligjit të tij – të ashtuquajturat bazat juridiksionale të tërthorta. Konventa nuk merret me çështjet e “juridiksionit të drejtpërdrejtë” të cilat mbeten për t’u vendosur nga ligji i brendshëm. Filtrat juridiksionalë të listuar në nenin 5 janë ata që gjykatat e një Shteti të kërkuar përdorin për të përcaktuar nëse një vendim gjyqësor e ka të drejtën e njohjes apo ekzekutimit. Kur merr në konsideratë nëse një vendim i huaj e plotëson kushtin e pragut si në nenin 5 ose 6, gjykata e kërkuar nuk e vlerëson zbatimin nga gjykata e atij Shteti të origjinës të rregullave juridiksionale të vetë atij shteti. Ndonëse Konventa nuk merr përsipër të ndikojë në ligjin e brendshëm ekzistues për juridiksion në lëndët ndërkombëtare, vendimet gjyqësore të Shteteve me rregulla të juridiksionit të drejtpërdrejtë të ngjashme me filtrat e neneve 5 dhe 6, do të kenë më gjasa të qarkullojnë sipas Konventës.
136. Neni 5 ndahet në tre paragrafë. Paragrafi i parë rendit lidhjet me Shtetin e origjinës që pranohen sipas Konventës për njohjen dhe zbatimin e vendimit në Shtetin e kërkuar. Paragrafi i dytë trajton vendimet gjyqësore të dhëna kundër konsumatorëve apo punëmarrësve dhe modifikon apo përjashton zbatimin e disa lidhjeve që jepen në paragrafin e parë. Paragrafi i tretë vendos filtrin juridiksional që zbatohet për vendime për qira rezidenciale të pronës së patundshme (qiramarrje) ose regjistrimin e pronës së patundshme dhe përjashton përdorimin e të gjitha filtrave të shënuar në paragrafin e parë.
137. **Pluraliteti i palëve.** Kur një vendim gjyqësor jepet kundër më shumë se një pale, filtrat e parashikuar në nenin 5 duhen vlerësuar një nga një për secilën palë. Kështu, nëse vendimi jepet bashkërisht ndaj tre të paditurve ku secili është përgjegjës, lidhja me Shtetin e origjinës që kërkohet nga neni 5, duhet të verifikohet individualisht për secilin prej tyre. Thjesht fakti që vetëm njëri prej tyre ka, për shembull, vendqëndrim të rregullt në Shtetin e origjinës (Neni 5(1)(a)), nuk është i mjaftueshëm që të bashkë-paditurit e tjerë të konsiderohen se janë banorë të rregullt në atë Shtet. Në një rast të tillë, vendimi nuk do t’i plotësojë kushtet për njohje apo zbatim kundër dy të bashkë-paditurve të tjerë, përveç se kur plotësohet filtri tjetër i nenit 5.

Paragrafi 1 – Vendimi gjyqësor është i përshtatshëm për njohje dhe zbatim nëse plotësohet një nga kushtet, si më poshtë:

138. Ky paragraf përmban 13 filtra juridiksionalë që u përkasin tri kategorive tradicionale lidhjesh me Shtetin e origjinës: lidhja midis Shtetit të origjinës dhe të paditurit, lidhje të vendosura me pëlqim dhe lidhje midis padisë dhe Shtetit të origjinës. Shumë nga lidhjet e renditura në paragrafin 1 gjenden në ligjet e brendshme, por mund të jenë të formuluar më saktë apo më ngushtë në Konventë. Nuk ka ndonjë hierarki midis filtrave në paragrafin 1; asnjëri nuk është më i ligjshëm se tjetri për qëllimet e njohjes apo ekzekutimit sipas Konventës. Për më tepër, plotësimi i një filtri është i mjaftueshëm sikundër deklarohet shprehimisht tek 1.

Nën-paragrafi (a) – personi ndaj të cilit kërkohet njohja ose zbatimi ishte banor me vendqëndrim të rregullt në shtetin e origjinës, në kohën, kur ai person u bë palë në procedurë në gjykatën e origjinës;

139. Ky nënparagraf parashikon një rregull të përgjithshëm të mbështetur në idenë e një forumi të “natyrshëm” apo “të Shtetit të vendbanimit të përhershëm/lindjes”. Të jetosh apo të jesh i vendosur në Shtetin e origjinës – *pra*, të kesh vendqëndrim të rregullt aty – tregon një lidhje të arsyeshme me Shtetin e origjinës. Ky parim qëndron pavarësisht nga pozita procedurale e atij personi në Shtetin e origjinës. Ndonëse si rregull ky nënparagraf do të zbatohet për një të paditur, ai nuk kufizohet vetëm tek një i paditur dhe mund të përfshijë çdo person tjetër, fizik apo juridik, për të cilin kërkohet njohja apo ekzekutimi. Njohja apo ekzekutimi mund të jepen ndaj një të padituri, paditësit apo një pale të tretë që ka pasur vendqëndrim të rregullt në Shtetin e origjinës në kohën që personi është bërë palë në proces.
140. Nënparagrafi (a) është i vetmi filtër në nenin 5 që ka të bëjë vetëm me lidhjet me personin ndaj të cilit kërkohet njohja apo ekzekutimi. Të gjithë filtrat e tjerë të paragrafit 1 kanë të bëjnë ose me pëlqimin ose me lidhjen me mosmarrëveshjen që u bë shkak për dhënien e vendimit.
141. **“Personi për të cilin kërkohet njohja apo ekzekutimi”.** Konventa përqendrohet në marrëdhënien midis Shtetit të origjinës dhe personit ndaj të cilit është dhënë vendimi. Për shkak se ai person mund të mos ketë qenë i paditur në gjykatën e origjinës, do të ishte tepër e ngushtë të kufizohej nënparagrafi (a) vetëm tek ajo palë. Mund të ndodhë që paditësi ta humbasë çështjen dhe i padituri të kërkojë njohjen apo zbatimin e urdhrin për shpenzimet kundër atij personi në Shtetin e kërkuar. Për ta kapur këtë, nënparagrafët (a), (b) dhe (c) përdorin shprehjen “personi ndaj të cilit kërkohet njohja apo ekzekutimi”. Në gjithë paragrafin 1, përdoren termat “personi ndaj të cilit kërkohet njohja apo ekzekutimi” dhe “i padituri”, në varësi të faktit nëse filtri do të zbatohet për njeri tjetër veç të paditurit. Kur kjo çështje nuk ngrihet, termi “i paditur” mjafton. Ndonëse kjo qasje shkakton një farë mbivendosjeje midis nën-paragrafëve (a) dhe (c), ajo i kap disa situata që ndryshe nuk do të ishin kapur vetëm nga nën-paragrafi (c).¹²⁷
142. **“Vendqëndrimi i rregullt” është një faktor lidhës.** Konventa përdor “vendqëndrimin e rregullt” si një faktor lidhës, përkundrajt qasjeve të tjera që gjenden në ligjin e brendshëm apo në të njëjtët instrumente ligjore, si vendbanimi apo shtetësia. Kjo qasje është në përputhje me instrumente moderne të KHDNP-së, të cilët kanë parapëlqyer vendqëndrimin e rregullt. Vendqëndrimi i rregullt është gjithashtu një faktor lidhës më i bazuar në fakte se sa vendbanimi apo shtetësia dhe shpreh një lidhje të ngushtë midis një personi dhe mjedisit të tij socio-ekonomik. Sigurisht, mungesa e një përkufizimi për vendqëndrimin e rregullt në Konventë në rastin e personave fizikë mund të bëhet shkak për lindjen e interpretimeve të brendshme të

¹²⁷ Kështu, nëse kostot i janë ngarkuar paditësit kundër një pale të tretë, ky filtër do të zbatohet nëse ajo palë e tretë do të ishte banor i rregullt në Shtetin e origjinës kur është bërë palë në proces.

kundërta, ndonëse kjo gjë nuk duhet bërë, sipas nenit 20 (“interpretimi i njëjtë”). Lidhur me një person apo subjekt tjetër nga një person fizik, duhet mbajtur parasysh se përkufizimi i vendqëndrimit të rregullt në nenin 3(2) përfshin katër alternativa. Si pasojë, sipas nën-paragrafit (a), Shteti i kërkuar duhet të marrë parasysh që Shteti i origjinës ka qenë i lidhur me një subjekt apo person tjetër nga një person fizik, nëse përmbushen secili nga katër faktorët lidhës të paraqitur në nenin 3(2).

143. **“Në kohën” e procesit në gjykatën e origjinës.** Vendi i vendqëndrimit të rregullt të një personi mund të ndryshojë me kohë, me gjasa edhe gjatë zhvillimit të procedurave gjyqësore, eventualisht përpara se vendimi të jepet, ose edhe pas kërimit të vendimit për njohje apo zbatim. Për qëllimet e nënparagrafit (a), vendqëndrimi i rregullt duhet të vlerësohet në kohën kur personi ndaj të cilit kërkohet njohja apo ekzekutimi është bërë palë në proces në gjykatën e origjinës.¹²⁸ Nuk është e nevojshme që ky person të vazhdojë të jetë banor i rregullt në Shtetin e origjinës në momentin që Shteti i kërkuar është duke vlerësuar lidhjen, për sa kohë që vërtetohet kjo lidhje në kohën që personi është bërë palë në procesin fillestar.
144. **Marrja përsipër, kalimi i të drejtave apo trashëgimia.** Formulimi i nënparagrafit (a) presupozon se personi ndaj të cilit kërkohet njohja apo ekzekutimi është i njëjti person që ka qenë palë në proces në Shtetin e origjinës. Por, kjo dispozitë nuk përjashton njohjen apo zbatimin ndaj një personi palë në procese në Shtetin e origjinës, me kusht që personi ndaj të cilit kërkohet njohja apo ekzekutimi ka “marrë përsipër” detyrimet e personit që ka qenë palë në proces në Shtetin e origjinës. Detyrimet mund të merren përsipër me anë të transferimit, trashëgimisë apo çdo mjeti tjetër të barasvlershëm, ose me pëlqim, ose me anë të veprimit të ligjit. Kjo do të ndodhte, për shembull, nëse pala në proces në Shtetin e origjinës ka vdekur dhe trashëgimtarët e saj kanë marrë përsipër detyrimet e saj përpara se të kërkohet njohja apo ekzekutimi, ose nëse pala në proces në Shtetin e origjinës ka qenë një shoqëri tregtare që është shkrirë me një tjetër shoqëri tregtare (e cila e ka përthithur) përpara se të kërkohet njohja apo ekzekutimi. Në këto situata, njohja apo ekzekutimi mund të jepen ndaj një personi të ndryshëm nga ai që ka qenë palë në proces në Shtetin e origjinës, *për aq sa personi i parë ka trashëguar në mënyrë të vlefshme detyrimet e këtij të fundit*. Fakti nëse ka pasur një “trashëgimi të vlefshme” rregullohet nga ligjet e Shtetit të kërkuar, duke përfshirë rregullat e tij të së drejtës ndërkombëtare private.
145. **Shembull 1.** X-i ngre një padi kundër Y-së në Shtetin A, ku Y-ja ka vendqëndrim të rregullt. Një vendim gjyqësor i dhënë kundër Y-së. Por, gjatë procedurave gjyqësore

¹²⁸ Siç është shpjeguar, ky person mund të jenë paditësi që nis një procedurë gjyqësore ndaj një të padituri të vetëm, por ky “person” mund të jetë gjithashtu një person i shtuar në përputhje me rregullat procedurale të Shtetit të origjinës pas fillimit të procesit, si për shembull, një paditës tjetër ose një i paditur i shtuar përmes një mekanizmi të detyruar apo vullnetar për bashkimin e padive, një ndërmjetësues, një palë e tretë, etj. Prandaj, është më e saktë t’i referohemi kohës kur një person bëhet palë në proces se sa kohës kur kanë filluar për herë të parë procedurat gjyqësore.

në Shtetin A ose pasi vendimi i dhënë, por përpara se të kërkohet njohja apo ekzekutimi, Y-ja vdes dhe detyrimet e tij i transferohen trashëgimtarit të tij. Në këtë rast, vendimi i plotëson kushtet për njohje apo zbatim sipas nënparagrafit (a) meqenëse Y-ja e kishte vendqëndrimin e rregullt në Shtetin e origjinës kur u bë palë në proces në gjykatën e origjinës dhe personi ndaj të cilit kërkohet njohja apo ekzekutimi i ka trashëguar në mënyrë të vlefshme detyrimet e Y-së. Natyrisht, në këtë rast vendqëndrimi i rregullt i trashëgimtarit nuk ka rëndësi.

146. **Shembulli 2.** Shoqëria tregtare X ngre një padi kundër një shoqërie tregtare Y në Shtetin A, ku shoqëria tregtare Y ka selinë e ligjshme. Gjatë procesit, shoqëria tregtare Y shkrihet me Shoqërinë tregtare Z (shoqëria përthithëse) dhe, si pasojë, shoqëria e parë ia transferon të gjitha aktivet dhe pasivet e saj kësaj të fundit. Në këtë rast, vendimi i dhënë kundër një personi (Shoqëria tregtare Z) të ndryshëm nga një i paditur, siç përcaktohet në nenin 3(1)(a). Gjithashtu, shkrirja mund të ndodhë pasi është dhënë vendimi në Shtetin e origjinës, por përpara se të kërkohet njohja apo ekzekutimi i tij në Shtetin e kërkuar. Në këtë rast të dytë, personi ndaj të cilit kërkohet njohja apo ekzekutimi (shoqëria tregtare Z) është gjithashtu i ndryshëm nga personi kundër të cilit procedurat gjyqësore kanë filluar në Shtetin e origjinës (Shoqëria tregtare Y). Në të dy rastet, vendimi, gjithsesi, i plotëson kushtet për njohje apo zbatim sipas nënparagrafit (a), duke qenë se i padituri e kishte vendqëndrimin e rregullt në Shtetin e origjinës në kohën që u bë palë në proces në gjykatën e origjinës dhe personi ndaj të cilit kërkohet njohja apo ekzekutimi është bërë trashëgimtar i vlefshëm i një të padituri të tillë.

Nënparagrafi (b) – personi fizik ndaj të cilit kërkohet njohja ose zbatimi kishte vendin kryesor të ushtrimit të aktivitetit në shtetin e origjinës, në kohën kur personi u bë palë në procedurë në gjykatën e origjinës dhe padia, mbi të cilën bazohet vendimi gjyqësor, lindi si pasojë e aktiviteteve të këtij biznesi;

147. Ky nënparagraf u drejtohet personave fizikë që merren me biznes ose që ushtrojnë një profesion dhe mbështetet në të njëjtin parim si nënparagrafi (a). Personat fizikë mund të kryejnë një veprimtari biznesi apo profesionale përmes ndërmarrjeve që ndodhen në Shtete të tjera nga Shteti i vendqëndrimit të tyre të rregullt. Kjo ka gjasa të ndodhë veçanërisht në qytetet kufitare, por me lehtësitë që ofrohen për udhëtimet e personelit, kjo mund të ndodhë gjithashtu jashtë këtij konteksti. Konventa parashikon se do të ketë lidhje të mjaftueshme me një Shtet të origjinës për qëllimet e njohjes apo ekzekutimit, nëse vendi kryesor i biznesit të një personi fizik¹²⁹ ndodhej në atë Shtet në kohën që personi u bë palë në proces në gjykatën e origjinës, por vetëm kur padia mbi të cilën vendimi është mbështetur ka ardhur për shkak të veprimtarisë së atij biznesi.

¹²⁹ Versioni në frëngjisht i referohet "établissement professionnel principal" në nenin 5(1)(b) dhe "principal établissement" në nenin 3(2)(d), ndërsa versioni në anglisht i referohet "vendit kryesor të biznesit" në të dy nënparagrafët. Dallimi në versionin në frëngjisht nuk ishte i qëllimshëm dhe si rrjedhojë, nuk duhet të shpjëret në ndonjë ndryshim në interpretim midis dy teksteve.

148. **Baza logjike.** Personat fizikë që kryejnë veprimtari biznesi janë të ngjashëm me personat juridikë për sa i takon lidhjes së tyre me një Shtet. Një biznes që është një person juridik do të konsiderohet si person me vendqëndrim të rregullt, *inter alia*, në selinë kryesore të biznesit sipas nenit 3(2). Nëse biznesi nuk është person juridik, është i ndarë nga person fizik që ofron mallrat apo shërbimet, lidhja e vendit kryesor të biznesit me Shtetin, sipas nënparagrafit (a), nuk vendoset. Megjithatë, nga perspektiva e paditësit, të dy situatat janë analoge, me përjashtim të statusit juridik të biznesit. Për të pasqyruar këtë barasvlershmëri, nënparagrafi (b) përcakton se vendndodhja e vendit kryesor të biznesit të një personi fizik është një lidhje e mjaftueshme për qëllimet e njohjes apo ekzekutimit të një vendimi gjyqësor, në rastin e një padie të ngritur kundër atij personi fizik që rrjedh nga veprimtaria e tij e biznesit.
149. **Kushtet.** Nënparagrafi (b) përfshin dy kushte. Së pari, padia mbi të cilën është marrë vendimi duhet të ketë ardhur si pasojë e veprimtarisë së biznesit të personit fizik. Ky është një filtër më i kufizuar se sa filtri i përgjithshëm i vendqëndrimit të rregullt sipas nënparagrafit (a). Formulimi i nënparagrafit (b) tregon se vendimi duhet të jetë marrë mbi një padi që ka rrjedhur nga “veprimtaria e biznesit”, por që nuk kërkon që veprimtaria në fjalë të jetë e lidhur konkretisht me vendin kryesor të biznesit. Vetë fakti që nënparagrafi (b) i referohet vendit “kryesor” të biznesit nënkupton që një person fizik mund të zhvillojë biznes në më shumë se një vend, por vetëm njëri prej tyre plotëson kushtet si vendi “kryesor” i biznesit. Sigurisht, dallime të tilla kanë më të ngjarë të jenë të pranishme në situata ballë për ballë se sa në situata online.
150. **Shembull.** X-i është kontabiliste me vendqëndrim të rregullt në Shtetin A, në një qytet në kufirin midis Shteteve B dhe C. Zyra qendrore e X-it ndodhet në një qytet në Shtetin B, ku ajo zhvillon pjesën më të madhe të biznesit të saj dhe ku punon me orë të plota. Megjithatë, ajo udhëton një herë në javë në Shtetin C për të ofruar shërbime për klientelën e saj të vogël aty. Për shkak se çmimi i letrës për fotokopje është më i ulët në Shtetin C, X-i i blen furnizimet e saj javore të letrës për fotokopje për të dy zyrat të premtëve në Y nga shoqëria *Paper Inc* kur është në Shtetin C. Në rast se lind një mosmarrëveshje lidhur me furnizimin me letër, një vendim gjyqësor i dhënë kundër X-it mbi një padi të tillë nga një gjykatë e origjinës në Shtetin B do të përmbushte kërkesën e nënparagrafit (b), sepse Shteti B është Shteti i vendit kryesor të biznesit të X-it (edhe pse padia lindi nga një transaksion i kryer në Shtetin C), dhe padia do të lindte nga “veprimtaria e biznesit” të personit fizik që merret me këto veprimtari. Nga ana tjetër, kur vendimi është për një padi që rrjedh nga veprimtaria personale apo familjare e X-it, nënparagrafi (b) nuk zbatohet.
151. Kushti i dytë lidhet me kohën e ngritjes së padisë dhe vendosjes së vendit kryesor të biznesit. Nënparagrafi (b) kërkon që vendi kryesor i biznesit të personit fizik të ndodhet në Shtetin e origjinës në kohën që personi është bërë palë në procesin e sjellë përpara gjykatës së origjinës. Kjo kërkesë për njëkohshmëri është e njëjtë si ajo në nënparagrafin (a) për vendqëndrimin e rregullt.

Nënparagrafi (c) – personi ndaj të cilit kërkohet njohja ose zbatimi është personi që e ka paraqitur padinë, të ndryshme nga kundërpadia, mbi të cilën bazohet vendimi gjyqësor;

152. Ngritja e një padie civile apo tregtare përpara një gjykate zakonisht tregon pranimin e juridiksionit të asaj gjykate, edhe pse paditësi mund të ketë zgjedhje të kufizuar apo të mos ketë asnjë zgjedhje lidhur me vendin ku mund të nisen procedurat gjyqësore, të cilat do të përcaktohen në rregullat e juridiksionit të drejtpërdrejtë të secilit Shtet. Ky arsyetim nuk zbatohet për njerëz të tjerë veç paditësit, të tillë si i padituri, i cili mund të mos ketë zgjedhje tjetër veç t'i përgjigjet procesit ose të rrezikojë të marrë një vendim në mungesë. Nënparagrafi (c) deklaron se vetë fakti i ngritjes së një padie përpara gjykatës së origjinës e bën çdo vendim për atë padi të zbatueshëm në Shtetin e kërkuar kundër personit që ngriti padinë në gjykatën e origjinës.
153. **Shembull.** X-i, me vendqëndrim të rregullt në Shtetin A, udhëton në Shtetin B për të bërë pushime në një kamp, ku takon Y-në, me vendqëndrim të rregullt në Shtetin C. Pajisjet e kampingut të X-it dëmtohen dhe sipas pretendimit të X-it, kjo ka ardhur për shkak të neglizhencës së Y-së. X-i vendos të ngrejë padi përpara një gjykate në Shtetin C, duke kërkuar kompensim për humbjen që pretendon se është shkaktuar për faj të Y-së. Y-ja e mbron me sukses padinë dhe gjykata shpall se Y-ja nuk është fajtores për ndonjë humbje të X-it dhe vendos që Y-it t'i paguhen shpenzimet. Nëse X-i orvatet të fillojë një proces të ri me një padi për neglizhencë në Shtetin B, Y-ja mund të kërkojë njohjen e vendimit të Shtetit C, duke iu referuar nenit 5(1)(c). Meqenëse X-i e ngriti fillimisht padinë në Shtetin C, vendimi i dhënë nga gjykata në Shtetin C ka të drejtë të njihet kundër X-it në çdo Shtet tjetër kontraktues. Për më tepër, nëse Y-ja dëshiron të ekzekutojë vendimin për pagimin e shpenzimeve kundër X-it në Shtetin A,¹³⁰ një gjykatë në Shtetin A mund të mbështetet në nenin 5(1)(c) për të ekzekutuar vendimin.
154. **Marrëdhënia me dispozitat e tjera.** Nëse paditësi ka qenë me vendqëndrim të rregullt në Shtetin e origjinës kur padia është ngritur, njohja apo ekzekutimi i një vendimi gjyqësor kundër paditësit mund të kërkohet gjithashtu sipas nënparagrafit (a). Vini re gjithashtu se nënparagrafi (c) nuk zbatohet për kundërpadije që trajtohen konkretisht në nënparagrafin (l).

Nënparagrafi (d) – i padituri zotëronte një degë, agjenci ose ndërmarrje tjetër pa personalitet juridik të veçantë, në shtetin e origjinës, në kohën kur personi u bë palë në procedurë në gjykatën e origjinës, dhe padia mbi të cilën bazohet vendimi gjyqësor lindi si pasojë e aktiviteteve të asaj dege, agjencie ose ndërmarrjeje;

155. Kur një degë e një të padituri ndodhet në Shtetin e origjinës, një vendim gjyqësor për një padi që lind për shkak të veprimtarisë të asaj dege, duhet të përmbushë filtrin e nënparagrafit (d), edhe nëse vendqëndrimi i rregullt i të paditurit është në një Shtet tjetër. Konventa ndjek një qasje të ngushtë kur kërkon që vendimi kundër

¹³⁰ Ky vendim për kostot konsiderohet si vendim gjyqësor sipas Konventës sipas nenit 3(1)(b).

të paditurit të përfshijë një padi që rrjedh drejtpërdrejt nga veprimtaria e degës që ndodhet në Shtetin e origjinës dhe jo nga veprimtaria e përgjithshme e një të padituri.

156. **Baza logjike.** Një person që krijon një ndërmarrje në një Shtet tjetër qëllimisht krijon lidhje me atë Shtet. Vendimet gjyqësore nga gjykatat e atij Shteti për paditë që lindin nga veprimtaria e asaj ndërmarrjeje janë kështu njëlloj të lidhura me Shtetin e origjinës.
157. **Dega, agjencia apo ndërmarrja tjetër.** Dispozita i referohet “degës, agjencisë apo ndërmarrjeve të tjera pa personalitet ligjor të veçantë”. Konventa nuk e përcakton këtë koncept. Në parim, një ndërmarrje nënkupton një prani fizike të qëndrueshme të një të padituri në Shtetin e origjinës ku i padituri kryen një veprimtari. Dispozita është shprehimisht e kufizuar tek ndërmarrjet pa personalitet ligjor të ndara nga i padituri. Ky kriter i përjashton filialet dhe çdo pjesë tjetër të një organizate tregtare që është themeluar si një subjekt i veçantë juridik.¹³¹ Kjo terminologji nuk i përjashton personat fizikë, dhe prandaj mund të bashkëjetojë me nenin 5(1)(b) kur një person fizik është, për shembull, një profesionist që e ka vendin kryesor të biznesit në njërin Shtet dhe një ndërmarrje të dytë në Shtetin tjetër.
158. **Fusha e veprimit.** Me qëllim që të zbatohet nënparagrafi (d), duhet të ketë një lidhje midis padisë mbi të cilën është marrë vendimi dhe veprimtarisë së degës, agjencisë apo ndërmarrjes në Shtetin e origjinës. Me fjalë të tjera, nuk mjafton që padia të lindë nga veprimtaria e përgjithshme e një të padituri; ajo duhet të lindë nga veprimtaria e degës apo ndërmarrjes në Shtetin e origjinës. Kështu, për shembull, në një vendim gjyqësor për një mosmarrëveshje kontraktuese, kontrata duhet të ketë qenë lidhur nëpërmjet ndërmarrjes në Shtetin e origjinës ose ndërmarrja duhet të jetë përgjegjëse për punën e vet. Nuk mjafton të ketë vetëm një lidhje të largët apo të rastësishme.
159. Megjithatë, kjo lidhje e bazuar në veprimtari nuk është e kufizuar sipas natyrës së padisë. Vendimi mund të jetë për një mosmarrëveshje që lind nga administrimi i brendshëm i degës, ose nga mënyra si e kryen punën e saj dhe mund të lidhet me çdo lloj padie, qoftë e lidhur me kontratën apo jashtë kontrate. Ajo mund të mbivendoset pjesërisht me nënparagrafë të tjerë që trajtojnë detyrimet kontraktuese (nënparagrafi (g)) dhe jo kontraktuese (nënparagrafi (j)).

Nënparagrafët (e) dhe (f) – pëlqimi

160. Këta dy nënparagrafë trajtojnë lidhjet me gjykatën e origjinës të vendosura me pëlqim. Neni 5(1) parashikon tri forma pëlqimi: pëlqimi i njëanshëm i shprehur gjatë

¹³¹ Në zbatimin e nenit 7(5) të Rregullores së Brukselit (Brussel Ia Regulation) që trajton këtë lloj lidhjeje, GJED-ja ka përfshirë gjithashtu edhe filialet, *pra*, ndërmarrjet me personalitet ligjor, sipas doktrinës së paraqitjes, që do të thotë, kur përpara palëve të treta, ato paraqiten thjesht si degë e të paditurit të huaj. Shih, Vendimi i 9 dhjetorit 1987, *SAR Schotte GmbH kundër Parfums Rothschild SARL*, C-218/86, EU:C:1987:536.

procedurave gjyqësore (nënparagrafi (e)), pëlqimi i nënkuptuar (nënparagrafi (f)) dhe marrëveshjet e palëve (nënparagrafi (m)). Secila nga këto forma pëlqimi e plotëson filtrin juridiksional sipas nenit 5(1), pavarësisht nga mungesa e çdo lidhjeje tjetër me Shtetin e origjinës.

161. Sikundër do të shihni më poshtë, në rastin e filtrave me bazë pëlqimin, ku vendimet gjyqësore jepen kundër të paditurve që janë konsumatorë apo punëmarrës, zbatohen kufizime specifike, sipas paragrafit 2.

Nënparagrafi (e) – i padituri kishte dhënë pëlqimin shprehimisht për juridiksionin e gjykatës së origjinës, gjatë procedurës në të cilën u dha vendimi gjyqësor;

162. Filtri në nenin 5(1)(e) zbatohet kur një i paditur ka dhënë pëlqimin e tij të shprehur për juridiksionin e gjykatës së origjinës gjatë zhvillimit të procesit në të cilin është dhënë vendimi. Ekzistenca e pëlqimit të shprehur dhe fakti nëse është dhënë "gjatë zhvillimit të procesit", është një çështje fakti për t'u vendosur nga gjykata e Shtetit të kërkuar. Nënparagrafi (e) nuk përshkruan formën apo thelbin e këtij pëlqimi të shprehur, *pra*, ai mund të jepet me gojë apo me shkrim. Megjithatë, dispozitat e tjera të Konventës duhen pasur parasysh në interpretimin e konceptit të "pëlqimit të shprehur". Së pari, një dispozitë e veçantë trajton pëlqimin e nënkuptuar (nënparagrafi (f)). Objekti i pëlqimit të shprehur si rrjedhojë ngushtohet dhe duhet të kërkojë një akt pozitiv (me gojë ose me shkrim), përkundrejt mosparaqitjes, për shembull, të një kundërshtimi apo thjesht tërheqjes së një kundërshtimi të juridiksionit të gjykatës të origjinës. Së dyti, ndryshe nga neni 5(2)(a), ky nënparagraf nuk kërkon që pëlqimi t'i drejtohet gjykatës; ai mund t'i drejtohet gjykatës ose palës tjetër, për sa kohë që bëhet gjatë procesit.
163. Kjo mënyrë dhënieje pëlqimi mund të mos njihet apo pranohet në të gjitha sistemet procedurale. Megjithatë, kjo mundësi nuk është pengesë për vlerësimin e një pëlqimi të tillë nga Shteti i kërkuar. Në fakt, sipas paragrafit 1, Shteti i kërkuar nuk vlerëson nëse gjykata e origjinës është përdorur si duhet sipas rregullave të saj të *juridiksionit të drejtpërdrejtë*. Përkundrazi, Shteti i kërkuar verifikon nëse një prej filtrave të nenit 5 plotësohet, pavarësisht nga baza e juridiksionit në gjykatën e origjinës.
164. **Shembuj.** Skenarët e mëposhtëm ilustrjnë se si mund të paraqitet pëlqimi i shprehur në kuptimin e nënparagrafit (e):
- (i) X-i nis procedurat gjyqësore kundër Y-së në Shtetin A. Sipas të drejtës procedurale të Shtetit A, gjykata është e detyruar të verifikojë juridiksionin e vet *ex officio* në paditë kundër të paditurve të huaj. Duke konstatuar se nuk ka ndonjë lidhje midis kërkesës dhe Shtetit A, gjykata e pyet Y-in, me vendqëndrim të rregullt në Shtetin B, nëse dëshiron të paraqesë ndonjë kundërshtim lidhur me juridiksionin. Y-ja përgjigjet se ajo e pranon juridiksionin e gjykatës në Shtetin A dhe se është e gatshme të vazhdojë me të.
 - (ii) X-i fillon procesin gjyqësor kundër Y-së në Shtetin A. Y-ja reagon duke i ftuar ata të gjejnë një zgjidhje me bashkëbisedim të mosmarrëveshjes. Palët zgjidhin me

sukses një pjesë të mosmarrëveshjes, por nuk janë në gjendje të pajtohen për aspektet e tjera. Si pjesë e marrëveshjes së zgjidhjes, X-i pranon shprehimisht të ndryshojë padinë e ngritur përpara gjykatës në Shtetin A dhe Y-ja shprehimisht pranon se kjo padi e ndryshuar do të vendoset nga gjykata në Shtetin A.¹³²

- (iii) X-i e fillon procesin kundër Y-së në Shtetin A dhe Y-ni njoftohet përkatësisht. Në përgjigjen e saj me postë elektronike, Y-ja i kujton X-it se kontrata e tyre përfshin një klauzolë arbitrazhi, por se shpenzimet e arbitrazhit do të ishin frenuese, duke marrë parasysh vlerën e padisë. Y-ja pranon shprehimisht se do të mbrohet në Shtetin A në këtë rast, por rezervon të drejtën e vet për ta ngritur klauzolën e arbitrazhit në çdo mosmarrëveshje të ardhme në bazë të kontratës së palëve.

Nënparagrafi (f) – i padituri kishte argumentuar çështjen në themel para gjykatës së origjinës, pa kontestuar juridiksionin, brenda afatit të parashikuar me ligj në shtetin e origjinës, përveç nëse është e qartë se kundërshtimi i juridiksionit ose i ushtrimit të juridiksionit nuk do të kishte funksionuar sipas atij ligji;

165. Ndryshe nga pëlqimi i shprehur i parashikuar në nënparagrafin (e), pëlqimi në nënparagrafin (f) është i nënkuptuar, zakonisht nga një i paditur që argumenton themelin e çështjes dhe nuk kundërshton juridiksionin e gjykatës së origjinës. Duke mos kundërshtuar juridiksionin e gjykatës së origjinës, merret se i padituri ka pranuar që padia e ngritur kundër tij të vendoset nga ajo gjykatë.
166. **Baza logjike.** Pëlqimi, qoftë i shprehur apo i nënkuptuar, mendohet se vendos një lidhje të ligjshme midis një gjykate dhe një të padituri. Një i paditur mund të pranojë që mosmarrëveshja të gjykohet nga gjykata ku padia është ngritur edhe kur mund të ketë pasur një farë baze për kundërshtimin e juridiksionit të asaj gjykate. I padituri mund të dojë të shmangë kostot dhe vonesën e kundërshtimit të juridiksionit, ose mund të mos shohë ndonjë përfitim të madh që të paditet në një gjykatë tjetër, ose nuk ka dijeni se ekziston mundësia e juridiksionit. Cilado qoftë arsyeja për të paditurit e veçantë, ka më shumë shtete që mendojnë se një i paditur mund të japë pëlqimin e tij të nënkuptuar për juridiksionin e një gjykate.¹³³
167. **Kushtet.** Përdorimi i nënparagrafit (f) i nënshtrohet dy kushteve. Së pari, i padituri duhet të ketë argumentuar themelin e çështjes përpara gjykatës së origjinës. Së dyti, i padituri duhet të mos e ketë kontestuar juridiksionin, përveç se kur është e qartë se kundërshtimi i juridiksionit do të kishte qenë i pasuksesshëm.
168. **I padituri ka argumentuar për themelin e çështjes.** Kushti i parë për përdorimin e nënparagrafit (f) është që i padituri duhet të ketë argumentuar themelin e çështjes

¹³² Ky skenar mund edhe të mendohet se futet në nënparagrafin (m) nëse klauzola e marrëveshjes së zgjidhjes interpretohet si “caktimi i një gjykate”.

¹³³ Kjo është një deklaratë shumë e përgjithshme, që sigurisht u nënshtrohet kufizimeve të shumta.

përpara gjykatës së origjinës. Konventa nuk përcakton kufijtë e saktë të argumentimit të themelit të çështjes. Në disa Shtete, çdo akt nga një i paditur i cili shkon përtej kontestimit të juridiksionit, si kërkesa për të ndryshuar avokatin mbrojtës, do të konsiderohet se futet brenda “argumentimit për themel”. Sigurisht, vlerësimi i “argumentimit për themel” sipas nënparagrafit (f) nuk varet nga mënyra se si ai përcaktohet sipas ligjit të Shtetit të origjinës. Gjykata e kërkuar duhet të bëjë vlerësimin e vet nëse i padituri ka ndërmarrë ndonjë hap në procedurat gjyqësore përpara gjykatës së origjinës, i cili përfshin kontestimin e themelit të mosmarrëveshjes.

169. **I padituri nuk ka kundërshtuar juridiksion e gjykatës së origjinës.** Ky është kushti i dytë sipas nënparagrafit (f). Nëse i padituri konsiderohet se ka argumentuar themelin e çështjes dhe këtë e ka bërë pa kundërshtuar juridiksionin e gjykatës të origjinës, filtri i nënparagrafit (f) do të jetë plotësuar dhe vendimi që do të rezultojë se i plotëson kushtet për njohje apo zbatim sipas Konventës. Nga ana tjetër, nëse një i paditur i është përgjigjur një padie për qëllimin e vetëm të kundërshtimit të juridiksionit dhe kundërshtimi është hedhur poshtë, çdo vendim i mëvonshëm nuk do të përmbushte filtrin.¹³⁴ Për më tepër, edhe nëse një i paditur argumenton për themelin e çështjes pas një kundërshtimi të pasuksesshëm të juridiksionit të gjykatës të origjinës, vendimi vijues nuk do ta përmbushte filtrin. Sido që të jetë puna, sigurisht vendimi mund të qarkullojë nëse përmbushet një filtër tjetër i nenit 5.
170. **Kundërshtimi i juridiksionit “brenda afatit kohor të parashikuar në ligjin e Shtetit të origjinës”.** Rregullat procedurale në ligjin e Shtetit të origjinës mund të përcaktojnë një afat kohor specifik brenda të cilit një i paditur mund të kundërshtojë juridiksionin. Ky afat mund të fillojë nga një kohë e caktuar, e tillë si dita kur është bërë njoftimi i padisë, ose sipas renditjes së ngjarjeve, si për shembull, përpara marrjes me çdo procedurë tjetër. Disa sisteme ligjore gjithashtu mund të parashikojnë përfshirjen e të gjitha mbrojtjeve, si procedurale dhe materiale, në të njëjtin dokument procedural. Sipas nënparagrafit (f), kundërshtimet e parakohshme nuk do ta shmangnin përfundimin se një filtër është përmbushur. Nëse i padituri nuk vepron në përputhje me rregullat procedurale të Shtetit të origjinës për kundërshtimin e juridiksionit dhe argumenton për themelin e çështjes, vendimi do të qarkullojë sipas nënparagrafit (f).
171. **Kundërshtimi për juridiksion nuk është i suksesshëm.** Filtri i nënparagrafit (f) bazohet në premisën se i padituri ka pranuar heshtur që mosmarrëveshja të gjykohet nga gjykata ku padia është ngritur, edhe pse mund të ketë një farë baze për kundërshtimin e atij juridiksioni. Është pikërisht mos ngritja e kundërshtimit në të cilën mbështetet pëlqimi i nënkuptuar i një të padituri. Një supozim i rëndësishëm i këtij filtri është që e drejta procedurale në gjykatën e origjinës e lejon të paditurin të kundërshtojë juridiksionin. Vetëm në një rast të tillë, moskundërshtimi

¹³⁴ Kjo ndodh nëse kundërshtimi i juridiksionit konsiderohet argument për themelin e çështjes. Në fakt, filtri e bën këtë çështje të parëndësishme duke qenë se kundërshtimi i juridiksionit është një mënyrë për të shmangur përdorimin e nënparagrafit (f).

mund të interpretohet si pëlqim i nënkuptuar. Nënparagrafi (f) e pasqyron këtë supozim duke e formuluar rregullën nga pikëpamja e kundërshtimit të juridiksionit.

172. Nënparagrafi (f) gjithashtu merr parasysh nëse një kundërshtim do të kishte mundur të ishte i suksesshëm, duke qenë se ndryshe do të kishte qenë e paarsyeshme t'i kërkoje një të padituri të ndërmerre një kundërshtim të tillë. Me fjalë të tjera, Konventa nuk vendos një detyrim pa kushte ndaj një të padituri për ta kundërshtuar juridiksionin në gjykatën e origjinës. Nëse i padituri mund të tregojë në Shtetin e kërkuar, se çdo përpjekje për të kundërshtuar juridiksionin e gjykatës së origjinës nuk do të kishte pasur sukses, mos ngritja nga i padituri i një kundërshtimi të tillë përpara gjykatës së origjinës nuk do ta përmbushte filtrin.
173. Gjithsesi, për të mos lejuar një sjellje strategjike apo oportuniste nga ana e të paditurit, Konventa parashikon një standard relativisht të lartë prove. Duhet të jetë e *qartë* se kundërshtimi i juridiksionit nuk do të kishte pasur sukses sipas ligjit të Shtetit të origjinës.
174. **Shembull.** Gjykata e origjinës merr juridiksion vetëm në bazë të faktit që i padituri i huaj ka pronë në atë juridiksion, edhe pse nuk ka ndonjë lidhje midis padisë dhe asaj prone. Vendime të mëparshme të gjykatës së origjinës tregojnë se kundërshtimet e një juridiksioni të tillë gjithnjë nuk janë lejuar dhe si rrjedhojë, i padituri nuk e kundërshton juridiksionin në gjykatën e origjinës. Në një rast të tillë, vendimi eventual i gjykatës së origjinës nuk do të mendohet se e përmbush filtrin e nënparagrafit (f), pavarësisht faktit që i padituri nuk e ka kundërshtuar juridiksionin përpara asaj gjykate dhe ka argumentuar për themelin e çështjes.
175. **Kundërshtimi ndaj ushtrimit të juridiksionit.** Formulimi i nënparagrafit (f) përfshin jo vetëm kundërshtimet e juridiksionit të gjykatës së origjinës, por edhe kundërshtimet e ushtrimit të atij juridiksioni. Kjo do të jetë e përshtatshme kur ligji i Shtetit të origjinës përfshin doktrinën e *forum non conveniens*, i cili e lejon një të paditur t'i kërkojë një gjykate të mos pranojë ta ushtrojë juridiksionin e vet.
176. Në shumicën e Shteteve ku *forum non conveniens* është i disponueshëm, ai dallon nga juridiksioni në vetvete. Doktrina e lejon një gjykatë të mos pranojë të ushtrojë juridiksionin e vet dhe kështu nuk përfshin pranimin nga gjykata se ajo nuk ka juridiksion. Aty ku kjo doktrinë zbatohet, nuk është e pazakontë që një i paditur së pari të kundërshtojë juridiksionin dhe pastaj, në rastin që gjykata e hedh poshtë atë kundërshtim, të kërkojë që gjykata të mos pranojë të ushtrojë juridiksionin e vet. Madje të paditurit mund ta pranojë juridiksionin, por mund të kërkojnë vetëm që gjykata të mos e ushtrojë atë.
177. Gjuha e përdorur në nënparagrafin (f) kërkon që një i paditur të ngrejë të gjitha pretendimet e mundshme ndaj juridiksionit të gjykatës së origjinës, ose ndaj ushtrimit nga ana e saj e juridiksionit me qëllim për të shmangur zbatimin e filtrit në Shtetin e kërkuar. Nëse një i paditur, që ka pasur mundësinë ta kundërshtojë juridiksionin e një gjykate, ka zgjedhur të mos e bëjë këtë, apo që ka pasur rastin t'i kërkojë një gjykate të mos pranojë ta ushtrojë juridiksionin e vet dhe që nuk e ka bërë këtë, ose që nuk tregon se kërkesa të tilla nuk do të kishin pasur rast të ishin

të suksesshme, filtri do të jetë përmbushur. Në këto rrethana, nëse i padituri argumenton për themelin e çështjes, vendimi do të plotësonte kushtet për njohje apo zbatim sipas nënparagrafit (f).

178. **Shembuj.** Supozoni se në Shtetin e origjinës ku doktrina e *forum non conveniens* është e disponueshme, një i paditur e ka përdorur *forum non conveniens* pa kundërshtuar në të njëjtën kohë edhe juridiksionin në vetvete. Në rast se i padituri nuk tregon, përpara Shtetit të kërkuar, se juridiksioni në vetvete nuk është kundërshtuar nga që nuk ka pasur shans të kishte sukses, vendimi do të konsiderohet se e ka përmbushur filtrin, edhe pse i padituri i ka kërkuar gjykata të mos e pranojë juridiksionin. Po ashtu, nëse një i paditur e ka kundërshtuar juridiksionin por, pasi ky kundërshtim është hedhur poshtë, nuk ka kërkuar që gjykata të refuzojë të ushtrojë juridiksionin e vet, i padituri duhet të provojë se kjo kërkesë nuk kishte rast të qe e suksesshme. Së fundi, nëse i padituri as nuk e ka kundërshtuar juridiksionin dhe nuk ka kërkuar që gjykata e origjinës të mos pranojë të ushtrojë juridiksionin e vet, i padituri duhet të tregojë se asnjëri nga opsionet nuk ka pasur shans për të qenë i suksesshëm, me qëllim që të shmangë konstatimin se nënparagrafi (f) është përmbushur.
179. Në të gjithë këta skenarë, nuk është me rëndësi nëse moskundërshtimi i juridiksionit apo mos kërkesa që gjykata të refuzojë të ushtrojë juridiksionin e saj do të ishin baras me pëlqimin e nënkuptuar, sipas ligjit të gjykatës së origjinës. Konventa përmban filtra juridiksionalë vetëm me qëllim që të përcaktojë të drejtën e vendimeve gjyqësore për të qarkulluar. Gjithashtu, gjykata në Shtetin e kërkuar nuk merret me mënyrën se si gjykata e origjinës e vlerëson juridiksionin, por vetëm me faktin nëse secili nga filtrat e nenit 5 përmbushet. Për t'iu shmangur filtrit në nënparagrafin (f), i padituri duhet të ketë rezistuar që t'i nënshtrohet juridiksionit të gjykatës së origjinës në çdo mënyrë të mundshme ose shprehimisht përpara asaj gjykate, ose më vonë, përpara gjykatës së kërkuar, duke treguar se ai nuk e bëri këtë gjë në gjykatën e origjinës për shkak se nuk kishte shans të kishte sukses në atë gjykatë. Veprime apo argumente të tilla nga një i paditur, sigurisht, nuk do të pengojnë qarkullimin e vendimit nëse ka një filtër tjetër të zbatueshëm sipas nenit 5 ose 6. Me fjalë të tjera, një i paditur nuk mund të ngrejë thjesht një kundërshtim për juridiksion ose të kërkojë që gjykata e origjinës të refuzojë të ushtrojë juridiksionin e vet dhe të presë që kjo gjë ta pengojë qarkullimin e vendimit sipas Konventës.

Nënparagrafi (g) – vendimi gjyqësor shprehet për një detyrim kontraktues dhe u dha nga gjykata e shtetit në të cilën ndodhi, ose do të duhej të kishte ndodhur, përmbushja e këtij detyrimi, në përputhje me:

(i) marrëveshjen mes palëve; ose

(ii) ligjin e zbatueshëm për kontratën, në mungesë të marrëveshjes për vendin e zbatimit të tij,

me përjashtim të rastit kur aktivitetet e të paditurit në lidhje me transaksionin, nuk përbënin në mënyrë të qartë një lidhje të qëllimshme dhe thelbësore me atë shtet;

180. Ky nënparagraf parashikon një filtër për vendimet gjyqësore mbi detyrimet kontraktuese. Rregulla është rezultat i një kompromisi midis ty qasjeve. Nga njëra anë, disa Shtete mendojnë se vendi i përmbushjes së detyrimeve është një lidhje e

mjaftueshme me shtetin e origjinës, pa pasur nevojë për plotësim kushtesh të tjera. Nga ana tjetër, disa Shtete kërkojnë një vlerësim më faktik të mbështetur në veprimtarinë e një të padituri në Shtetin e origjinës. Ia vlen të vihet në dukje se, përshkak se palët në kontratat ndërkombëtare shpesh përfshijnë marrëveshje për zgjedhjen e gjykatës ose klauzola arbitrazhi në kontratat e tyre, ky nënparagraf nuk duhet të përdoret shpesh në fazën e ekzekutimit ligjor.¹³⁵

181. **Vendi i përmbushjes së detyrimeve kontraktuese si pikënisje.** Nënparagrafi (g) përfaqëson qasjen e parë ku vendi i punës për përmbushjen e një detyrimi kontraktues është bazë për njohjen dhe zbatimin e një vendim gjyqësor. Ky formulim do të thotë se lidhja mund të ndryshojë në varësi të burimit të mosmarrëveshjes midis palëve, objekt i vendimit. Për shembull, në një kontratë për shitjen e mallrave, nëse shitësi ngre një padi për pagesë dhe vendimi mbështetet në atë padi, nënparagrafi (g) do të njohë lidhjen me gjykatën e vendit ku duhej të ishte bërë pagesa. Por, nëse blerësi ngre një padi për vonesë në dorëzim, nënparagrafi (g) në vend të saj, do t'u referohet gjykatave në vendin e dorëzimit të mallit. Kjo qasje ndryshon nga ajo e instrumenteve të tjera, si *Rregullorja e Brukselit*, që për disa lloj kontratash parashtron një forum të vetëm kontraktues, i cili nuk ndryshon në varësi të detyrimit që përbën bazën e padisë.¹³⁶
182. **Vendi i përmbushjes së detyrimeve kontraktuese: mosmarrëveshja midis palëve.** Konventa parashikon dy burime për të identifikuar vendin e kryerjes së detyrimeve kontraktuese: vetë kontrata, ose ligji që rregullon kontratën. Nëse kontrata e përcakton vendin e kryerjes së detyrimit, një vendim gjyqësor i dhënë nga një gjykatë në atë vend do të përmbushë filtrin e nënparagrafit (g)(i), pavarësisht nga fakti nëse puna është bërë vërtet në atë vend. Me fjalë të tjera, marrëveshja e palëve lidhur me vendin e përmbushjes së detyrimeve është përcaktuese. Në praktikë, ndodh shumë shpesh që vendi i kryerjes së detyrimeve të përfshihet në kushtet e përgjithshme të kontratës të njëjës apo të të dyja palëve. Vlefshmëria e kushteve të tilla kontraktuese do të përcaktohet nga ligji i Shtetit të kërkuar, duke përfshirë edhe rregullat e tij të së drejtës ndërkombëtare private.
183. Kur termat e kontratës nuk e përcaktojnë vendin e përmbushjes së detyrimeve, por palët kanë përfshirë në kontratë një klauzolë për zgjedhjen e ligjit, nënparagrafi (i) ose (ii) mund të jenë me rëndësi. Sigurisht që “marrëveshja e palëve” mund të përfshijë një marrëveshje për ligjin e zbatueshëm, i cili pastaj përcakton vendin e përmbushjes së detyrimit përkatës. Por, Konventa nuk vendos rregulla për ligjin mbi zgjedhjen e gjykatës për kontratat. Mund të ndodhë që në një Shtet të kërkuar, nuk i jepet ndonjë efekt apo i jepet një efekt i kufizuar zgjedhjes nga palët të klauzolës për zgjedhjen e ligjit të nënparagrafit (g)(ii). Kështu, për që qenë në përputhje me fushën e veprimit të Konventës, e cila nuk synon të përcaktojë rregulla për zgjedhjen e ligjit, do të ishte e parapëlqyeshme që të kufizohej nënparagrafi (g)(i) për ato raste

¹³⁵ Për vendimet gjyqësore të dhëna nga gjykata, të përcaktuar në një marrëveshje, shih, nën-paragrafi (m) më poshtë. Për një diskutim të përjashtimit të arbitrazhit nga Konventa, shih, neni 2(3) më lart.

¹³⁶ Shih, neni 7(1) i Rregullores së Brukselit (*Brussels Ia Regulation*).

ku kushtet e kontratës e përcaktojnë drejtpërdrejt vendin e përmbushjes së detyrimeve.

184. **Ligji i zbatueshëm.** Situata e dytë lind kur nuk ka marrëveshje për vendin e përmbushjes së detyrimeve, ose kur marrëveshja për përmbushjen e detyrimeve nuk është e vlefshme. Në një rast të tillë, vendi i përmbushjes së detyrimeve do të duhet të përcaktohet në bazë të ligjit që rregullon kontratën. Konventa nuk e specifikon se si ai ligj duhet të përcaktohet dhe si pasojë ky vendim i lihet ligjit të Shtetit të kërkuar, duke përfshirë rregullat e tij të së drejtës ndërkombëtare private.
185. **Shembull.** X-i ngre një padi kundër Y-së në Shtetin A. Baza e padisë është mos pagesa nga ana Y-it e disa mallrave dërguar atij në Shtetin B. Kontrata është bërë me telefon dhe palët nuk kanë caktuar vendin e pagesës. Në këtë rast, nëse X-i merr një vendim nga gjykata në favor të tij, bazuar në atë padi, ai vendim do të njihet dhe ekzekutohet sipas nënparagrafit (g) kur, në përputhje me ligjin që rregullon kontratën, vendi i pagesës ka qenë Shteti A. Ligji i Shtetit të kërkuar, duke përfshirë rregullat e tij të së drejtës ndërkombëtare private, do të përcaktojë se cili ligj e rregullon atë kontratë.
186. **Disa vende ku kryhet puna.** Nën-paragrafi (g) i referohet vendit të përmbushjes së detyrimeve kontraktuese në bazë të së cilave është dhënë vendimin. Ky zakonisht do të jetë detyrimi që përbën bazën e padisë së paditësit. Nëse e njëjta kontratë përmban detyrime të ndryshme dhe të ndashme për njërën palë, rregulla duhet të zbatohet veçan për secilin prej tyre. Për shembull, nëse shitësi ka detyrimin për të dërguar mallrat në dy Shtetet, A dhe B, një vendim gjyqësor i dhënë në Shtetin A do të qarkullojë vetëm sipas këtij filtri për sa i takon detyrimin për dorëzimin e mallrave në këtë Shtet (Por, mund të zbatohet edhe neni 9 për ndarjen, shih, *infra*). Përdorimi i kësaj rregulle për detyrimet negative, *pra*, detyrimet për të mos bërë diçka, u diskutua shkurtimisht gjatë Sesionit njëzetë e dy, por u la i hapur për analizë të mëtejshme nga gjykata dhe studiuesit e së drejtës.
187. **Mbrojtja: “lidhje të qëllimshme dhe të rëndësishme me Shtetin e origjinës”.** Vendi i përmbushjes së detyrimeve mund të jetë një vend që është arbitrar, i rastësishëm apo jo mjaftueshëm i lidhur me transaksionin midis palëve. Njohja e lidhjes me një vend të tillë si një filtër i kënaqshëm mund të konsiderohet e padrejtë për të paditurin. Për shembull, në rastin e kontratave të përmbushura online, lidhja me Shtetin e origjinës mund të jetë thjesht virtuale dhe, si rrjedhojë, e pamjaftueshme për të justifikuar qarkullimin e vendimit sipas Konventës. Po ashtu, Konventa parashikon njohjen apo zbatimin e një vendimi gjyqësor të dhënë në Shtetin e vendit të përmbushjes së detyrimeve përveç se kur lidhjet e veprimtarisë së të paditurit me transaksionin duket qartë se nuk kanë përbërë një lidhje të qëllimshme dhe të rëndësishme me atë Shtet.
188. Kjo klauzolë nuk ka homologe në instrumente të tjera apo në ligjin e brendshëm, edhe pse ajo pasqyron shqetësimet e disa sistemeve lidhur me drejtësinë që u jepet të paditurve jo rezidentë apo të drejtave të tyre për një proces të rregullt. Termat “i qëllimshëm dhe i rëndësishëm” janë përdorur për të siguruar që filtri i nënparagrafit (g) të mos përmbushet nga lidhjet gjeografike të cilat janë arbitrare,

të rastësishme apo jo mjaftueshëm të lidhura me transaksionin midis palëve.¹³⁷ Kështu, sipas shembullit të paragrafit 185, Y-ja mund të ngrëjë çështjen e mbrojtjes dhe të argumentojë se është e qartë se ata nuk kishin për qëllim të angazhoheshin në veprimtari që përbëjnë një lidhje të qëllimshme dhe të rëndësishme me Shtetin A.

Nënparagrafi (h) – vendimi gjyqësor shprehet për kontratën e qirasë së pronës së paluajtshme (qiramarrjen) dhe u dha nga gjykata e shtetit në të cilin ndodhet prona;

189. Nënparagrafi (h) është një kompromis midis dy pikëpamjeve të kundërta në lidhje me qiratë e pronës së patundshme, që quhen qira në shumicën e shteteve. Qiradhënia e pronave të patundshme i referohet marrëdhënies ligjore që krijohet nga një marrëveshje ku njëra palë merr përsipër t'i japë palës tjetër një të drejtë të përkohshme për të përdorur një pronë të patundshme, ose një pjesë të saj, në këmbim të pagimit të qirasë. Në disa Shtete, një qiradhënie e tillë trajtohet në të njëjtën mënyrë si të drejtat sendore *in rem* dhe paditë në lidhje me të i nënshtrohen juridiksionit ekskluziv të Shtetit ku prona ndodhet. Në Shtete të tjera, një qiradhënie e tillë trajtohet si kontratë (*pra*, të drejtat *in personam*) pa ekskluzivitetin shoqërues që u jepet gjykatave të Shtetit ku prona e patundshme ndodhet lidhur me paditë për qiradhënien.
190. Në përputhje me nënparagrafin (h), një vendim gjyqësor që vendos për qiradhënien e një prone të patundshme (qiraja) plotëson kushtet për njohje apo zbatim nëse vendimi është dhënë në Shtetin në të cilin prona ndodhet. Ai përfshin çdo qiradhënie pavarësisht nga natyra e saj, *pra*, për qëllim profesional, tregtar apo personal (përveç një qiradhënie për banim që i nënshtrohet në rregulle të posaçme në para. 3). Gjithashtu, dispozita mbulon mosmarrëveshjet midis të zotit të pronës dhe qiramarrësit duke përfshirë, për shembull, ekzistencën apo interpretimin e marrëveshjes së qirasë, nxjerrja jashtë me forcë, dëmshpërblimi për dëmet e shkaktuara nga qiramarrësi, apo rikuperimin e qirasë.
191. Kjo dispozitë nuk e përjashton përdorimin e filtrave të tjerë, siç është nënparagrafi (a) (vendqëndrimi i rregullt i një të padituri). Kështu, një vendim gjyqësor i dhënë nga gjykatat e Shtetit ku i padituri ka pasur vendqëndrim të rregull, do të qarkullojnë sipas Konventës edhe nëse ajo ka vendosur për një qiradhënie të një prone të patundshme që ndodhet në një Shtet tjetër në lidhje me nënparagrafin (g) (detyrimet kontraktuese), rregulla e veçantë për qiradhënien mund të marrë rëndësi kur, për shembull, pagesa e qirasë nga qiramarrësi duhet të bëhet në një Shtet të ndryshëm nga Shteti ku prona ndodhet. Paragrafi 3 parashikon një rregull të qartë për qiratë rezidenciale.

Nënparagrafi (i) – vendimi gjyqësor shprehet kundër të paditurit për detyrimin kontraktor, të garantuar nga e drejta e përdorimit, in rem, të një prone të paluajtshme të marrë me qira nga i padituri, që ndodhet në shtetin e origjinës, nëse padia lidhur me

¹³⁷ Shih, *Burger King Corp. kundër Rudzewicz*, 471 U.S. 462 (1985), sidomos Brennan J. në f. 478-479 (Shtetet e Bashkuara të Amerikës).

kontratën është paraqitur së bashku me padinë ndaj të njëjtit të paditur në lidhje me atë të drejtë përdorimi, in rem;

192. Kjo dispozitë pranon se është efikase të lejohet një padi për detyrime kontraktuese, e siguruar nga e drejta sendore *in rem*, të bashkohet me një padi që lidhet me atë të drejtë *in rem* në të njëjtin proces ligjor.¹³⁸ Sipas nenit 6, vetëm Shteti ku prona e patundshme ndodhet, konsiderohet se futet në filtrin për paditë sendore *in rem*. Pa nënparagrafin (i), mund të mos jetë e mundur të njihet një vendim gjyqësor për padinë e lidhur kontraktuese të ngritur në atë Shtet ku, për shembull, debitori nuk ka pasur vendqëndrim të rregullt në atë Shtet (nënparagrafi (a)) apo kur këto pagesa nuk duheshin bërë në atë Shtet (nënparagrafi (g)).
193. **Shembull.** Z-ja, me vendqëndrim të rregullt në Shtetin A, blen një pronë të patundshme në Shtetin B. Çmimi i blerjes financohet nga një kredi hipotekare e dhënë nga një bankë në Shtetin C. Marrëveshja hipotekare parashikon që pagesat duhen bërë në Shtetin C. Z-ja nuk e paguan kredinë hipotekare dhe banka çel procedura gjyqësore në Shtetin B për të siguruar shitjen me vendim gjyqi të pronës dhe një vendim gjyqësor kundër Z-së për çdo pamjaftueshmëri fondesh që rrjedh nga shitja me vendim gjyqi. Prona shitet për më pak se sa shuma e mbetur në kredinë hipotekare. Vendimi i gjykatës në Shtetin B i cili e shpall Z-në përgjegjës për pamjaftueshmëri fondesh do të jetë i zbatueshëm në Shtetin A sipas nënparagrafit (i).¹³⁹

Nënparagrafi (j) – vendimi gjyqësor shprehet për detyrimin jokontraktor që lind nga vdekja, dëmtimi fizik, dëmi ose humbja e pasurisë së patundshme, si dhe nga veprimi ose mosveprimi që shkaktoi drejtpërdrejt këtë lloj dëmi për shtetin e origjinës, pavarësisht se ku ka ndodhur ai dëm;

194. Ky nënparagraf vendos një filtër për njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore në çështje që kanë të bëjnë me detyrimet jo kontraktuese. Edhe një herë, kjo lidhje nuk është e nevojshme nëse personi kundër të cilit kërkohet ekzekutimi ka pasur vendqëndrim të rregullt në Shtetin e origjinës në kohën përkatëse (nënparagrafit (a)). Për sa i takon të paditurit në gjykatën e origjinës, kjo dispozitë do të kufizohet kështu me vendimet gjyqësore për paditë kundër të paditurve të huaj në gjykatën e origjinës.¹⁴⁰ Duhet pranuar se raste të tilla janë situatat kur ekzekutimi jashtë

¹³⁸ Bashkimi i këtyre dy padive në një proces të vetëm gjyqësor pritet të ndodhë në juridiksione ku ekzekutimi i barrës sigurose për një pronë të patundshme administrohet me vendim gjyqi. Kur ekzekutimi mund të bëhet në mënyrë të njëanshme nga kreditori – pra, kur lejohet ekzekutimi jashtëgjyqësor – duhet ngritur vetëm një padi për pamjaftueshmëri të mundshme fondesh, duke e pakësuar rëndësinë e këtij nën-paragrafi për këto sisteme ligjore.

¹³⁹ Për një shembull tjetër në kuadër të një dispozite të ngjashme të parashikuar nga Rregullorja e Brukselit (Brussels Ia Regulation), shih, GJED, Vendimi i 14 shkurtit 2019, *Anica Milivojevis kundër Reiffeisen bank St. Stefan-Jagerberg-Wolfsberg eGen*, C-630/17, EU:C:2019:123 (padi për shpalljen e pavlefshmërisë së një marrëveshjeje kredie dhe të tapisë së noterizuar për dorëzimin e një hipoteke të marrë si garanci për borxhin e krijuar nga ajo marrëveshje).

¹⁴⁰ Kur vendimet gjyqësore jepen kundër shumë të paditurve ose kur shpallin se të paditur të tillë janë bashkërisht përgjegjës, filtrat sipas nenit 5, duke përfshirë nënparagrafin (j), duhet të përmbushen në bazë individuale që vendimi kundër një të padituri të caktuar të qarkullojë sipas Konventës (Shih

Shtetit të origjinës ka më gjasa të ndodhë, duke supozuar se i padituri është gjetur fajtor dhe është urdhëruar të paguajë kompensime.

195. Konventa nuk i përcakton detyrimet jo kontraktuese, njëlloj sikundër nuk përcakton detyrimet kontraktuese në nënparagrafin (g). Në parim, këto koncepte duhet të përcaktohen nga gjykatat e brendshme në mënyrë autonome, duke marrë në konsideratë karakterin ndërkombëtar të Konventës për të nxitur zbatimin e njëjtë së saj (shih Neni 20). Megjithatë, përdorimi i këtij nënparagrafi është i kufizuar në disa lloje të caktuara dëmsh të pësuar.
196. **Detyrimet jo kontraktuese që krijohen nga vdekja, lëndimi fizik, dëmi apo humbja e pronës së trupëzuar.** Jo të gjitha paditë që përfshijnë detyrimet jo kontraktuese janë të mbuluara nga kjo dispozitë. Në objektin saj, ajo është e kufizuar tek vendimet gjyqësore për detyrimet që dalin nga dy lloje lëndimesh: ndaj personave dhe ndaj pronës. Edhe me këto ndarje, dispozita është e kufizuar tek lëndimet fizike (duke përfshirë vdekjen) të individëve dhe të pronave të trupëzuara (dëmtim apo humbje). Kjo dispozitë nuk zbatohet kur vendimi jepet për një padi të mbështetur në humbje që nuk janë të lidhura me një lëndim fizik apo dëm ndaj pronës së trupëzuar.
197. **Vendi ku ka ndodhur veprimi apo mosveprimi që shkaktoi dëmin.** Konventa ka ndjekur një bazë të ngushtë për detyrimet jo kontraktuese: ajo kufizohet me vendin e veprimit (apo mosveprimit) që ka shkakuar drejtpërdrejt dëmin. Kjo qasje ndryshon në sisteme ligjore kombëtare dhe rajonale që gjithashtu e njohin juridiksionin e ushtruar nga gjykata në Shtetin ku dëmi ka ndodhur.¹⁴¹ Ky kufizim në një lidhje të vetme dhe kufizimi i llojeve të dëmeve të vëna në dukje më lart, mund t'i pakësojë vështirësitë në interpretim që kanë dalë në sisteme të tjera. Për shembull, argumentet që disa lloj lëndimesh janë thjesht “të tërthorta” shpesh paraqiten në lidhje me lëndimet jo fizike që pësojnë viktimat e ashtuquajtura dytësore, humbjet e të cilave vijnë si rezultat i një lëndimi fizik apo vdekjes të pësuar nga një person tjetër. Një shembull i qartë është ai i një bashkëshorteje apo fëmije që ngre padi për humbje morale apo ekonomike, si pasojë e vdekjes së padrejtë të bashkëshortit apo prindit. Ka mundësi që vendimet gjyqësore për paditë e ngritura nga personat në ngarkim të tyre për vdekje të padrejtë të mos mbulohen nga nënparagrafi (j), sepse ajo dispozitë i përjashton lëndimet jo fizike dhe trajton vetëm dëmin e shkakuar drejtpërdrejt. Nga ana tjetër, meqë nënparagrafi (j) trajton detyrimet jo kontraktuese që rrjedhin nga vdekja, vendime të tilla gjyqësore për padi ndaj personave në ngarkim mund të përfshihen shumë mirë në këtë filtër. Kjo do të duhet të vendoset nga gjykatat që zbatojnë Konventën, të udhëhequr nga qëllimi i Konventës për një zbatim të njëjtë të saj të shprehur në nenin 20.

gjithashtu *supra*, para. 137).

¹⁴¹ Sigurisht kjo është me rëndësi nëse ky vend është i ndryshëm nga vendi i veprimit apo mosveprimit. Shih *Brussels la Regulation*, neni 7(2) siç është interpretuar nga GJED-ja, vendimi i 30 nëntorit 1976, *Handelskwekerij G. J. Bier BV kundër Mines de potasse d'Alsace*, C-21/76, EU:C:1976:166.

198. Nga ana tjetër, formulimi i nënparagrafit (j) eliminon çdo pikëpyetje lidhur me faktin nëse vazhdimi i dhimbjeve dhe vuajtjeve në Shtetin e origjinës, si pasojë e një lëndimi fizik të pësuar në një Shtet tjetër, është i mjaftueshëm për të justifikuar filtrin. Duke e kufizuar nënparagrafin (j) me vendin ku ka ndodhur veprimi apo mosveprimi që ka shkaktuar dëmin, nuk ka vend për një lidhje alternative me vendin e “vazhimit të lëndimit”. Por, përsëri mund të dalin vështirësi të tjera në interpretim që lidhen me përjashtimin e vendit të lëndimit në nënparagrafin (j). Për shembull, një vendim gjyqësor për një padi të ngritur kundër një fabrikanti të huaj në Shtetin ku thuhet se ka ndodhur një lëndim fizik, mund të mos e përmbushë kërkesën e nënparagrafit (j) nëse vendi i veprimit (projekti apo produkt me defekte) kuptohet se është në Shtetin ku prodhuesi ndodhet. Megjithatë, nëse vendimi është për një padi të bazuar në mosparalajmërim, mund të argumentohet se ky mosveprim ka ndodhur në vendin e lëndimit, që është vendi ku produkti është shitur apo përdorur. Nëse vendndodhja e mosveprimit konsiderohet se është një çështje ligji dhe jo fakti në Shtetin e kërkuar, objekti i nënparagrafit (j) mund të ndryshojë në varësi të mënyrës me anë të së cilës kjo çështje zgjidhet në Shtetin e kërkuar.¹⁴² Sikundër në paragrafin e mëparshëm, kjo çështje do të duhet të vendoset nga gjykatat që zbatojnë Konventën, të udhëhequra nga objektivi i Konventës për zbatimin e njëjtë së saj, të shprehur në nenin 20.

Nënparagrafi (k) – vendimi gjyqësor ka të bëjë me vlefshmërinë, ndërtimin, efektet, administrimin ose variacionet e instrumentit të trustit, të krijuar vullnetarisht dhe të dëshmuar me shkrim, dhe –

- (i) në kohën e fillimit të procedurës, shteti i origjinës ishte përcaktuar në instrumentin e trustit si shteti, në gjykatat e të cilit do të zgjidheshin mosmarrëveshjet në lidhje me çështje të tilla; ose***
- (ii) në kohën e fillimit të procedurës, shteti i origjinës ishte përcaktuar shprehimisht ose në mënyrë të nënkuptuar në instrumentin e trustit si shteti në të cilin ndodhet vendi kryesor i administrimit të trustit.***

Ky nën-paragraf zbatohet vetëm për vendimet gjyqësore që kanë të bëjnë me aspektet e brendshme të një trusti mes personave, që janë ose ishin të inkuadruar brenda marrëdhënieve të trustit;

199. Ky nënparagraf zbatohet për vendime gjyqësore që kanë të bëjnë me vlefshmërinë, ndërtimin, pasojat, administrimin apo ndryshimin e një trusti.¹⁴³ Sikundër specifikohet në pjesën e fundit të nënparagrafit (k), vetëm vendimet gjyqësore që trajtojnë mosmarrëveshje të brendshme të trustit janë të përfshira. Vendimet gjyqësore që trajtojnë mosmarrëveshjet midis palëve të trustit dhe palëve të treta duhet të shqyrtohen sipas dispozitave të tjera të nenit 5(1).

¹⁴² Me fjalë të tjera, gjykata e kërkuar mund të shohë ligjin e saj të brendshëm apo ligjin e zbatueshëm për çështjen sipas rregullave të saj për zgjedhjen e ligjit.

¹⁴³ Sipas nenit 8 të KHDNP-së, *Konventa e 1 korrikut 1985 për ligjin e zbatueshëm për trustet dhe për njohjen e tyre* (më poshtë, the “KHDNP 1985, Konventa për Trustet”), e cila lidhur me këtë pikë, pasqyron doktrinën e vendosur të së drejtës anglosaksone, këto çështje përcaktohen nga ligji që rregullon trustet.

200. **Trustet.** Termi “trust” nuk përkufizohet në Konventë. Në fakt trusti është një koncept i të drejtës anglosaksone dhe mund të mos njihet nga sistemet e tjera ligjore. Megjithatë, ai përkufizohet në nenin 2 të KHDNP 1985, Konventa për Trustet, për qëllimet e asaj Konvente.¹⁴⁴ Ai përkufizim do të jetë udhëzues nëse del ndonjë çështje përkufizimi, sepse ai përmend veçoritë e trustit sipas koncepteve të së drejtës anglosaksone.¹⁴⁵
201. Ky nënparagraf zbatohet për një trust të krijuar me vullnet të lirë dhe të evidentuar me shkrim.¹⁴⁶ Ai nuk përfshin situatat sipas të drejtës anglosaksone ku një trust që krijohet apo që ndërtohet imponohet me ligj. Megjithëse trusti duhet të jetë krijuar me vullnet të lirë, ai nuk duhet të jetë produkt i një marrëveshjeje; ai mund të krijohet në mënyrë të njëanshme me titull trusti apo me një instrument testamentar. Përrjashtimi i testamenteve dhe trashëgimisë nga objekti material i Konventës (Neni 2(1)(d)) nuk bie ndesh me përfshirjen e trusteeve testamentare të nënparagrafit (k). Neni 2(1)(d) përjashton çështjet paraprake, siç janë çështjet lidhur me vlefshmërinë apo interpretimin e testamentit, për aq sa ato lidhen me vlefshmërinë dhe kuptimin e trustit. Por vendimet gjyqësore për çështje të tjera që dalin gjatë administrimit të një trusti testamentar, të krijuar në mënyrë të vlefshme, mbulohen nga nënparagrafi (k) (Shih, gjithashtu, neni 8(2)).¹⁴⁷
202. **Emërtimi i një Shteti për vendosjen e çështjeve të renditura.** Nënparagrafi (k) parashikon dy lidhje alternative në varësi të instrumentit me anë të së cilit trusti është krijuar. Opsioni i parë është ai kur instrumenti i trustit i përcakton gjykatat e një Shteti për të vendosur mbi vlefshmërinë, ndërtimin, pasojat, administrimin apo ndryshimin e trustit. Nëse ai Shtet është Shteti i origjinës, filtri përmbushet. Nënparagrafi (k)(i) nuk kërkon që emërtimi i instrumentit të jetë përjashtues. Për më tepër, emërtimi duhet të jetë i përfshirë në instrument në kohën që kanë nisur procedurat gjyqësore. Në këtë rast, çdo modifikim i mëvonshëm i emërtimit të gjykatës nuk do të pengojë njohjen e vendimit eventual në një datë të mëvonshme.
203. **Emërtimi i vendit të administrimit të trustit.** Opsioni i dytë është kur instrumenti i trustit përmban emërtimin e shprehur të Shtetit në të cilin ndodhet vendi kryesor i administratës së trustit. Nëse ai Shtet është Shteti i origjinës, filtri përmbushet. Sikundër opsioni i parë më lart, emërtimi duhet të ekzistojë në kohën që nisin procedurat gjyqësore. Një variant më i vonshëm i emërtimit nuk e shuan në mënyrë retroaktive këtë lidhje në çastin e njohjes apo ekzekutimit të vendimit.
204. **Emërtimi i nënkuptuar.** Nënparagrafi (k)(ii) i referohet emërtimit të vendit kryesor të administrimit të trustit në vetë instrumentin e trustit. Në mungesë të emërtimit të shprehur, detyra e gjykatës të kërkuar është që të përcaktojë nëse ka një

¹⁴⁴ Në kohën e këtij shkrimi, kjo Konventë ka hyrë në fuqi në 14 Shtete kontraktuese: Australi, Kanada, Republika Popullore e Kinës (Hong Kong SAR), Qipro, Itali, Lihtenshtein, Luksemburg, Maltë, Monako, Holandë, Paraguai, San Marino, Zvicër dhe në Mbretërinë e Bashkuar.

¹⁴⁵ Raporti Nygh/Pocar, para. 150.

¹⁴⁶ Ky është gjithashtu kufiri i zbatimit të KHDNP 1985, Konventa për Trustet (shih Neni 3).

¹⁴⁷ Shih, për një përjashtim të ngjashëm, KHDNP 1985, Konventa për Trustet (Neni 4).

emërtim të nënkuptuar në instrumentin e trustit, përmes interpretimit të kushteve të atij instrumenti, të marrë në tërësi. Gjykata mund të marrë parasysh rrethana të tjera të rastit vetëm që ta ndihmojnë atë për të interpretuar nëse kushtet e instrumenteve të trustit përmbajnë një emërtim të nënkuptuar. Në çdo rast, gjykata duhet të përcaktojë nëse synimet e krijuesit të trustit dalin pah nga kushtet e instrumenteve të trustit në fjalë, pa përdorur ndonjë prezumim specifik në lidhje me ato synime.

205. Për të ndihmuar në këtë përcaktim, më poshtë keni shembuj jo shterues të kushteve që mund të ofrojnë prova lidhur me qëllimet e nënkuptuara të krijuesit të trustit: (i) i besuari apo të besuarit janë rezidentë në një Shtet dhe identiteti i tyre është parashikuar në vetë instrumentin e trustit; (ii) një i besuar është një shoqëri tregtare e themeluar në një juridiksion të caktuar posaçërisht për të mbajtur pasuritë e trustit; (iii) një trust themelohet për një qëllim të caktuar i parashikuar në instrumentin e trustit (për shembull, për të përfituar një bamirësi në një Shtet të caktuar); (iv) një klauzolë në instrumentin e trustit parashikon që pasuritë e trustit të mbahen apo investohen në një juridiksion të caktuar.
206. Opsionet në nënparagrafin (k)(i) dhe (ii) janë alternativa dhe një vendim gjyqësor i dhënë nga një Shtet që është emërtuar në secilën prej mënyrave do të përmbushë filtrin e nënparagrafit (k). Në rastin e nënparagrafit (k)(ii), njohja apo ekzekutimi i një vendimi të tillë gjyqësor gjithsesi mund të refuzohet pas nenit 7(1)(d).
207. **Aspekte të brendshme.** Fjalja e fundit e nënparagrafit (k) e kufizon filtrin për vendimet gjyqësore për mosmarrëveshje të brendshme të trustit, *pra*, mosmarrëveshje midis personave brenda marrëdhënies së trustit (siç është krijuesi i trustit, kujdestarët dhe përfituesit) dhe jo me persona jashtë trustit. Përdorimi i fjalisë “*janë apo kanë qenë në marrëdhënie trusti*” siguron që një person ka qenë në një marrëdhënie trusti, por që nuk ka qenë më në atë pozicion në kohën e njohjes apo ekzekutimit mbetet i mbuluar nga filtri. Vendimet gjyqësore që trajtojnë mosmarrëveshjet midis palëve në trust dhe palëve të treta duhen konsideruar sipas dispozitave të tjera të paragrafit 1.

Nënparagrafi (l) – vendimi gjyqësor shprehet për kundërpadinë:

- (i) në masën që ishte në favor të kundërpaditësit, me kushtin që kundërpadia të paraqitet për të njëjtin transaksion ose të njëjtën ngjarje si edhe padia; ose***
- (ii) në masën që ishte kundër kundërpaditësit, me përjashtim të rastit kur ligji i shtetit të origjinës kërkonte që kundërpadia të paraqitet për të shmangur prekluzivitetin;***

208. Ky nënparagraf vendos filtra për kundërpaditë. Në më shumë sisteme ligjore, një i paditur mund të përgjigjet ndaj një padie jo vetëm me anë të mbrojtjes së drejtpërdrejtë kundër asaj padie, që do të kishte efektin e shuarjes tërësisht apo pjesërisht të kërkesës së paditësit, por gjithashtu duke bërë një kërkesë të pavarur të vetën, që kërkon një vendim gjyqësor kundër paditësit fillestar, e quajtur kundërpadi. Për shembull, në një kontratë për shitjen e mallrave me këste, nëse shitësi bën një padi për pagimin e pjesës së mbetur të vlerës së çmimit, blerësi mund të mbrohet kundër asaj padie në bazë të faktit se kjo shumë nuk duhej paguar dhe të shtojë një kundërpadi për dëmshpërblim, duke pretenduar se mallrat janë

dërguar me vonesë. Kundërpadia nuk ka nevojë të dalë nga e njëjta kontratë, por zakonisht duhet të lidhet me marrëdhënien midis palëve. Ndonëse kundërpadia mund të ishte ngritur veçan, në një proces tjetër gjyqësor, konsiderohet më efikase që të lejohet të paraqitet në kuadër të procesit fillestar. Në disa juridiksione dhe në rrethana të caktuara, mund të jetë madje e detyrueshme që një i paditur të paraqesë padinë e vet si kundërpadi; mosbërja e një gjëje të tillë kërkon që të konsiderohet se është hequr dorë nga padia e cila nuk mund të paraqitet më vonë në një proces të veçantë.¹⁴⁸

209. Nënparagrafi (I) përmban dy filtra në varësi nga fakti nëse vendimi për kundërpadinë ka qenë në favor apo kundër kundërpaditësit. Trajtimi i ndryshëm i kundërpadive të suksesshme dhe të pasuksesshme përfshihet për të ekuilibruar interes e palëve në lidhje me kundërpadinë dhe për të marrë parasysh mundësinë e kundërpadive të detyruara sipas të drejtës procedurale në gjykatën e origjinës.
210. **Vendimet gjyqësore në favor të kundërpaditësit.** Nuk ka arsye të kufizohet qarkullimi kur kundërpadia është e suksesshme. Në fakt, në një rast të tillë, çdo cenim i mundshëm që rrjedh nga të qenit i detyruar të bësh një kundërpadi ekuilibrohet me rezultatin e favorshëm për kundërpaditësit. Megjithatë, për të siguruar drejtësi ndaj paditësit fillestar (i padituri në kundërpadi), kundërpadia duhet të dalë nga transaksioni apo një ndodhi mbi të cilën mbështetet padia origjinale. Paditësi fillestar ka dhënë pëlqimin e tij për juridiksionin e gjykatës së origjinës duke bërë një padi përpara asaj gjykate. Prandaj është legjitime që kjo gjykatë mund të japë vendim edhe për një kundërpadi por vetëm për atë sa ajo rrjedh nga i njëjti transaksion apo ndodhi.
211. Fjala “transaksion” ka për qëllim të ketë një fushëveprim të gjerë, duke iu referuar marrëdhënies së palëve. Me fjalë të tjera, kundërpadia nuk është e thënë që të dalë nga kontrata aktuale mbi të cilën mbështetet padia fillestare; ajo mund të dalë nga një kontratë tjetër e varur prej saj, që është pjesë e transaksionit më të gjerë midis palëve. Ndryshe, fjala në anglisht “ndodhi e njëjtë” është përdorur për të përfaqësuar formulimin në frëngjisht “des mêmes faits - të njëjtat fakte” për të theksuar se faktet mbi të cilat mbështetet kundërpadia nuk kanë nevojë të jenë identike dhe mund të dalin nga bashkësi rrethanash më të gjera, por megjithatë të lidhura.¹⁴⁹
212. **Vendimet gjyqësore kundër kundërpaditësit.** Kur kundërpadia dështon, nuk ka nevojë të mbrojtë paditësin fillestar duke vendosur kërkesën e lidhjes së ngushtë. Interesi i paditësit fillestar është saktësisht përfitimi nga Konventa dhe duke bërë kundërpadi, kundërpaditësi ka dhënë pëlqimin e heshtur për juridiksionin e gjykatës së origjinës. Meqenëse i padituri është në fakt paditësi për sa i takon kundërpadisë, këtë filtër mund të përsërisë nën-paragrafin (c). Por, baza logjike më

¹⁴⁸ *Për shembull*, sipas Rregullës 13 të Rregullores Federale Amerikane të procedurës civile.

¹⁴⁹ Raporti Nygh/Pocar, para. 200. Krahasojeni me formulimin më të ngushtë të nenit 8(3) të Rregullores së Brukselit, që përmban frazën “e njëjta kontratë ose të njëjtat fakte mbi të cilat është mbështetur padia fillestare”.

lart presupozon që kundërpaditësi e ka bërë vullnetarisht kundërpadinë. Prandaj, për të shpjeguar se kundërpadia ishte e detyrueshme sipas ligjit të Shtetit të origjinës, nënparagrafi (I)(ii) mbron kundërpaditësit në rastin kur kundërpadia dështon, duke mos e penguar kundërpaditësin humbës që të ngrejë të njëjtën padi diku gjetkë.

213. Ajo që ka rëndësi është se kjo dispozitë nuk e pengon qarkullimin e vendimit për kundërpadinë nëse zbatohet një filtër tjetër i paragrafit 1. Për shembull, nëse kundërpaditësi ka vendqëndrim të rregullt në Shtetin e origjinës, vendimi kundër atij kundërpaditësi përmbush nënparagrafin (a) dhe përjashtimi i kundërpadisë së detyruar në nënparagrafin (I)(ii) nuk do ta mbrojë atë kundërpaditës të pasuksesshëm. Po ashtu, nëse paditësi fillestar ka vendqëndrim të rregullt në Shtetin e origjinës, vendimi për kundërpadinë e suksesshme gjithashtu do të përmbushë filtrin e nënparagrafit (a) edhe nëse kundërpadia nuk ka dalë nga i njëjti transaksion.

Nënparagrafi (m) – vendimi gjyqësor u dha nga gjykata e përcaktuar në një marrëveshje të lidhur ose të dokumentuar me shkrim ose me anë të ndonjë mjeti tjetër të komunikimit, që e bën informacionin të arritshëm në mënyrë që të jetë i përdorshëm për referim të mëvonshëm, të ndryshme nga një marrëveshje ekskluzive për zgjedhjen e gjykatës.

Për qëllimet e këtij nën-paragrafi, “marrëveshje ekskluzive për zgjedhjen e gjykatës” do të thotë një marrëveshje e lidhur nga dy a më shumë palë, që përcakton, me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që kanë lindur ose që mund të lindin në lidhje me një marrëdhënie të veçantë juridike, gjykatat e një shteti ose një a më shumë gjykata specifike të një shteti, duke përjashtuar juridiksionin e gjykatave të tjera.

214. Ky nënparagraf ofron një filtër të bazuar në pëlqimin e shprehur. Kur palët kanë rënë dakord paraprakisht për forumin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes së tyre, gjykimi në atë forum konsiderohet i drejtë për të dyja palët dhe zakonisht e plotëson kërkesën juridiksionale për qëllimet e njohjes apo ekzekutimit në Shtetin e kërkuar. KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës parashikon njohjen apo zbatimin e marrëveshjeve të tilla dhe të vendimeve gjyqësore lidhur me marrëveshjen ekskluzive për Zgjedhjen e Gjykatës. Përkufizimi i një marrëveshjeje për Zgjedhjen e Gjykatës në nënparagrafin (m) është nxjerrë nga KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës, si për sa i takon formës së marrëveshjes ashtu edhe natyrës së saj ekskluzive apo jo ekskluzive, që duhet të sigurojë një interpretim të njëjtë në të dy instrumentet.

215. **Marrëdhënia me KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës.** Konventa kërkon të shmangë mbivendosjen me KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës. Për atë qëllim, Konventa trajton vetëm marrëveshjen jo ekskluzive për Zgjedhjen e Gjykatës në nënparagrafin (m). Kjo e lejon gjykatën në Shtetin e kërkuar të marrë parasysh se filtri përmbushet kur marrëveshja e palëve ka emëruar gjykatën e origjinës si gjykata përpara të cilës mund të paraqiten mosmarrëveshjet, por jo kur emërtimi i përjashton të gjitha gjykatat e tjera. Në rastin e fundit, *pra*, kur

marrëveshja për Zgjedhjen e Gjykatës është ekskluzive, vendimi mund të njihet dhe zbatohet sipas KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës, ose kur kjo nuk është e zbatueshme, sipas ligjit të brendshëm.¹⁵⁰

216. **Marrëveshjet jo ekskluzive.** Konventa përkufizon marrëveshjet jo ekskluzive negativisht. Ajo përfshin përkufizimin e një "marrëveshje ekskluzive për Zgjedhjen e Gjykatës" të marrë nga neni 3(a) i Konventës KHDNP të 2005 për Zgjedhjen e Gjykatës dhe thotë se Konventa zbatohet për çdo marrëveshje "përveç marrëveshjes ekskluzive për Zgjedhjen e Gjykatës". Gjithashtu, KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës, përmban prezumimin që një marrëveshje për Zgjedhjen e Gjykatës që emëron gjykatat e një Shteti, ose një apo më shumë gjykata specifike të një Shteti, gjykohet se është ekskluzive përveç se kur palët shprehimisht kanë parashikuar ndryshe (Neni 3(b)). Në parim, qasja e ndjekur nga Konventa kërkon të shmangë hendeqet midis dy instrumenteve.
217. Marrëveshjet jo ekskluzive mund të kenë forma të ndryshme. Marrëveshja mund të parashikojë një listë të gjykatave në Shtete të ndryshme midis të cilave paditësi ftohet (ose kërkohet) të zgjedhë. Ajo mund të vërë thjesht në dukje se palët bien dakord të mos e kundërshtojnë juridiksionin nëse padia paraqitet përpara një gjykate të emëruar. Nga ana tjetër marrëveshja mund të jetë "asimetrike" (ose "hibride"), që do të thotë se është ekskluzive për një palë, por jo-ekskluzive për tjetrën. Klauzolat asimetrike nuk konsiderohen ekskluzive sipas KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës, dhe si rrjedhojë futen në fushën e veprimit të Konventës.¹⁵¹ Raporti Hartley/Dogauchi përfshin shembujt e mëposhtëm konkretë të marrëveshjeve jo ekskluzive për Zgjedhjen e Gjykatës:
- “– Gjykatat e Shtetit A kanë juridiksion jo-ekskluziv për të dëgjuar një proces gjyqësor sipas kësaj kontrate.”
- “– Procesi gjyqësor sipas kësaj kontrate mund të silllet përpara një Gjykate në Shtetin A, por kjo nuk e përjashton faktin se procesi përpara një Gjykate të çdo Shteti tjetër mund të ketë juridiksion sipas ligjit të vet.”
- “– Procesi sipas kësaj kontrate mund të silllet përpara një Gjykate X në Shtetin A ose përpara gjykatës Y në Shtetin B, duke përjashtuar të gjitha gjykatat e tjera.”
- “– Procesi kundër X-it mund të silllet ekskluzivisht në vendbanimin e X-it në Shtetin A; procesi kundër Y-së mund të silllet ekskluzivisht në vendbanimin e Y-it në Shtetin B.”
218. Konventa, si KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës, e kufizon këtë filtër për marrëveshjet e lidhura apo të dokumentuara me shkrim ose me çdo mjet tjetër

¹⁵⁰ Për më shumë hollësi për marrëdhënien midis KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës, dhe Konventës, shih *infra*, para. 375-378.

¹⁵¹ Raporti Hartley/Dogauch, para. 32, 106 dhe 249.

komunikimi që e bën informacionin të mundshëm për t'u siguruar, me qëllim që të jetë i përdorshëm për referencë të mëvonshme.¹⁵² Marrëveshjet me gojë, si rrjedhojë, nuk përfitojnë nga ky nënparagraf.

219. **Shembuj.** Marrëveshja me shkrim midis X-it (me vendqëndrim të rregullt në Shtetin A) dhe Y-it (me vendqëndrim të rregullt në Shtetin B) përmban klauzolën e mëposhtme: "Për çdo mosmarrëveshje që krijohet nga kjo marrëveshje për shpërndarje, palët bien dakord për juridiksionin e gjykatës së Shtetit C." Pas një mosmarrëveshjeje që palët nuk janë në gjendje të zgjidhin në mënyrë miqësore, Y-ni ngre një padi kundër X-it përpara gjykatave të Shtetit C. Vendimi jepet në favor të Y-së dhe ekzekutimi i tij kërkohet në Shtetin A ku X-i ka pasuritë e tij. Në një rast të tillë, nënparagrafi (m) do të zbatohet vetëm nëse gjykata në Shtetin A gjen se klauzola është një marrëveshje jo-ekskluzive për Zgjedhjen e Gjykatës. Nëse jo, atëherë nënparagrafi (m) nuk zbatohet dhe vendimi nuk do t'i plotësojë kushtet për të qarkulluar sipas Konventës, përveç se kur ka ndonjë filtër tjetër të zbatueshëm sipas paragrafit 1. Nëse Shteti A dhe Shteti C janë të dy palë në KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës, një klauzolë e tillë do të prezumohet se është ekskluzive dhe vendimi do t'i plotësonte kushtet për të qarkulluar sipas atij instrumenti.
220. Marrëveshja me shkrim midis X-it (me vendqëndrim të rregullt në Shtetin A) dhe Y-së (me vendqëndrim të rregullt në Shtetin B) përmban klauzolën që vijon: "Për çdo mosmarrëveshje që lind nga kjo marrëveshje, palët vendosin që t'i ngrenë paditë ekskluzivisht në gjykatat tregtare të kryeqytetit, të Shtetit C." Pas një mosmarrëveshjeje që palët nuk janë në gjendje ta zgjidhin në mënyrë miqësore, Y-ja ngre një padi kundër X-it në Shtetin C. Vendimi jepet në favor të Y-së dhe kërkohet ekzekutimi i tij në Shtetin A ku X-i ka pasuritë. Nënparagrafi (m) nuk zbatohet për këtë rast meqë klauzola që emëron gjykatat e Shtetit C është një marrëveshje ekskluzive për Zgjedhjen e Gjykatës. Për më tepër, nëse nuk zbatohet asnjë nga shkaqet e renditura në paragrafin 1, Shteti i kërkuar nuk është i detyruar të njohë vendimin sipas nenit 4 të Konventës, ndonëse mund ta njohë atë në bazë të ligjit të tij të brendshëm, sikundër lejohet nga neni 15. Nëse Shtetet C dhe A janë të dy palë në KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës, atëherë vendimi i plotëson kushtet për të qarkulluar sipas atij instrumenti. Ky është rezultati i synuar si çështje politike, meqë të dy Konventat plotësojnë njëra tjetrën.

Paragrafi 2 – Nëse kërkohet njohja ose zbatimi ndaj një personi fizik që vepron kryesisht për qëllime personale, familjare ose shtëpiake (pra, konsumator) për çështje që lidhen me një kontratë shit-blerje, ose ndaj një punonjësi për çështje që lidhen me kontratën e tij të punës –

Nënparagrafi (a) – paragrafi 1(e) zbatohet vetëm nëse palët kanë shprehur pëlqimin e tyre, me gojë ose me shkrim, pranë gjykatës;

¹⁵² Për këtë kërkesë formale, shih, Raporti Hartley/Dogauch, para. 110-114.

Nënparagrafi (b) – pikat (f), (g) dhe (m) të paragrafit 1 nuk zbatohen.

221. **Kontrata konsumatore dhe punësimi.** Paragrafi 2 parashikon përjashtime ndaj rregullave të përgjithshme të paragrafit 1 për kontratat konsumatore dhe të punësimit.¹⁵³ Këto përjashtime zbatohen vetëm për njohjen apo zbatimin kundër një konsumatori apo punëmarrësi dhe jo për njohjen apo zbatimin e kërkuar nga një konsumator apo punëmarrës. Këto përjashtime përputhen me mbrojtjen që u sigurohet konsumatorëve apo punëmarrësve brenda sferës kontraktuese nga shumë sisteme ligjore, qoftë nga e drejta e brendshme apo nga e drejta ndërkombëtare private. Paragrafi 2 nuk krijon filtra të veçantë për këto dy lloj kontratash, të cilat mbeten subjekt i rregullave të parashikuara në paragrafin 1. Përkundrazi, paragrafi 2 kufizon apo përjashton, në favor të palës më të dobët, referencën ndaj tre nënparagrafëve në paragrafin 1 që trajtojnë filtrat e bazuara në pëlqim (nënparagrafi (e), (f) dhe (m)), dhe ndaj nënparagrafit (g), i cili trajton filtrin për detyrimet kontraktuese. Në praktikë, këto përjashtime kanë të ngjarë të kufizojnë qarkullimin e vendimeve gjyqësore kundër një konsumatori apo punëmarrësi në ato që jepen në Shtetin e vendqëndrimit të rregullt të atij personi, në mungesë të pëlqimit të shprehur për juridiksionin e një gjykate tjetër nga konsumatori apo punëmarrësi, drejtuar asaj gjykate.
222. **Përkufizimi i konsumatorit.** Konventa e përkufizon konsumatorin si “një person fizik që vepron kryesisht për qëllime personale, familjare apo shtëpiake”. Ky është i njëjti përkufizim që gjendet në KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës, e cila i përjashton kontratat me konsumatorët nga fusha e veprimit të saj në nenin 2(1)(a). Gjithashtu, ai përputhet me përkufizimin e konsumatorit që gjendet në *Konventën e Vjenës së 11 prillit 1980 për kontratat për shitjen ndërkombëtare të mallrave* (Neni 2(a)), dhe KHDNP, *Konventa e 22 dhjetorit 1986 për ligjin e zbatueshëm për kontratat për shitjet ndërkombëtare të mallrave* (Neni 2(c)). Opsioni tjetër do të kishte qenë formulimi negativ që gjendet në Rregulloren e Brukselit (Neni 17(1)) dhe Rregulloren 1 e Romës¹⁵⁴ (Neni 6(1)): “për një qëllim [...] jashtë zanatit apo profesionit të tij [...]”. Ndryshe nga Rregullorja Evropiane, kjo Konventë nuk përcakton që pala tjetër kontraktuese duhet të veprojë në cilësinë e saj tregtare apo profesionale. Kjo shtron çështjen nëse kontratat konsumatore me konsumatorët përfshihen sipas paragrafit 2. Duke qenë se sesioni njëzetë e dy nuk e diskutoi këtë çështje, ajo duhet të vendoset nga gjykatat që zbatojnë Konventën, të udhëhequra nga objektivi i Konventës për zbatim të njëjtë, siç shprehet në nenin 20.

¹⁵³ KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës përjashton nga fusha e veprimit të saj marrëveshjet për Zgjedhjen e Gjykatës në kontrata konsumatore dhe punësimi: Neni 2(1)(a) dhe (b).

¹⁵⁴ Rregullorja (KE) nr. 593/2008 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 17 qershorit 2008 lidhur me ligjin e zbatueshëm për detyrimet kontraktuese (Romë I), *Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian*, 4.7.2008, nr. L 177, f. 6-16.

223. **Kontratat e punësimit.** Kontratat e punësimit nuk janë përkufizuar sipas Konventës, por është e qartë nga fraza “kontratë punësimi” se paragrafi 2 synon të mbulojë punëtorët me pagë në çdo nivel dhe jo njerëzit që kryejnë aktivitet të pavarur profesional.¹⁵⁵
224. **Marrëveshjet kolektive me negociim.** Referenca ndaj “çështjeve që lidhen me kontratën e punësimit të një punëmarrësi” tregon se paragrafi 2 synon të përdoret për vendime gjyqësore të lidhura me kontrata individuale punësimi, *pra*, në mosmarrëveshjet midis punëmarrësit dhe punëdhënësit që krijohen nga marrëdhënia e tyre e punës. Kjo përfshin çdo padi midis punëdhënësit dhe punëmarrësit në bazë të kuadrit ligjor të zbatueshëm për atë marrëdhënie, duke përfshirë ligjin e punës apo marrëveshjet kolektive me bashkëbisedime.¹⁵⁶ Nga ana tjetër, mosmarrëveshjet që krijohen nga marrëveshjet kolektive me bashkëbisedime midis palëve në këtë marrëveshje – zakonisht një sindikatë apo organ përfaqësues i punëmarrësve, nga njëra anë, dhe një punëdhënësi apo shoqate punëdhënësish, nga ana tjetër — nuk janë të mbuluara nga ky paragraf.
225. **Përfshirja nga paragrafi 1 lidhur me pëlqimin.** Paragrafi 2(a) e kufizon efektin e paragrafit 1(e), në lidhje me pëlqimin e shprehur të dhënë gjatë zhvillimit të procesit. Kur bëhet fjalë për punëmarrësit dhe konsumatorët, pëlqimi duhet të jetë “dërguar në gjykatë, me gojë ose me shkrim”. Me fjalë të tjera, shembulli i parë dhe i dytë i dhënë më lart për paragrafin 1(e) (shih *supra*, para. 164) nuk do ta përmbushte paragrafin 2(a), por i treti do ta përmbushte, duke qenë se është e vetmja situatë kur shprehja e pëlqimit i drejtohet gjykatës dhe jo ndonjë pale tjetër. Mënyrat e tjera të shprehjes së pëlqimit të njohura në paragrafin 1 janë pëlqimi i nënkuptuar (para. 1(f)) dhe pëlqimi me marrëveshje paraprake midis palëve (para. 1(m)). Për sa u takon konsumatorëve dhe punëmarrësve, asnjëra nga format e pëlqimit nuk është trajtuar si e mjaftueshme. Me fjalë të tjera, një vendim gjyqësor kundër një konsumatori apo punëmarrësi nuk do të qarkullojë sipas Konventës, nëse lidhja me Shtetin e origjinës është bazuar vetëm në pëlqimin e çfarëdo lloji. Sigurisht, paragrafi 1(a) do të përmbushet kur punëmarrësi apo konsumatori ka vendqëndrim të rregullt në Shtetin e origjinës.¹⁵⁷
226. **Përfshirja e filtrit të bazuar në vendin e përmbushjes së detyrimeve kontraktuese.** Ashtu si më lart, paragrafi 2 e përjashton rekursin në paragrafin 1(g), që ka të bëjë me vendin e përmbushjes së detyrimeve kontraktuese. Një vendim gjyqësor nuk do të njihet apo zbatohet kundër një konsumatori apo punëmarrësi nëse e vetmja lidhje me shtetin e origjinës është vendi i përmbushjes së detyrimeve përkatëse kontraktuese.

¹⁵⁵ Raporti Nygh/Pocar, para. 117.

¹⁵⁶ Në KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës, neni 2(1)(b) përjashton marrëveshjen për Zgjedhjen e Gjykatës “në lidhje me kontratat e punësimit, duke përfshirë marrëveshjet kolektive”.

¹⁵⁷ Mund të përmbushen gjithashtu edhe filtra të tjerë sipas nenit 5(1).

Paragrafi 3 – Paragrafi 1 nuk zbatohet për vendimin gjyqësor që shprehet për kontratën e qirasë së banimit në pronë të paluajtshme (qiramarrjen) ose shprehet për regjistrimin e pronës së paluajtshme. Vendimi gjyqësor i tillë është i pranueshëm për njohjen dhe zbatimin vetëm nëse është dhënë nga gjykata e shtetit ku ndodhet prona.

227. Paragrafi 3 vendos një përjashtim nga filtrat e paragrafit 1 për qiratë rezidenciale dhe regjistrimin e pronës së patundshme. Ky filtër specifik i paragrafit 3 përjashton çdo filtër tjetër të paragrafit 1, dhe si rrjedhojë çdo filtër tjetër të paragrafit 2.
228. **Qiratë rezidenciale.** Një qira rezidenciale i referohet një kontrate për përdorimin e një mjedisi për të jetuar, për qëllime personale, familjare, apo shtëpiake në këmbim të pagimit të qirasë. Nënparagrafi (h) ndërkohë parashikon një filtër të posaçëm për një vendim gjyqësor për qiradhënien e një prone të patundshme (qiradhënia), pasi një vendim i tillë gjyqësor gjithashtu mund të qarkullojë sipas çdo filtri tjetër përkatës të paragrafit 1. Shumë Shtete i trajtojnë qiratë rezidenciale si një kategori e veçantë e qirave me qëllim për të mbrojtur qiramarrësin rezidencial – i konsideruar i cenueshëm në të njëjtën mënyrë si edhe një konsumator apo punëmarrës – ose për të lehtësuar mundësitë për të gjetur strehim përmes juridiksionit ekskluziv në vendin ku prona e patundshme ndodhet, duke siguruar që të zbatohet çdo regjim i detyrueshëm që rregullon qiradhënien rezidenciale sipas ligjit të atij Shteti.¹⁵⁸ Paragrafi 3 mbulon vendimet gjyqësore për mosmarrëveshje midis të zotit të shtëpisë dhe qiramarrësit, duke përfshirë, *për shembull*, vendimet gjyqësore për ekzistencën apo interpretimin e marrëveshjes së qiradhënies, nxjerrjes me forcë, kompensimit për dëmtimet e shkaktuara qiraxhiut, apo të rikuperimit të qirasë.
229. **Regjistrimi i pronës së patundshme.** Paragrafi 3 gjithashtu zbatohet për vendime gjyqësore për regjistrimin e pronës së patundshme. Kjo dispozitë mbulon vendime gjyqësore që vendosin për aktin e regjistrimit të pronës së patundshme dhe që rrjedhin nga një mosmarrëveshje midis dy palëve private, zakonisht nga një vendim gjyqësor që urdhëron regjistrimin e një transferimi prone të patundshme në kontekstin e një mosmarrëveshjeje midis blerësit të pronës dhe shitësit (*pra*, në veprim *in personam*). Nga ana tjetër, mosmarrëveshje të tjera kontraktuese të bazuara në kontratat për transferimin e pronës së patundshme nuk janë të mbuluara nga kjo dispozitë, *për shembull*, pagesa e çmimit ose përgjegjësia e shitësit. Nga ana tjetër, vendimet gjyqësore për regjistrimin e pronës së patundshme të bazuara në të drejtat sendore *in rem* futen në objektin e nenit 6. Dhe së fundi, vendimet gjyqësore për vlefshmërinë e regjistrimeve në regjistrat publikë janë të përjashtuara sipas nenit 2(1)(j) (për kuptimin e këtij përjashtimi, shih *supra*, para. 58).

¹⁵⁸ Në shumicën e Shteteve që ofrojnë regjime mbrojtëse për qiratë rezidenciale, këto nuk përfshijnë qiratë e përkohshme për pushime për të cilat shpesh kontratat përfshijnë shërbime të tjera përveç përdorimit për ambient strehimi dhe jetese. Këto Shtete zakonisht nuk mendojnë se gjykatat e tyre kanë juridiksion ekskluziv ndaj kontratave të tilla. Ndonëse duhet ndjekur një interpretim i njëjtë i termit “qira rezidenciale” (sipas nenit 20), natyra përjashtuese e para. 3 dhe qëllimi mbrojtës i tij duhen marrë parasysh në përcaktimin e objektit të zbatimit të tij nga gjykata e Shtetit të kërkuar.

230. Sipas paragrafit 3, një vendim gjyqësor për një qira rezidenciale të pronës së patundshme ose për regjistrimin e pronës së patundshme mund të njihet dhe zbatohet sipas Konventës, vetëm nëse ai është dhënë nga një gjykatë e Shtetit ku ndodhet prona. Asnjë filtër tjetër sipas paragrafit 1 nuk do të zbatohet. Kështu, për shembull, një vendim gjyqësor i dhënë në Shtetin A, ku i padituri ka vendqëndrim të rregullt, në lidhje me një qiradhënie rezidenciale për një pronë të patundshme që ndodhet në Shtetin B, nuk do të qarkullojë sipas Konventës.¹⁵⁹ Megjithatë, ndryshe nga neni 6, neni 5(3) nuk e pengon njohjen apo zbatimin sipas ligjit të brendshëm (Neni 15).

¹⁵⁹ Është e diskutueshme nëse fjalia e parë e nenit 5(3), e cila përjashton përdorimin e para. 1, zbatohet edhe kur prona e patundshme ndodhet në një Shtet jo kontraktues. Rregulla është formuluar në terma absolute dhe kështu, në parim, ajo mbulon çdo vendim për qiratë rezidenciale apo regjistrimin e pronës së patundshme pa ndonjë kufizim territorial. Në projekt Konventën 2018 e përgatitur nga komisioni i Posaçëm të majit 2018 (shih, *supra*, shënimi 10), neni 6(c) kishte një bazë ekskluzive për njohje apo zbatim në lidhje me qiratë e pronave të patundshme, përdorimin i të cilave kufizohej me rastet kur prona ndodhej në një Shtet kontraktues. Si pasojë e kompromisit të arritur në Sesionin njëzetë e dy, kjo dispozitë u ndryshua dhe u kalua tek neni 5(3), por kjo çështje konkrete nuk u diskutua (Shih, gjithashtu *infra* para. 231-233).

Neni 6

Baza ekskluzive për njohjen dhe zbatimin

Pavarësisht nga neni 5, vendimi gjyqësor që shprehet për të drejtat e përdorimit, *in rem* të pronës së paluajtshme njihet dhe zbatohet nëse dhe vetëm kur prona ndodhet në shtetin e origjinës.

231. Neni 6 ofron një bazë të vetme ekskluzive për njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore për të drejtat sendore *in rem* mbi pronat e patundshme. Kjo dispozitë ka efekt pozitiv dhe negativ. Vendimet gjyqësore që përmbushin filtrin në nenin 6 plotësojnë kushtet për njohje apo zbatim. Vendimet gjyqësore që nuk e përmbushin filtrin, nuk duhet as të njihen dhe as të ekzekutohen, qoftë sipas Konventës apo sipas ligjit të brendshëm. Si rrjedhojë, neni 6 zbatohet, “pavarësisht nga neni 5” dhe parashikon që vendime të tilla gjyqësore do të ekzekutohen “vetëm nëse” lidhja e parashikuar është e pranishme. Ai vendos një filtër “absolut” ekskluziv për vendime gjyqësore për të drejtat sendore *in rem* ndaj pronës së patundshme. Kështu, për shembull, nëse X-i ngre një padi kundër Y-së në Shtetin A për një të drejtë sendore *in rem* ndaj një prone të patundshme të ndodhur në Shtetin B, vendimi që do të pasojë nuk do të njihet apo zbatohet në asnjë Shtet tjetër. Kjo është arsyeja përse neni 15, i cili parashikon se Konventa nuk e pengon njohjen apo zbatimin sipas ligjit të brendshëm, shprehet se ai duhet t’i nënshtrohet nenit 6.
232. Megjithatë, neni 6, zbatohet vetëm për vendime gjyqësore ku gjykimi për të drejtat sendore *in rem* ndaj pronës së patundshme është objekti kryesor i procesit. Konventa përmban rregulla të posaçme kur një çështje e tillë ka dalë thjesht si një çështje paraprake (shih, nenet 2(2) dhe 8).
233. **Baza logjike.** Është e zakonshme dhe në të shumtën e rasteve e padiskutueshme që një Shtet ta konsiderojë veten se ka juridiksion ekskluziv për paditë që lidhen me të drejtat sendore *in rem* ndaj pronës së patundshme që ndodhet në atë Shtet. Gjykatat e Shtetit ku prona e patundshme ndodhet janë në pozitën më të mirë, për arsye afërsie, të vërtetojnë faktet dhe të zbatojnë rregullat dhe praktikrat që rregullojnë të drejtat sendore *in rem*, që përgjithësisht janë ato të Shtetit në të cilin prona ndodhet. Procese të tilla zakonisht përfshijnë edhe regjistrat publike apo dokumente të tjera publike.¹⁶⁰
234. **Fusha e veprimit: të drejtat sendore *in rem*.** Neni 6 zbatohet për vendime gjyqësore në procese që kanë pasur si objekt të drejtat sendore *in rem*, *pra*, të drejta që kanë të

¹⁶⁰

Për argumentet në favor të këtij filtri, shih, Raporti Nygh/Pocar, para. 164.

bëjnë drejtpërdrejt me një prona të patundshme dhe që janë të ekzekutueshme “kundër gjithkujt (*erga omnes*)”.¹⁶¹ Nocionit të një të drejte sendore *in rem* sipas Konventës duhet t’i jepet një kuptim autonom, duke u përqendruar në efektet e të drejtës sipas ligjit të Shtetit ku prona e patundshme ndodhet. Çdo e drejtë ndaj një prone të patundshme që ka efekt *erga omnes* sipas atij ligji duhet të konsiderohet se futet në kategorinë e të drejtave sendore *in rem*, për qëllimet e nenit 6. Në shumicën e Shteteve, kjo përfshin, për shembull, pronësinë, hipotekat, të drejtën e përdorimit të pronës së dikujt (usufruktit) apo të përdorimit të pjesshëm (servitutit); Shtete të tjera mund t’u japin efekt *erga omnes* disa të të drejtave të caktuara të pronësisë apo përdorimit, apo disa llojeve të qirave afatgjata. Vendimet gjyqësore për të drejta të tilla futen në rregullin ekskluziv të nenit 6.

235. Neni 6 mbulon vendimet gjyqësore për padi që kërkojnë të përcaktojnë ekzistencën e këtyre të drejtave, shkallën dhe përmbajtjen e tyre dhe t’u japin mbajtësve të tyre mbrojtjen e kompetencave të bashkëngjitura përfitimeve të tyre. Nga ana tjetër, paditë e bazuara në të drejta të lidhura me prona të patundshme, që nuk kanë efekt *erga omnes*, nuk mbulohen nga objekti i kësaj dispozitë. Për shembull, një padi për dorëzimin e një prone të patundshme të bazuar në një kontratë shitjeje (*pra*, ku problemi është detyrimi i të paditurit për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për të transferuar dhe dorëzuar pronën), ose një padi jashtë kontraktuese për dëmshpërblime për prona të patundshme, nuk janë të mbuluara nga kjo dispozitë. Të drejtat sendore *in rem* ndaj pronave të patundshme po ashtu nuk futen në objektin e këtij neni.
236. **Prona të patundshme.** Termi “prona të patundshme” nuk përkufizohet në Konventë, por duhet të merret se përfshin toka, përfitime apo përmirësime të tokës dhe instalime (ndryshe nga sendet e luajtshme), duke përfshirë gjëra të ngulitura, të bashkëngjitura apo të vendosura në tokë, apo të lidhura me çdo gjë të ngulitur, ngjitur, apo të vendosur në tokë. Ky udhëzues në lidhje me pronën e patundshme nuk është shterues.
237. **Zbatimi përkundrejt Shteteve jo kontraktuese.** Të kuptosh përdorimin e kësaj dispozite përkundrejt Shteteve jo kontraktuese është i dobishëm për të dalluar tre skenarë që ndryshojnë në varësi të vendndodhjes së pronës së patundshme dhe Shtetit të origjinës së vendimit.
238. *Skenari i parë: prona e patundshme ndodhet në një Shtet kontraktues, ndërsa Shteti i origjinës është gjithashtu një Shtet kontraktues.* Nuk ka dyshim se neni 6 zbatohet kur prona e patundshme ndodhet në një Shtet kontraktues. Në një rast të tillë, vendimi do të njihet dhe ekzekutohet nëse dhe vetëm nëse prona ndodhet në Shtetin e origjinës. Ndryshe, vendimi nuk do të njihet dhe as nuk do të ekzekutohet sipas Konventës ose sipas ligjit të brendshëm (shih, neni 15). Për më tepër, çdo

¹⁶¹ *Po aty.*

traktat i nënshkruar pas kësaj Konvente nuk do ta prekë këtë rezultat, nëse Shteti kontraktues ku prona ndodhet nuk është palë në këtë traktatin e fundit (shih, neni 23(3) dhe (4)).

239. *Skenari i dytë: prona e patundshme ndodhet në një Shtet jo-kontraktues por Shteti i origjinës është një Shtet kontraktues dhe një nga filtrat e parashikuar në nenin 5 përmbushet.* Ky skenar kërkon një interpretim më me nuanca.
240. Neni 6 fillon me “Pavarësisht nga neni 5 [...]”. Kështu, ai përbën një përjashtim nga rregulla që vendimet gjyqësore të dhëna në një Shtet kontraktues plotësojnë kushtet për njohje apo zbatim nëse secili prej filtrave të parashikuar nga neni 5 përmbushet. Pra, në këtë kuptim, kur bëhet fjalë për të drejtat sendore *in rem* ndaj pronës së patundshme, neni 5 nuk zbatohet. Për më tepër, neni 6 nuk i përjashton shprehimisht vendimet gjyqësore për të drejtat sendore *in rem* ndaj pronës së patundshme të ndodhur në Shtete jo kontraktuese.¹⁶² Ky lexim i nenit 6 nuk do të lejonte qarkullimin e vendimit në skenarin e përshkruar. Kjo qasje do të përputhej me ligjin e brendshëm në më shumë Shtete që nuk e pranojnë njohjen apo zbatimin e një vendimi të huaj të dhënë, për shembull, në Shtetin ku i padituri ka vendqëndrimin e rregullt, nëse ai vendim është për një të drejtë sendore *in rem* ndaj pronës së patundshme të ndodhur në një Shtet të ndryshëm. Sipas këtij interpretimi, një vendim gjyqësor i dhënë në Shtetin A, i cili është palë në Konventë, për një të drejtë sendore *in rem* ndaj një prone të patundshme të ndodhur në Shtetin B, i cili nuk është palë, nuk qarkullon sipas Konventës. Shtetet e tjera kontraktuese, si rrjedhojë, do të ishin të detyruara ta njihnin apo ekzekutonin një vendim të tillë sipas Konventës, edhe nëse një filtër i nenit 5(1) përmbushet dhe nuk ka arsye për refuzim sipas nenit 7 ose 8.
241. Gjithsesi, neni 6 nuk krijon një detyrim për Shtetet jo kontraktuese. Nuk duket e arsyeshme të thuhet se Shtetet kontraktuese e kanë kufizuar me dëshirën e tyre sovranitetin e tyre në një farë mënyre. Si rrjedhojë, nuk ka arsye të kuptohet se, në shembullin më lart, Shtetet e tjera kontraktuese pengohen të njohin apo ekzekutojnë një vendim të dhënë në Shtetin A ndaj një prone të patundshme të ndodhur në një Shtet jo-kontraktues, ose sipas ligjit të tyre të brendshëm

¹⁶² Për ta kuptuar këtë deklaram, ka rëndësi të kujtojmë shkurtimisht precedentët e kësaj dispozite. Sikurse thuhet në shënimin 159, në projekt Konventën 2018 (shih, *supra*, shënimi 10), neni 6 përmbante tre baza ekskluzive për njohje apo zbatim: (i) njëra për vendime gjyqësore për vlefshmërinë e të drejtave të regjistruara të pronësisë intelektuale; (ii) një tjetër për vendime gjyqësore për të drejtat sendore *in rem* ndaj pronave të patundshme; dhe (iii) një të tretë për qiradhënien e pronës së patundshme. Sikurse është shpjeguar në versionin korrespondues të projekt Raportit shpjegues (Dok paraprak nr. 1 i dhjetorit 2018, “Konventa për vendimet gjyqësore: Projekt Raporti shpjegues i rishikuar”, para. 271), dy bazat e para janë hartuar në terma absolute, ndërsa i treti është kufizuar për rastet kur baza ekskluzive kishte të bënte me një Shtet kontraktues. Si rrjedhim, neni 5 nuk mbulonte vendimet gjyqësore për vlefshmërinë e një të drejte të pronësisë intelektuale, pavarësisht nëse kjo e drejtë ishte regjistruar në një Shtet kontraktues apo jo kontraktues, ose për të drejtat sendore *in rem* ndaj pronave të patundshme, pavarësisht nëse prona e patundshme ndodhej në një Shtet kontraktues apo jo kontraktues (shih, *po aty*, para. 263, me një shembull). Nga ana tjetër, neni 5 mbulonte vendimet gjyqësore për qiradhënien e pronës së patundshme kur prona e patundshme ndodhet në një Shtet jo-kontraktues.

(pavarësisht nga neni 15) ose sipas një instrumenti tjetër ndërkombëtar. Ky përfundim mund të nxirret nga formulimi i nenit 23(3) dhe (4), i cili u referohet “[...] detyrimeve sipas nenit 6 *ndaj Shteteve kontraktuese* [...]” (theksi i shtuar).

242. Kështu, interpretimi i parapëlqyer duket se është që Shtetet kontraktuese nuk janë të detyruara të njohin apo ekzekutojnë një vendim gjyqësor të dhënë në një Shtet tjetër kontraktues për një pronë të patundshme të ndodhur në një Shtet jo-kontraktues. Sipas kësaj pikëpamjeje, Konventa nuk e pengon një njohje apo zbatim të tillë qoftë sipas ligjit të brendshëm apo sipas një instrumenti tjetër ndërkombëtar.
243. *Skenari i tretë: prona e patundshme ndodhet në një Shtet kontraktues dhe Shteti i origjinës është një Shtet jo-kontraktues.* Konventa nuk zbatohet për njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore të dhënë në Shtete jo kontraktuese dhe, si rrjedhojë, nuk e trajton këtë skenar. Kjo çështje do të rregullohet nga ligji i brendshëm dhe, siç u tha më lart, shumica e ligjeve të brendshme nuk do ta lejonin gjithsesi njohjen e këtyre rasteve. Por, nëse ligji i brendshëm nuk e bën këtë, mund të mos jetë e arsyeshme që një Shtet kontraktues të njohë dhe ekzekutojë një vendim të tillë gjyqësor, duke pasur parasysh politikën dhe objektivat e Konventës.

Neni 7***Refuzimi i njohjes dhe zbatimit***

1. Njohja ose zbatimi mund të refuzohet nëse –
 - (a) dokumenti me të cilin u fillua procedura, ose një dokument ekuivalent, përfshirë kërkesë-padinë që jep elementet thelbësore të padisë –
 - (i) nuk i është bërë e ditur të paditurit përmes njoftimit në kohë të mjaftueshme dhe në mënyrën që do t’ia mundësonte palës së paditur që të merrte masa për mbrojtje, përveç nëse i padituri është paraqitur në gjykatë dhe ka dhënë argumentet e veta pa kontestuar njoftimin në gjykatën e origjinës, me kushtin që ligji i shtetit të origjinës ka lejuar që njoftimi të kundërshtohet; ose
 - (ii) i është bërë e ditur të paditurit përmes njoftimit në Shtetin e kërkuar në formën që nuk përputhet me parimet themelore të Shtetit të kërkuar sa i takon dorëzimit të dokumenteve;
 - (b) vendimi gjyqësor u mor me mashtrim;
 - (c) njohja ose zbatimi është dukshëm në mospërputhje me politikën publike të Shtetit të kërkuar, përfshirë situatat kur procedurat specifike që çuan te vendimi gjyqësor, ishin në mospërputhje me parimet themelore të korrektësisë procedurale të atij shteti, si dhe me situata që kanë të bëjnë me cenimet e sigurisë ose sovranitetit të tij;
 - (d) procedurat në gjykatën e origjinës ishin në kundërshtim me marrëveshjen, ose përcaktimin e bërë në instrumentin e trustit, sipas të cilit vendimi për mosmarrëveshjen në fjalë do të merrej nga një gjykatë të një shteti të ndryshëm nga shteti i origjinës;
 - (e) vendimi gjyqësor është në mospërputhje me vendimin gjyqësor të dhënë nga gjykata e Shtetit të kërkuar në mosmarrëveshjen mes të njëjtave palë; ose
 - (f) vendimi gjyqësor është në mospërputhje me vendimin gjyqësor të mëparshëm të dhënë nga gjykata e një shteti tjetër mes të njëjtave palë, për të njëjtën çështje lëndore, me kushtin që vendimi gjyqësor i mëparshëm plotëson kushtet e nevojshme për njohjen e tij në Shtetin e kërkuar.
2. Njohja ose zbatimi mund të shtyhet ose të refuzohet nëse procedurat mes të njëjtave palë, për të njëjtën çështje lëndore, janë në pritje për shqyrtim para një gjykate të Shtetit të kërkuar, kur:

- (a) gjykata e Shtetit të kërkuar e kishte marrë juridiksionin para gjykatës së origjinës; dhe
- (b) ekziston një lidhje e ngushtë mes mosmarrëveshjes dhe Shtetit të kërkuar.

Refuzimi sipas këtij paragrafi nuk parandalon paraqitjen e mëvonshme të kërkesës për njohjen ose zbatimin e vendimit gjyqësor.

244. Konventa parashikon kuadrin për njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore. Për atë qëllim, neni 4 përcakton detyrimin e përgjithshëm lidhur me njohjen apo zbatimin e vendimeve gjyqësore, me kërkesa për filtra të parashikuara në nenet 5 dhe 6, dhe mbrojtjet specifike në nenin 7. Këto mbrojtje grupohen në dy kategori. E para, e paragrafit 1, rendit shkaqet që *lejojnë*, por që nuk kërkojnë, që Shteti i kërkuar të refuzojë njohjen apo zbatimin e bazuar në mënyrën se si janë zhvilluar procedurat gjyqësore në Shtetin e origjinës, ose në natyrën apo përmbajtjen e vetë vendimit. Sikurse konfirmohet në nenin 4(1), kjo është një listë shteruese, e cila i kufizon shkaqet që mund të përdorë një debitor objekt i një vendimi gjyqësor, për të shmangur njohjen apo zbatimin e vendimit në Shtetin e kërkuar dhe atë që një gjykatë në Shtetin e kërkuar mund të bëjë. Kategoria e dytë trajton situatën e veçantë të *lis pendens* ndërkombëtar dhe mbulohet nga paragrafi 2.

Paragrafi 1 – Njohja ose zbatimi mund të refuzohet nëse –

245. Ky paragraf përfshin shtatë shkaqe të cilat mund të shpien në refuzimin e njohjes apo ekzekutimit të një vendimi gjyqësor në Shtetin e kërkuar. Në një masë të madhe ato përsërisin dispozitën e barasvlershme të KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës.¹⁶³ Shkaqet në nënparagrafët (a), (b) dhe (d) lidhen me mënyrën në të cilën procesi ka filluar dhe është zhvilluar në Shtetin e origjinës. Shkaqet në nënparagrafët (c) dhe (e) kanë të bëjnë me efektin që njohja apo ekzekutimi do të kishte në Shtetin e kërkuar. Së fundi, nënparagrafi (f) merr në konsideratë vendime gjyqësore të mëparshme të dhëna në një Shtet të tretë.
246. Neni 7 përcakton se Shtetet “*mund*” të refuzojnë njohjen apo zbatimin nëse plotësohen një apo më shumë shkaqe. Kjo dispozitë u drejtohet Shteteve. Shtetet mund (i) të miratojnë ligje të brendshme që nuk parashikojnë refuzimin në disa nga këto rrethana ose parashikojnë refuzimin në të gjitha këto rrethana, (ii) kërkojnë njohjen

¹⁶³ Neni 9 i Konventës KHDNP të 2005 për Zgjedhjen e Gjykatës.

apo zbatimin në disa nga këto rrethana, (iii) përcaktojnë kriteret shtesë që kanë rëndësi për ushtrimin e lirisë për të vendosur, ose (iv) e lënë gjithçka në lirinë e gjykata për të vendosur.

Nënparagrafi (a) – dokumenti me të cilin u fillua procedura, ose një dokument ekuivalent, përfshirë kërkesë-padinë që jep elementet thelbësore të padisë –

- (i) *nuk i është bërë e ditur të paditurit përmes njoftimit në kohë të mjaftueshme dhe në mënyrën që do t'ia mundësonte palës së paditur që të merrte masa për mbrojtje, përveç nëse i padituri është paraqitur në gjykatë dhe ka dhënë argumentet e veta pa kontestuar njoftimin në gjykatën e origjinës, me kushtin që ligji i shtetit të origjinës ka lejuar që njoftimi të kundërshtohet; ose*
- (ii) *i është bërë e ditur të paditurit përmes njoftimit në Shtetin e kërkuar në formën që nuk përputhet me parimet themelore të Shtetit të kërkuar sa i takon dorëzimit të dokumenteve;*

247. Mbrojtja e parë ndaj njohjes apo ekzekutimit i referohet mënyrës në të cilën i padituri është njoftuar për padinë e bërë në Shtetin e origjinës. Në thelb, ajo parashikon se mungesa e njoftimit të duhur të një të padituri do të justifikojë mosnjohjen ose mosekzekutimin.

248. **Dokumenti që fillon procedurat gjyqësore.** Dokumenti që duhet t'i dorëzohet të paditurit është dokumenti i cili ka filluar procedurat gjyqësore ose një dokument i barasvlershëm, duke përfshirë një deklaratë rreth elementëve thelbësorë të padisë. Kjo dispozitë synon të sigurojë që i padituri të njoftohet për elementët e padisë dhe të ketë mundësinë të marrë masa për mbrojtjen e tij. Kështu, koncepti i dokumentit me të cilin fillojnë procedurat gjyqësore përfshin çdo dokument që, sipas ligjit të Shtetit të origjinës, e fillon procesin në mënyrë të tillë që t'i japë mundësi paditësit të marrë një vendim gjyqësor i cili të mund të qarkullojë sipas Konventës.¹⁶⁴ Për më tepër, dokumenti duhet të përmbajë “elementët kryesorë të padisë” për t'i dhënë mundësi të paditurit të marrë një vendim të arsyeshëm për veprimet e tij procedurale.

249. Nënparagrafi (a) përcakton dy rrethana në të cilat procesi i njoftimit mund të justifikojë refuzimin për të njohur apo ekzekutuar një vendim gjyqësor. I pari ka të bëjë me interesat e një të padituri, ndërsa i dyti ka të bëjë me interesat e Shtetit të kërkuar kur njoftimi është bërë në atë Shtet.¹⁶⁵

250. **Mbrojtja e të paditurit.** Shkaku për refuzimin e njohjes apo ekzekutimit sipas nënparagrafit (a)(i) është kur i padituri nuk është vënë në dijeni në kohë për padinë e ngritur ndaj tij në Shtetin e origjinës. Ky shkak garanton parimin me bazë të drejtësinë procedurale: e drejta për t'u dëgjuar.¹⁶⁶ Testi për njoftimin e duhur më

¹⁶⁴ Ajo njeh shumëllojshmërinë e mjeteve me të cilat e drejta procedurale vendos se si nis bërja e një padie.

¹⁶⁵ Raporti Hartley/Dogauch, para. 185.

¹⁶⁶ Si e tillë, ajo mbivendoset me nënparagrafin (c), i cili u referohet konkretisht parimeve themelore të së drejtës procedurale. Pra, nënparagrafi (a) mund të kuptohet si një zbatim specifik i nënparagrafit

shumë se teknik, është faktik.¹⁶⁷ Nëse një i paditur mund të mbështetet në nënparagrafin (a)(i), kjo varet nga fakti i sjelljes së të paditurit në Shtetin e origjinës. Nëse i padituri nuk është paraqitur në gjykatën e origjinës dhe vendimi është dhënë në mungesë, mbrojtja e bazuar në një njoftim jo të duhur mund të përdoret për refuzimin e njohjes apo ekzekutimit. Nëse i padituri “është paraqitur dhe e ka bërë të njohur lëndën e tij” në gjykatën e origjinës pa e kontestuar njoftimin, mbrojtja e bazuar në një njoftim jo të duhur nuk do të jetë e disponueshme në Shtetin e kërkuar.¹⁶⁸ Ky kusht siguron që njoftimi të kontestohet në rastin më të parë dhe përpara gjykatës që është më në gjendje për të trajtuar çdo mangësi në njoftim, si për shembull, duke miratuar shtyrjen e procesit. Kur ligji në Shtetin e origjinës nuk lejon kundërshtime për njoftimin, kushti nuk zbatohet.

251. **Njoftimi.** Nënparagrafi (a)(i) nuk i përcakton mjetet e njoftimit. Në veçanti, ai nuk kërkon njoftimin personal të të paditurit dhe metodat e tjera të njoftimit mund të jenë të mjaftueshme, siç është, njoftimi i personave të tjerë të ndryshëm nga i padituri, *për shembull*, një punëmarrës i tij, apo një i afërm me të cilin i padituri jeton, ose edhe me anë të një njoftimi publik. Konventa kërkon që njoftimi të jetë i mjaftueshëm për t'i dhënë mundësi të paditurit të marrë masa për mbrojtjen e tij. Për sa i takon përshtatshmërisë së njoftimit publik, disa gjykata kanë ardhur në përfundim se e drejta për t'u dëgjuar nuk është shkelur nëse gjykata e kërkuar është bindur se të gjitha hetimet e kërkuara nga parimet e kujdesit të duhur dhe mirëbesimit janë ndërmarrë për të gjetur të paditurin, ndonëse, pa sukses.¹⁶⁹
252. **Mbrojtja e Shtetit të kërkuar.** Sipas nënparagrafit (a)(ii), çështja është nëse i padituri është njoftuar në një mënyrë të papajtueshme me parimet themelore të Shtetit të kërkuar lidhur me dorëzimin e dokumenteve. Ky nënparagraf zbatohet vetëm kur njoftimi i një të padituri ka ndodhur në Shtetin e kërkuar. Kështu ai ka një zbatim shumë të kufizuar dhe nuk e lejon Shtetin e kërkuar të vlerësojë bërjen e njoftimit në një Shtet tjetër sipas ligjit të Shtetit të kërkuar, ose edhe sipas ligjit të Shtetit ku është bërë njoftimi.¹⁷⁰ Madje ai nuk e lejon Shtetin e kërkuar as të vlerësojë

(c) në lidhje me njoftimin, me kushtet e tij që, pa diskutim, duhet të përjashtojnë rekursin në nënparagrafin (c) për çështje që janë në objektin e nënparagrafit (a).

¹⁶⁷ Raporti Hartley/Dogauch, para. 186, sidomos, shënimi 225.

¹⁶⁸ Kjo të kujton filtrin në nenin 5(1)(f). Shprehjet e ndryshme të përdorura (“argumentoi për themelin e çështjes” dhe “u paraqit në gjykatë dhe bëri të njohur lëndën e vet”) tregojnë se veprimet e mundshme që mund të ndërmarrë një i paditur sipas nenit 7(1)(a)(i) janë konceptuar në një plan më të gjerë. Paraqitja, e shoqëruar me kundërshtimin e juridiksionit, për shembull, do të mjaftonin për të përjashtuar një kundërshtim të bazuar në njoftimin e pamjaftueshëm në fazën e njohjes apo ekzekutimit të vendimit, sipas Konventës, edhe pse i padituri nuk konsiderohet se ka argumentuar për themelin e çështjes.

¹⁶⁹ GJED, Vendimi i 15 marsit 2012, *G kundër Cornelius de Visser*, C-292/10, EU:C:2012:142.

¹⁷⁰ Nënparagrafi (a) është marrë vetëm me faktin nëse gjykata e kërkuar mund apo jo të refuzojë të njohë apo ekzekutojë një vendim. Gjykata e origjinës do të zbatojë të drejtën e saj procedurale, duke përfshirë konventat ndërkombëtare për dorëzimin e dokumenteve që janë në fuqi në Shtetin në fjalë dhe të zbatueshme për faktet e lëndës. Këto rregulla, që mund të kërkojnë që dorëzimi i dokumenteve të bëhet në përputhje me ligjet e Shtetit në të cilin ky veprim ndodh, nuk preken nga nënparagrafi (a). Gjithsesi, përveç shkallës së kufizuar të ofruar në nënparagrafin (a)(ii), gjykata e kërkuar mund të mos

Njoftimin në Shtetin e kërkuar sipas thjesht ligjit të përgjithshëm të atij Shteti, *pra*, the *lex fori*; nën-paragrafi (a)(ii) e kufizon referimin ndaj “parimeve themelore [...] lidhur me shërbimin e dorëzimit të dokumenteve” në Shtetin e kërkuar.¹⁷¹

253. **Baza logjike.** Shumë Shtete nuk e kundërshtojnë shërbimin e dorëzimit të një dokumenti të huaj me anë të së cilit nis një proces gjyqësor në territorin e tyre pa përfshirjen e autoriteteve të tyre, dhe e njohin një shërbim të tillë si të efektshëm.¹⁷² Ka shtete të tjera që e konsiderojnë shërbimin e dorëzimit të dokumenteve me të cilat fillon një proces gjyqësor si një akt sovran dhe shërbimin e pa autorizuar të dorëzimit të dokumenteve të huaja si shkelje të sovranitetit të tyre dhe një shërbim jo të efektshëm, pa u dhënë leja me një marrëveshjeje ndërkombëtare.¹⁷³ Nënparagrafi (a)(ii) e merr parasysh këtë pikëpamjen e fundit dhe parashikon se gjykata e kërkuar mund të refuzojë njohjen apo zbatimin nëse i padituri është njoftuar në Shtetin e kërkuar në një mënyrë të papajtueshme me parimet themelore të atij Shteti në lidhje me shërbimin e dorëzimit të dokumenteve.
254. Konventa nuk i përcakton “parimet themelore lidhur me shërbimin e dorëzimit të dokumenteve”. Referenca në nënparagrafin (a)(ii) ndaj parimeve të *Shtetit të kërkuar*, sugjeron se nuk kërkohet kuptim i njëjtë apo autonom (gjithsesi, interpretimi duhet gjithnjë të marrë parasysh thirrjen për interpretim të njëjtë në nenin 20). KHDNP 1965, Konventa për Shërbimin e /dorëzimit/, në fuqi në 78 Shtete kontraktuese në kohën e shkrimit të këtij Raporti, parashikon se njoftimi sipas atij instrumenti mund të refuzohet nëse respektimi i tij do të shkelte sovranitetin apo sigurinë e Shtetit të kërkuar.¹⁷⁴ Ndonëse të dy instrumentet zbatohen në kontekste të ndryshëm, mbrojtja që rezulton nga shkaqet e tyre përkatëse për refuzim është e ngjashme, *pra*, mbrojtja e parimeve themelore të Shtetit të kërkuar në lidhje me njoftimin e procesit të huaj në atë Shtet.

refuzojë të njohë apo ekzekutojë vendimin thjesht për shkak se shërbimi i dokumenteve nuk përputhet me ligjin e Shtetit në të cilin ka ndodhur, me ligjin e Shtetit të origjinës, ose me konventat ndërkombëtare për shërbimin e dorëzimit të dokumenteve. Raporti Hartley/Dogauch, shënimi 224.

¹⁷¹ Kjo dispozitë gjithashtu mbivendoset me nën-paragrafit (c), i cili u referohet konkretisht parimeve themelore të drejtësisë procedurale (shih, *supra*, shënimi 166).

¹⁷² Raporti Hartley/Dogauch, para. 187.

¹⁷³ KHDNP, *Konventa e 15 nëntorit 1965, për shërbimin jashtë vendit të dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në lëndë civile apo tregtare* (më poshtë, “KHDNP 1965, Konventa për Shërbimin/e Dokumenteve”) është shembulli më i rëndësishëm. Shih, gjithashtu Rregullorja (KE) nr. 1393/2007 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 13 nëntorit 2007 për shërbimin Shtetet anëtare të dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në lëndë civile apo tregtare (shërbimi i dokumenteve).

¹⁷⁴ Neni 13(1). Ai presupozon se kërkesa për njoftim ndryshe përputhet me kërkesat e tjera të Konventës. Për një diskutim të jurisprudencës shumë të pakët për këtë dispozitë, shih, Byroja e Përhershme e KHDNP-së, *Udhëzues praktik për funksionimin e Konventës së Shërbimit*, ed.4, Hagë 2016, para. 220-224. Kufizimi i bazuar në “sovranitet apo siguri” gjithashtu është përfshirë në KHDNP, *Konventa e 18 marsit 1970 për marrjen e dëshmimeve jashtë vendit për lëndë civile dhe tregtare* (Neni 12(1)(b)). Shih, Byroja e Përhershme e KHDNP-së, *Udhëzues praktik për funksionimin e Konventës së Shërbimit*, e. 3, Hagë 2016, para. 310.

Nënparagrafi (b) – vendimi gjyqësor u mor me mashtrim;

255. Nënparagrafi (b) parashikon se mashtrimi në marrjen e vendimit është një shkak për refuzimin e njohjes apo ekzekutimit. Mashtrimi i referohet një sjelljeje që qëllimisht kërkon të mashtrrojë me qëllim për të siguruar një përfitim të padrejtë ose të paligjshëm, ose për ta privuar dikë tjetër nga një e drejtë. Ndërsa disa Shtete e përfshijnë mbrojtjen e bazuar në mashtrim në mbrojtjen e politikës publike, të tjerë e trajtojnë mashtrimin si një mbrojtje më vete për njohje apo zbatim.¹⁷⁵
256. Dispozita e barasvlershme në KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës e përcakton se ajo zbatohet për mashtrimin “në lidhje me një çështje procedurale”.¹⁷⁶ Raporti Hartley/Dogauchi deklaron se specifika tjetër e KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës, është se “mund të ketë disa sisteme ligjore në të cilët siguria publike nuk mund të përdoret në lidhje me mashtrimin procedural”.¹⁷⁷ Ai raport parashikon shembujt e mëposhtëm për përdorimin e mbrojtjes: kur një palë qëllimisht “e dorëzon një fletëthirrje [...] në adresën e gabuar”, “jep informacion të gabuar lidhur me kohën dhe vendin e seancës dëgjimore”, “kërkon të korruptojë një gjyqtar apo dëshmitar”, ose “fsheh prova kyçe”.¹⁷⁸ Këta shembuj lidhen me parimet themelore të drejtësisë procedurale, duke përfshirë të drejtën për t’u dëgjuar nga një gjykatë e paanshme dhe e pavarur.¹⁷⁹ Ato kanë të bëjnë me mashtrime të kryera nga njëra palë në proces në dëm të palës tjetër.
257. Ndryshe nga KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës, kjo Konventë nuk përfshin kufizimin që mashtrimi të jetë “i lidhur me një çështje procedure”. Kjo presupozon që mashtrimi material mund gjithashtu të justifikojë refuzimin për ekzekutim të një vendimi. Ndërsa nënparagrafi (b) nuk është hartuar aq ngushtësisht sa dispozita përkatëse në KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës, Raporti Hartley/Dogauchi tregon se “mashtrimi lidhur me aspektin material mund të futet në përjashtimin për sa i takon politikës publike”.¹⁸⁰ Si rrjedhojë, ndryshimi midis këtyre dy Konventave nuk ka gjasa të ketë ndonjë ndikim në praktikë.

¹⁷⁵ Këto janë kryesisht Shtetet e traditës së të drejtës anglo-saksone. Për një diskutim për mbrojtjen nga mashtrimi në bisedimet për Projekt Konventën paraprake të 1999, shih, C. Kessedjian, “Sinteza e punës së Komisionit të Posaçëm e marsit 1998 për juridiksionin ndërkombëtar dhe efektet e vendimeve të huaja gjyqësore në lëndë civile dhe tregtare”, Dok. Paraprak nr. 9 i korrikut 1998, në *Punimet e sesionit të njëzetë (2005)*, Vëllimi II, *Vendime gjyqësore*, Cambridge – Antwerp – Portland, Intersentia 2013, f. 109-143, para. 40-45.

¹⁷⁶ Neni 9(d) i KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës.

¹⁷⁷ Raporti Hartley/Dogauchi, shënimi 228.

¹⁷⁸ *Po aty*, para. 188.

¹⁷⁹ Shih, për shembull, Konventa ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara e 1966 për të drejtat civile dhe politike (Neni 14) dhe Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut (Neni 6(1)).

¹⁸⁰ Raporti Hartley/Dogauchi, shënimi 228.

Nënparagrafi (c) – njohja ose zbatimimi është dukshëm në mospërputhje me politikën publike të Shtetit të kërkuar, përfshirë situatat kur procedurat specifike që çuan te vendimi gjyqësor, ishin në mospërputhje me parimet themelore të korrektësisë procedurale të atij shteti, si dhe me situata që kanë të bëjnë me cenimet e sigurisë ose sovranitetit të tij;

258. Mbrojtja e politikës publike lidhur me njohjen apo zbatimin e vendimeve të huaja gjyqësore është pranuar gjerësisht në sistemet ligjore. Ndërkombëtarisht, ajo është përfshirë në konventat përkatëse të KHDNP-së për dekada¹⁸¹ dhe gjendet në Konventën e Nju Jorkut të vitit 1958. Teksti i Konventës ndjek më së shumti formulimin e përdorur në KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës.¹⁸²
259. **Qartazi e papajtueshme me politikën publike.** Mbrojtja e politikës publike është një mbrojtje e fundit ndaj njohjes apo ekzekutimit të një vendimi të huaj që konsiderohet se është “qartazi e papajtueshme me politikën publike të Shtetit të kërkuar”. Është pranuar gjerësisht se koncepti i politikës publike duhet të “interpretohet në mënyrë të ngurtë” dhe përdorimi i tij si mjet “duhet të bëhet vetëm në raste të veçanta.”¹⁸³ Njohja apo ekzekutimi i vendimit në fjalë “do të duhet të përbënte një shkelje të qartë të sundimit të ligjit, e konsideruar thelbësore në rendin juridik të Shtetit në të cilin kërkohet ekzekutimi i një të drejte të njohur si themelore në atë rend juridik”.¹⁸⁴
260. “Qartazi” është një prag ilartë, synimi i të cilit është të sigurojë që vendimet gjyqësore të Shteteve të njihen dhe ekzekutohen në Shtetet e tjera, përveç rasteve kur mund të ketë pasur një arsye të fortë të sigurisë publike për të mos e bërë këtë në një rast të caktuar. Fjala “qartazi” është përdorur edhe në raste të mëparshme për të dekurajuar përdorimin e tepërt të përjashtimit për shkak të politikës publike dhe

¹⁸¹ Shih, për shembull, Konventa e 15 prillit 1958 lidhur me njohjen apo zbatimin e vendimeve që kanë të bëjnë me detyrimet e mbajtjes së fëmijëve, në nenin 2; Konventa e 5 tetorit 1961 që ka të bëjë me kompetencat e autoriteteve dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me mbrojtjen e foshnjave, në nenin 16; Konventa e 1 qershorit 1970 për njohjen e divorceve dhe të ndarjeve ligjore, në nenin 10; Konventa e 14 marsit 1978 për krenimin dhe njohjen e vlefshmërisë së martesave, në nenet 5 dhe 14; KHDNP 1985, Konventa e Trusteve, në nenin 18; Konventa e 29 majit 1993 për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimi në lidhje me miratimin ndërvendor të saj, në nenin 24; KHDNP 1996, Konventa për mbrojtjen e fëmijëve, në nenet 22 dhe 23; KHDNP 2000, Konventa për mbrojtjen e të rriturve, në nenet 21 dhe 22; KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës, në nenet 6 dhe 9; dhe KHDNP 2007, Konventa për mbështetjen e fëmijëve, në nenin 22. Vihet re se, disa prej këtyre Konventave i referohen përjashtimit për shkak të politikës publike në kontekstin e përcaktimit të ligjit të zbatueshëm në një mosmarrëveshje.

¹⁸² Neni 9(e) i Konventës KHDNP 2005 për Zgjedhjen e Gjykatës. Shih, gjithashtu Raporti Hartley/Dogauch, para. 189-190.

¹⁸³ Shih, “Shënim për nenin 7(1)(c) të projekt Konventës paraprake të 2016”, hartuar nga bashkëraportuesit e projekt Konventës dhe Byroja e Përhershme, Dok. paraprak nr. 5 i dhjetorit 2016 në vëmendje të Komisionit të Posaçëm, i shkurtit 2017, për njohjen apo zbatimin e vendimeve të huaja gjyqësore (më poshtë, “Dok. paraprak nr. 5 i dhjetorit 2016”), para. 28.

¹⁸⁴ Shih, Raportin shpjegues të Profesor Fausto Pocar-it mbi Konventën për juridiksion dhe njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore në lëndë civile dhe tregtare, (më poshtë, “Raporti Pocar për Konventën e Luganos të 2007”), Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, 23.12.2009, Nr. C 319/01.

për të kufizuar përdorimin e saj në situata kur njohja apo ekzekutimi do të shpinte në një “rezultat të patolerueshëm”.¹⁸⁵

261. **Parimet e drejtësisë procedurale.** Formulimi i mbrojtjes në nënparagrafin (c) është më specifik se sa ai që gjendet në instrumentet e mëparshme të KHDNP-së, me përjashtim të KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës. Sipas nënparagrafit (c), politika publike përfshin shprehimisht “situatat ku proceset specifike që kanë çuar në një vendim janë të papajtueshme me parimet themelore të drejtësisë procedurale” të Shtetit të kërkuar. Raporti Hartley/Dogauchi¹⁸⁶ shpjegon se në disa Shtete, parimet themelore të drejtësisë procedurale (gjithashtu e njohur si procesi i rregullt ligjor, drejtësia e natyrshme apo e drejta e gjykimit të drejtë) janë të detyruara për t’u zbatuar me kushtetutë.¹⁸⁷ Në Shtete të tilla, mund të quhet antikushtetuese që të njihet një vendim i huaj i marrë në një proces ku ka ndodhur një shkelje themelore e këtyre parimeve. Referenca në nënparagrafin (c) mbivendoset me mbrojtjet procedurale dhe parimet themelore që kanë të bëjnë me njoftimin në nënparagrafin (a), dhe me shqetësimet lidhur me drejtësinë procedurale përpara një mashtrimi të parashikuar në nënparagrafin (b). Kjo mbivendosje duhet të sigurojë që të ofrohet mbrojtje e mjaftueshme procedurale për palët që përballen me procesin e njohjes apo ekzekutimit, pavarësisht nga mënyra e veçantë në të cilin këto çështje trajtohen në Shtetin e kërkuar.¹⁸⁸
262. **Përmbajtja e politikës publike.** Përmbajtja e mbrojtjes së politikës publike është jashtëzakonisht e vështirë për t’u përkufizuar. Fusha e veprimit i saj në Konventë, gjithsesi, duhet të kuptohet në lidhje me dispozitat e tjera në tekst. Sikundër u përmend më lart, mbrojtje të tjera sipas paragrafit 1 mbivendosen me mbrojtjen e politikës publike, e cila duhet të interpretohet përkatësisht, duke e tejkaluar specifikën e mbrojtjeve të caktuara vetëm kur, duke vepruar ndryshe, do të ishte një kundërthënie “e qartë” ndaj politikave thelbësore të Shtetit të kërkuar.
263. Karakteri përjashtues i mbrojtjes së politikës publike do të thotë se nuk mjafton që pala që kundërshton njohjen apo zbatimin të vërë në dukje një rregull të detyrueshëm të ligjit të Shtetit të kërkuar, të cilën ai vendim i huaj nuk e mbështet. Në fakt, ky rregull i detyrueshëm mund të konsiderohet urdhërues për lëndët e brendshme, por jo për situatat ndërkombëtare. Mbrojtja e politikës publike në nënparagrafin (c) duhet të vihet në lëvizje vetëm kur një rregull e tillë e detyrueshme pasqyron një vlerë themelore, shkelja e të cilës do të ishte e qartë

¹⁸⁵ Shih, Dok. paraprak nr. 5 i dhjetorit 2016, para. 29.

¹⁸⁶ Raporti Hartley/Dogauch, para. 190.

¹⁸⁷ Për disa shtete në Evropë, shih, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, shih Amendamentin e pesë dhe të katërbëdhjetë të Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara. Shumë Shtete të tjera kanë dispozita të ngjashme.

¹⁸⁸ Shih, për shembull, Raporti Hartley/Dogauch, para. 153, për përjashtimin procedural nga mbrojtja e politikës publike në disa Shtete.

nëse do të lejohej zbatimi i vendimit të huaj. Në disa juridiksione, kjo përmendet si një “politikë publike ndërkombëtare” në dallim nga “politika publike e brendshme”.¹⁸⁹

264. Nënparagrafi (c) nuk përcakton se ajo i referohet politikës publike të *Shtetit të kërkuar*, duke treguar se nuk ka ndonjë pritshmëri për sa i takon uniformitetin të përmbajtjes së politikës publike në secilin Shtet. Ndonëse qëllimi i përgjithshëm i Konventës për lehtësimin e qarkullimit të vendimeve gjyqësore duhet të kufizojë përdorimin e kësaj mbrojtjeje, sikundër duhet të bëjë edhe fusha e veprimit i ngushtë i zbatimit të saj, i përshkruar në paragrafët e mëparshëm, është në dorën e çdo Shteti që të përkufizojë mbrojtjen e politikës publike. Dispozita u referohet shkëlqeve të sovranitetit apo sigurisë së Shtetit si situata ku njohja apo ekzekutimi mund të jenë qartazi të papajtueshme me politikën publike. Pavarësisht nga kjo shtesë, fusha e veprimit i kësaj dispozite nuk është i ndryshëm nga ai i dispozitës së barasvlershme në KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës. Shtesa thjesht mund të pasqyrojë një potencial më të madh lidhur me çështjet që përfshijnë shkëlqet e sigurisë apo sovranitetit që dalin në kontekstin e kësaj Konvente, krahasuar me KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës.
265. **Dëmshpërblimet.** Konventa përfshin vendimet për dëmshpërblime në fushën e veprimit saj, por i lejon një Shteti të kërkuar të refuzojë ekzekutimin e një vendim gjyqësor në masën që kjo gjë përfshin një vendim për dëmshpërblime ndëshkuese apo shembullore (Neni 10). Në disa Shtete, ku dëmshpërblimet ndëshkuese apo shembullore zakonisht nuk lejohen, refuzimi për ekzekutimin e vendimeve të tilla është vlerësuar sipas mbrojtjes së politikës publike. Gjithsesi, për shkak se neni 10 trajton dëmshpërblimet ndëshkuese apo shembullore, mbrojtja e politikës publike në nën-paragrafin (c) nuk duhet të përdoret për të trajtuar kundërshtimet ndaj njohjes apo ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në bazë të saj.¹⁹⁰ Kjo e ngushton edhe më tej fushën e veprimit të mbrojtjes së politikës publike sipas Konventës.
266. Megjithëse mundësia e përdorimit të mbrojtjes së politikës publike është pranuar gjerësisht, rrallë është e suksesshme si mjet për të mohuar njohjen apo zbatimin e një vendimi të huaj, veçanërisht në lëndë civile apo tregtare.¹⁹¹ Shembuj ku ky mjet ka

¹⁸⁹ Një propozim për të përfshirë termin “politika publike ndërkombëtare” në tekstin e nenit 7(1)(c) u diskutua gjatë bisedimeve për Konventën. Shih, Dok. pune nr. 136 i shkurtit 2017, “Propozimi i delegacionit të Uruguait” dhe diskutimet e lidhura me të në Procesverbalet e Komisionit të Posaçëm për njohjen apo zbatimin e vendimeve të huaja gjyqësore (16-24 shkurt 2017), Procesverbali nr. 7, para. 91-105. Gjatë diskutimeve, ndonëse propozimi mori një farë mbështetjeje, disa delegacione vunë në dukje se nuk ishin të njohur me termin “politika publike ndërkombëtare” dhe shprehën shqetësim lidhur me përfshirjen e tij në tekstin e Konventës.

¹⁹⁰ Mundësia për ndarjen e komponentit të dëmshpërblimit ndëshkues nga komponenti kompensues, dhe të ekzekutohet vetëm kjo e fundit, mbështetet edhe më tej nga neni 9 e Konventës.

¹⁹¹ Në një vendim të 1998 të Gjykatës së Apelit të Anglisë dhe Uellsit, vetëm tre refuzime për ekzekutime për shkaqe të politikës publike shkaqet u vunë re, dy prej të cilëve ishin për çështje të lidhura me të drejtën e familjes, të përjashtuara sipas Konventës (shih *Soleimore kundër Soleimany*, [1998] EWCA Civ 285). Në edicionin më të fundit të *Jurisclasseur de droit ndërkombëtar*, pothuaj të gjithë shembujt e refuzimit nga gjykatat franceze rrjedhin nga çështje të së drejtës së familjes (divorci, birëria dhe

pasur sukses përfshijnë: kur një gjykatë e huaj ka ekzekutuar një kontratë për kryerjen e një akti të paligjshëm (kontrabandë),¹⁹² kur vendimi i huaj ka ndërhyrë në të drejta themelore të garantuara me kushtetutë (liria e fjalës),¹⁹³ dhe kur vendimi i huaj ka ekzekutuar një borxh bixhozi.¹⁹⁴

Nënparagrafi (d) – procedurat në gjykatën e origjinës ishin në kundërshtim me marrëveshjen, ose përcaktimin e bërë në instrumentin e trustit, sipas të cilit vendimi për mosmarrëveshjen në fjalë do të merrej nga një gjykatë të një shteti të ndryshëm nga shteti i origjinës;

267. Ky nënparagraf e lejon gjykatën e kërkuar të refuzojë t'i japë efekt një vendimi gjyqësor të dhënë nga një gjykatë kur procedurat gjyqësore në Shtetin e origjinës kanë qenë në kundërshtim me një marrëveshjeje për zgjedhjen e gjykatës ose me emërtimin e një instrumenti trusti. Baza logjike e tij është të mbrojtë marrëveshjen ose emërtimin, dhe si pasojë të respektojë autonominë e palës. Përdorimi i këtij nënparagraf do të ishte i nevojshëm vetëm kur vendimi ka përmbushur një filtër sipas nenit 5. Në fakt, nëse vendimi nuk ka gërmushur asnjë nga filtrat, vendimi nuk mund të merret parasysh për njohje apo zbatim sipas Konventës (përveç sipas ligjit të brendshëm, sikundër lejohet nga neni 15).
268. **Shembuj.** X-i ngre një padi kontraktuese kundër Y-së në Shtetin A, ku duhet të kryhej detyrimi kontraktues mbi të cilin është bazuar vendimi. Palët, gjithsesi, kishin rënë dakord të ngrinin një padi ndaj juridiksionit ekskluziv të gjykatës në Shtetin B. Y-ja paraqitet përpara gjykatës së origjinës dhe kundërshton juridiksionin e saj në bazë të marrëveshjes për zgjedhjen e gjykatës, por kjo mbrojtje është hedhur poshtë. Vendimi për themel është në favor të X-it. Njohja apo ekzekutimi i këtij vendimi gjithsesi, mund të refuzohet sipas nënparagrafit (d) duke qenë se procedurat gjyqësore në Shtetin A kanë qenë në kundërshtim me marrëveshjen për zgjedhjen e gjykatës. Vini re se nëse Y-ja do të paraqitej përpara gjykatave të Shtetit A dhe do të argumentonte për themel, pa kundërshtuar juridiksionin, nënparagrafi (d), në parim, nuk do të zbatohet.¹⁹⁵

adoptimi) – shih, Fashikullin 584-40.

¹⁹² Shih, *Soleimore kundër Soleimore (id.)*. Megjithëse kjo lëndë përfshinte një vendim arbitrazhi dhe jo një vendim të huaj, gjykata pohoi se ajo pa dyshim do të kish refuzuar të ekzekutonte vendimin po të kish qenë një vendim gjyqësor i dhënë nga një gjykatë e huaj.

¹⁹³ Shih, *Bachchan kundër India Abroad Publ'n Inc.*, 154 Misc. 2d 228, 235 (N.Y. sup. Ct. 1992) (Shtetet e Bashkuara të Amerikës), ku një vendim anglez për shpifje iu refuzua njohja në Nju Jork. Shih, gjithsesi, diskutimin për politikën publike dhe lirinë e fjalës te *Yahoo! kundër LICRA*, 433 F.3d 1199 (9th Cir. 2006) (Shtetet e Bashkuara të Amerikës).

¹⁹⁴ Shih, *Sporting Index Limited kundër John O'Shea* [2015] IEHC 407 (Gjykata e Lartë e Irlandës); Kazino e *Ritz Hotelit Ltd kundër Datuk Seri Osu Haji Sukam*, [2005] 6 *Malayan Law Journal* 760 (Gjykata e Lartë e Malezisë). Por, gjykata të tjera e kanë hedhur poshtë përdorimin e politikës publike nëse bixhozi ka qenë i ligjshëm kur borxhi ka ndodhur: shih, për shembull, *Boardwalk Regency Corp. kundër Maalouf* (1992), 6 O.R. (3d) 737 (Ontario C.A.); *G.N.L.V. Corp. kundër Wan*, [1991] B.C.J. nr 3725 (British Columbia S.C.); *Liao Eng Kiat kundër Burswood Nominees Ltd*, [2004] 4 S.L.R. 690 (Singapore C.A.).

¹⁹⁵ Një sjellje e tillë mund konsiderohet si shmangie e heshtur nga marrëveshja për zgjedhjen e gjykatës

269. Ky nënparagraf zbatohet kurdoherë që marrëveshja për zgjedhjen e gjykatës në mënyrë të vlefshme e përjashton juridiksionin e gjykatës të origjinës, pavarësisht nëse marrëveshja është ekskluzive ose jo-ekskluzive. Ajo zbatohet gjithashtu pavarësisht nëse gjykata e zgjedhur nga palët ose e caktuar në një instrument trusti ishte gjykata e një Shteti kontraktues apo e një Shteti të tretë. Vlefshmëria dhe efektiviteti i marrëveshjes ose caktimit rregullohet nga ligji i Shtetit të kërkuar, duke përfshirë rregullat e tij të së drejtës ndërkombëtare private.

Nënparagrafët (e) dhe (f) –

270. Këta dy nënparagrafë pasqyrojnë faktin që në situata ndërkombëtare, më shumë se një gjykatë mund të ketë juridiksionin ndaj një mosmarrëveshjeje dhe se, përpara këtyre gjykatave mund të sillen procese paralele apo të shumëfishta, duke çuar në dhënien e më shumë se të një vendimi. Kur ekzistojnë vendime gjyqësore që bien ndesh me njëra tjetrën, lind çështja e hierarkisë: cilit vendim i duhet dhënë përparësi? Neni 7(1) dallon dy situata: së pari, kur vendimi konkurrues është dhënë nga një gjykatë në Shtetin e kërkuar dhe, së dyti, kur vendimi konkurrues është dhënë në një Shtet tjetër (i ndryshëm nga Shteti i origjinës). Këto dispozita janë identike me ato që gjenden në KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës (Neni 9(f) dhe (g)). Neni 7(2), nga ana e tij, i trajton ato çështje kur proceset në Shtetin e kërkuar janë ende pezull, kur kërkohet njohja apo ekzekutimi.

Nënparagrafi (e) – vendimi gjyqësor është në mospërputhje me vendimin gjyqësor të dhënë nga gjykata e Shtetit të kërkuar në mosmarrëveshjen mes të njëjtave palë; ose

271. Në rastin e parë, nën-paragrafi (e) përcakton se vendimit të dhënë nga Shteti i origjinës mund t'i refuzohet njohja apo ekzekutimi kur ai vendim nuk është në përputhje me një vendim gjyqësor të dhënë nga Shteti i kërkuar. Ka dy kushte: vendimet gjyqësore duhet të jenë “mospërputhëse” dhe vendimi i dhënë nga Shteti i kërkuar duhet të ketë të bëjë me “një mosmarrëveshje midis palëve të njëjta”.¹⁹⁶ Vendimi nuk ka nevojë të jetë dhënë përpara vendimit konkurrues, as të jetë i mbështetur në të njëjtën shkak padie. Nënparagrafi (e) është pra më i gjerë se sa nënparagrafi (f) dhe paragrafi 2 i nenit 7, sepse ai nuk kërkon që të dy vendimet gjyqësore të përfshijnë të njëjtën lëndë.¹⁹⁷ Të dy vendimet gjyqësore do të jenë

dhe si pasojë, vendimi nuk mund të jetë në kundërshtim me të.

¹⁹⁶ Raporti Hartley/Dogauch, shënimi 231, deklaron: “Kërkesa në lidhje me palët do të jetë plotësuar nëse palët e detyruara nga vendimet gjyqësore janë të njëjta edhe kur palët në proces janë të ndryshme, për shembull, kur një vendim është kundër një personi të caktuar dhe vendimi tjetër është kundër trashëgimtarit të atij personi.” (shih *supra*, para. 92).

¹⁹⁷ Në kontekstin e Rregullores së Brukselit, ky dallim është ilustruar në vendimin e 4 shkurtit 1988, *Hoffmann kundër Krieg*, C-145/86, EU:C:1988:61, ku GJED-ja vendosi që një vendim i huaj që e urdhëron një person të bëjë pagesat e mbajtjes së bashkëshortes së tij, që krijohet nga detyrimi i tij nga martesja që nuk është zgjidhur, ishte i papajtueshëm me një vendim të brendshëm që shpall divorcin e bashkëshortëve. Vini re, gjithsesi, se Konventa nuk zbatohet për detyrimet e mbajtjes. Sidoqoftë, përdorimi i kësaj dispozite nuk duhet të nxisë sjellje strategjike apo oportuniste nga ana e debitorit objekt i vendimit, siç mund të ndodhë në rastin që procedurat gjyqësore në Shtetin e kërkuar kanë nisur ndërkohë që shpallja e zbatueshmërisë (*exequatur*) është në pritje. Kështu, një rregull e

“mospërputhëse” kur nuk është e mundur të veprohet në përputhje me njërin, pa shkelur tjetrin tërësisht apo pjesërisht.

Nënparagrafi (f) – vendimi gjyqësor është në mospërputhje me vendimin gjyqësor të mëparshëm të dhënë nga gjykata e një shteti tjetër mes të njëjtave palë, për të njëjtën çështje lëndore, me kushtin që vendimi gjyqësor i mëparshëm plotëson kushtet e nevojshme për njohjen e tij në Shtetin e kërkuar.

272. Në rastin e dytë, nënparagrafi (f), zbatohet ku vendimet gjyqësore që bien ndesh me njëra tjetrën janë të dy nga Shtete të huaja. Ai e përcakton se një vendimi gjyqësor i dhënë në Shtetin e origjinës, mund t’i refuzohet njohja apo ekzekutimi ku ai është mospërputhës me një vendim të mëparshëm të dhënë në një Shtet tjetër, pavarësisht nëse ai Shtet është apo jo kontraktues. Edhe tre kushte të tjera duhen përmbushur me qëllim që të zbatohet nënparagrafi (f). Së pari, vendimi i Shtetit të tretë duhet të jetë dhënë *përpara* vendimit të Shtetit të origjinës, pavarësisht nga se cila gjykatë është futur fillimisht në lojë. Vendimi i parë në kohë ka përparësi. Së dyti, të dy vendimet gjyqësore duhet të kenë të bëjnë me palë të njëjta dhe me të njëjtën lëndë. Kjo është një kërkesë më e ngushtë se sa kushti sipas nënparagrafit (e), por paralel me shkakun *lis pendens* formuluar në paragrafin 2.¹⁹⁸ Versioni frëngjisht përdor shprehjen *ayant le même objet* (të kenë të njëjtën objekt) për t’iu referuar të “njëjtës lëndë”. Këto shprehje konsiderohen të barasvlershme sipas Konventës dhe kanë për qëllim të përjashtojnë kërkesën që të dy vendimet gjyqësore të përfshijnë saktësisht të njëjtin “shkak për veprim”, siç kërkohet në KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhje e Gjykatës. Ajo qasje është konsideruar si tepër kufizuese në këtë Konventë, duke pasur parasysh shumëllojshmërinë e shkaqeve për të ngritur padi në Shtete të ndryshme. Elementi kyç është që “çështja qendrore apo thelbësore” duhet të jetë e njëjtë në të dy vendimet gjyqësore. Së treti, vendimi më i hershëm duhet të plotësojë kushtet për njohje apo zbatim në Shtetin e kërkuar, pavarësisht nëse njohja apo ekzekutimi është kërkuar apo jo ende.¹⁹⁹

arsyeshme mund të ishte të pezulloheshin në procedurat gjyqësore deri sa të merrej vendimi për *exequature*. Konventa, gjithsesi, nuk e imponon një rregull të tillë.

¹⁹⁸ Shih, Raportin Pocar në Konventën e Luganos të 2007, para. 139: “Në raste të këtij lloji, fakti që vendimet gjyqësore janë të papajtueshme e pengon njohjen e këtij të fundit, por vetëm nëse vendimet gjyqësore janë dhënë në mosmarrëveshje midis palëve të njëjta dhe kanë lëndë dhe shkak të njëjtë padie, gjithnjë me kusht që të plotësojnë testet për njohje në Shtetin e kërkuar. Nëse lënda apo shaku i padisë nuk janë të njëjtë, vendimet gjyqësore njihen të dy, edhe kur janë të papajtueshëm me njëri tjetrin. Në këtë rast, papajtueshmëria duhet të zgjidhet nga gjykata e brendshme përpara të cilës kërkohet ekzekutimi, i cili mund të zbatohet rregulla të sistemit të tij për këtë qëllim dhe mund t’u japë në fakt peshë faktorëve të tjerë dhe jo renditjes në kohë të vendimeve gjyqësore, siç është rendi në të cilën procedurat gjyqësore kanë filluar apo rendi në të cilin ata u bënë vendime *res judicata*, që nuk është një kërkesë për njohje sipas Konventës.”

¹⁹⁹ Sigurisht, nëse vendimi i mëparshëm vjen nga një Shtet jo-kontraktues, çështja nëse vendimi i plotëson kushtet për njohje apo zbatim do të përcaktohet sipas ligjit të brendshëm të Shtetit të kërkuar.

Paragrafi 2 – Njohja ose zbatimi mund të shtyhet ose të refuzohet nëse procedurat mes të njëjtave palë, për të njëjtën çështje lëndore, janë në pritje për shqyrtim para një gjykate të Shtetit të kërkuar, kur:

273. Mund të ndodhë që procese paralele midis palëve të njëjta për të njëjtën lëndë, të zhvillohen në Shtete të ndryshme. Neni 7 përcakton tre rregulla për mënyrën se si vendimet gjyqësore trajtohen në këto situata. Paragrafët 1(e) dhe (f), të diskutuar më lart, trajtojnë rastet kur proceset paralele kanë përfunduar dhe vendimet gjyqësore që dalin prej tyre janë mospërputhëse. Paragrafi 2 trajton ato çështje ku proceset janë ende në pritje në Shtetin e kërkuar kur kërkohet njohja apo ekzekutim i një vendimi gjyqësor të dhënë në një Shtet tjetër.²⁰⁰ *Lis pendens* në një Shtet tjetër nuk mund të përdoret për të refuzuar njohjen apo zbatimin. Për më tepër, procedurat gjyqësore në pritje në Shtetin e kërkuar duhet të jenë “midis palëve të njëjta për të njëjtën lëndë”. Në këto raste, njohja apo ekzekutimi duhen shtyrë apo refuzuar kur plotësohen dy kushte në vazhdimësi (kumulative).

Nënparagrafi (a) – gjykata e Shtetit të kërkuar e kishte marrë juridiksionin para gjykatës së origjinës; dhe

274. **Kushti i parë.** Sipas paragrafit 2(a), gjykata e Shtetit të kërkuar duhet të ketë qenë gjykata e parë e përfshirë në proces. Si rrjedhojë, ky shkak për refuzim mund të përdoret nëse procedurat gjyqësore në Shtetin e kërkuar kanë filluar përpara procedurave gjyqësore në Shtetin e origjinës. Baza logjike për këtë kusht është që Shteti i kërkuar të lejohet të procedojë në bazë të faktit që gjykata e origjinës duhet t’ia kish lënë vendin përparësisë që ka gjykata e përfshirë më parë dhe të pezullonte apo refuzonte fillimin e procesit, meqenëse e njëjta mosmarrëveshje ndërkohë ishte në pritje në një Shtet tjetër (lidhur me çastin kur një gjykatë është përfshirë në proces, shih *supra*, para. 41).

Nënparagrafi (b) – ekziston një lidhje e ngushtë mes mosmarrëveshjes dhe Shtetit të kërkuar.

275. **Kushti i dytë.** Gjithsesi, vetëm përparësia nuk mjafton. Sipas paragrafit 2(b), duhet gjithashtu të ketë një lidhje të ngushtë midis mosmarrëveshjes dhe Shtetit të kërkuar. Ky kusht është për të parandaluar sjellje strategjike apo oportuniste. Për shembull, pa këtë kusht, një i paditur potencial në një Shtet mund të shkojë në një Shtet tjetër dhe aty të hedhë në gjyq palën tjetër, duke kërkuar një të ashtuquajtur “deklaratë negative”, thjesht për të penguar njohjen apo zbatimin e vendimit të huaj në të ardhmen dhe në bazë të një shkakut të tepruar juridiksional. Konventa nuk e përcakton se cilat baza të juridiksionit e përmbushin kushtin e “lidhjes së ngushtë”. Në parim, secili prej filtrave të listuar në nenin 5 e përmbush këtë kusht, por mund të ketë edhe të tjerë që po ashtu e plotësojnë, *për shembull*, vendi ku

²⁰⁰ Projekt Konventa paraprake e 1999 përmbante një dispozitë paralele (shih, Neni 28(1)(a)).

dëmi është pësuar drejtpërdrejt në një në mosmarrëveshje jo-kontraktuese. Nga ana tjetër, vetëm shtetësia e paditësit apo vendqëndrimi i tij i rregullt në Shtetin e kërkuar nuk do të ishte e mjaftueshme apo i mjaftueshëm.

Refuzimi sipas këtij paragrafi nuk parandalon paraqitjen e mëvonshme të kërkesës për njohjen ose zbatimin e vendimit gjyqësor.

276. **Pasoja.** Nëse procedurat gjyqësore janë në pritje midis palëve të njëjta për të njëjtën lëndë në Shtetin e kërkuar dhe dy kushtet e mësipërme plotësohen, njohja apo zbatimi i vendimit mund të shtyhen apo refuzohen. Paragrafi 2 sqaron se refuzimi sipas këtij paragrafi nuk e pengon një kërkesë të mëvonshme për njohje apo zbatim. Kjo dispozitë trajton situatat kur procesi për të njëjtën lëndë në Shtetin e kërkuar përfundon pa një vendim gjyqësor për themel (*për shembull*, për shkaqe procedurale) ose me një vendim për themel që është në përputhje me vendimin e huaj.

Neni 8
Çështje paraprake

- 1. Vendimi për çështje paraprake nuk njihet ose nuk zbatohet sipas kësaj Konvente nëse vendimi lidhet me një çështje për të cilën kjo Konventë nuk zbatohet, ose me një çështje të përmendur në nenin 6, për të cilën vendosi një gjykatë e një shteti të ndryshëm nga shteti i përmendur në atë nen.**
- 2. Njohja ose zbatimi i një vendimi gjyqësor mund të refuzohet nëse, dhe deri në masën që, vendimi gjyqësor është bazuar në një vendim lidhur me një çështje për të cilën kjo Konventë nuk zbatohet, ose lidhur me një çështje, që përmendet në nenin 6, për të cilën vendosi/ka vendosur një gjykatë e një shteti të ndryshëm nga shteti i përmendur në atë nen.**

277. Neni 8 trajton çështjet paraprake, që janë çështje juridike të cilat duhen trajtuar përpara se të merret vendimi për padinë e paditësit, por nuk janë objekti kryesor apo çështja qendrore e procesit.²⁰¹ Neni 8 njeh se, konceptualisht, çështjet juridike brenda një vendimi gjyqësor mund të jenë të ndara nga njëra tjetra, por duhet të merren në shqyrtim njëra pas tjetrën, *pra*, që një vendim për çështjen bazë mbështetet në një vendim për një tjetër çështje paraprake. Për shembull, në një kërkesëpadi për dëmshpërblime për shkeljen e një kontrate shitjesh (objekti kryesor), gjykata mundet që së pari, të vendosë për zotësinë e një pale për të lidhur një kontratë të tillë (çështja paraprake). Këto çështje paraprake zakonisht, por jo gjithnjë, futen në proces nga i padituri si një mënyrë për t'u mbrojtur.

278. Sipas nenit 2(2), vendimet gjyqësore që përfshijnë vendime paraprake për çështje të përjashtuara, nuk përjashtohen vetëm për atë arsye nga fusha e veprimit të Konventës (shih, *supra*, para. 75-77). Neni 8 trajton një çështje të veçantë, e cila është njohja dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore për çështje paraprake që trajtojnë lëndë të përjashtuara. Neni 8 gjithashtu trajton vendimet gjyqësore për një çështje paraprake të përmendur në nenin 6: kur gjykata e origjinës nuk është një gjykatë e Shtetit ku prona e patundshme ndodhet.

²⁰¹ Sikurse vihet në dukje më lart, shënimi 77, “fusha e veprimit” ka për synim të tregojë çështjen me të cilën procedurat gjyqësore merren drejtpërdrejt dhe e cila përcaktohet kryesisht nga padia e paditësit; shih, Raporti Hartley/Dogauch, para.77 dhe 149. Termat “çështje të rastësishme” dhe “çështja kryesore” përdoren në Raportin Nygh/Pocar, para. 177.

279. **Struktura i nenit 8.** Kjo dispozitë përmban dy rregulla për çështjet paraprake. Paragrafi 1 përjashton vendimet për disa çështje paraprake nga njohja apo ekzekutimi sipas Konventës. Paragrafi 2 e lejon gjykatën e kërkuar të refuzojë të njohë apo ekzekutojë vendime gjyqësore që janë të bazuara në vendime për disa çështje të caktuara paraprake.

Paragrafi 1 – Vendimi për çështje paraprake nuk njihet ose nuk zbatohet sipas kësaj Konvente nëse vendimi lidhet me një çështje për të cilën kjo Konventë nuk zbatohet, ose me një çështje të përmendur në nenin 6, për të cilën vendosi një gjykatë e një shteti të ndryshëm nga shteti i përmendur në atë nen.

280. Paragrafi 1 parashikon që kur një çështje, për të cilën Konventa nuk zbatohet, ka dalë si një çështje paraprake, vendimi për atë çështje paraprake nuk duhet të njihet apo zbatohet sipas Konventës. I njëjti rezultat del edhe kur një çështje paraprake ka dalë lidhur me një çështje të përmendur në nenin 6 në një gjykatë tjetër nga gjykata e Shtetit ku prona e patundshme ndodhet.

281. Parimi i përgjithshëm është që zbatimi i Konventës përcaktohet nga objekti i procesit dhe jo nga çështja paraprake (shih, *supra*, neni 2(2)). Si rrjedhojë, një vendim gjyqësor i plotëson kushtet për njohje apo zbatim nëse përmbush secilin prej këtyre filtrave të parashikuar në nenin 5 ose 6 lidhur me *objektin kryesor të procesit*. Nëse gjykata e origjinës ka vendosur gjithashtu për një çështje paraprake, ai vendim mund të ketë efekt në një proces në të ardhmen sipas ligjit të atij Shteti. Për shembull, sipas doktrinës së mos gjykimit dy herë të së njëjtës çështje apo përjashtimit të gjykimit të së njëjtës lëndë dy herë, një çështje paraprake duhet të njihet në një proces të ardhshëm.²⁰² Qëllimi i paragrafit 1 është të sqarojë se njohja e këtyre efekteve nuk parashikohet sipas Konventës.²⁰³

282. **Çështje të përjashtuara nga fusha e veprimit të Konventës.** Paragrafi 1 u referohet atyre vendimeve për çështje për të cilat Konventa “nuk zbatohet”. Kjo mbulon çështje që nuk i plotësojnë kushtet si lëndë civile apo tregtare sipas nenit 1(1), lëndët e përjashtuara shprehimisht sipas nenit 2(1), dhe lëndët e përjashtuara me anë të një deklarimi të bërë nga Shteti i kërkuar sipas nenit 18. Vendime për lëndë për të cilat Konventa nuk zbatohet nuk duhet të përfitojnë nga zbatimi i saj, qoftë nëse dalin si

²⁰² Shih, Raporti Hartley/Dogauch, para. 195-196.

²⁰³ Meqenëse Konventa nuk kërkon njohjen e vendimeve për çështje paraprake, Neni 8(1) mund të jetë i panevojshëm, (siç deklarohet në raportin Hartley/Dogauchi, *id.*, “[...] Konventa nuk kërkon kurrë njohjen apo zbatimin e vendimeve të tilla, megjithatë, ajo nuk i përjashton Shtetet kontraktuese nga njohja e tyre sipas ligjit të brendshëm”, para. 195). Kjo shpjegon se përse Konventa është e heshtur për këto raste kur çështja paraprake nuk futet në asnjë nga dy kategoritë e përmendura në nenin 8. Për shembull, në një kërkesëpadi për dëmshpërblime ndaj një pasurie të tundshme (fusha e veprimit kryesor), gjykata mund të duhet të vendosë për pronësinë e një prone të tillë (çështja paraprake). Në parim, pjesa e vendimit që shprehet për një çështje paraprake nuk do të qarkullojë sipas Konventës dhe, si pasojë, neni 8(1) nuk duhet të interpretohet *a contrario*. Gjithsesi, “në rastin e vendimeve për çështje jashtë fushës së veprimit të Konventës [...] çështja është kaq e rëndësishme sa që u pa me vend të kishte një dispozitë të shprehur”, Raporti Hartley/Dogauch, para. 196.

çështje paraprake ose si çështje kryesore. Shtetet nuk përjashtohen nga njohja dhe ekzekutimi i këtyre vendimeve sipas ligjit të tyre të brendshëm.

283. **Shembuj.** Nëse një vendim gjyqësor për një shkelje kontrate jepet për një çështje paraprake, për zotësinë juridike të palëve (një personi fizik) për të lidhur një kontratë të tillë, vendimi për këtë çështje paraprake nuk do të njihet sipas Konventës, sepse një çështje e tillë është përtej fushës së veprimit të Konventës sipas nenit 2(1)(a). Ose, nëse një vendim gjyqësor për përgjegjësinë e drejtuesve jepet, për një çështje paraprake, për vlefshmërinë e një vendimi të marrë në mbledhjen e aksionarëve, ky vendim nuk do të njihet sipas Konventës sepse një çështje e tillë është përtej fushës së veprimit të saj, sipas nenit 2(1)(i). Gjithsesi, vendimi për fushën e veprimit kryesor do të përfitonte nga njohja apo ekzekutimi sipas Konventës, duke iu nënshtruar paragrafit 2, të diskutuar më poshtë. Kështu, për shembull, ku një vendim gjyqësor thotë se një palë ka të drejtë të marrë kompensim për shkeljen e kontratës, por përmban një vendim për një çështje paraprake lidhur me zotësinë juridike të personit fizik bashkëkontraktues për të lidhur kontratë, vendimi për objektin kryesor të vendimit – urdhri për dëmshpërblim – mund të njihet dhe zbatohet sipas Konventës (duke iu nënshtruar nenit 8(2)). Konventa, gjithsesi, nuk kërkon njohjen e vendimeve për çështje paraprake në procese të mëvonshme në Shtetin e kërkuar që kanë të bëjnë me apo që përfshijnë atë çështje. Nga kjo del, për shembull, se vendimi për dëmshpërblim mund të mos e pengojë procesin të fillojë në Shtetin e kërkuar lidhur me zotësinë juridike të personit fizik (ose, në shembullin e dytë, për vlefshmërinë e një vendimi të mbledhjes së aksionarëve).²⁰⁴
284. **Çështje që futen në nenin 6.** Paragrafi 1 gjithashtu u referohet vendimeve për çështje paraprake lidhur me një aspekt të përmendur në nenin 6 të dhënë nga një gjykatë e një Shteti tjetër nga Shteti i përmendur në këtë dispozitë, *pra*, Shteti ku prona e patundshme ndodhet. Për shembull, nëse një vendim gjyqësor për dëmshpërblim i dhënë në Shtetin A, në bazë të vendqëndrimit të një të padituri, është dhënë për një çështje paraprake mbi pronësinë e pronës së patundshme të ndodhur në Shtetin B, vendimi për këtë çështje paraprake nuk do të njihet sipas Konventës, sepse gjykatat e Shtetit ku prona e patundshme ndodhet kanë juridiksion ekskluziv për të vendosur për pronësinë (Neni 6). Vendimi i Shtetit A mund të mos e pengojë çeljen e një procesi të ri në Shtetin B për të dhënë vendim për të drejtën sendore *in rem* ndaj pronës së patundshme, siç është shpjeguar në paragrafin paraprak ku përmendet procesi në Shtetin e kërkuar lidhur me zotësinë juridike të një personi fizik ose për vlefshmërinë e një vendimi të mbledhjes së aksionarëve.

²⁰⁴ Nëse vendimet janë të papajtueshme, do të ishte detyrë e ligjit të Shtetit të kërkuar të vendoste për pasojat. Mund të ndodhë që efektet e vendimit të huaj të rishikohen kur një vendim i ri për “çështjen paraprake” jepet në Shtetin e kërkuar, por në këtë rast, koha është objekti kryesor.

Paragrafi 2 – Njohja ose zbatimi i një vendimi gjyqësor mund të refuzohet nëse, dhe deri në masën që, vendimi gjyqësor është bazuar në një vendim lidhur me një çështje për të cilën kjo Konventë nuk zbatohet, ose lidhur me një çështje, që përmendet në nenin 6, për të cilën vendosi/ka vendosur një gjykatë e një shteti të ndryshëm nga shteti i përmendur në atë nen.

285. Paragrafi 2 e lejon një gjykatë të refuzojë njohjen apo zbatimin e një vendimi gjyqësor, nëse ai është i bazuar në vendime për çështje paraprake për të njëjtat lëndë të trajtuara nga paragrafi 1. Kjo dispozitë shton edhe një shkak tjetër për mosnjohje përveç atyre që përmban neni 7. Njohja apo ekzekutimi i një vendimi gjyqësor mund të refuzohet *nëse, dhe për aq sa*, vendimi ishte mbështetur në një vendim për një çështje (i) për të cilën Konventa nuk zbatohet, ose (ii) që përmendet në nenin 6, i cili është vendosur një Shtet tjetër nga Shteti ku prona e patundshme ndodhet. Kështu, për shembull, sipas paragrafit 2, gjykata e Shtetit të kërkuar mund të refuzojë njohjen e një vendimi gjyqësor për pavlefshmërinë e një kontrate (fusha e veprimit kryesor), ose të një vendimi gjyqësor që miraton dëmshpërblime për shkelje kontrate (fusha e veprimit kryesor), nëse dhe për aq sa ai është bazuar në një vendim për mungesë zotësie të një personi fizik për të lidhur një kontratë të tillë (çështje paraprake).
286. Zbatimi praktik i kësaj dispozite kërkon nga gjykata e Shtetit të kërkuar të shqyrtojë përmbajtjen e vendimit të huaj dhe të verifikojë nëse, dhe në çfarë mase, vendimi për objektin kryesor të procesit është i bazuar në një vendim për çështje paraprake. Çështja është nëse një vendim i ndryshëm për çështje paraprake do të kishte çuar në një vendim të ndryshëm lidhur me objektin kryesor të procesit. Me fjalë të tjera, gjykata e Shtetit të kërkuar duhet të verifikojë nëse vendimi për çështje paraprake parashikon një premisë të nevojshme mbi të cilën është marrë vendimi.²⁰⁵ Për shembull, nëse gjykata e origjinës shpall pavlefshmërinë e një kontrate për shkak të mungesës së zotësisë juridike dhe ekzistencës së mashtrimit, vendimi për zotësinë juridike nuk është i nevojshëm për aktgjykimin duke qenë se mashtrimi në vetvete do të kishte mjaftuar për ta bërë kontratën të pavlefshme. Raporti Hartley/Dogauchi sqaron se ky përjashtim duhet të përdoret vetëm kur gjykata e Shtetit të kërkuar do të kishte vendosur ndryshe për çështjen paraprake,²⁰⁶ në mënyrë të tillë që ai vendim për fushën e veprimit kryesor po ashtu do të kish qenë i ndryshëm. Sesioni njëzetë e dy e konfirmoi se ky kusht duhet të plotësohet kur zbatohet neni 8(2) i Konventës. Kjo gjë mund të dalë në një vendim gjyqësor i cili urdhëron pagimin e dëmshpërblimeve për shkelje kontrate, si fusha e veprimit kryesor, por në bazë të një vendimi paraprak lidhur me zotësinë e një personi fizik për ta lidhur atë kontratë. Në një rast të tillë, gjykata e kërkuar vetëm mund të

²⁰⁵ Raporti Hartley/Dogauch, para. 200.

²⁰⁶ *Po aty*, para. 197.

refuzojë njohjen apo zbatimin, nëse ajo gjykatë do të kishte vendosur ndryshe për çështjen e zotësisë,²⁰⁷ dhe kjo do të kishte çuar gjithashtu në një vendim të ndryshëm lidhur me detyrimin për të paguar dëmshpërblime.

287. **Dallimi me KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës.** Dispozita paralele në KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës, përmban një paragraf të tretë që trajton vendimet gjyqësore për vlefshmërinë e një të drejte të pronësinë intelektuale të ndryshme nga e drejta e autorit apo një e drejtë e lidhur, si një çështje paraprake (Neni 10(3)). Sipas kësaj dispozite, njohja apo ekzekutimi i vendimit mund të refuzohet vetëm nëse, dhe për aq sa, vendimi për vlefshmërinë e të drejtës së pronësisë intelektuale është mospërputhës me një vendim gjyqësor, ose një vendim të një autoriteti kompetent, dhënë në Shtetin sipas ligjit të të cilit lindi e drejta e pronësisë intelektuale, ose nëse procesi lidhur me vlefshmërinë e të drejtës së pronësisë intelektuale është në pritje në atë Shtet. Qëllimi kryesor i kësaj rregulle është të kufizojë përdorimin strategjik të pavlefshmërisë së një të drejte të regjistruar të pronësinë intelektuale si formë mbrojtjeje.
288. Kjo dispozitë nuk është përfshirë në Konventë. Sesioni njëzetë e dy vendosi të largohej nga zgjidhja e KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës, për dy arsye kryesore. Së pari, kur juridiksioni i gjykatës të origjinës bazohet në marrëveshjen e palëve, mund të ishte e arsyeshme të kufizohej opsioni i të paditurit për të përdorur pavlefshmërinë e një të drejte të regjistruar të pronësisë intelektuale si një mënyrë për t'u mbrojtur. I padituri me dëshirën e vet e ka marrë përsipër këtë risk. Por, kjo nuk ndodh në lidhje me shumicën e filtrave të parashikuar nga Neni 5 i Konventës. Dhe së dyti, objekti i përjashtimit të çështjeve të pronësisë intelektuale në Konventë kërkon një analizë të hollësishme që mund të ndryshojë në varësi të rrethanave të lëndës, sidomos, në kontekstin e kontratës që lidhet me këto çështje (shih, *supra*, para. 65). Përfshirja e një dispozite paralele mund të ketë cenuar interpretimin e atij përjashtimi; në veçanti, ai mund të ketë ftuar një interpretim sipas të cilit të gjitha mosmarrëveshjet kontraktuese të lidhura me të drejtat e pronësisë intelektuale do të futeshin në fushën e veprimit të Konventës.²⁰⁸ Për shkak të kësaj fshirjeje, dhe duke supozuar se Konventa zbatohet për fushën e veprimit kryesor të vendimit, neni 8 zbatohet për çështje të pronësisë intelektuale në të njëjtën mënyrë siç zbatohet për çdo çështje të tjera të përjashtuara.

²⁰⁷ Kjo duhet vendosur sipas ligjit të Shtetit të kërkuar, duke përfshirë rregullat e tij të së drejtës ndërkombëtare private.

²⁰⁸ Shih, Raporti Hartley/Dogauch, para. 199-200.

Neni 9
Veçimi

Njohja ose zbatimi i pjesës së vendimit gjyqësor që mund të veçohet, miratohet kur bëhet kërkesë për njohjen ose zbatimin e asaj pjese, ose kur vetëm një pjesë e vendimit gjyqësor mund të njihet ose të zbatohet sipas kësaj Konvente.

289. Neni 9 parashikon njohjen apo zbatimin e një pjese të veçueshme të një vendimi gjyqësor kur kjo gjë kërkohet, ose kur vetëm një pjesë e vendimit mund të njihet apo ekzekutohet sipas Konventës.²⁰⁹ Shembujt përfshijnë ato situata ku pjesë të vendimit nuk do t'i nënshtroheshin njohjes apo ekzekutimit sepse ato përfshijnë çështje që dalin nga fusha e veprimit të Konventës, janë të kundërt me politikën publike, ose nuk janë ende të ekzekutueshme në Shtetin e origjinës. Një shembull tjetër është një vendim gjyqësor për shumë detyrime kontraktuese ku kriteri i nenit 5(1)(g) përmbushet vetëm në lidhje me njërin prej tyre.²¹⁰
290. Për të qenë e veçueshme një pjesë e një vendimi gjyqësor duhet të jetë e aftë të qëndrojë më vete. Normalisht kjo do të varej nga fakti nëse ekzekutimi i vetëm asaj pjese të vendimit do të ndryshonte shumë detyrimet e palëve. Nëse veçueshmëria do të ngrinte çështje ligji, ato do të duhet të përcaktoheshin sipas ligjit të Shtetit të kërkuar.²¹¹

²⁰⁹ Ky nen përsëritnenin 15 të Konventës KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës. Shih, gjithashtu Raporti Hartley/Dogauch, para. 217.

²¹⁰ Ky shembull supozon se nuk ka filtër tjetër të disponueshëm sipas nenit 5(1).

²¹¹ Raporti Nygh/Pocar, para. 374.

Neni 10
Dëmshpërblimi

- 1. Njohja ose zbatimi i një vendimi gjyqësor mund të refuzohet nëse, dhe deri në masën që, vendimi gjyqësor cakton dëmshpërblimin, përfshirë dëmshpërblimin me vlerë më të madhe se dëmi i shkaktuar, i cili ka karakter ndëshkues, që nuk e kompenzon palën për humbjen ose dëmin e pësuar në të vërtetë.**
- 2. Gjykata, të cilës i është drejtuar pala, merr parasysh nëse, dhe deri në çfarë mase, dëmshpërblimi i caktuar nga gjykata e origjinës, shërben për të mbuluar kostot dhe shpenzimet në lidhje me procedurat.**

291. Neni 10 e lejon një gjykatë të refuzojë njohjen apo zbatimin e një vendimi gjyqësor nëse, dhe për aq sa, vendimi i dëmshpërblimit të mos kompensojë paditësit për humbjen apo dëmin konkret të pësuar. Pjesa kompensuese e vendimit mbetet e ekzekutueshme.
292. Dëmshpërblime “shembullore” dhe “ndëshkuese” do të thotë e njëjta gjë dhe pasqyrojnë faktin që këto dëmshpërblime kanë një objekt ndëshkues, përkundrejt një objekti kryesisht kompensues. Ndërsa është pranuar përgjithësisht se dëmshpërblimet kompensuese mund të kenë një efekt frenues, fusha e veprimit parësor i tyre është të riparojnë humbjen reale të pësuar. Dëmshpërblimet ndëshkuese apo shembullore, nga ana tjetër, zakonisht jepen për të shprehur dënimin e sjelljeve tepër flagrante nga ana e personit përgjegjës për to.
293. Teksti i nenit 10 është një përsëritje e dispozitës së barasvlershme në KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës.²¹² Për të sqaruar burimin dhe fushën e veprimit të rregullës, raporti shpjegues për atë Konventë përfshinte deklarin e mëposhtëm të hollësishëm miratuar në sesionin e njëzetë.²¹³

²¹² Neni 11 i Konventës KHDNP 2005 për Zgjedhjen e Gjykatës.

²¹³ Vetëm ato pjesë të deklarin e që kanë lidhje me Konventën janë përfshirë. Pjesë të deklarin e që u referohen versioneve të mëparshme të nenit për dëmshpërblim në KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës, janë hequr. Heqjet janë vënë në dukje me [...]. Për deklarin e plotë, sikundër ai paraqitet në raportin shpjegues të Konventës KHDNP 2005 për Zgjedhjen e Gjykatës, shih, Raporti Hartley/Dogauch, para. 203-205.

“(a) Të fillojmë me një parim bazë dhe të pa kundërshtuar ndonjëherë: vendime gjyqësore që japin dëmshpërblime hyjnë në fushën e veprimit Konventës. Kështu, një vendim gjyqësor i dhënë nga një gjykatë e caktuar në një marrëveshje ekskluzive për zgjedhjen e gjykatës i cili, në tërësi apo pjesërisht, i jep dëmshpërblime paditësit, do të njihet dhe ekzekutohet në të gjitha Shtetet kontraktuese sipas Konventës. Meqenëse vendime të tilla gjyqësore nuk janë të ndryshëm nga vendime të tjera që futen në fushën e veprimit të Konventës, neni 8 zbatohet pa kufizim. Kjo do të thotë, si detyrimi për të njohur dhe zbatuar një vendim, ashtu edhe të gjitha shkaqet për refuzimin e tij.

(b) Gjatë bisedimeve, u bë e qartë se disa delegacione kanë probleme me vendimet gjyqësore që japin dëmshpërblime të cilat e tejkalojnë shumë humbjen aktuale të paditësit. Dëmshpërblimet ndëshkuese apo shembullore janë një shembull i rëndësishëm. Disa delegacione ishin të mendimit se përjashtimi për shkak të politikës publike në nenin 9 e) mund t'i zgjidhte këto probleme, por të tjerë e bënë të qartë se kjo nuk ishte e mundur sipas konceptit të tyre të kufizuar të politikës publike. Kështu që u ra dakord që të shtohet edhe një shkak tjetër për refuzimin e vendimeve gjyqësore për dëmshpërblim. Ky është neni i ri 11. Si në rastin e të gjitha shkaqeve të tjera për refuzim, kjo dispozitë duhet interpretuar dhe zbatuar në një mënyrë sa më kufizuese që të jetë e mundur.

(c) Neni 11 është i bazuar në funksionin parësor të pa kontestuar të dëmshpërblimeve: ato duhet të kompensojnë humbjen aktuale. Prandaj, neni i ri 11(1) thotë se njohja apo ekzekutimi i një vendim gjyqësor mund të refuzohet nëse, dhe për aq sa, dëmshpërblimet nuk e kompensojnë një palë për humbjen apo dëmin aktual të pësuar. Duhet thënë se fjala në anglisht “aktual” ka një kuptim të ndryshëm nga fjala “aktual” në frëngjisht (e cila nuk përdoret në tekstin në frëngjisht); kështu që mbulohen edhe humbjet e ardhshme.

(d) Kjo nuk do të thotë që gjykata e kërkuar lejohet të shqyrtojë nëse ajo do të kish dhënë apo jo të njëjtën shumë dëmshpërblimesh. Pragu është shumë më i lartë. Neni 11 vepron vetëm kur është e qartë se vendimi duket se e tejkalon humbjen reale apo dëmin e pësuar. Në veçanti, kjo zbatohet për dëmshpërblimet ndëshkuese apo shembullore. Këto lloje dëmshpërblimesh përmenden kështu shprehimisht. Por, në raste të veçanta, edhe dëmshpërblimet që karakterizohen si kompensuese nga gjykata e origjinës gjithashtu mund të përfshihen sipas kësaj dispozite.

(e) Kjo dispozitë gjithashtu trajton si kompensim për humbjen apo dëmin aktual dëmshpërblimet që jepen në bazë të marrëveshjes së një pale (dëmshpërblime të likuiduara), ose të një ligji (dëmshpërblimi i parashikuar në ligj). Në lidhje me dëmshpërblime të tilla, gjykata e kërkuar mund ta refuzojë njohjen apo zbatimin vetëm nëse, dhe për aq sa, këto dëmshpërblime kanë për synim të ndëshkojnë të paditurin dhe jo të parashikojnë një vlerësim të drejtë të një shkalle të përshtatshme kompensimi.

(f) Do të ishte e gabuar të pyesje nëse gjykata e kërkuar duhet të zbatojë ligjin e Shtetit të origjinës apo ligjin e Shtetit të kërkuar. Neni 11 përmban një koncept

autonom. Është sigurisht gjykata e kërkuar që e zbaton këtë dispozitë, por ky zbatim nuk çon një zbatimin e thjeshtë të ligjit të Shtetit të kërkuar lidhur me dëmshpërblimet.

(g) Njohja apo ekzekutimi mund të refuzohet vetëm për atë që ai vendim e tejkalon humbjen apo dëmin real të pësuar. Për shumicën e delegacioneve, kjo mund të jetë pasojë logjike e qëllimit të kufizuar të kësaj dispozite. Gjithsesi, do të ishte me dobi që kjo të deklarohet shprehimisht. Kjo shmang qasjen e mundshme “gjithçka apo asgjë” që disa sisteme ligjore e zbatojnë në rastin e përjashtimeve për shkak të politikës publike.

(h) [...] Neni 11 parashikon shqyrtimin vetëm nëse vendimi jep dëmshpërblime që nuk e kompensojnë humbjen aktuale; ai nuk lejon ndonjë shqyrtim lidhur me themelin e lëndës. Si të gjitha shkaqet e tjera për refuzim, ai do të zbatohet vetëm në raste të veçanta. Çdo formulim i tepruar i këtyre rasteve do t’u jepte atyre peshë politike tepër të madhe.

(i) Neni 11 nuk e detyron gjykatën të refuzojë njohjen apo zbatimin. Kjo është e dukshme nga formulimi i tij – gjykata mund të refuzojë – dhe është në përputhje me qasjen e përgjithshme të nenit 9 [për refuzimin e njohjes apo ekzekutimit]. Kështu dispozita në asnjë mënyrë nuk e kufizon njohjen apo zbatimin e dëmshpërblimeve sipas ligjit të brendshëm ose të instrumenteve të tjerë ndërkombëtare, dhe ai lejon (por nuk kërkon) njohjen apo zbatimin sipas Konventës. Edhe një herë, Grupi i Punës ishte i mendimit se një dispozitë e shprehur do të kishte qenë një formulim i tepruar që do t’i kish dhënë tepër shumë peshë çështjes së dëmshpërblimeve.

(j) [...] Sipas nenit 11(1), mund të argumentohet se dëmshpërblimet e synuara që mbulojnë kostot e procesit nuk kompensojnë humbjet aktuale. Kjo sigurisht do të ishte e gabuar nga një perspektive krahasuese. Megjithatë, është e arsyeshme të ketë një referencë të shprehur ndaj këtij problemi në dispozitë. Kjo referencë nuk përmban një rregull të ngurtë; fakti që dëmshpërblimet kanë për synim të mbulojnë kostot dhe shpenzimet është i vetmi që duhet marrë në konsideratë.”

294. Ky deklaram është njëlloj i zbatueshëm edhe për Konventën.

Neni 11

Marrëveshjet me ndërmjetësim (transaksions judiciaires)

Marrëveshjet me ndërmjetësim (*transactions judiciaires*) që i ka miratuar gjykata e Shtetit Kontraktues, ose të cilat janë lidhur gjatë zhvillimit të procedurës para gjykatës së Shtetit Kontraktues, dhe që janë të zbatueshme në të njëjtën mënyrë si vendimi gjyqësor në shtetin e origjinës, zbatohen sipas kësaj Konvente, në të njëjtën mënyrë si vendimi gjyqësor.

295. Konventa zbatohet për marrëveshjet me ndërmjetësim (*transaksions judiciaires*). Sipas nenit 11, zgjidhjet e miratuara nga një gjykatë e një Shteti, apo që janë lidhur gjatë procesit përpara një gjykate të një Shteti dhe që janë të zbatueshme në Shtetin e origjinës, duhet të zbatohen sipas Konventës në të njëjtën mënyrë si një vendim gjyqësor.
296. **Marrëveshjet me ndërmjetësim.** Termi në anglisht “marrëveshje me ndërmjetësim” është përdorur në këtë nen si i barasvlershëm me termin në frëngjisht *transaksion judiciaire*. Marrëveshjet me ndërmjetësim, një institucion i zakonshëm në juridiksionet e të drejtës civile, janë marrëveshje të lidhura përpara gjykatës, apo të miratuara nga, gjykata në të cilin palët zgjidhin mosmarrëveshjen e tyre, zakonisht duke bërë lëshime të ndërsjella.²¹⁴ Marrëveshje të tilla kanë disa, ose edhe të gjitha efektet e një vendimi të formës së prerë. Një marrëveshje me ndërmjetësim zakonisht dallohet nga një “urdhër me pëlqim” ose “vendim me pëlqim” (“*jugement d’accord*”) dhënë nga gjykata me pëlqimin e të dy palëve. Urdhra apo vendime të tilla me pëlqim trajtohen sipas nenit 4 dhe jo nenit 11.²¹⁵
297. Neni 11 mbulon si marrëveshjet “në-gjykatë”, *pra*, marrëveshjet e miratuara apo të arritura përpara një gjykate gjatë procesit (siç ndodh zakonisht në shumicën e juridiksioneve të së drejtës civile), edhe marrëveshjet “jashtë gjykate”, *pra*, marrëveshjet e arritura nga palët jashtë procesit gjyqësor, që më pas miratohen apo konfirmohen nga një gjykatë.²¹⁶ Kështu, për shembull, marrëveshjet e arritura

²¹⁴ Shih, Raporti Hartley/Dogauch, para. 207. Rregullorja e Brukselit e përkufizon marrëveshjen në gjykatë si “një marrëveshje e cila është miratuar nga një gjykatë e një Shteti anëtar ose është lidhur nga një gjykate e një Shteti anëtar gjatë një procesi”.

²¹⁵ Raporti Nygh/Pocar, para. 379; Raporti Hartey/Dogauchi, para. 207.

²¹⁶ KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës përmban një dispozitë të barasvlershme për marrëveshjet gjyqësore (Neni 12). Raporti Hartley/Dogauchi nuk e mbulon shprehimisht trajtimin e marrëveshjeve jashtë gjykate të miratuara më pas nga një gjykatë (shih, para. 207). Interpretimi i dhënë në këtë Raport Shpjegues është në përputhje me gjuhën e dispozitës në të dy instrumentet.

si rezultat i ndërmjetësimit mbulohen nga neni 11 kur miratohen më pas nga një gjykatë.²¹⁷ Kjo mundësi buron nga dallimi i bërë në tekst midis marrëveshjeve “të miratuara nga një gjykatë” dhe marrëveshjeve “të arritura gjatë procesit përpara një gjykate”. Në të dy rastet, marrëveshja me ndërmjetësim duhet të jetë e zbatueshme në Shtetin e origjinës në të njëjtën mënyrë si një vendim gjyqësor. Për ta provuar këtë, pala që kërkon zbatimin e saj duhet të paraqesë certifikatën e përmendur në nenin 12(1)(d), *pra*, një certifikatë të një gjykate të Shtetit të origjinës ku të thuhet se marrëveshja me ndërmjetësim ose një pjesë e saj është e zbatueshme në të njëjtën mënyrë si një vendim gjyqësor në Shtetin e origjinës.

298. **Zbatimi *përkundrejt* njohjes.** Neni 11 parashikon zbatimin e marrëveshjeve me ndërmjetësim gjyqësore, por jo njohjen e tyre.²¹⁸ Prandaj, sipas Konventës, një marrëveshje me ndërmjetësim në një Shtet tjetër mund të mos përdoret në Shtetin e kërkuar si, për shembull, një mbrojtje procedurale ndaj një padie të re.²¹⁹ Raporti Nygh/Pocar shpjegon se në disa juridiksione, marrëveshjet me ndërmjetësim nuk kanë forcë *res judicata* dhe si pasojë nuk mund të njihen në një Shtet tjetër.²²⁰ Raporti Hartley/Dogauchi shton se KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës, nuk parashikon njohjen e marrëveshjes me ndërmjetësim “kryesisht sepse efektet e marrëveshjes janë shumë të ndryshme në sisteme ligjore të ndryshme”,²²¹ por “Konventa nuk e përjashton një gjykatë nga trajtimi i një marrëveshjeje si mbrojtje kontraktuese ndaj një padie për themel” për të provuar se çështja ndërkohë është zgjidhur.²²² Po ashtu, Konventa nuk e përjashton një gjykatë nga dhënia e efektit *res judicata* një marrëveshjeje të huaj gjyqësore sipas ligjit të brendshëm.
299. Shkaqet për refuzimin e zbatimit të një marrëveshjeje me ndërmjetësim janë të njëjta si ato që zbatohen për vendimet gjyqësore. Por, çështjet e juridiksionit nuk mund të ngrihen, sepse marrëveshjet janë kryesisht konsensuale; e njëjta gjë mund të thuhet për shkaqet e tjera për refuzimin e parashikuar në nenin 7, *për shembull*, mangësitë në njoftim. Në praktikë, shkakun më të rëndësishëm për refuzimin e zbatimit do të ishte politika publike.

²¹⁷ Ky interpretim nuk i mbivendoset Konventës UNICTRAL për zgjedhjen e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare që rezultojnë nga ndërmjetësimi ose ndaj Ligjit model me të njëjtin emër. Të dy instrumentet i përjashtojnë shprehimisht marrëveshjet me ndërmjetësim qoftë të miratuara nga gjykata, qoftë të arritura gjatë procesit gjyqësor.

²¹⁸ Shih, *supra*, para. 113-117.

²¹⁹ Raporti Hartley/Dogauchi, para. 208-209 (me një shembull).

²²⁰ Raporti Nygh/Pocar, para. 123. Vini re, gjithsesi, se sipas projekt Konventës paraprake të 1999, me qëllim për t'u njohur, vendimet gjyqësore duhet të kenë efektin *res judicata* në Shtetin e origjinës (Neni 25(2)). Ky kusht nuk gjendet në Konventë.

²²¹ Hartey/Dogauchi Raport, para. 209.

²²² *Po aty*.

Neni 12

Dokumentet që duhet të paraqiten

1. Pala që kërkon njohje ose që paraqet kërkesë për zbatim, paraqet dokumentet e mëposhtme:
 - (a) kopje të plotë dhe të noterizuar të vendimit gjyqësor;
 - (b) nëse vendimi gjyqësor është dhënë në mungesë, origjinali ose kopje e noterizuar e dokumentit, që përcakton se dokumenti me të cilin ka filluar procedura, ose dokumenti i njëvlershëm, i është bërë i ditur përmes njoftimit palës që nuk ka qenë e pranishme në gjykim;
 - (c) çdo dokument i nevojshëm për të vërtetuar se vendimi gjyqësor ka hyrë në fuqi ose, në rastet kur gjen zbatim, është i zbatueshëm në shtetin e origjinës;
 - (d) në rastin e përmendur në nenin 11, vërtetimi i gjykatës (lëshuar dhe nga një zyrtar) së shtetit të origjinës ku deklарohet se marrëveshja me ndërmjetësim, ose një pjesë e saj, është e zbatueshme në të njëjtën mënyrë si vendimi gjyqësor në shtetin e origjinës.

2. Nëse kushtet e vendimit gjyqësor nuk lejojnë që gjykata, së cilës i është drejtuar pala, të verifikojë nëse janë përmbushur kushtet e këtij Kapitulli, ajo gjykatë mund të kërkojë çdo dokument të nevojshëm.

3. Kërkesa për njohjen ose zbatimin mund të shoqërohet me dokumentin që ka të bëjë me vendimin gjyqësor, të nxjerrë nga gjykata (lëshuar dhe nga një zyrtar) e shtetit të origjinës, në formën e rekomanduar dhe të botuar nga Konferenca e Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private.

4. Nëse dokumentet e përmendura në këtë nen nuk janë në një gjuhë zyrtare të Shtetit të kërkuar, ato shoqërohen me përkthimin e noterizuar në një gjuhë zyrtare, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligjin e Shtetit të kërkuar.

300. Neni 12 rendit dokumentet që duhen paraqitur nga pala që kërkon njohjen apo zbatimin e një vendimi gjyqësor sipas Konventës.²²³ Në sistemet ligjore pa një

²²³

Kjo dispozitë është në thelb e njëjtë me nenin 13 të Konventës KHDNP 2005 për Zgjedhjen e Gjykatës

procedurë të posaçme për njohje (shih, *infra*, para. 308), pala që kërkon njohjen mund të duhet t'i paraqesë këto dokumente kur kërkon të mbështetet tek një vendim i huaj, *për shembull*, si një mënyrë për t'u mbrojtur.²²⁴

Paragrafi 1 – Pala që kërkon njohje ose që paraqet kërkesë për zbatim, paraqet dokumentet e mëposhtme:

Nënparagrafi (a) – kopje të plotë dhe të noterizuar të vendimit gjyqësor;

Nënparagrafi (b) – nëse vendimi gjyqësor është dhënë në mungesë, origjinali ose kopje e noterizuar e dokumentit, që përcakton se dokumenti me të cilin ka filluar procedura, ose dokumenti i njëvlershëm, i është bërë i ditur përmes njoftimit palës që nuk ka qenë e pranishme në gjykim;

Nënparagrafi (c) – çdo dokument i nevojshëm për të vërtetuar se vendimi gjyqësor ka hyrë në fuqi ose, në rastet kur gjen zbatim, është i zbatueshëm në shtetin e origjinës;

Nënparagrafi (d) – në rastin e përmendur në nenin 11, vërtetimi i gjykatës (lëshuar dhe nga një zyrtar) së shtetit të origjinës ku deklarohet se marrëveshja me ndërmjetësim, ose një pjesë e saj, është e zbatueshme në të njëjtën mënyrë si vendimi gjyqësor në shtetin e origjinës.

301. Paragrafi 1(a) kërkon paraqitjen e një kopjeje të plotë dhe të noterizuar të vendimit. Një “vendim” përfshin, sipas rastit, arsyetimin e gjykatës dhe jo vetëm urdhrin e formës së prerë (*dispozitivin*).²²⁵ Nëse vendimi është dhënë në mungesë, paragrafi 1(b) kërkon paraqitjen e një kopjeje origjinale dhe një të noterizuar të dokumentit që provon se dokumenti me të cilin nisi procesi gjyqësor apo një dokument i njëvlershëm i është bërë i ditur palës së munguar. Nga ana tjetër, nëse vendimi nuk është dhënë në mungesë, është supozuar se i padituri është njoftuar, përveç rasteve kur ai paraqit prova për të kundërtën (shih, neni 7(1)(a)). Paragrafi 1(c) kërkon paraqitjen e çdo dokumenti të nevojshëm për të provuar se ai vendim ka hyrë në fuqi, sipas rastit, dhe është i zbatueshëm në Shtetin e origjinës. Në parim, kjo bëhet e ditur nga gjykata e origjinës në formularin e rekomanduar të përgatitur nga Byroja e Përhershme e KHDNP-së (shih, para. 3). Gjithashtu, mund të përdoren edhe mjete të tjera prove, në përputhje me rregullat procedurale të Shtetit të kërkuar, *për shembull*, deklarata zyrtare apo opinione ligjore.²²⁶ Në rastin e marrëveshjeve me ndërmjetësim, paragrafi 1(d) kërkon paraqitjen e një vërtetimi nga një gjykatë e Shtetit të origjinës, duke përfshirë një nga një punonjësi i gjykatës,²²⁷ ku të thuhet

dhe me nenin 29(1) të projekt Konventës paraprake të 1999.

²²⁴ Raporti Hartley/Dogauch, para. 210, e kufizon këtë kërkesë në rrethanat kur “pala tjetër e kundërshton njohjen e një vendimi”. Kjo, gjithsesi, nuk i përjashton palët e treta apo autoritetet lokale (për shembull, një regjistra) që t'i kërkojnë këto dokumente.

²²⁵ Raporti Hartley/Dogauch, para. 211.

²²⁶ Për të siguruar efikasitetin e Konventës, Shtetet kontraktuese duhet të parashikojnë disa mjete për përmbushjen e kësaj kërkesë.

²²⁷ Referenca ndaj një punonjësi të gjykatës në nenin 12(1)(d) nuk është në dispozitën paralele të Konventës KHDNP 2005 për Zgjedhjen e Gjykatës (shih, neni 13(1)(e)). Sesioni njëzetë e dy nuk gjeti ndonjë arsye të veçantë për ta përjashtuar këtë mundësi, e cila parashikohet në nenin 12(3) dhe në

se zgjidhja, apo një pjesë e saj është e zbatueshme në të njëjtën mënyrë si një vendim gjyqësor në Shtetin e origjinës (shih, *supra*, para. 295-296). Ky vërtetim mund të lëshohet nga një gjykatë tjetër nga gjykata e përfshirë në zgjidhje.

302. Raporti Hartley/Dogauchi sqaron dy çështje në lidhje me paragrafin 1. Së pari, ligji i Shtetit të kërkuar përcakton pasojat e mosparaqitjes së dokumenteve të kërkuara. Së dyti, formalizmi i tepruar duhet të shmanget. Nëse debitori objekt i vendimit nuk është cenuar nga mungesa e dokumenteve, kreditori objekt i vendimit duhet lejuar t'i korrigjojë mosveprimet.²²⁸

Paragrafi 2 – Nëse kushtet e vendimit gjyqësor nuk lejojnë që gjykata, së cilës i është drejtuar pala, të verifikojë nëse janë përmbushur kushtet e këtij Kapitulli, ajo gjykatë mund të kërkojë çdo dokument të nevojshëm.

303. Paragrafi 2 parashikon se gjykata e kërkuar mund të kërkojë paraqitjen e dokumenteve thelbësore për të verifikuar nëse kushtet e Kapitullit II të Konventës janë përmbushur. Kjo tregon se lista e dokumenteve që përmban paragrafi 1 nuk është shteruese. Por, gjithsesi, barrët e panevojshme për palët duhen shmangur.

Paragrafi 3 – Kërkesa për njohjen ose zbatimin mund të shoqërohet me dokumentin që ka të bëjë me vendimin gjyqësor, të nxjerrë nga gjykata (lëshuar dhe nga një zyrtar) e shtetit të origjinës, në formën e rekomanduar dhe të botuar nga Konferenca e Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private.

304. Paragrafi 3 parashikon se një kërkesë për njohje apo zbatim mund të shoqërohet me formularin e rekomanduar dhe të publikuar nga KHDNP-ja.²²⁹ Ky formular lëshohet nga një gjykatë (duke përfshirë edhe nga një punonjës i asaj gjykate) e Shtetit të origjinës. Konventa nuk kërkon që gjykata që jep formularin të jetë gjykata që ka dhënë vendimin. Ndonëse Shteteve nuk u kërkohet ta miratojnë këtë formular, përdorimi i tij mund të lehtësojë procesin e njohjes apo zbatimit. Nëse përdoret formulari, gjykata e kërkuar mund të mbështetet në informacionin që ai përmban në mungesë të një kundërshtimi. Por, edhe nëse nuk ka ndonjë kundërshtim, informacioni nuk është përfundimtar; gjykata e kërkuar mund të vendosë për lëndën në bazë të të gjitha provave që ka përpara.²³⁰

dispozitën paralele të Konventës KHDNP të 2005 për Zgjedhjen e Gjykatës (shih, neni 13(3)). Si rezultat, referenca ndaj një punonjësi të gjykatës në nenin 12(1)(d) u përfshi, por pa pasur qëllim që të largohet nga KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës.

²²⁸ Raporti Hartley/Dogauch, para. 211.

²²⁹ Formulari gjendet në faqen e internetit të KHDNP < www.KHDNP.net > tek "Vendime gjyqësore".

²³⁰ Raporti Hartley/Dogauch, para. 213.

305. Formulari përfshin një seksion për marrëveshjet me ndërmjetësim. Kur formulari përdoret në lidhje me një marrëveshje me ndërmjetësim, ai e përmbush kërkesën si vërtetim sipas paragrafit 1(d).

Paragrafi 4 – Nëse dokumentet e përmendura në këtë nen nuk janë në një gjuhë zyrtare të Shtetit të kërkuar, ato shoqërohen me përkthimin e noterizuar në një gjuhë zyrtare, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligjin e Shtetit të kërkuar.

306. Paragrafi 4 trajton gjuhën e dokumenteve të listuara në nenin 12. Nëse dokumentet nuk janë në gjuhën zyrtare të Shtetit të kërkuar, ato duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në një gjuhë zyrtare, përveç kur Shteti i kërkuar e parashikon ndryshe. Si rrjedhojë, ky Shtet mund të parashikojë që përkthimi nuk është aspak i nevojshëm, sepse një përkthim i pavërtetuar është i mjaftueshëm.
307. Ndryshe nga KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës, (shih, neni 18), kjo Konventë nuk përfshin një dispozitë për përjashtimin e legalizimit. Si rrjedhojë, vërtetimi i një dokumenti të huaj ligjor (*pra*, legalizimi apo vula apostile) rregullohet nga rregullat e Shtetit të kërkuar, duke përfshirë konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga ai Shtet.

Neni 13
Procedura

1. Procedura për njohjen, deklarin e zbatueshmërisë ose regjistrimin për zbatim, dhe zbatimin e vendimit gjyqësor rregullohet nga ligji i Shtetit të kërkuar, përveç rasteve kur në këtë Konventë parashikohet ndryshe. Gjykata e Shtetit të kërkuar vepron me shpejtësi.
2. Gjykata e Shtetit të kërkuar nuk e refuzon njohjen ose zbatimin e vendimit gjyqësor sipas kësaj Konvente, me arsyetimin se njohja ose zbatimi do të duhet të kërkohet në një shtet tjetër.

Paragrafi 1 – Procedura për njohjen, deklarin e zbatueshmërisë ose regjistrimin për zbatim, dhe zbatimin e vendimit gjyqësor rregullohet nga ligji i Shtetit të kërkuar, përveç rasteve kur në këtë Konventë parashikohet ndryshe. Gjykata e Shtetit të kërkuar vepron me shpejtësi

308. Paragrafi 1 parashikon se procedura për njohjen, deklarin e zbatueshmërisë apo regjistrimit të zbatimit dhe ekzekutimi i vendimit, rregullohen nga një ligj i Shtetit të kërkuar, përveç kur Konventa e parashikon ndryshe. Kështu, ligji i Shtetit të kërkuar përcakton nëse njohja bëhet automatikisht apo kërkon një procedurë të posaçme. Kur ligji i Shtetit të kërkuar nuk kërkon një procedurë të posaçme për njohjen e një vendimi të huaj, një vendim gjyqësor do të njihet automatikisht, *pra*, përmes veprimit të ligjit, në bazë të nenit 4 të Konventës.²³¹

309. **Procesi i zbatimit.** Neni 13 u referohet fazave të dallueshme të procesit të zbatimit në Shtetin e kërkuar.²³² Në shumë shtete, zbatimi duhet të bëhet me dy faza: së pari, procesi duhet të fillohet nga kreditori objekt i vendimit, për marrjen nga autoriteti kompetent në Shtetin e kërkuar të një konfirmimi apo deklarimi se ai vendim i huaj është i zbatueshëm në atë Shtet. Një deklarim i tillë për zbatim është quajtur “*exequatur*” në shumë shtete. Në Shtete të tjera, duhet të ketë një procedurë regjistrimi. Faza e dytë e zbatimit i referohet procedurës ligjore përmes të cilës Gjykatat (apo autoritetet kompetente) e Shtetit të kërkuar sigurojnë që debitori objekt i vendimit t’i bindet vendimit të huaj. Ai përfshin masa të tilla si sekuestrimi, konfiskimi, urdhri për të qenë në varësi të gjykatës, (attachment), ose

²³¹ Po aty,, para. 215.

²³² Vini re gjithashtu se, në dispozitat e tjera e Konventës, termi “zbatim” është përdorur në kuptimin e “deklarimit të zbatueshmërisë ose regjistrimit për zbatim” (shih, *për shembull*, neni 5 ose 7).

shitja gjyqësore. Kjo fazë e dytë – shpesh e përmendur si “përmbartimi” i vendimit – presupozon një deklaratë zbatueshmërie apo regjistrimin e zbatimit. Posa që faza e parë ka përfunduar, origjina e huaje vendimit nuk është më me rëndësi dhe kreditori objekt i vendimit do të ketë qasje në të njëjtat masa zbatimi (faza e dytë e zbatimit) në Shtetin e kërkuar që do të ishin të disponueshme për një vendim të brendshëm. Në Shtete të tjera, këto dy faza mund të kombinohen në një proces të vetëm ku gjykata mund të japë një deklaratim për zbatueshmërinë e vendimit të huaj dhe në të njëjtën kohë të urdhërojë masat e zbatimit. Pavarësisht nga procesi i saktë në një Shtet të dhënë, paragrafi 1 ia nënshtron të dyja fazat procesit të zbatimit në ligjin e Shtetit të kërkuar.

310. **Afati i parashkrimit.** Kur i referohet procedurës së zbatimit, neni 13 ka për synim të përfshijë rregulla të ligjit të Shtetit të kërkuar që parashikojnë një periudhë parashkrimi për zbatimin e një vendimi gjyqësor.²³³ Rregulla të tilla janë të zbatueshme, përveç kur sikundër mund të jetë shprehur shprehimisht neni 13, “Konventa e parashikon ndryshe”. Konventa parashikon, në nenin 4(3), se zbatimi në Shtetin e kërkuar varet nga vendimi që po zbatohet në Shtetin e origjinës. Si pasojë, një periudhë më e gjatë parashkrimi për zbatim në Shtetin e kërkuar nuk e zgjat afatin e zbatueshmërinë e një vendimi të huaj që nuk është më i zbatueshëm në Shtetin e origjinës.²³⁴
311. Gjithsesi, kjo nuk trajton rastin kur një afat më i shkurtër parashkrimi është i zbatueshëm për zbatimin e vendimeve gjyqësore në Shtetin e kërkuar. Një kreditor objekt i vendimit gjyqësor mund të kërkojë që procesin e zbatimit ta sjellë në Shtetin e kërkuar gjatë periudhës së zbatueshmërisë së vendimit, sipas ligjit të Shtetit të origjinës, por vetëm pasi ka përfunduar afati i parashkrimit për zbatim sipas ligjit të Shtetit të kërkuar. Edhe nëse vendimi i huaj mbetet i zbatueshëm sipas ligjit të Shtetit të origjinës, neni 13 nuk e pengon përdorimin e një afati më të shkurtër parashkrimi për zbatimin e një vendimi gjyqësor, sipas ligjit të Shtetit të kërkuar. Për shembull, nëse sipas ligjit të Shtetit të origjinës (Shteti A), vendimi është i zbatueshëm për 15 vite, por ligji i Shtetit të kërkuar (Shteti B) vendos një

²³³ Afati i parashkrimit i përmendur këtu lidhet vetëm me zbatimin e një vendimi të huaj dhe si koncept nuk duhet ngatërruar me afati e parashkrimit që rregullon të drejtën fillestare materiale ose padinë në diskutim, *pra*, afati i parashkrimit për të ngritur një padi për themel përpara një gjykate. Kjo çështje lidhet me themelin e vendimit të dhënë nga gjykata e origjinës dhe mund të mos shqyrtohet nga Shteti i kërkuar në përputhje me nenin 4(2).

²³⁴ Afate të dallueshme parashkrimi mund të përdoren sipas ligjit të brendshëm për të dy fazat e zbatimit. Një afat fillestar parashkrimi mund të përdoret lidhur me afatin kohor për nisjen e procesit për të kërkuar një deklaratim apo konfirmimin e zbatueshmërisë (kjo mund të përdoret njëjloj në ato Shtete ku të dy fazat janë bashkuar në një proces të vetëm). Me t'u marrë ai vendim, zbatimi i tij në praktikë mund t'i nënshtrohet një afati të ndryshëm parashkrimi. Në një rast të tillë, zbatimi real i vendimit në Shtetin e kërkuar mund të jetë i mundshëm përtej afatit të parashkrimit në Shtetin e origjinës. Kjo mund të shpjegohet me faktin që posa që një vendim gjyqësor është shpallur i zbatueshëm sipas Konventës në Shtetin e kërkuar, vendimi bëhet i barasvlershëm me një vendim të brendshëm dhe Konventa nuk përdoret më për zbatim e tij në Shtetin e kërkuar.

afat 5 vjeçar, ky i fundit ka të drejtë të ketë përparësi. Kjo do të thotë se, posa që ky afati i fundit ka përfunduar, vendimi i dhënë në Shtetin A nuk do të jetë më i zbatueshëm në Shtetin B.

312. Referenca ndaj ligjit të Shtetit të kërkuar në nenin 13 nuk duhet kuptuar patjetër si një referencë e drejtpërdrejt ndaj ligjit të tij të brendshëm. Në fakt, ligji i Shtetit të kërkuar mund që në vend të kësaj të përcaktojë afatin përkatës të parashkrimit, duke iu referuar përsëri ligjit të Shtetit të origjinës, ose edhe të zbatojë afatin e parashkrimit që rregullon të drejtën materiale mbi të cilën është dhënë vendimi. Qasjet ndaj kësaj çështjeje ndryshojnë shumë midis juridiksioneve të ndryshme dhe Konventa nuk mban asnjë qëndrim lidhur me mënyrën se si afati i zbatueshëm i parashkrimit përcaktohet sipas ligjit të Shtetit të kërkuar. Ky interpretim është i nevojshëm për të siguruar një trajtim të barabartë të Shteteve në lidhje me afatin e parashkrimit të një çështjeje.
313. **Parimi i përgjithshëm sipas të drejtës së traktateve.** Pavarësisht nga paragrafët e mëparshëm, referenca ndaj ligjit të Shtetit të kërkuar nuk është një referencë e përgjithshme. Në përputhje me nenin 31(1) të Konventës së Venës së 1969, një traktat duhet interpretuar “me mirëbesim, në përputhje me kuptimin e zakonshëm që u duhet dhënë kushteve të traktatit në kontekstin e tyre dhe në dritën e fushës së veprimit dhe qëllimit të tij”. Një element thelbësor për të siguruar efektivitetin e Konventës (shih, para. 2 i Hyrjes së saj) është parimi i mosdiskriminimit: vendimet gjyqësore të dhëna në Shtete të tjera, posa që përcaktohen si të ekzekutueshme sipas Konventës, duhen trajtuar në të njëjtën mënyrë si vendimet gjyqësore të brendshme. Ky parim ka implikime në afatet e parashkrimit. Në veçanti, një ligj i brendshëm që parashikon afate më të shkurtra parashkrimi për zbatimin e vendimeve të huaja gjyqësore se sa për vendimet gjyqësore të brendshme, nuk do të ishte në përputhje me këtë parim. Në të njëjtën mënyrë, kur ligji i Shtetit të kërkuar vendos një rregull të posaçëm për afatin e parashkrimit lidhur me shpalljen e zbatueshmërisë së vendimeve të huaja gjyqësore, një afat i paarsyeshëm i shkurtër mund të jetë i papajtueshëm me parimin e efektivitetit të Konventës.
314. Paragrafi 1 gjithashtu parashikon se në procese të mbuluara nga kjo dispozitë, Gjykatat (ose autoritetet kompetente) të Shtetit të kërkuar duhet të veprojnë me shpejtësi. Shtetet duhet të marrin parasysh dispozitat e saj për të shmangur vonesat e panevojshme.²³⁵
315. **Kërkesa për refuzim.** Neni 13 i referohet vetëm një procedure për njohjen, shpalljen e zbatueshmërisë apo regjistrimin për ekzekutim. Por, ai nuk i përjashton Shtetet nga parashikimi i kërkesave *për refuzimin* e njohjes apo zbatimit. Kështu, Shtetet mund të parashikojnë që debitori subjekt i një vendimi gjyqësor të kërkojë shpalljen e mosnjohjes (ose të mos zbatueshmërisë) së një vendimi gjyqësor të dhënë në një Shtet tjetër, në bazë të faktit që ai vendim nuk i plotëson kushtet për njohje sipas nenit 5 ose 6, ose për një nga shkaqet e përmendura në nenin 7.

²³⁵ Raporti Hartley/Dogauch, para. 216.

Paragrafi 2 – Gjykata e Shtetit të kërkuar nuk e refuzon njohjen ose zbatimin e vendimit gjyqësor sipas kësaj Konvente, me arsyetimin se njohja ose zbatimi do të duhet të kërkohej në një shtet tjetër

316. Paragrafi 2 parashikon që gjykata e Shtetit të kërkuar nuk duhet ta refuzojë njohjen apo zbatimin e një vendimi gjyqësor sipas Konventës, për shkakun se njohja apo zbatimi duhet të kërkohej në një Shtet tjetër. Kjo e pengon një gjykatë të refuzojë me arsyen që, për shembull, ka një forum alternativ ku njohja apo zbatimi i vendimit është më i përshtatshëm dhe më i volitshëm.
317. Sipas Konventës, kreditori objekt i vendimit mund të kërkojë njohjen apo zbatimin e vendimit në çdo Shtet. Edhe nëse kjo kërkon një kosto më të madhe, një kreditor objekt i vendimit gjyqësor mund të ketë një interes të ligjshëm në kërkimin e zbatimit të një vendimi gjyqësor në më shumë se një Shtet, siç ndodh me sigurimet e padive në gjithë botën, apo me rastet e vendimeve gjyqësore monetare kundër një palë me pasuri në Shtete të ndryshme, por që secili më vete është i pamjaftueshëm për të shlyer vendimin.
318. Ekzistenca e qasjeve të ndryshme ndaj çështjes së trajtuar në këtë paragraf shpjegon nevojën për këtë dispozitë. Në shumë sisteme ligjore, zbatimi nuk kërkon një bazë për juridiksion, *pra*, një lidhje të veçantë midis debitorit objekt i vendimit dhe Shtetit të kërkuar, siç është prania e pasurive të debitorit në atë Shtet. Thjesht interesi i kreditorit objekt i vendimit është i mjaftueshëm.
319. Nga ana tjetër, në sisteme të tjera ligjore, zbatimi i një vendimi të huaj nuk kërkon një bazë për juridiksion, siç është vendqëndrimi i rregullt i debitorit objekt i vendimit, ose prania e pasurive të debitorit, objekt i vendimit, në Shtetin e kërkuar. Në disa prej këtyre sistemeve ligjore, debitori objekt i vendimit mund edhe ta kundërshtojë *exequatur* në bazë të doktrinës *forum non conveniens*, *pra*, të argumentimit se zbatimi duhet të kërkohej në një Shtet tjetër, më të përshtatshëm dhe të volitshëm. Mosmarrëveshje të tilla mund t'i vonojnë procedurat gjyqësore dhe të bëhen të lodhshme për kreditorin objekt i vendimit. Paragrafi 2 i drejtohet këtij grupi sistemesh ligjore dhe vendos një përjashtim nga paragrafi 1. Megjithëse procedurat për njohjen, shpalljen e zbatueshmërisë apo regjistrimin për ekzekutim dhe zbatimin e vendimit rregullohen nga ligji i Shtetit të kërkuar, Gjykatat e Shtetit të kërkuar nuk mund ta refuzojnë njohjen apo zbatimin e një vendimi gjyqësor sipas Konventës, me shkakun se ai duhet të kërkohej në një Shtet tjetër. Në praktikë, kjo e pengon mbështetjen në doktrinën e *forum non conveniens* si një shkak për të refuzuar njohjen apo zbatimin.

Neni 14
Kostot e procedurës

1. **Asnjë garanci, obligacion ose depozitë, sido që të përshkruhet, nuk kërkohet nga një palë që aplikon në një Shtet Kontraktues për zbatimin e vendimit gjyqësor, të dhënë nga gjykata e një Shteti tjetër Kontraktues me arsyetimin e vetëm se pala e tillë është shtetase e huaj, ose nuk është me vendbanim ose me vendqëndrim në shtetin në të cilin kërkohet zbatimi.**
2. **Urdhri për pagesën e kostove ose shpenzimeve të procedurës, i lëshuar në Shtetin Kontraktues ndaj çdo personi të përjashtuar nga kërkesat për garancinë, dorëzanimin ose depozitën, në bazë të paragrafit 1 ose në bazë të ligjit të shtetit ku janë filluar procedurat, bëhet i zbatueshëm në çdo Shtet Kontraktues tjetër, me paraqitjen e kërkesës nga personi që ka të drejtë të përfitojë nga urdhri.**
3. **Shteti mund të deklarojë se nuk e zbaton paragrafin 1 ose të përcaktojë përmes një deklarimi se cila nga gjykatat e tij nuk e zbaton paragrafin 1.**

320. Neni 14 trajton garancinë që mund të kërkohet për të garantuar pagesën e kostove të procedurës, duke përfshirë deklarimin e zbatueshmërisë apo regjistrimin për zbatimin dhe ekzekutimin e vendimit.²³⁶ Dispozita pasqyron një kompromis. Disa Shtete mbështetën rregullën “pa garanci”. Shtete të tjera parapëlqyen që këtë çështje t’ia linin ligjit të brendshëm. Qasja e parë pasqyrohet në paragrafët e parë dhe të dytë, ndërsa qasja e dytë pasqyrohet në paragrafin e tretë me anë të një mekanizmi për moszgjedhjen e asnjërës qasje.

Paragrafi 1 – Asnjë garanci, obligacion ose depozitë, sido që të përshkruhet, nuk kërkohet nga një palë që aplikon në një Shtet Kontraktues për zbatimin e vendimit gjyqësor, të dhënë nga gjykata e një Shteti tjetër Kontraktues me arsyetimin e vetëm se pala e tillë është shtetase e huaj, ose nuk është me vendbanim ose me vendqëndrim në shtetin në të cilin kërkohet zbatimi.

²³⁶

Nuk ka dispozitë të barasvlershme në KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës.

321. Paragrafi i parë i nenit 14 pasqyron një pikëpamje tradicionale se kërkuesit nuk i duhet kërkuar asnjë garanci, dorëzani apo depozitë për arsyen e vetme se ai është shtetas i një Shteti tjetër, ose sepse vendqëndrimi i rregullt apo vendbanimi i tij është në një Shtet tjetër.²³⁷ Paragrafi 1 e ndalon kërkesën për garanci vetëm në bazë të këtyre shkaqeve. Një kërkesë për garanci është pra e lejueshme për shkaqe të tjera, *për shembull*, kur kreditori objekt i vendimit nuk ka pasuri në Shtetin e kërkuar. Klauzola zbatohet si për personat fizikë edhe juridikë, pavarësisht nëse janë shtetas të një Shteti tjetër kontraktues, apo të një Shteti të tretë (ose nëse e kanë vendqëndrimin e rregullt apo vendbanimin në një Shtet tjetër kontraktues ose në një Shtet të tretë).²³⁸

Paragrafi 2 – Urdhri për pagesën e kostove ose shpenzimeve të procedurës, i lëshuar në Shtetin Kontraktues ndaj çdo personi të përjashtuar nga kërkesat për garancinë, dorëzanimin ose depozitën, në bazë të paragrafit 1 ose në bazë të ligjit të shtetit ku janë filluar procedurat, bëhet i zbatueshëm në çdo Shtet Kontraktues tjetër, me paraqitjen e kërkesës nga personi që ka të drejtë të përfitojë nga urdhri.

322. Paragrafi i dytë i nenit 14 është rrjedhojë e “rregullës pa garanci”. Ai mbron debitorin objekt i vendimit kur zbatimi i vendimit është refuzuar dhe kur është lëshuar një urdhër për pagimin e kostove apo shpenzimeve kundër kreditorit objekt i vendimit. Sipas paragrafit 2, një urdhër i tillë futet në fushën e veprimit të Konventës dhe është i zbatueshëm në çdo Shtet tjetër. Kjo dispozitë e veçantë kërkohet sepse një urdhër i tillë për kostot ndryshe nuk do të merrej në konsideratë si një vendim gjyqësor për qëllimet e Konventës. Sipas nenit 3(1)(b), vetëm urdhrat për pagimin e kostove apo shpenzimeve, që lidhen me një “vendim për themel që mund të njihet apo zbatohet sipas Konventës”, plotësojnë kushtet për zbatim sipas Konventës. Një vendim për zbatimin e një vendimi të huaj nuk është një “vendim për themel” në kuptimin e nenit 3(1)(b). Megjithëse zbatimi i një urdhri për pagesën e kostove apo shpenzimeve lejohet sipas nenit 14(2), ai mund të refuzohet për shkaqet e paraqitura në nenin 7 të Konventës.
323. Ky paragraf zbatohet në dy situata. Së pari, ai zbatohet kur është miratuar një përjashtim nga garancia për kostot në përputhje me paragrafin 1. Kjo presupozon se ligji i Shtetit të kërkuar kërkon, përgjithësisht, garanci për kostot e zbatimit të vendimeve të huaja gjyqësore me shkakun e shtetësisë, vendbanimit apo vendqëndrimit të rregullt të kreditorit objekt i vendimit, por që përjashtimi të jetë dhënë në sajë të paragrafit 1, *pra*, për vendime gjyqësore të dhëna në një Shtet tjetër kontraktues. Ky përjashtim mund të dalë automatikisht përmes veprimit të ligjit, ose rast pas rasti, me vendim të gjykatës së kërkuar. Së dyti, ky paragraf zbatohet kur një garanci e tillë në fakt nuk ekziston sipas ligjit të Shtetit të kërkuar,

²³⁷ Raporti Nygh/Pocar, para. 356.

²³⁸ Viri re se në këtë dispozitë, termi “banor” nuk vihet në diskutim nga mbiemri “i rregullt”. Kjo mund të shpjegohet me faktin që ky nen riprodhon fjalinë e parë të nenit 14 të KHDNP-së, *Konventa e 25 tetorit 1980 për qasjen ndërkombëtare në drejtësi* (më poshtë “KHDNP 1980, Konventa për qasjen në drejtësi”), i cili përdor të njëjtin formulim.

pra, kur ligji i Shtetit të kërkuar nuk kërkon garanci për kostot vetëm bazuar në shtetësinë e huaj, vendbanimin apo vendqëndrimin e rregullt të kreditorit objekt i vendimit. Natyrisht, këto Shtete duhet gjithashtu të marrin përfitimet e plota të kësaj dispozite, në kuptimin që urdhrat e gjykatës së tyre për kostot gjithashtu të qarkullojnë sipas Konventës. Fjalët “ose të ligjit të Shtetit ku procesi ka nisur” pasqyrojnë këtë situatë të dytë.²³⁹

Paragrafi 3 – Shteti mund të deklarojë se nuk e zbaton paragrafin 1 ose të përcaktojë përmes një deklarimi se cila nga gjykatat e tij nuk e zbaton paragrafin 1.

324. Së fundi, paragrafi i tretë parashikon një mekanizëm deklarimi për të mos zbatuar rregullën pa garanci. Një Shtet mund të deklarojë se ai nuk do ta zbatojë paragrafin 1 në disa apo në të gjitha gjykatat e tij. Kështu, është e mundur të përjashtohet zbatimi i paragrafit 1 për disa gjykata, *për shembull*, për gjykatat federale, por jo gjykatat e një Shteti.
325. Neni 14 nuk e sqaron se si parimi i reciprocitetit do të përdoret kur një Shtet bën një deklaram sipas paragrafit 3. Nëse origjina e vendimit merret si pikë referimi, kur vendimi është dhënë nga gjykata e një Shteti që ka bërë deklaramin, kreditori objekt i vendimit nuk duhet të përfitojë nga rregulla pa garanci e paragrafit 1. Paragrafi i dytë nuk duhet të përdoret për urdhra lidhur me kostot, të dhëna nga një gjykatë e Shtetit që ka bërë deklaramin, kur ajo gjykatë ka vendosur garanci për kostot.²⁴⁰

²³⁹ Shih, Neni 15 i KHDNP 1980, Konventa për qasjen në drejtësi.

²⁴⁰ Natyrisht, kjo ka gjasa të ndodhë vetëm kur garancia për kostot është e pamjaftueshme për të mbuluar urdhrin për kostot në tërësi.

Neni 15***Njohja dhe zbatimi sipas të ligjit të brendshëm***

Në varësi të nenit 6, kjo Konventë nuk parandalon njohjen ose zbatimin e vendimeve gjyqësore sipas ligjit të brendshëm.

326. Neni 15 trajton mënyrën se si Konventa lidhet me ligjin e brendshëm, duke parashikuar që, në varësi të nenit 6, Konventa nuk e pengon njohjen apo zbatimin e vendimeve gjyqësore sipas ligjit të brendshëm. Kjo dispozitë është e bazuar në parimin e *favorizimit të njohjes*. Nëse një vendim gjyqësor mund të mos njihet apo zbatohet sipas Konventës, sepse, *për shembull*, nuk i plotëson kushtet sipas nenit 5, një palë përsëri mund të kërkojë njohjen apo zbatimin e tij sipas ligjit të brendshëm. Me fjalë të tjera, Konventa vendos një standard minimal për njohjen apo zbatimin e ndërsjellë të vendimeve gjyqësore, por Shtetet mund të shkojnë edhe më tej. Nëse një vendim gjyqësor nuk i plotëson kushtet për njohje apo zbatim sipas Konventës, ligji i brendshëm i Shtetit të kërkuar përcakton nëse një palë mund ta përdorë ligjin e brendshëm “si një të tërë” apo mund të marrë dispozita nga të dy sistemet.
327. Gjithsesi, Neni 6 nuk lejon që ligji i brendshëm të përdoret për miratimin e njohjes apo zbatimit të një vendimi gjyqësor që shkel bazën ekskluzive të juridiksionit në atë dispozitë (shih, *supra*, para. 231).

KAPITULLI III – KLAUZOLA TË PËRGJITHSHME**Neni 16**
Dispozita kalimtare

Kjo Konventë zbatohet për njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore nëse, në kohën kur filluan procedurat në shtetin e origjinës, Konventa kishte hyrë në fuqi mes atij shteti dhe Shtetit të kërkuar.

328. Neni 16 trajton zbatimin kohor të Konventës. Konventa zbatohet nëse, në kohën që kanë filluar procedurat gjyqësore në Shtetin e origjinës, Konventa ndërkohë ishte në fuqi për atë Shtet dhe Shtetin e kërkuar. Gjykata e kërkuar duhet të verifikojë (i) datën kur procedurat gjyqësore kanë filluar në Shtetin e origjinës (shih *supra*, para. 41) dhe (ii) nëse në atë kohë Konventa ishte në fuqi midis Shtetit të origjinës dhe Shtetit të kërkuar. Neni 16 bazohet kështu në parimin e mosretroaktivitetit. Kjo zgjidhje parashikon sigurinë ligjore. Të gjitha palët duhet të jenë në gjendje të përcaktojnë, përpara fillimit të procesit, nëse vendimi i ardhshëm do të qarkullojë sipas Konventës dhe të përgatitin strategjitë procedurale përkatësisht.
329. Përcaktimi i zbatimit kohor të Konventës është i ndryshëm nga çështja e hyrjes së saj në fuqi (shih *infra*, neni 28) dhe vendosja e marrëdhënieve midis dy Shteteve kontraktuese (shih *infra*, neni 29). Meqenëse Konventa vepron vetëm midis dy Shteteve kontraktuese (shih, *supra*, neni 1(2)), neni 16 presupozon se (i) Konventa ka hyrë në fuqi (Neni 28) dhe (ii) se as Shteti i origjinës dhe as Shteti i kërkuar nuk e kanë kundërshtuar vendosjen e marrëdhënieve me njëri tjetrin sipas nenit 29, pra, ai presupozon se Konventa “ka efekt” midis Shtetit të origjinës dhe Shtetit të kërkuar.
330. **Shembull.** Shteti A ratifikon Konventën në prill 2020 dhe Shteti B në maj 2020. Sipas neneve 28 dhe 29(1), nëse asnjëri prej tyre nuk bën deklaram sipas nenit 29(2) ose 29(3), Konventa do të hyjë në fuqi dhe do të ketë efekt midis atyre dy Shteteve në 1 qershor 2021 (shih, *infra*, para. 401). Në bazë të nenit 16, ajo do të përdoret për njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore që rrjedhin nga procese gjyqësore që fillojnë në apo pas asaj date.

Neni 17

Deklarimet që kufizojnë njohjen dhe zbatimin

Një shtet mund të deklarojë se gjykatat e tij mund të refuzojnë të njohin ose të zbatojnë një vendim gjyqësor, të dhënë nga një gjykatë e një Shteti Kontraktues tjetër, nëse palët kanë qenë me vendqëndrim të rregullt në Shtetin e kërkuar, dhe marrëdhëniet e palëve dhe të gjithë elementet e tjera të rëndësishme për mosmarrëveshjen, të ndryshme nga vendndodhja e gjykatës së origjinës, kanë qenë të lidhura vetëm me Shtetin e kërkuar.

331. Neni 17 parashikon se një Shtet mund të deklarohet se gjykatat e tij mund të refuzojnë të njohin apo ekzekutojnë një vendim gjyqësor të dhënë nga një gjykatë e një Shteti tjetër, nëse palët kanë qenë banorë në Shtetin e kërkuar dhe marrëdhënia e palëve dhe të gjithë elementët e tjerë që kanë lidhje me mosmarrëveshjen (përveç vendndodhjes së gjykatës së origjinës) kanë pasur lidhje vetëm me Shtetin e kërkuar. Kjo dispozitë është nga KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës (shih Neni 20).
332. **Baza logjike.** Neni 17 trajton situatat që, nga këndvështrimi i Shtetit të kërkuar, janë tërësisht të brendshme. Ai e lejon një Shtet që të çlirohet nga detyrimi për të njohur dhe zbatuar një vendim gjyqësor sipas Konventës në këto raste. Faza e parë, instrumentet e KHDNP-së përdoren vetëm për lëndët ndërkombëtare. Gjithsesi, për qëllimet e njohjes apo zbatimit, një lëndë është gjithnjë ndërkombëtare, nëse vendimi është dhënë nga një gjykatë në një Shtet tjetër nga ai në të cilin kërkohet njohja apo zbatimi. Megjithatë, mund të ketë skenarë ku ndërkombëtariteti i lëndës është i sajuar nga palët. Disa nga filtrat e parashikuar nga Neni 5 mund të përmbushen në një situatë tërësisht të brendshme, në veçanti, në ato të bazuara në pëlqimin e nënkuptuar apo të shprehur (shih, Neni 5(1)(c), (e), (f), (k), (l), or (m)). Një vendim gjyqësor i dhënë në raste të tilla do të qarkullonte normalisht sipas Konventës edhe kur mosmarrëveshja nuk ka pasur lidhje të tjera me Shtetin e origjinës. Neni 17 pranon se një lëndë e tillë mund të mos jetë një lëndë vërtet ndërkombëtare dhe se, pas një analize të duhur të elementëve lidhës të mosmarrëveshjes, mosmarrëveshja duhet të ishte dëgjuar në Shtetin e kërkuar. Shtetet mund të bëjnë një deklaram për të trajtuar skenarë të tillë.
333. **Koha e përshtatshme.** Koha e përshtatshme për të përcaktuar nëse një situatë është tërësisht e brendshme është koha kur procedurat gjyqësore kanë nisur në Shtetin e origjinës. Kështu, nëse Shteti i kërkuar e ka bërë deklaramin e parashikuar nga neni 17, gjykata e kërkuar duhet të verifikojë nëse, në kohën kur procedurat gjyqësore kanë nisur në Shtetin e origjinës, palët ishin banorë në Shtetin e kërkuar

dhe marrëdhëniet e tyre dhe të gjitha elementët e tjerë me rëndësi gjithashtu ishin të lidhur vetëm me Shtetin e kërkuar.²⁴¹ Vetëm në një rast të tillë gjykata e kërkuar mund të refuzojë të njohë apo ekzekutojë vendimin sipas neni 17.

334. **Shembulli.** Palët janë banorë në Shtetin A dhe të gjithë elementët e tjerë me rëndësi janë të lidhur vetëm me atë Shtet. Njëra nga palët e sjell procesin përpara një gjykate në Shtetin B dhe i padituri argumenton për themelin e çështjes, pa kundërshtuar juridiksionin. Nëse gjykata e Shtetit B jep një vendim gjyqësor për themel, ai vendim do të qarkullojë sipas Konventës (shih, neni 5(1)(f)). Gjithsesi, nëse Shteti A ka bërë deklarin e parashikuar nga neni 17, nuk do t'i kërkohej ta njohë apo zbatojë atë vendim. Gjithsesi, Shtetet e tjera nuk mund të përdorin deklarin e bërë nga Shteti A për refuzimin e njohjes apo zbatimit të vendimit.

²⁴¹ Vini re se kjo dispozitë, sikundër Neni 20 në KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës, nuk përdor termin “vendqëndrimi i rregullt” por thjesht “vendqëndrim”. Në praktikë, kjo nuk ka rëndësi duke qenë se, nëse vendqëndrimi nuk është i përhershëm, kushtet e përdorimit të kësaj dispozite nuk do të plotësohen.

Neni 18

Deklarimet lidhur me çështje specifike

1. Kur një shtet ka interes të fortë për të mos e zbatuar këtë Konventë për një çështje specifike, ai shtet mund të deklarojë se nuk do ta zbatojë Konventën për atë çështje. Shteti që bën një deklaram të tillë siguron që deklarimi nuk është më i gjerë sesa është e nevojshme dhe që çështja specifike e përjashtuar, është përkufizuar qartë dhe me përpikëri.
2. Në lidhje me atë çështje, Konventa nuk aplikohet:
 - (a) në Shtetin Kontraktues që ka bërë deklaramin;
 - (b) në Shtetet Kontraktuese të tjera, ku kërkohet njohja ose zbatimi i vendimit gjyqësor, të dhënë nga një gjykatë e një Shteti Kontraktues që ka bërë deklaramin.

335. Neni 18 i lejon Shtetet t'i zgjerojnë listat e çështjeve të përjashtuara nga fusha e veprimit të Konventës përtej atyre që jepen në nenin 2(1) me anë të një deklarimi. Ai parashikon se, kur një Shtet ka një interes të fortë për të mos e zbatuar Konventën për një çështje specifike, ai mund të deklarojë se nuk do ta bëjë një gjë të tillë.

336. **Baza logjike.** Kjo dispozitë lehtëson ratifikimin e Konventës duke "e zbutur" objektin e zbatimit të saj. Nëse një refuzim i tillë nuk do të ishte i mundur, disa Shtete mund të mos bëheshin palë në Konventë.²⁴² Gjithsesi, kjo politikë duhet të balancohet me interesat e Shteteve të tjera dhe me objektin themelor të vetë Konventës, *pra*, rritja e efektivitetit ndërkufitar të vendimeve gjyqësore në lëndë civile dhe tregtare. Për të arritur një ekuilibër të tillë, neni 18 përmban disa mbrojtje të caktuara.

Paragrafi 1 – Kur një shtet ka interes të fortë për të mos e zbatuar këtë Konventë për një çështje specifike, ai shtet mund të deklarojë se nuk do ta zbatojë Konventën për atë çështje. Shteti që bën një deklaram të tillë siguron që deklarimi nuk është më i gjerë sesa është e nevojshme dhe që çështja specifike e përjashtuar, është përkufizuar qartë dhe me përpikëri

337. **Mbrojtjet.** Së pari, një Shtet duhet të bëjë një deklaram të tillë vetëm kur ka një interes të fortë për ta bërë këtë dhe deklarimi duhet të plotësojë parimin e

²⁴² Shih, gjithashtu, Raporti Hartley/Dogauch, para. 236.

proporcionalitetit, *pra*, objekti i deklarimit nuk duhet të jetë më i gjerë se sa është e nevojshme. Në përputhje me këtë parim, përjashtimi mund të përkufizohet si një referencë ndaj një lënde të caktuar, *për shembull*, “kontrata për prona të patundshme”, “kontrata me konsumatorët”, “kontrata pune”, “për dëmin mjedisor” ose “për anti-trustin”. Një referencë e tillë mund të ngushtohet, *për shembull*, nga: (i) një lidhje e caktuar midis lëndës dhe Shtetit të kërkuar, *për shembull*, “kontrata për një pronë të patundshme të ndodhur në Shtetin e kërkuar”; ose (ii) një lloj i caktuar mjete ligjor që mund të përdoret në atë lëndë, *për shembull*, “sigurime padie në çështje anti-trust”. Kjo qasje është në përputhje me politikën mbi të cilën bazohet dispozita duke qenë se ajo siguron që deklarimi “të mos jetë më i gjerë se sa nevojitet”.²⁴³

338. Së dyti, çështjet specifike të përjashtuara duhet të jenë qartësisht dhe saktësisht të përcaktuara. Kjo siguron që palët dhe Shtetet e tjera të jenë në gjendje të përcaktojnë me lehtësi objektin dhe shtrirjen e deklarimit.²⁴⁴ Sipas nenit 30, çdo deklarim sipas nenit 18 duhet t’i njoftohet depozitarit, i cili do të informojë Shtetet e tjera (Neni 32 (c)). Deklarimet gjithashtu duhet të vihen edhe në faqen e internetit të KHDNP-së për të siguruar transparencë.
339. Konventa nuk kërkon ndonjë formular të veçantë për deklarimet. Gjithsesi, kur një Shtet bën një deklarim ku thotë se Konventa nuk zbatohet për çështje brenda juridiksionit të tij ekskluziv, për shembull, ai duhet të përfshijë një listë të qartë dhe të saktë të këtyre çështjeve.²⁴⁵
340. **Mosretroaktiviteti.** Një deklarim sipas nenit 18 i bërë në kohën që Konventa hyn në fuqi në Shtetin e kërkuar bëhet efektiv njëkohësisht. Por, një deklarim i bërë *pasi* Konventa ka hyrë në fuqi, për Shtetin e kërkuar do të bëhet efektiv në ditën e parë të muajit pas mbarimit të tre muajve pas datës në të cilën njoftimi është marrë nga depozitari (shih, neni 30(4)). Një deklarim i tillë nuk do të përdoret për vendime gjyqësore që rezultojnë nga një proces që ndërkohë ka filluar përpara gjykatës së origjinës kur deklarimi bëhet efektiv (shih Neni 30(5)). Kjo siguron që palët të jenë në gjendje të përcaktojnë, pasi procedurat gjyqësore kanë filluar, nëse vendimi i ardhshëm do të ndikohet apo jo nga ky deklarim.

²⁴³ Vini re se Raporti Hartley/Dogauchi, në para. 235, mund të lexohet sikur sugjeron një interpretim më të rreptë të dispozitës paralele të KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës. I vetmi deklarim i bërë sipas nenit 21 të Konventës KHDNP të 2005 për Zgjedhjen e Gjykatës në këtë pikë është në përputhje me interpretimin e paraqitur në këtë Raport (shih, Deklarimi i Bashkimit Evropian, sipas nenit 21 të Konventës KHDNP të 2005 për Zgjedhjen e Gjykatës, i 11 qershorit 2015, i disponueshëm në faqen e internetit të KHDNP < www.KHDNP.net > në “Seksionin për Zgjedhjen e gjykatës” atëherë “Tabela e statusit”).

²⁴⁴ Raporti Hartley/Dogauchi, në shënimin 274, vë në dukje se kur Shteti që bën deklarimin kështu ka dashur, deklarimi mundet t’i dërgohet së pari si projekt Sekretarit të Përgjithshëm të KHDNP-së për qarkullim në Shtetet e tjera për të bërë komentet e tyre.

²⁴⁵ Shih, *Aide memoire* e Kryetarit të Komisionit të Posaçëm (Komisioni i Posaçëm për Njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja gjyqësore (13-17 nëntor 2017)), para. 23.

Paragrafi 2 – Në lidhje me atë çështje, Konventa nuk aplikohet:

Nënparagrafi (a) – në Shtetin Kontraktues që ka bërë deklarin;

Nënparagrafi (b) – në Shtetet Kontraktuese të tjera, ku kërkohet njohja ose zbatimi i vendimit gjyqësor, të dhënë nga një gjykatë e një Shteti Kontraktues që ka bërë deklarin.

341. **Reciprociteti.** Paragrafi 2 përcakton reciprocitetin për deklarinet e bëra sipas nenit 18(1). Në lidhje me çështje të përjashtuara nga një deklarin, Konventa nuk zbatohet (i) në Shtetin që ka bërë deklarin dhe (ii) në Shtete të tjera ku kërkohet njohja apo zbatimi i një vendimi gjyqësor i dhënë në Shtetin që ka bërë deklarin. Në këtë rastin e fundit, gjithsesi, parimi i reciprocitetit nuk e pengon njohjen apo zbatimin i vendimit sipas ligjit të brendshëm.
342. **Shqyrtimi i deklarimeve.** Neni 21 parashikon që funksionimi i deklarimeve sipas nenit 18 mund të shqyrtohet herë pas here (shih, *infra*, para. 354).

Neni 19

Deklarimet në lidhje me vendimet gjyqësore që i përkasin shtetit

1. Një shtet mund të deklarojë se nuk e zbaton këtë Konventë për vendimet gjyqësore që lindin nga procedurat në të cilat është palë cilado nga palët e mëposhtme:

- (a) ai shtet, ose personi fizik që vepron për atë shtet; ose
- (b) një agjenci qeveritare e atij shteti, ose një person fizik që vepron për një agjenci të tillë qeveritare.

Shteti që bën një deklaram të tillë siguron që deklarimi nuk është më i gjerë sesa është e nevojshme dhe që përjashtimi nga fusha e veprimit është përkufizuar qartë dhe me përpikëri. Deklarimi nuk bën dallimin midis vendimeve gjyqësore kur shteti, një agjenci qeveritare e atij shteti ose një person fizik që vepron për cilindo prej tyre, është i paditur ose paditës në procedurat para gjykatës së origjinës.

2. Njohja ose zbatimi i një vendimi gjyqësor, të dhënë nga një gjykatë e një shteti që ka bërë deklaramin, në pajtim me paragrafin 1, mund të refuzohet nëse vendimi gjyqësor ka lindur si pasojë e procedurave në të cilat është palë qoftë shteti që ka bërë deklaramin, ose Shteti i kërkuar, një nga agjencitë e tyre qeveritare ose një person fizik që vepron për cilindo prej tyre, në të njëjtën masë, siç specifikohet në deklaram.

343. Kjo dispozitë e lejon një Shtet të bëjë një deklaram se ai nuk do ta zbatojë Konventën për vendime gjyqësore që kanë dalë nga një proces në të cilin ai Shtet, një agjenci shtetërore apo një person fizik që vepron për secilin prej tyre, ka qenë palë, edhe pse vendimi lidhet me lëndë civile apo tregtare.

344. **Baza logjike.** Konventa nuk i përjashton vendimet gjyqësore nga fusha e veprimit të saj thjesht sepse një Shtet ka qenë palë në proces (Neni 2(4)). Ndërsa Konventa zbatohet shprehimisht vetëm për lëndë civile apo tregtare (Neni 1(1)), disa delegacione ishin të mendimit se ky kufizim mund të ishte problematik për ta zbatuar lidhur me një Shtet palë, në veçanti, nëse një Shtet palë ka ushtruar të drejta sovraane. Një shqetësim tjetër ishte se ruajtja e imuniteteve në nenin 2(5) mund të ishte e pamjaftueshme për të mbrojtur interesat e Shtetit. Neni 19 u përgjigjet këtyre shqetësimeve duke i lejuar Shtetet të bëjnë deklarime që përjashtojnë zbatimin e Konventës për vendime gjyqësore që kanë rezultuar nga procesi në të cilin një Shtet i tillë ka qenë palë.

Paragrafi 1 – Një shtet mund të deklarojë se nuk e zbaton këtë Konventë për vendimet gjyqësore që lindin nga procedurat në të cilat është palë cilado nga palët e mëposhtme:

Nënparagrafi (a) – ai shtet, ose personi fizik që vepron për atë shtet; ose

Nënparagrafi (b) – një agjenci qeveritare e atij shteti, ose një person fizik që vepron për një agjenci të tillë qeveritare.

Shteti që bën një deklaram të tillë siguron që deklarimi nuk është më i gjerë sesa është e nevojshme dhe që përjashtimi nga fusha e veprimit është përkufizuar qartë dhe me përpikëri. Deklarimi nuk bën dallimin midis vendimeve gjyqësore kur shteti, një agjenci qeveritare e atij shteti ose një person fizik që vepron për cilindo prej tyre, është i paditur ose paditës në procedurat para gjykatës së origjinës.

345. Paragrafi 1 përcakton palët që mund të përfshihen në një deklaram. Sipas paragrafit 1(a) dhe (b), këto përfshijnë vetë Shtetin dhe një agjenci shtetërore të atij Shteti. Gjithashtu ai përfshin një person fizik që vepron për secilin prej tyre,²⁴⁶ por ai nuk përfshin persona juridikë që veprojnë për Shtetin, përveç se kur ata plotësojnë kushtet si agjenci shtetërore.²⁴⁷ Në të gjitha rastet, paragrafi 1 përcakton palët që kanë autoritet të ushtrojnë të drejta sovraane, qoftë drejtpërdrejt apo në mënyrë të deleguar në përgjithësi, ose në një fushë të caktuar, si dhe personat fizikë që veprojnë për ta, pavarësisht nga statusi i punësimit të tyre. Për shembull, një entitet i ngarkuar me zbatimin e ligjit të konkurrencës ose të konsumatorit do të futej në paragrafin 1, pavarësisht nëse është i integruar në strukturën shtetërore apo i themeluar si një entitet autonom dhe i pavarur. Nënndarjet politike të një Shteti (duke përfshirë pushtetin rajonal apo lokal) gjithashtu mund të përfshihen në një deklaram sipas kësaj dispozite. Në thelb, një deklaram sipas këtij neni mund të bëhet vetëm në lidhje me një palë që ka zotësinë për të ushtruar një të drejtë sovraane, edhe nëse ajo mund të angazhohet në veprimtari tregtare. Termat janë të gjerë për të kapur morinë e strukturave dhe përkufizimeve procedurale të personalitetit juridik apo të zotësisë të Shteteve. Paragrafi 1 gjithashtu kërkon që deklarimi të mos jetë më i gjerë se sa është e nevojshme dhe që përjashtimi nga objekti i tij të jetë përcaktuar qartësisht dhe saktësisht. Si rrjedhojë, një Shtet që bën një deklaram sipas nenit 19 duhet të përcaktojë se cilat agjenci shtetërore janë të mbuluara nga deklarimi i tij dhe rrethanat në të cilat ato do të përfshiheshin në të.

346. **Mbrojtjet.** Struktura dhe përmbajtja e nenit 19 është më së shumti paralele me atë të nenit 18. Si në nenin 18, Shteti që bën një deklaram të tillë siguron që ky deklaram

²⁴⁶ Shprehja “që vepron për” është përdorur gjithashtu në nenin 2(4). Ajo mbulon rastet kur person fizik është ai që vepron “në emër të” Shtetit apo të një agjencie shtetërore; faza e parë, personi vepron si një “përfaqësues” i Shtetit. Nga ana tjetër, ajo nuk mbulon ato raste kur personi fizik është ai që vepron në emër të vet, për shembull, që lidh një kontratë me një palë të tretë në emrin dhe me zotësinë e vet, edhe nëse kontrata është në interes të Shtetit.

²⁴⁷ Për një dokumentacion rreth kësaj pjesë të nenit 19(1), shih, Procesverbalet e Sesionit njëzetë e dy për njohjen apo zbatimin e vendimeve të huaja gjyqësore (18 qershor – 2 korrik 2019), Procesverbalet nr. 6, para. 36-43, dhe Procesverbalet nr. 15, para. 155-162, në veçanti, konsensusin për këtë dispozitë se ajo nuk mbulon personat juridikë, pavarësisht nga pronësia e tyre, qofshin ndërmarrje tregtare në pronësi të Shtetit apo në pronësi private, përveç kur janë agjenci shtetërore.

të mos jetë më i gjerë se sa duhet (shih, *supra*, para. 337) dhe që përjashtimi nga objekti i tij të përcaktohet qartë dhe saktë (shih, *supra*, para. 338). Për shembull, deklarimi mund t'i referohet çdo procesi, në lëndë civile apo tregtare, ose vetëm disa kategorive të procesit. Deklarimi mund të kufizohet në disa çështje të caktuara dhe për ta ngushtuar fushën e veprimit të tij, mund të përcaktohen kritere shtesë, *për shembull*, për disa agjenci të caktuara shtetërore, një lidhje e veçantë midis lëndës dhe Shtetit të kërkuar ose lloje të caktuara mjetesh ligjore (shih *supra*, para. 337). Gjithashtu, paragrafi 1 sqaron se deklarimi nuk duhet të bëjë dallim midis vendimeve gjyqësore ku Shteti, një agjenci shtetërore ose një person fizik që vepron për secilin prej tyre, është i paditur ose janë paditës në procedurat gjyqësore përpara gjykatës së origjinës. Për më tepër, ai nuk duhet të bëjë dallim midis vendimeve gjyqësore që varen nga fakti nëse janë vendime për një kreditor objekt i vendimit apo për një debitor objekt i vendimit.²⁴⁸ Kur Shteti deklarues thjesht ndërhyr në procedurat gjyqësore në Shtetin e origjinës si palë e tretë, vendimi mund të qarkullojë si midis kërkuarit edhe të paditurit, që nuk janë prekur nga deklarimi.

347. **Mosretroaktiviteti.** Si në nenin 18, një deklarim i bërë *pasi* Konventa ka hyrë në fuqi për Shtetin që e bën atë deklarim, do të ketë efekt në ditën e parë të muajit pas përfundimit të tre muajve pas datës në të cilën njoftimi është marrë nga depozitari (shih *infra*, neni 30(4)). Një deklarim i tillë nuk përdoret për vendimet gjyqësore që rezultojnë nga një proces që është filluar ndërkohë nga ose kundër Shtetit palë, ose të cilit ndërkohë i është shtuar Shteti palë, përpara gjykatës së origjinës kur deklarimi ka hyrë në fuqi (shih *infra*, Neni 30(5)).

Paragrafi 2 – Njohja ose zbatimi i një vendimi gjyqësor, të dhënë nga një gjykatë e një shteti që ka bërë deklarimin, në pajtim me paragrafin 1, mund të refuzohet nëse vendimi gjyqësor ka lindur si pasojë e procedurave në të cilat është palë qoftë shteti që ka bërë deklarimin, ose Shteti i kërkuar, një nga agjencitë e tyre qeveritare ose një person fizik që vepron për cilindo prej tyre, në të njëjtën masë, siç specifikohet në deklarim.

348. Si në nenin 18, paragrafi 2 vendos reciprocitetin për deklarimet e bëra sipas nenit 19(1).²⁴⁹ Kur një deklarim është bërë sipas nenit 19(1), një Shtet tjetër *mund të refuzojë* ta njohë apo ekzekutojë një vendim gjyqësor të dhënë nga një gjykatë e Shtetit që e ka bërë deklarimin dhe që krijohet nga procesi ku një apo më shumë nga sa më poshtë është/janë palë: (i) Shteti deklarues, (ii) Shteti i kërkuar, (iii) një agjenci shtetërore e Shtetit deklarues ose Shteti i kërkuar, (iv) një person fizik që vepron për Shtetin deklarues ose Shtetin e kërkuar, ose (v) një person fizik që

²⁴⁸ Mbrojtja kërkon të parandalojë deklarimet strategjike apo oportuniste. Gjithsesi, në praktikë, ajo nuk mund ta pengojë Shtetin deklarues që të njohë apo ekzekutojë vendime të favorshme gjyqësore sipas ligjit të vet të brendshëm. Kjo do të bëhej jashtë fushës së veprimit të Konventës, *pra*, jo sipas nenit 15.

²⁴⁹ Ndryshe nga neni 18(2), parimi i reciprocitetit në nenin 19(2) nuk vepron për të përjashtuar zbatimin e Konventës.

vepron për një agjenci shtetërore të Shtetit deklarues ose Shtetit të kërkuar.²⁵⁰ Objekti i refuzimit për të njohur apo zbatuar bazuar në reciprocitet, duhet të pasqyrojë shkallën e deklarimit.

349. **Shembulli 1.** Shteti A ka bërë një deklaram sipas nenit 19(1), i cili mbulon çdo vendim që rrjedh nga procesi ku ai Shtet është palë. Një vendim gjyqësor i dhënë në Shtetin B kundër Shteti A nuk do të njihet apo zbatohet në Shtetin A sipas Konventës. Një vendim i tillë gjyqësor gjithsesi do të qarkullojë sipas Konventës në Shtete të tjera (sigurisht, duke supozuar se kushtet për një qarkullim të tillë janë plotësuar, në veçanti, filtrat e parashikuar nga Neni 5, dhe duke iu nënshtruar nenit 2(5), i cili konfirmon se asgjë në Konventë nuk i prek imunitetet e Shtetit A).
350. **Shembulli 2 (reciprociteti).** Nëse një vendim gjyqësor jepet në Shtetin A (shteti deklarues) kundër Shtetit B (Shtetit të kërkuar), Shteti i fundit mund të përdorë nenin 19(2) për të refuzuar njohjen apo zbatimin e një vendimi të tillë gjyqësor. Shteti B gjithsesi mund të mos e përdorë klauzolën e reciprocitetit nëse njohja apo zbatimi i atij vendimi kërkohet në një Shtet tjetër, *për shembull*, në Shtetin C. Po ashtu, nëse vendimi do të ishte dhënë në Shtetin C. (Shteti i origjinës) dhe Shteti A (Shteti deklarues) është kreditori objekt i vendimit, Shteti B (Shteti i kërkuar) mund të mos refuzojë të njohë apo ekzekutojë një vendim të tillë gjyqësor sipas nenit 19(2).
351. **Shqyrtimi i deklarimeve.** Neni 21 parashikon se veprimi i deklarimeve sipas nenit 19 mund të konsiderohet herë pas here (shih, *infra*, para. 354).

²⁵⁰ Formulimi i para. 2 konfirmon se njohja apo zbatimi mund të ketë kuptim kur Shteti deklarues është debitori objekt i vendimit.

Neni 20
Interpretimi i unifikuar

Në interpretimin e kësaj Konvente i kushtohet vëmendje karakterit të saj ndërkombëtar dhe nevojës për të nxitur unifikimin në zbatimin e saj.

352. Neni 20 deklaron se në interpretimin e Konventës duhet pasur parasysh karakteri ndërkombëtar i saj dhe nevoja për të promovuar zbatimin e njëjtë të saj. Gjykata që zbaton Konventën duhet ta interpretojë atë në frymën ndërkombëtare, për të promovuar zbatimin e njëjtë të saj. Kur është e mundur në mënyrë të arsyeshme, vendimet e huaja dhe komentari duhen pasur në konsideratë, duke mbajtur parasysh se konceptet dhe parimet aksiomatike në një sistem ligjor mund të mos njihen apo të hidhen poshtë në një tjetër. Fusha e veprimit të Konventës mund të arrihet vetëm nëse të gjitha gjykatat e zbatojnë atë me mendje të hapur.²⁵¹
353. Ky nen duhet lexuar bashkë me nenin 21, më poshtë (Shqyrtimi i veprimit të Konventës), sepse të dy nenet kanë si qëllim zbatimin e duhur dhe të njëjtë të Konventës.

²⁵¹ Kjo klauzolë është gjithashtu e pranishme në KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës (Neni 23). Shih Raporti Hartley/Dogauch, para. 256; KHDNP, *Konventa e 5 korrikut 2006 për ligjin e zbatueshëm për të drejta të caktuar në lidhje me garancitë e mbajtura nga ndërmjetësuesi* (Neni 13); dhe KHDNP 2007, Konventa për Mbajtjen e Fëmijës (Neni 53).

Neni 21***Rishikimi i funksionimit të Konventës***

Sekretari i Përgjithshëm i Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private organizon rishikimin në intervale të rregullta të funksionimit të kësaj Konvente, përfshirë çdo deklaram, dhe i raporton Këshillit për Çështjet e Përgjithshme dhe Politikat.

354. Neni 21 kërkon që Sekretari i Përgjithshëm i KHDNP-së të marrë masat e duhura në intervale kohe të rregullta për shqyrtimin e funksionimit të Konventës, duke përfshirë çdo deklaram të bërë sipas tij, dhe të raportojë në Këshillin e Çështjeve të Përgjithshme dhe Politikave. Një qëllim i rëndësishëm i këtyre rishikimeve është të shqyrtojë funksionimin e deklarameve sipas neneve 14, 17, 18 or 19. Këshilli për Çështjet e Përgjithshme dhe të Politikave do të përcaktojë nëse ka nevojë të fillojë procesin e shqyrtimit të bërjes së ndryshimeve të mundshme në Konventë.

Neni 22
Sistemet ligjore të paunifikuara

1. Në lidhje me Shtetin Kontraktues në të cilin zbatohen dy ose më shumë sisteme ligjore në njësi të ndryshme territoriale lidhur me çdo çështje që trajtohet në këtë Konventë:
 - (a) çdo referim ndaj ligjit ose procedurës së një shteti interpretohet se i referohet, kur është e përshtatshme, ligjit ose procedurës në fuqi, në njësinë territoriale përkatëse;
 - (b) çdo referim ndaj gjykatës ose gjykatave të një shteti interpretohet se i referohet, kur është e përshtatshme, gjykatës ose gjykatave në njësinë territoriale përkatëse;
 - (c) çdo referim ndaj lidhjes me një shtet interpretohet se i referohet, kur është e përshtatshme, lidhjes me njësinë territoriale përkatëse;
 - (d) çdo referim ndaj një faktor të lidhjes në raport me një shtet interpretohet se i referohet, kur është e përshtatshme, atij faktori të lidhjes në raport me njësinë territoriale përkatëse.
2. Pavarësisht nga paragrafi 1, një Shtet Kontraktues me dy ose më shumë njësi territoriale, në të cilat aplikohen sisteme të ndryshme ligjore, nuk është i detyruar ta zbatojë këtë Konventë për situatat që kanë të bëjnë vetëm me këto njësi territoriale të ndryshme.
3. Gjykata në një njësi territoriale të një Shteti Kontraktues me dy ose më shumë njësi territoriale, në të cilat zbatohen sisteme të ndryshme ligjore, nuk është e detyruar të njohë ose të zbatojë vendimin gjyqësor të një Shteti Kontraktues tjetër vetëm për arsye se vendimi gjyqësor është njohur ose zbatuar në njësinë tjetër territoriale të të njëjtit Shtet Kontraktues sipas kësaj Konvente.
4. Ky nen nuk zbatohet për Organizatat Rajonale të Integritit Ekonomik.

355. Neni 22 merret me vështirësitë e mundshme që rrjedhin nga sistemet ligjore të paunifikuara, *pra*, Shtete të përbëra nga dy apo më shumë njësi territoriale, secili me sistemin e vet gjyqësor apo juridik. Njësitë individuale territoriale të këtyre Shteteve mund të kenë gjykata dhe procedura civile të veçanta (sisteme gjyqësore

të paunifikuara) ose rregulla të ndryshme të së drejtës materiale (sistem juridik i paunifikuar) të tilla që referencat ndaj “gjykatave të Shtetit A” ose “ligjit të Shtetit A” janë ose të pakuptimta ose pamjaftueshmërisht të sakta. Disa Shtete mund t’i shfaqin të dyja këto veçori “të paunifikuara”. Në parim, meqë Konventa trajton çështje procedurale (njohja apo zbatimi i vendimeve gjyqësore), ky nen normalisht do të jetë i përshtatshëm vetëm për ato Shtete që përbëhen nga dy apo më shumë njësi territoriale, ku secili ka sistemin e vet gjyqësor.²⁵²

356. Kjo situatë ndodh më së shumti në rastin e federatave, siç është Kanadaja apo Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por mund të ndodhë gjithashtu edhe në Shtete të tjera, siç është Republika Popullore e Kinës. Në këto raste, çështja mund të shtrohet nëse një referencë ndaj një Shteti të Konventës është ndaj Shtetit si një i tërë (“Shteti” në kuptimin ndërkombëtar), apo nëse është për një njësi të caktuar territoriale në atë Shtet.

Paragrafi 1 – Në lidhje me Shtetin Kontraktues në të cilin zbatohen dy ose më shumë sisteme ligjore në njësi të ndryshme territoriale lidhur me çdo çështje që trajtohet në këtë Konventë:

Nënparagrafi (a) – çdo referim ndaj ligjit ose procedurës së një shteti interpretohet se i referohet, kur është e përshtatshme, ligjit ose procedurës në fuqi, në njësinë territoriale përkatëse;

Nënparagrafi (b) – çdo referim ndaj gjykatës ose gjykatave të një shteti interpretohet se i referohet, kur është e përshtatshme, gjykatës ose gjykatave në njësinë territoriale përkatëse;

Nënparagrafi (c) – çdo referim ndaj lidhjes me një shtet interpretohet se i referohet, kur është e përshtatshme, lidhjes me njësinë territoriale përkatëse;

Nënparagrafi (d) – çdo referim ndaj një faktori të lidhjes në raport me një shtet interpretohet se i referohet, kur është e përshtatshme, atij faktori të lidhjes në raport me njësinë territoriale përkatëse.

357. **Rregulla interpretuese.** Neni 22(1) parashikon se kur sisteme të ndryshme ligjore zbatohen në njësitë territoriale në lidhje me çdo çështje të trajtuar në Konventë, Konventa duhet interpretuar se do të thotë që zbatohet ose në një Shtet në kuptimin ndërkombëtar, ose në njësinë përkatëse territoriale, sipas rastit. Neni 22(1) shërben si një udhëzues interpretues për ato dispozita të Konventës që kërkojnë përcaktimin e një vendndodhjeje gjeografike apo territoriale. Ai nuk ka implikime për fushën e veprimit të Konventës.

358. Fjalët “sipas rastit” në katër nënparagrafët e nenit 22(1) nuk u japin gjykatave të Shtetit të kërkuar liri veprimi për këtë çështje. Përkundrazi, ata i referohen faktit që

²⁵² Shih, gjithashtu Raporti Hartley/Dogauch, para. 258.

referenca ndaj njësisë territoriale dhe jo Shtetit ndodh vetëm kur një reference e tillë është e përshtatshme për shkak të karakteristikave përkatëse jo të unifikuara të atij Shteti.

359. Pikënisja e kësaj analize është që Konventa zbatohet për një vendim gjyqësor nëse ai ka efekt apo është i zbatueshëm në Shtetin e origjinës (Neni 4(3)). Kur vendimi në fjalë vjen nga një Shtet me një sistem gjyqësor të paunifikuar, mund të ndodhë që vendimi gjyqësor i një gjykate në një njësi territoriale ka efekt ose është i zbatueshëm si një vendim i brendshëm vetëm në njësinë territoriale dhe jo në gjithë Shtetin në tërësi. Me fjalë të tjera, ndonëse vendimi i njësisë territoriale mund të bëhet efektiv apo i zbatueshëm në njësi të tjera territoriale brenda atij Shteti, ai nuk konsiderohet si një vendim i brendshëm në njësitë e tjera territoriale. Në varësi të konfigurimit të veçantë apo natyrës së sistemit juridik të një Shteti, vendimet gjyqësore nga gjykatat e tij mund të konsiderohen në fakt si vendime gjyqësore të brendshme në gjithë Shtetin.²⁵³ Kur vendime gjyqësore të gjykatave konsiderohen si të brendshme vetëm brenda një njësie të caktuar territoriale, mund të jetë “rasti” që t’i referohemi asaj njësie territoriale kurdoherë që Konventa i referohet “Shtetit”.
360. **Filtrat.** Përdorimi i filtrave në nenet 5 dhe 6 mund të përfshijë zbatimin e rregullave interpretuese të paraqitura në nenin 22. Fjalët “sipas rastit” në nenin 22 tregojnë se mbështetje në rregullën interpretuese kufizohet në ato situata ku veçoria e paunifikuar e Shtetit të origjinës është me rëndësi. Në rastet kur filtri i referohet një faktori lidhës me territorin e një Shteti (*për shembull*, në nenin 5(1)(a), (b), (d) ose (g)), analiza e dhënë në paragrafin e mëparshëm do të jetë me rëndësi për interpretimin e atij filtri. Që do të thotë, kur vendimi i njësisë territoriale është një vendim i brendshëm vetëm për atë njësi territoriale dhe jo për Shtetin në tërësi, do të ishte e papërshtatshme që të trajtohej referenca ndaj “Shtetit” në filtër si një referencë ndaj njësisë territoriale. Kështu, për shembull, kushti i nenit 5(1)(a) do të plotësohet nëse vendqëndrimi i rregullt i palës kundër të cilës kërkohet njohja apo zbatimi është në njësinë territoriale ndaj të cilës gjykata e origjinës ushtron juridiksionin e vet. Nga ana tjetër, nëse vendimi është një vendim efektiv dhe i zbatueshëm si një vendim i brendshëm në gjithë Shtetin, atëherë do të ishte me vend të trajtohej referenca ndaj “Shtetit” në filtër si një referencë ndaj Shtetit në tërësi.
361. Jo të gjithë filtrat përfshijnë faktorë lidhës. Disa i referohen vetëm ligjit të Shtetit. Për shembull, neni 5(1)(f) i referohet kontestimit të juridiksionit brenda afatit kohor të parashikuar nga “ligji i Shtetit të origjinës”. Në një rast të tillë, do të ishte e përshtatshme t’i referoheshim të drejtës procedurale të njësisë territoriale në sistemin gjyqësor të paunifikuar të atij Shteti, meqenëse ligji i zbatueshëm për këtë çështje ndryshon nga një njësi territoriale në një tjetër. Në fakt, një referencë ndaj ligjit të Shtetit në tërësi do të ishte e paefektshme për të përcaktuar nëse filtri përmbushet.

²⁵³ Neni 22(2) e përcakton se Konventa nuk zbatohet në situata që përfshijnë njohjen apo zbatimin midis njësive territoriale të Shteteve të paunifikuara (shih *infra*, para. 365).

362. **Dispozitat e tjera të Konventës.** Çështja e interpretimit mund të dalë gjithashtu kur Shteti *i kërkuar* është një Shtet i paunifikuar. Për shembull, sipas nenit 13, rregulla që procedura për njohjen apo zbatimin rregullohet nga ligji i Shtetit të kërkuar mund të jetë me vend për t’iu referuar ligjit të njësisë territoriale në një Shtet me sistem gjyqësor të paunifikuar.
363. Sipas nenit 7(2), njohja apo zbatim i mund të shtyhen apo refuzohen nëse procesi midis palëve për të njëjtën lëndë është në pritje përpara një gjykate të Shtetit të kërkuar. Rregulla interpretuese në nenin 22(1)(c) e justifikon një lexim kufizues të kësaj dispozite, duke e kufizuar zbatimin e saj në procese paralele përpara një gjykate në njësinë territoriale, nëse kjo është pasoja e duhur e sistemit gjyqësor të paunifikuar të Shtetit. Pa nenin 22(1)(c), mund të ishte në dorën e gjykatës të njësisë territoriale ta refuzonte zbatimin e një vendimi gjyqësor, për shkak të proceseve paralele përpara gjykatave të një njësie të ndryshme territoriale në atë Shtet, edhe pse normalisht ky nuk do të ishte një opsion i disponueshëm në ligjin e tij të brendshëm. Nga ana tjetër, kjo përforcon parimin e përgjithshëm të Konventës që vendimet e huaja gjyqësore të trajtohen në të njëjtën mënyrë si vendimet gjyqësore të brendshme kur përmbushen kriteret përkatëse për njohje apo zbatim.
364. **Ndryshimi nga KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës.** Struktura e nenit 22 ndryshon paksa nga dispozita paralele e saj në KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës (Neni 25). Këto ndryshime vijnë nga nevoja për t’ua përshtatur këtë dispozitë veçorive të Konventës, por jo nga synimi për të ndryshuar kuptimin e saj. Në nenin 25 të Konventës KHDNP të 2005 për Zgjedhjen e Gjykatës, referenca ndaj termit “vendbanimin” përmendet shprehimisht në një gjymtyrë të pavarur. Nga ana tjetër, neni 22 i kësaj Konvente përfshin të gjithë faktorët lidhës, duke përfshirë “vendbanimin”, në njërin gjymtyrë (Neni 22(1)(d)) dhe referencën ndaj “një lidhjeje” me një Shtet e mban në një gjymtyrë të ndryshme (Neni 22(1)(c)). I pari përfshin të gjithë faktorët lidhës me një Shtet të përmendur në Konventë, në veçanti, në nenet 5 dhe 6 (filtra). Ky i fundit mbulon referencën ndaj termit “lidhje” me një Shtet, i përdorur në nenet 5(1)(g) dhe 7(2) të Konventës.

Paragrafi 2 – Pavarësisht nga paragrafi 1, një Shtet Kontraktues me dy ose më shumë njësi territoriale, në të cilat aplikohen sisteme të ndryshme ligjore, nuk është i detyruar ta zbatojë këtë Konventë për situatat që kanë të bëjnë vetëm me këto njësi territoriale të ndryshme.

365. Neni 22(2) përcakton se një Shtet me dy apo më shumë njësi territoriale, në të cilin zbatohen sisteme të ndryshme ligjesh, nuk është i detyruar të zbatojë Konventën në situata që përfshijnë vetëm njësi të tilla të ndryshme territoriale. Kjo është në përputhje me nenin 1(2) të Konventës që përcakton fushën e veprimit e Konventës në pikëpamje të njohjes apo zbatimit në një Shtet të vendimeve gjyqësore të dhëna në një Shtet tjetër. Detyrimet e njohjes apo zbatimit sipas Konventës dalin vetëm lidhur me vendimet e huaja gjyqësore, në kuptimin ndërkombëtar.

Paragrafi 3 – Gjykata në një njësi territoriale të një Shteti Kontraktues me dy ose më shumë njësi territoriale, në të cilat zbatohen sisteme të ndryshme ligjore, nuk është e detyruar të njohë ose të zbatojë vendimin gjyqësor të një Shteti Kontraktues tjetër vetëm për arsye se vendimi gjyqësor është njohur ose zbatuar në njësinë tjetër territoriale të të njëjtit Shtet Kontraktues sipas kësaj Konvente.

366. Neni 22(3) thotë se nuk ka një detyrim për njohje apo zbatim në një njësi territoriale që buron nga njohja apo zbatimi i një vendimi të huaj në një njësi tjetër territoriale të të njëjtit Shtet. Kështu, për shembull, një vendim francez i ekzekutuar sipas Konventës në Kebek, Kanada, nuk ka pse të ekzekutohet automatikisht në Ontario, Kanada. Kjo është një pasojë e natyrshme e fushës së veprimit të Konventës, siç përcaktohet në nenin 1(2), por që trajtohet shprehimisht në nenin 22(3) për të shmangur paqartësitë.

Paragrafi 4 – Ky nen nuk zbatohet për Organizatat Rajonale të Integritit Ekonomik.

367. Së fundi, Neni 22(4) tregon se këto rregulla të veçanta që zbatohen për sistemet ligjore të paunifikuara, nuk zbatohen edhe për një ORIE, e cila në vend të kësaj, drejtohet nga rregullat e veta në nenet 26 dhe 27 (shih, më poshtë).

Neni 23

Marrëdhënia me instrumentet e tjera ndërkombëtare

1. Kjo Konventë interpretohet aq sa është e mundur në mënyrë që të jetë në përputhje me traktatet e tjera në fuqi për Shtetet Kontraktuese, pavarësisht nëse janë lidhur përpara ose pas kësaj Konvente.
2. Kjo Konventë nuk ndikon në zbatimin nga ana e një Shteti Kontraktues të një traktati që është lidhur përpara kësaj Konvente.
3. Kjo Konventë nuk ndikon në zbatimin nga ana e një Shteti Kontraktues të një traktati që është lidhur pas kësaj Konvente në lidhje me njohjen ose zbatimin e vendimit gjyqësor, të dhënë nga një gjykatë e një Shteti Kontraktues që është gjithashtu palë e atij traktati. Asgjë në traktatin tjetër nuk ndikon në detyrimet, sipas nenit 6, ndaj Shteteve Kontraktuese që nuk janë palë të atij traktati.
4. Kjo Konventë nuk ndikon në zbatimin e rregullave të Organizatës Rajonale të Integritimit Ekonomik, që është palë e kësaj Konvente për sa i përket njohjes ose zbatimit të një vendimi gjyqësor, të dhënë nga një gjykatë e një Shteti Kontraktues që është gjithashtu shtet anëtar i Organizatës Rajonale të Integritimit Ekonomik kur:
 - (a) rregullat u janë miratuar përpara nënshkrimit të kësaj Konvente; ose
 - (b) rregullat u janë miratuar pas nënshkrimit të kësaj Konvente, në masën që ato nuk ndikojnë në detyrimet, sipas nenit 6, ndaj Shteteve Kontraktuese që nuk janë shtete anëtare të Organizatës Rajonale të Integritimit Ekonomik.

368. Neni 23 trajton marrëdhënien midis Konventës dhe instrumenteve të tjera ndërkombëtare.²⁵⁴ Pikënisja është neni 30 i Konventës së Venës së 1969, neni 30(2)

²⁵⁴ Për një diskutim informues, shih, A. Schulz, "Marrëdhënia midis Projektit të Aktgjytimeve dhe instrumenteve të tjera ndërkombëtare", Dok. paraprak nr. 24 të dhjetorit 2003 në vëmendje të Komisionit të Posaçëm të dhjetorit 2003. Shih, gjithashtu, diskutimi i së drejtës ndërkombëtare zakonore për Shtetet kontraktuese të Konventës, të cilat nuk janë palë në Konventën e Vjenës të 1969

i të cilës parashikon se, kur një traktat thotë se është subjekt i një traktati tjetër (qoftë më i hershëm apo më i vonshëm), traktati tjetër ka përparësi. Neni 23 i kësaj Konvente përcakton tri raste (Neni 23(2)-(4)) kur një traktat tjetër ka përparësi ndaj saj, duke përfshirë kur ka një konflikt midis Konventës dhe rregullave të një ORIE-je që është palë në Konventë. Përveç këtyre tri rasteve, Konventa ka efekt në shkallën më të plotë të lejuar nga e drejta ndërkombëtare.

369. Problemi i instrumenteve kontradiktore del vetëm nëse plotësohen dy kushte. Së pari, Shteti i gjykatës së kërkuar duhet të jetë palë në të dy instrumentet. Nëse ai Shtet është palë vetëm në njërin prej tyre, gjykata e tij thjeshtë do të zbatojë atë instrument. Pra, neni 23 u drejtohet vetëm Shteteve që janë palë në të një dy Konventat dhe në një instrument tjetër ndërkombëtar detyrues që bie ndesh me to.
370. Së dyti, duhet të ketë një pajtueshmëri reale midis dy instrumenteve. Me fjalë të tjera, përdorimi i dy instrumenteve duhet të çojë në rezultate të pajtueshme në një situatë konkrete. Kur kjo nuk ndodh, të dy instrumentet mund të përdoren. Në disa raste, një pajtueshmëri e dukshme mund të eliminohet me anë të interpretimit. Kur kjo është e mundur, problemi është i zgjidhur. Neni 23(1) pasqyron këtë qasje.

Paragrafi 1 – Kjo Konventë interpretohet aq sa është e mundur në mënyrë që të jetë në përputhje me traktatet e tjera në fuqi për Shtetet Kontraktuese, pavarësisht nëse janë lidhur përpara ose pas kësaj Konvente.

371. **Interpretimi.** Paragrafi i parë i nenit 23 përmban një rregull interpretimi. Ai parashikon se Konventa duhet interpretuar, për aq sa është e mundur, për të qenë e pajtueshme me instrumente të tjera në fuqi në Shtetet kontraktuese. Kjo zbatohet pavarësisht nëse instrumenti tjetër është vendosur përpara apo pas Konventës. Kështu, kur një dispozitë në Konventë është arsyeshëm në gjendje të ketë dykuptime, kuptimi që përputhet më shumë me instrumentin tjetër duhet parapëlqyer. Gjithsesi, kjo nuk do të thotë se duhet miratuar një interpretim i sforcuar për të arritur pajtueshmërinë.

Paragrafi 2 – Kjo Konventë nuk ndikon në zbatimin nga ana e një Shteti Kontraktues të një traktati që është lidhur përpara kësaj Konvente.

372. Kur dy instrumente nuk janë të pajtueshme në zbatimin e tyre në një situatë konkrete, neni 23(2) lejon që instrumenti më i hershëm të ketë përparësi. Neni 23(2) nuk kërkon nga instrumenti më i hershëm që të ketë qenë në fuqi përpara hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, por thjesht që të jetë nënshkruar përpara nënshkrimit të Konventës, *pra*, përpara 2 korrikut 2019. Sigurisht, nëse traktati më i hershëm nuk është ende në fuqi, nuk mund të krijohet asnjë pajtueshmëri e

mundshme. Kjo veçori shmang çdo pasiguri lidhur me elementin e kohës.²⁵⁵ Për më tepër, ndryshe nga paragrafët 3 dhe 4, paragrafi 2 nuk kërkon nga Shteti i origjinës që të jetë gjithashtu palë në traktatin më të hershëm.

373. **Shembulli 1 (Traktat midis Shteteve kontraktuese).**²⁵⁶ Shteti A (Shteti i origjinës) dhe Shteti B (Shteti i kërkuar) janë palë në Konventën e Luganos 2007 dhe Shtete kontraktuese të kësaj Konvente në lidhje me një vendim për një policë sigurimi, sipas Konventës së Luganos të 2007, përfituesi i policës së sigurimit (*pra*, personi i dëmtuar apo mbajtësi i policës së sigurimit) mund të paditet vetëm përpara gjykatave të vendbanimit të tij. Nëse ai paditet diku tjetër, njohja apo zbatimi i vendimit do të refuzohet (Neni 35). Kjo Konventë, gjithsesi, nuk përfshin një rregull të veçantë për kontrata sigurimesh për të mbrojtur përfituesit, policëmbajtësit apo palët e dëmtuara (përveç kur ata plotësojnë kushtet si konsumatorë). Nëse një vendim gjyqësor e përmbush filtrin e parashikuar, *për shembull*, në nenin 5(1)(g), atëherë Shteti B do të jenë i detyruar të njohë dhe ekzekutojë vendimin sipas Konventës, ndonëse Konventa e Luganos të 2007 e ndalon një gjë të tillë. Në një rast të tillë, Neni 23(2) i jep përparësi zbatimit të Konventës së Luganos të 2007 dhe kështu e lejon Shtetin B të refuzojë njohjen apo zbatimin e vendimit pa shkelur detyrimin e tij sipas Konventës.²⁵⁷
374. **Shembulli 2 (traktat me Shtete të treta).** Shteti A (Shteti i origjinës) dhe Shteti B (Shteti i kërkuar) janë të dy Shtete kontraktuese të Konventës. Shteti B është gjithashtu palë në një traktat të mëhershëm për marrëveshje për zgjidhje ndërkombëtare.²⁵⁸ Supozoni se një vendim gjyqësor i dhënë nga një gjykatë e Shtetit A paraqitet për njohje apo zbatim sipas Konventës në Shtetin B, dhe debitori objekt i vendimit kundërshton me shkakun se ajo bie ndesh me një marrëveshje për zgjidhje midis palëve të njëjta. Në një rast të tillë, gjykata e Shtetit B mund t'i japë përparësi traktatit mbi marrëveshjet për zgjidhjen ndërkombëtare dhe të refuzojë të njohë apo ekzekutojë vendimin, edhe nëse Shteti A nuk është palë në atë traktat, por edhe nëse ai traktat ka hyrë në fuqi në Shtetin B pas Konventës. Mjafton që ajo

²⁵⁵ Vini re se neni 23 e merr kohën e nënshkrimit të Konventës si element të rëndësishëm për të bërë dallimin midis traktateve më të hershëm dhe më të vonshëm dhe jo datën kur ajo ka hyrë në fuqi. Data e nënshkrimit është një element i fushës së veprimit (i përcaktuar nga e drejta ndërkombëtare publike) e përbashkët për të gjitha Shtetet, ndërsa data e hyrjes në fuqi mund të ndryshojë midis Shteteve. Prandaj, referenca ndaj datës së hyrjes në fuqi mund të ketë nënkuptuar se, në lidhje me të njëjtin traktat, disa Shtete do të kishin zbatuar nenin 23(2) dhe të tjerë nenin 23(3). Shih, "Raporti i grupit informal të punës III – Marrëdhënia me instrumentet e tjera ndërkombëtare", Dok. paraprak nr. 9, Rish, Rishikimi i qershorit 2019 në vëmendje të Sesionit njëzetë e dy për njohjen apo zbatimin e vendimeve të huaja gjyqësore (18 qershor – 2 korrik 2019) (më poshtë, "Dok. paraprak nr. 9 i qershorit 2019"), para. 4.

²⁵⁶ Shembulli është marrë nga Dok. paraprak nr. 9 i qershorit 2019, para. 11 dhe 14 të Shtojcës.

²⁵⁷ Konventa e Luganos 2007. Vini re gjithsesi, se ky shembull ndryshe nuk do të kishte gjasa të ndodhte kur edhe traktati tjetër gjithashtu vendos rregullën e juridiksionit të drejtpërdrejtë, siç është rasti me Konventën e Luganos 2007.

²⁵⁸ *Bashkëraportuesit* konstatojnë se çdo ngjashmëri midis këtij shembulli hipotetik dhe Konventës 2018 për Marrëveshjen Ndërkombëtare për Zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që rrjedhin nga ndërmjetësimi është thjesht rastësi.

është arritur përpara Konventës. Baza logjike është që kur Shteti A ka aderuar në Konventë, traktati tjetër ndërkohë ishte nënshkruar dhe si pasojë Shteti A në një farë mënyrë e ka marrë përsipër riskun që Shtetet e tjera kontraktuese mund ta ratifikonin atë.

375. **Marrëdhënia me KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës.** Meqenëse KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës, është nënshkruar në 2005, dhe përfshin njohjen apo zbatimin e vendimeve të huaja gjyqësore, do të ishte me dobi të përmendej konkretisht në lidhje me nenin 23(2). Në përgjithësi, nuk ka tensione apo mospërputhje midis KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës, dhe Konventës, sepse asnjëri nga instrumentet nuk e kufizon apo e limiton njohjen apo zbatimin e vendimeve gjyqësore sipas ligjit të brendshëm,²⁵⁹ duke e përfshirë sipas traktateve të tjera.
376. **Shembulli 1.** Kur dy Shtete (Shteti i origjinës dhe Shteti i kërkuar) janë Shtete kontraktuese të Konventës dhe palë në KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës, dhe kur, për shembull, vendimi i dhënë nga gjykata e zgjedhur pas një marrëveshjeje ekskluzive për Zgjedhjen e Gjykatës dhe Shteti i origjinës ishte gjithashtu vendqëndrimi i rregullt i personit kundër të cilit kërkohet njohja apo zbatimi, në parim nuk duhet të ketë ndonjë tension midis dy instrumenteve. Në shumicën e sistemeve, pala që kërkon njohjen apo zbatimin mund të mbështetet në secilin prej instrumenteve, ose në të dy instrumentet, si alternativë. Mund të ketë një shkak për refuzim sipas njërit instrument që nuk ekziston sipas tjetrit. Kjo do të ndodhte nëse shkaqet për refuzim sipas Konventës largohen shumë nga shkaqet për refuzim sipas nenit 9 të Konventës KHDNP të 2005 për Zgjedhjen e Gjykatës. Rezultati do të ishte që Shteti i kërkuar duhet gjithsesi ta njohë dhe zbatojë sipas instrumentit që nuk lejon refuzimin. Kjo vjen për shkak se arsyet për refuzim sipas të dy instrumenteve janë shkaqe të lejuara por jo të detyruara për refuzim. Pra, nuk ka kërkesë për refuzimin e njohjes apo zbatimit në instrumentin që e lejon refuzimin. Nëse ka një detyrim për njohje dhe ekzekutim sipas KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës – ose ligjit të brendshëm – atëherë ai do të zbatohet dhe nuk do të ketë mospërputhje me Konventën.
377. **Shembulli 2.** Shteti A (Shteti i origjinës) dhe Shteti B (Shteti i kërkuar) janë të dy Shtete kontraktuese të Konventës, ndërsa Shteti B dhe Shteti C janë palë në KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës. Një vendim gjyqësor është dhënë në Shtetin A, ku i padituri ka vendqëndrim të rregullt, por pavarësisht nga marrëveshja ekskluzive për zgjedhjen e gjykatës që cakton Gjykatat e Shtetit C. Në një rast të tillë, Shteti B mund të refuzojë ta njohë dhe ekzekutojë atë vendim sipas nenit 7(1)(d) të Konventës. Si rrjedhojë, në këtë rast nuk është as e nevojshme që t'i referohet nenit 23 sepse nuk ka mospërputhja midis të dy instrumenteve.

²⁵⁹ Kufizimi i vetëm për zbatimin sipas ligjit të brendshëm në Konventë i referohet Neni 6, por të drejtat sendore *in rem* ndaj pronës së patundshme janë të përjashtuara nga fusha e veprimit të Konventës KHDNP të 2005 për Zgjedhjen e Gjykatës (shih Neni 2(2)(l)), duke shmangur kështu çdo risk mospërputhjes për këtë pikë.

378. **Shembulli 3.** Një shembull tjetër mund të përfshijë dy vendime gjyqësore. Shteti A (Shteti i origjinës) dhe Shteti B (Shteti i kërkuar) janë të dy Shtete kontraktuese të Konventës, ndërsa Shteti B dhe Shteti C janë palë në KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës. Shteti A jep një vendim gjyqësor që përshihet në një rën prej bazave për njohje apo zbatim sipas nenit 5 të Konventës dhe më pas Shteti C jep një vendim tjetër në bazë të një marrëveshjeje ekskluzive për Zgjedhjen e Gjykatës. Vendimet gjyqësore janë mospërputhëse. Në parim, të dy vendimet gjyqësore mund të përmbajnë një kërkesë për njohje apo zbatim në Shtetin B. Në këto rrethana, Neni 7(1)(d) i Konventës do ta lejonte dhënien përparësi vendimit të gjykatës së zgjedhur (Shteti C). Në këtë rast Gjykatës së kërkuar i kërkohet të njohë dhe ekzekutojë vendimin e gjykatës së zgjedhur, përveç kur vendimi tjetër është dhënë i pari, rast në të cilin njohja apo zbatimi mund të refuzohen sipas nenit 9(g) të KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës. Në këtë situatë paradoksale, kur vendimi i gjykatës së pazgjedhur ishte vendimi më i hershëm, gjykata e kërkuar nuk është e detyruar të ekzekutojë asnjërin prej vendimeve. Në parim, i duhet lënë lirisë së veprimit (diskrecionit) të Shtetit të kërkuar të vendosë nëse shkak për refuzim do të çojë eventualisht në refuzimin e njohjes apo zbatimit të një vendimi gjyqësor, duke qenë se të dy Konventat parashikojnë që Shteti i kërkuar “mund të refuzojë”. Gjithsesi, në dritën e qëllimit të të dy Konventave për promovimin e njohjes apo zbatimit të vendimeve gjyqësore, Shteti i kërkuar nuk duhet të refuzojë njohjen apo zbatimin e të dy vendimeve gjyqësore.²⁶⁰

Paragrafi 3 – Kjo Konventë nuk ndikon në zbatimin nga ana e një Shteti Kontraktues të një traktati që është lidhur pas kësaj Konvente në lidhje me njohjen ose zbatimin e vendimit gjyqësor, të dhënë nga një gjykatë e një Shteti Kontraktues që është gjithashtu palë e atij traktati. Asgjë në traktatin tjetër nuk ndikon në detyrimet, sipas nenit 6, ndaj Shteteve Kontraktuese që nuk janë palë të atij traktati.

379. Neni 23(3) parashikon një situatë kur një Shtet kontraktues hyn në një traktat që trajton njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore me një tjetër Shtet kontraktues dhe kur traktati tjetër është nënshkruar pas kësaj Konvente. Ndryshe nga neni 23(2), ky paragraf kërkon që Shteti i origjinës dhe Shteti i kërkuar të jenë të dy Shtete kontraktuese të Konventës dhe palë në instrumentin e mëvonshëm. Për më tepër, Neni 23(3) përdor shprehjen “për sa i takon njohjes apo zbatimit të një vendimi gjyqësor” për t’i lejuar Shtetet kontraktuese të zbatojnë një instrument më të vonshëm për qëllimin e miratimit apo refuzimit të njohjes apo zbatimit të vendimeve gjyqësore të dhëna nga një gjykatë e një Shteti kontraktues, që është gjithashtu palë në atë instrument, pra, përparësia e instrumentit të dytë nuk kufizohet nga parimi i favorizimit të njohjes.²⁶¹ Kërkesa e përgjithshme e mospërputhshmërisë midis dy instrumenteve vazhdon të zbatohet.

²⁶⁰ Shih, Dok. paraparak nr. 9 e qershorit 2019, para. 4 i Shtojcës.

²⁶¹ Po aty, para. 3

380. Dallimi i dytë midis traktateve më të hershme dhe më të vonshme lidhet me Nenin 6 të Konventës. Kjo rregull e përparësisë së instrumenteve më të vona nuk prek detyrimet sipas nenit 6 të Konventës që u detyrohen Shteteve kontraktuese që nuk janë palë në instrumentin më të vonshëm. Kjo siguron mbrojtjen e filtrit ekskluziv që gjendet në nenin 6 për Shtetet kontraktuese që nuk janë palë në instrumentin më të vonshëm. Ai nuk zbatohet, gjithsesi, për sa i takon një prone të patundshme në Shtete jo kontraktuese (shih *supra*, para. 237-243).
381. **Shembulli 1.** Shtetet A dhe B janë të dy Shtete kontraktuese të Konventës. Më vonë ato nënshkruajnë një traktat dypalësh për zbatimin e vendimeve gjyqësore. Ky traktat parashikon që asnjëri nga këto Shtete nuk do të zbatojë vendimet gjyqësore jo monetare në çështje të caktuara. Sipas nenit 23(3), ky traktat ka përparësi ndaj Konventës dhe si rrjedhojë Shteti B mund të refuzojë zbatimin e një vendimi jo monetar të dhënë në Shtetin A, edhe nëse një apo më shumë nga filtrat e parashikuar nga Neni 5 i Konventës përmbushen. Është e qartë se ky traktati i mëvonshëm nuk mund të përdoret kundër Shteteve të tjera kontraktuese të Konventës, për të refuzuar njohjen apo zbatimin e vendimeve gjyqësore jo monetare të dhëna në këto Shtete.
382. **Shembulli 2.** Shtetet A dhe B janë të dy Shtete kontraktuese të Konventës. Më vonë ata nënshkruajnë një traktat dypalësh për zbatimin e vendimeve gjyqësore. Ky traktat parashikon, ndër të tjera, njohjen apo zbatimin e vendimeve gjyqësore për padi që përfshijnë të drejtat sendore *in rem* të lidhura me pronën e patundshme të ndodhur në njërin prej të dy Shteteve. Traktati parashikon se vendime të tilla gjyqësore mund ta kenë zanafillën ose në gjykatën e Shtetit ku prona e patundshme ndodhet, ose në Shtetin e vendqëndrimit të rregullt të një të padituri. Sipas Konventës, vendimi i mëvonshëm *nuk* mund të njihet edhe sipas ligjit të brendshëm, për shkak të nenit 6. Kjo do të shkaktonte një konflikt me traktatin e mëvonshëm dypalësh. Në një rast të tillë, traktati më i vonshëm mund të ketë përparësi sipas nenit 23(3) dhe e justifikon njohjen apo zbatimin e vendimit sipas atij traktati.
383. **Shembulli 3.** Shtetet A, B dhe C janë të gjitha Shtete kontraktuese në Konventë. Shtetet A dhe B më pas nënshkruajnë një traktat dypalësh sipas të cilit vendimet gjyqësore për padi të lidhura me të drejtat sendore *in rem* ndaj pronës së patundshme njihen dhe ekzekutohen nga të dy palët edhe nëse prona e patundshme ndodhet në një Shtet të tretë, për aq kohë sa paditësit dhe të paditurit janë me vendqëndrim të rregullt ose në Shtetin A ose në Shtetin B. Një gjykatë në Shtetin A jep një vendim të tillë gjyqësor që lidhet me një të drejtë sendore *in rem* ndaj pronës së patundshme në Shtetin C. Vendimi sillet për zbatimin në Shtetin B. Sipas Konventës, ky vendim nuk mund të ekzekutohet sepse ai nuk e përmbush rregullën në nenin 6. Në një rast të tillë, neni 23(3) nuk mund të përdoret për të justifikuar njohjen apo zbatimin meqenëse prona ndodhet në një Shtet kontraktues që nuk është palë në traktatin tjetër.

Paragrafi 4 – Kjo Konventë nuk ndikon në zbatimin e rregullave të Organizatës Rajonale të Integritimit Ekonomik, që është palë e kësaj Konvente për sa i përket njohjes ose zbatimit të një vendimi gjyqësor, të dhënë nga një gjykatë e një Shteti Kontraktues që është gjithashtu shtet anëtar i Organizatës Rajonale të Integritimit Ekonomik kur:

Nënparagrafi (a) – rregullat u janë miratuar përpara nënshkrimit të kësaj Konvente; ose Nënparagrafi (b) – rregullat u janë miratuar pas nënshkrimit të kësaj Konvente, në masën që ato nuk ndikojnë në detyrimet, sipas nenit 6, ndaj Shteteve Kontraktuese që nuk janë shtete anëtare të Organizatës Rajonale të Integritimit Ekonomik.

384. Neni 23(4) trajton situatën kur një ORIE bëhet palë kontraktuese në Konventë dhe lidhet me qarkullimin e vendimeve gjyqësore brenda ORIE-së. Në këtë kontekst, është e mundur që rregullat (legjislacioni) e miratuara nga ORIE të bien ndesh me Konventën. Neni 23(4) përmban dy rregulla përparësore. Së pari, Konventa nuk prek përdorimin e rregullës së miratuar nga ORIE-ja përpara nënshkrimit të Konventës. Së dyti, Konventa nuk cenon përdorimin e rregullave të miratuara nga ORIE pas nënshkrimit të Konventës, për aq sa ato nuk prekin detyrimet sipas nenit 6 ndaj Shteteve kontraktuese që nuk janë Shtete anëtare të ORIE-së. Në praktikë, kjo nënkupton që ORIE-ja nuk mund të miratojë një rregull pasi Konventa është përfunduar, duke lejuar qarkullimin e vendimeve gjyqësore për një të drejtë sendore *in rem* ndaj pronës së patundshme të ndodhur në një Shtet tjetër kontraktues midis Shtetet të saj anëtare.

KAPITULLI IV – KLAUZOLAT PËRFUNDIMTARE

Neni 24

Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim nga të gjitha shtetet.
2. Kjo Konventë është subjekt i ratifikimit, pranimit ose miratimit nga shtetet nënshkruese.
3. Kjo Konventë është e hapur për aderim nga të gjitha shtetet.
4. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit depozitohen pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Vendeve të Ulëta, që është Depozitari i Konventës.

385. Kjo dispozitë merret me mënyrat se si një Shtet mund të bëhet palë në Konventë. Ajo parashikon dy metoda ose (i) me nënshkrim të pasuar nga ratifikimi, me pranim ose miratim (para. 1 dhe 2), ose (ii) me aderim (para. 3). Thjesht nënshkrimi i Konventës e detyron Shtetin të mos ndër marrë veprime që bien ndesh me fushën e veprimit dhe qëllimin e Konventës (shih, neni 18 i Konventës së Vjenës së 1969). Depozitimi i instrumentit të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit përbën në çdo rast, një akt ndërkombëtar me anë të së cilit një Shtet shpreh pëlqimin e tij për të qenë i detyruar nga Konventa (shih, neni 2(1)(b) të Konventës së Vjenës së 1969).
386. Cilado metodë që mund të përqafohet nga një Shtet, rezultati është i njëjtë.²⁶² Të dy metodat janë njëlloj të disponueshme për Shtetet anëtare dhe jo anëtare të KHDNP-së. Neni 24 gjithashtu nuk bën dallim midis Shteteve që morën pjesë në Sesionin njëzetë e dy, ku teksti u miratua, dhe atyre që nuk morën pjesë. Shtetet janë të lira të zgjedhin me anë të metodës që është më e përshtatshme për ta të bëhen palë, gjë që lehtëson aderimin e gjerë në Konventë.

²⁶² Raporti Hartley/Dogauchi vë në dukje se në Konventë të tjera të KHDNP-së, një Shtet aderues është në një pozitë më pak të favorshme se sa një Shtet ratifikues, meqenëse aderimi në këtë Konventë është subjekt i marrëveshjes së Shteteve që ndërkohë janë Palë (para. 311). Kjo nuk ndodh as me KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës, as në këtë Konventë (shih para. 407).

387. Instrumentet depozitohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Holandës. Pastaj depozitari njofton ata që përcaktohen në nenin 32 për çdo nënshkrim, ratifikim, pranim, miratim, apo aderim sipas këtij neni. Hyrja në fuqi e Konventës, si në nivel ndërkombëtar edhe në nivel të një Shteti të caktuar kontraktues, rregullohet nga neni 28, dhe vendosja e marrëdhënieve të traktatit midis Shteteve kontraktuese rregullohet nga Neni 29.

Neni 25

Deklarimet në lidhje me sistemet ligjore të paunifikuara

1. Nëse një shtet ka dy ose më shumë njësi territoriale, në të cilat zbatohen sisteme të ndryshme ligjore në lidhje me çështjet e trajtuara në këtë Konventë, ai mund të deklarojë se fusha e veprimit të Konventës shtrihet në të gjitha njësitë e tij territoriale, ose vetëm në një a më shumë prej tyre. Një deklaram i tillë thekson shprehimisht njësitë territoriale në të cilat zbatohet Konventa.
2. Nëse një shtet nuk bën asnjë deklaram sipas këtij neni, fusha e veprimit të Konventës shtrihet në të gjitha njësitë territoriale të atij shteti.
3. Ky nen nuk zbatohet për organizatat rajonale të integritit ekonomik.

388. Konventa trajton “sistemet ligjore të paunifikuara” në dy dispozita të ndryshme, në nenet 22 dhe 25. I pari përcakton se si Konventa duhet të shpjegohet dhe interpretohet në atë rast (shih, *supra*, para. 355-359). I dyti parashikon një mekanizëm deklarimi për ta zgjeruar zbatimin e Konventës në të gjitha njësitë territoriale ose vetëm në një apo më shumë njësi.
389. **Sistemet ligjore të paunifikuara.** Neni 25, si neni 22, u referohet Shteteve që kanë dy apo më shumë njësi territoriale ku zbatohen sisteme të ndryshme ligjore lidhur me çështjet e trajtuara në këtë Konventë. Meqenëse Konventa trajton çështje procedurale (njohja apo zbatimi i vendimeve gjyqësore), një përkufizim i tillë në fakt u referohet Shteteve të përbërë nga dy apo më shumë njësi territoriale, ku secili ka sistemin e vet gjyqësor (shih, *supra*, para. 355-356). Kjo ndodh në rastin e Shteteve federale, *për shembull*, Kanadaja apo Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por mund të ndodhë edhe në Shtete të tjera, *për shembull*, në Republikën Popullore të Kinës ose Mbretërinë e Bashkuar. ORIE-të, gjithsesi, nuk janë të mbuluara nga ky nen (shih para. (3)).
390. **Deklarimi.** Neni 25(1) i lejon Shtetet të deklarojnë se Konventa shtrihet për të gjitha njësitë e tyre territoriale ose vetëm për një apo më shumë prej tyre. Ky deklaram mund të bëhet në kohën e deklaramit, ratifikimit, pranimit, miratimit, apo aderimit apo në çdo time më pas. Gjithashtu ai mund të modifikohet, duke paraqitur një tjetër deklaram në çdo kohë më pas. Këto deklarime i njoftohen depozitarit dhe

përcaktojnë shprehimisht njësinë apo njësitë territoriale për të cilat Konventa zbatohet. Hyrja në fuqi dhe zbatimi në kohë i Konventës në këto raste trajtohen nga neni 28 (shih *infra*, para. 405-406).

391. Nëse një Shtet për të cilin ky nen zbatohet nuk bën asnjë deklaram, Konventa zbatohet për të gjitha njësitë territoriale të atij Shteti (shih para. 2).
392. Së fundi, paragrafi 3 thotë që kjo dispozitë nuk zbatohet për një ORIE. Neni 25 zbatohet vetëm për Shtetet (në kuptimin ndërkombëtar) dhe njësitë territoriale *brenda* një Shteti kur zbatohen sisteme të ndryshme ligjore. Nga ana tjetër, ORIE-ve përbëhen nga dy apo më shumë Shtete sovraane dhe trajtohen në dy nenet e tjera.

Neni 26

Organizatat Rajonale të Integritit Ekonomik

1. **Organizata Rajonale e Integritit Ekonomik, e cila përbëhet vetëm nga shtete sovrane dhe ka kompetencë mbi disa ose mbi të gjitha çështjet e rregulluara me këtë Konventë, mund të nënshkruajë, pranojë, miratojë ose aderojë në këtë Konventë. Në këtë rast, Organizata Rajonale e Integritit Ekonomik ka të drejtat dhe detyrimet e një Shteti Kontraktues, në masën që Organizata ka kompetencë mbi çështjet e rregulluara me këtë Konventë.**
2. **Në momentin e nënshkrimit, pranimit, miratimit ose aderimit, Organizata Rajonale e Integritit Ekonomik njofton me shkrim Depozitarin për çështjet që rregullohen me këtë Konventë në lidhje me kompetencat që shtetet anëtare i kanë transferuar kësaj Organizate. Organizata njofton menjëherë me shkrim Depozitarin, për çdo ndryshim në kompetencat e saj, siç specifikohet në njoftimin më të fundit, të dhënë sipas këtij paragrafi.**
3. **Për qëllimet e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, çdo instrument i depozituar nga një organizatë rajonale e integritit ekonomik nuk llogaritet nëse Organizata Rajonale e Integritit Ekonomik nuk deklaron në përputhje me nenin 27(1) se shtetet anëtare të saj nuk do të jenë palë në këtë Konventë.**
4. **Çdo referim ndaj një “Shteti Kontraktues” ose “Shteti” në këtë Konventë zbatohet në mënyrë të barabartë, kur është e përshtatshme, për Organizatën Rajonale të Integritit Ekonomik.**

393. Nenet 26 dhe 27 u japin mundësi Organizatave rajonale të integritit ekonomik (ORIE) të bëhen palë kontraktuese në Konventë. Një ORIE e krijuar vetëm nga Shtete sovrane mund të nënshkruajë, pranojë, miratojë apo aderojë në Konventë (mungesa e termit *ratifikon* është e qëllimshme, sepse vetëm Shtetet ratifikojnë Konventa), por vetëm për aq sa se ajo ka kompetencë ndaj çështjeve të mbuluara nga Konventa.²⁶³ ORIE-të nuk konsiderohen se janë sisteme ligjore të paunifikuara

²⁶³ Raporti Hartley/Dogauchi, në shënimin 351, shpjegon se ORIE-të duhet të kenë kuptim autonom (duke mos u varur nga ligji i çdo Shteti) dhe se ajo duhet të interpretohet me fleksibilitet për të përfshirë

sipas kuptimit të Konventës dhe si rrjedhojë është e nevojshme të përfshijnë një dispozitë që i lejon ato të bëhen palë kontraktuese.

394. Konventa parashikon që një ORIE dhe Shtetet anëtare të saj të bëhen palë (Neni 26) ose që vetëm ORIE të bëhet palë (Neni 27).
395. Neni 26 merret me mundësinë e parë, *pra*, kur si ORIE ashtu edhe Shtetet anëtare të saj bëhen palë në Konventë. Kjo mund të ndodhë nëse ato gëzojnë kompetencë të njëkohshme ndaj lëndës së Konventës (kompetencë e përbashkët), ose nëse disa çështje futen në kompetencën e jashtme të ORIE-së ndërsa të tjerat brenda kompetencës së atij Shteti anëtar (që do të rezultonte në kompetencë të përbashkët apo të përzier për Konventën në tërësi).
396. Duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj çështjeje, ORIE-të duhet të njoftojnë depozitarin me shkrim për çështje e mbuluara nga kjo Konventë në lidhje me të cilat kompetenca i është transferuar asaj organizate nga Shtetet e saj anëtare. Njoftimi duhet të bëhet në kohën e nënshkrimit, pranimit, miratimit apo aderimit. Për më tepër, ORIE-të duhet të njoftojnë *menjëherë* depozitarin me shkrim për çdo ndryshim në kompetencën e tyre, siç specifikohet në njoftimin më të fundit (Neni 26(2)).
397. Kur numri i Shteteve është me rëndësi për qëllimet e hyrjes në fuqi të Konventës, paragrafi 3 parashikon se çdo instrument i depozituar nga një ORIE nuk do të numërohet përveçse kur ajo deklaron, në përputhje me nenin 27(1), se ato Shtete anëtare nuk do të jenë palë në të.
398. **Kuptimi i “Shtetit”.** Një kontraktues ORIE ka, brenda kufijve të kompetencës së vet, të njëjtat të drejta dhe detyra si një Shtet kontraktues. Kështu, paragrafi 4 parashikon se kur një ORIE bëhet palë në Konventë, nëse sipas nenit 26 ose sipas nenit 27, çdo reference në Konventë ndaj “Shtetit kontraktues” ose ndaj “Shtetit” zbatohet njëllë, sipas rastit, me ORIE-në. Në rastin e Bashkimit Evropian, kjo do të thotë se “Shteti” mund të thotë ose Bashkimi Evropian ose një nga Shtetet e tij anëtare, në varësi të asaj që është e përshtatshme. Nga kjo del se, meqenëse Bashkimi Evropian si një ORIE mund të bëhet palë në Konventë dhe të plotësojë kushtet si një Shtet kontraktues, krahu gjyqësor i tij, Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian, duhet të konsiderohet si gjykata e një Shteti kontraktues për qëllimet të kësaj Konvente.²⁶⁴

organizata nën-rajonale dhe trans-rajonale, si edhe organizatat mandati i të cilave shtrihet përtej çështjeve ekonomike.

²⁶⁴ Shih, gjithashtu Raporti Hartley/Dogauch, para. 17: “Nga kjo del se një marrëveshje për Zgjedhjen e Gjykatës që cakton “Gjykatat e Komunitetit Evropian” ose i referohet konkretisht “Gjykatës së Drejtësisë të Komuniteteve Evropiane (Gjykata e shkallës së parë)” do të mbulohej nga Konventa.”

Neni 27***Organizata Rajonale e Integrimit Ekonomik si palë kontraktuese
pa shtetet anëtare të saj***

- 1. Në momentin e nënshkrimit, pranimit, miratimit ose aderimit, një organizatë rajonale e integrimit ekonomik mund të deklarojë se ushtron kompetencën mbi të gjitha çështjet e rregulluara me këtë Konventë dhe se shtetet anëtare të saj nuk do të jenë palë në këtë Konventë, por do të kenë detyrime si pasojë e nënshkrimit, pranimit, miratimit ose aderimit të Organizatës.**
- 2. Në rast të deklarimit të bërë nga një organizatë rajonale e integrimit ekonomik në përputhje me paragrafin 1, çdo referim ndaj një “Shteti Kontraktues” ose një “Shteti” në këtë Konventë zbatohet në mënyrë të barabartë, kur është e përshtatshme, për shtetet anëtare të Organizatës.**

399. Neni 27 trajton mundësinë e dytë të përmendur më lart, *pra*, kur vetëm ORIE bëhet palë. Kjo mund të ndodhë kur ajo ka kompetencë të jashtme ekskluzive për lëndët e Konventës. Në një rast të tillë, ORIE-ja mund t’i deklarojë Shtetet anëtare të saj si të detyruara nga Konventa për shkak të marrëveshjes së ORIE-së. Sikur në rastin e mëparshëm, çdo reference ndaj “Shtetit kontraktues” ose “Shtetit” sipas Konventës zbatohet njëllë, sipas rastit, për Shtetet anëtare të ORIE-ve.

Neni 28
Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit, në përfundim të periudhës gjatë së cilës mund të jetë bërë njoftimi, në përputhje me nenin 29(2) që ka të bëjë me shtetin e dytë që ka depozituar instrumentin e tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, të përmendur në nenin 24.
2. Pas kësaj kjo Konventë hyn në fuqi:
 - (a) për çdo shtet që në vijim do të ratifikojë, pranojë, miratojë ose aderojë në të, në ditën e parë të muajit në përfundim të periudhës gjatë së cilës mund të bëhen njoftimet, në përputhje me nenin 29(2) që ka të bëjë me atë shtet;
 - (b) për njësinë territoriale në të cilën është shtrirë fusha e veprimit të kësaj Konvente, në përputhje me nenin 25, pasi Konventa të ketë hyrë në fuqi për shtetin që bën deklarinimin, në ditën e parë të muajit në përfundim të tre muajve, pas njoftimit të deklarinimit të referuar në atë nen.

400. Neni 28 e përcakton kur Konventa hyn në fuqi. Ajo bën dallimin midis hyrjes në fuqi të Konventës si e tillë, *pra*, si një instrument ndërkombëtar (para. 1), dhe hyrjes e saj në fuqi më pas në rastin e Shteteve që aderojnë më vonë (para. 2). Në të dy rastet, data e hyrjes në fuqi përcaktohet nga referenca ndaj periudhës së parashikuar nga Neni 29(2), gjatë të cilës Shteti kontraktues mund të refuzojë vendosjen e marrëdhënieve sipas Konventës lidhur me një Shtet të ri aderues,²⁶⁵ me qëllim për të ruajtur paralelizmin midis hyrjes në fuqi të Konventës dhe efektivitetit të saj midis dy Shteteve kontraktuese. Paragrafi 2(b) përmban një rregull të posaçëm për Shtetet e paunifikuara.

²⁶⁵ Për të lehtësuar leximin e kësaj pjese të Raportit, përdoren termat e përgjithshëm “aderim” apo “Shtet aderues” për të kuptuar një akt përmes të cilit një Shtet shpreh pëlqimin e tij për të qenë i detyruar nga Konventa dhe përfshin “ratifikimin”, “pranimin”, “miratimin” ose “aderimin” (shih, Neni 24).

Paragrafi 1 – Kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit, në përfundim të periudhës gjatë së cilës mund të jetë bërë njoftimi, në përputhje me nenin 29(2) që ka të bëjë me shtetin e dytë që ka depozituar instrumentin e tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, të përmendur në nenin 24.

401. Paragrafi 1 përcakton se Konventa do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit pas përfundimit të periudhës gjatë të cilës duhet bërë njoftimi në përputhje me nenin 29(2) për sa i takon Shtetit të dytë që ka depozituar instrumentin e tij të aderimit në Konventë. Neni 28(1) duhet lexuar bashkë me nenin 29, i cili I lejon Shtetet kontraktuese të refuzojnë vendosjen e marrëdhënieve pas Konventës. Kjo mundësi për t'u tërhequr mund të ushtrohet nga (i) ato Shtete që janë Shtete kontraktuese lidhur me Shtetet e reja që aderojnë në Konventë, dhe (ii) nga Shtetet adruuese në lidhje me ato Shtete që janë ndërkohë Shtete kontraktuese. Periudha për të ushtruar opsionin e tërheqjes është 12 muaj nga data e njoftimit të aderimit të një Shteti të ri. Duke iu referuar periudhës së parashikuar në nenin 29(2), neni 28(1) kërkon që Konventa të hyjë në fuqi 12 muaj pas datës kur aderimi i Shtetit të dytë i është njoftuar Shtetit të parë kontraktues. Në një datë të tillë, Konventa do të hyjë në fuqi njëkohësisht për të dy Shtetet.

402. **Shembulli.** Shteti A ratifikon Konventën më 14 prill 2020, ndërsa Shteti B e ratifikon atë një muaj më vonë, më 14 maj 2020. Shteti B nuk njofton se ratifikimi prej saj nuk do të ketë efektin e vendosjes së marrëdhënieve me Shtetin A (shih, neni 29(3)). Ratifikimi nga Shteti B i është njoftuar nga depozitari Shtetit A në 16 maj 2020. Në përputhje me nenin 29(2), Shteti A ende mund të bëjë një njoftim sipas kësaj dispozite dhe kështu të tërhiqet nga vendosja e marrëdhënieve sipas Konventës me Shtetin B, deri në dhe duke përfshirë 16 majin 2021. Ka dy situata të imagjinueshme në këtë rast. Nëse Shteti A nuk e bën një njoftim të tillë, Konventa do të hyjë në fuqi dhe do të ketë efekt midis Shteti A dhe B në 1 qershor 2021. Nëse, gjithsesi, Shteti A bën një njoftim të tillë, Konventa do të hyjë në fuqi në 1 qershor 2021, por nuk do të ketë efekt midis Shtetit A dhe Shtetit B.²⁶⁶

Paragrafi 2 – Pas kësaj kjo Konventë hyn në fuqi:

Nënparagrafi (a) – për çdo shtet që në vijim do të ratifikojë, pranojë, miratojë ose aderojë në të, në ditën e parë të muajit në përfundim të periudhës gjatë së cilës mund të bëhen njoftimet, në përputhje me nenin 29(2) që ka të bëjë me atë shtet;

²⁶⁶

Në teori, kur aderon në Konventa, Shteti B mund të ketë njoftuar gjithashtu se ai aderim nuk do të ketë efektin e vendosjes së marrëdhënieve me Shtetin A, por kjo rrethanë e pamundur nuk do të ketë ndikim në lidhjen e saj; Konventa do të hyjë në fuqi në 1 qershor 2021, por nuk do të ketë efekt.

Nënparagrafi (b) – për njësinë territoriale në të cilën është shtrirë fusha e veprimit të kësaj Konvente, në përputhje me nenin 25, pasi Konventa të ketë hyrë në fuqi për shtetin që bën deklarin, në ditën e parë të muajit në përfundim të tre muajve, pas njoftimit të deklaramit të referuar në atë nen.

403. **Aderimet e mëvonshme.** Paragrafi 2 e përcakton kur Konventa hyn në fuqi për Shtetet e mëvonshme aderuese. Për të ruajtur paralelizmin midis hyrjes në fuqi dhe datës së efektivitetit të saj, ajo përfshin gjithashtu një referencë ndaj periudhës 12-mujore të parashikuar nga Neni 29(2), në paragrafin 1. Sipas paragrafit 2, për çdo Shtet që aderon më vonë në Konventë, ajo do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit pas përfundimit të periudhës gjatë të cilës njoftimi mund të jetë bërë në përputhje me nenin 29(2) lidhur me atë Shtet. Kështu, duke marrë shembullin më lart, kur Shteti A nuk bën një njoftim lidhur me Shtetin B, nëse Shteti C e ratifikon Konventën më 15 qershor 2021, dhe ky ratifikim u është njoftuar nga depozitari Shteteve A dhe B më 17 qershor 2021, Konventa do të hyjë në fuqi në lidhje me Shtetin C më 1 korrik 2022. Nëse, për shembull, përpara 18 qershorit 2022, Shteti A ka njoftuar se aderimi në Konventë i Shtetit C nuk ka efektin e vendosjes së marrëdhënieve midis dy Shteteve (shih, neni 29(2)), Konventa do të hyjë në fuqi për Shtetin C më 1 korrik 2022, por do të ketë efekt vetëm lidhur me Shtetin B. Kështu, në këtë datë, Konventa do të jetë në fuqi në tre Shtetet, por do të ketë efekt vetëm midis Shtetet A dhe B, dhe midis Shtetit B dhe C.
404. Rregulla e vendosur nga neni 28(2) fillon me ndajfoljen “pas kësaj” dhe kështu zbatohet pasi Konventa ndërkohë ka hyrë në fuqi. Gjithsesi, ajo mbulon edhe rastet kur një Shtet i tretë aderon përpara se Konventa të ketë hyrë në fuqi, me kusht që të dy Shtetet ndërkohë të kenë aderuar në të. Nëse një Shtet i tretë aderon në Konventë përpara hyrjes së saj në fuqi, data e duhur për të filluar numërimin e periudhës 12 mujore lidhur me këtë Shtet të tretë është data e aderimit të tij, jo data e hyrjes në fuqi të Konventës. Kështu, për shembull, Shteti A aderon në Konventë më 14 prill 2020, Shteti B në 14 maj 2020 dhe Shteti C më 14 shtator 2020. Njoftimi i aderimit të Shtetit C për Shtetet A dhe B ndodh më 16 shtator 2020. Në një rast të tillë, Konventa do të hyjë në fuqi për Shtetin C më 1 tetor 2021.
405. **Rregulla e posaçme për Shtetet e paunifikuara.** Paragrafi 2(b) vendos një rregull të posaçme për Shtetet e paunifikuara (shih, *supra*, para. 390-391). Në përputhje me nenin 25, një Shtet i paunifikuar, kur aderon në Konventë, mund të deklarojë se Konventa do të zbatohet për të gjitha njësitë territoriale të tij. Në një rast të tillë, hyrja në fuqi rregullohet nga neni 28(2)(a). Neni 25 gjithashtu e lejon një Shtet të paunifikuar të deklarojë se Konventa do të zbatohet vetëm për një apo më shumë nga njësitë territoriale të tij. Në këtë rast, Shteti mundet që më pas ta shtrijë Konventën për njësi të tjera territoriale. Neni 28(2)(b) vendos një rregull të posaçme për hyrjen në fuqi të Konventës in këto situata, *pra*, kur një Shtet i paunifikuar që është ndërkohë palë në Konventë e shtrin zbatimin e saj në një njësi territoriale që fillimisht nuk mbulohej nga aderimi në të. Në një rast të tillë, Konventa do të hyjë në fuqi për këtë njësi territoriale në ditën e parë të muajit pas

përfundimit të tre muajve pas njoftimit të deklaramit të asaj shtrirjeje. Meqenëse neni 29(2) nuk zbatohet për njësi territoriale individuale, por për Shtetin kontraktues në tërësi (shih, *infra*, para. 411), periudha më e gjatë 12 mujore nuk nevojitet.

406. **Shembulli.** Të imagjinojmë që Shteti A ka tri njësi territoriale me sisteme të ndryshme gjyqësore A1, A2 dhe A3. Konventa është në fuqi që nga maji 2022. Shteti A e ratifikon Konventën në maj 2024 dhe deklaron, në përputhje me nenin 25, se Konventa do të shtrihet vetëm në njësinë territoriale A1. Hyrja në fuqi e Konventës për Shtetin A, për sa i takon njësisë territoriale A1, rregullohet nga rregulla e përgjithshme e shpjeguar më lart, *pra*, nga neni 28(2)(a). Dy vite më pas, më 14 maj 2026, Shteti A bën një deklaram që e shtrin Konventën në njësinë territoriale A2. Lidhur me këtë deklaram, neni 29 nuk zbatohet: Shteti A nuk mund të njoftojë se ai nuk do të vendosë marrëdhënie traktati midis A2 dhe Shteteve të tjera kontraktuese; po ashtu Shtetet kontraktuese nuk mund të njoftojnë se Konventa nuk do të ketë efekt në lidhje me A2. Kështu, në përputhje me nenin 28(2)(b), Konventa do të hyjë në fuqi dhe do të ketë efekt për sa i takon njësisë territoriale A2 më 1 shtator 2026.

Neni 29

Vendosja e marrëdhënieve në përputhje me Konventën

1. Kjo Konventë do jetë e zbatueshme nga të dy Shtetet Kontraktuese përveç rasteve kur njëri prej tyre ka njoftuar Depozitarin në lidhje me shtetin tjetrin, në përputhje me paragrafin 2 ose 3 në mungesë të një njoftimi të tillë, Konventa ka efekt mes dy Shteteve Kontraktuese nga dita e parë e muajit, në përfundim të periudhës gjatë së cilës mund të bëhen njoftimet.
2. Një shtet kontraktues mund të njoftojë Depozitarin, brenda 12 muajve nga data e njoftimit nga Depozitari, që përmendet në nenin 32(a), se ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi i një shteti tjetër nuk ka efekt për vendosjen e marrëdhënieve mes të dy shteteve në përputhje me këtë Konventë.
3. Një shtet mund të njoftojë Depozitarin, me depozitimin e instrumentit të tij në përputhje me nenin 24(4), se ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi i tij nuk ka efekt për vendosjen e marrëdhënieve me një Shtet Kontraktues në përputhje me këtë Konventë.
4. Një Shteti Kontraktues mund të tërheqë në çdo kohë njoftimin që ka bërë sipas paragrafit 2 ose 3. Një tërheqje e tillë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit, në përfundim të tre muajve nga data e njoftimit.

407. Neni 29 plotëson dy funksione: ai përcakton se kur Konventa bëhet efektive midis dy Shteteve kontraktuese dhe lejon një opsion të kufizuar tërheqjeje për të shmangur vendosjen e marrëdhënieve të traktatit me Shtete të tjera kontraktuese. Një opsion i tillë u konsiderua themelor për disa Shtete dhe konsensusi për përfshirjen e tij u arrit me idenë e lehtësimit të aderimit të Shteteve të veçanta dhe për të maksimizuar shtrirjen e Konventës. Mekanizmat e tërheqjes përfshihen edhe në instrumentet e tjera të KHDNP-së²⁶⁷ por jo në KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës. Për shkak se ky instrument i fundit zbatohet vetëm për marrëveshje ekskluzive për

²⁶⁷ Shih, për shembull KHDNP, *Konventa e 25 tetorit 1980 për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve* (Neni 38); KHDNP, *Konventa e 5 tetorit 1961 për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve të huaja publike* (Konventë e Apostilit) (Neni 12). Shih, gjithashtu *supra*, shënimi 263.

zgjedhjen e gjykatës, një mekanizëm i tillë nuk do të kishte qenë në përputhje me qëllimin e sigurimit të efektit të autonomisë së palëve. Konventa aktuale është shumë më e gjerë në fushën e veprimit vet dhe si pasojë një largim nga KHDNP 2005, Konventa për Zgjedhjen e Gjykatës, mund të justifikohet.

Paragrafi 1 – Kjo Konventë do jetë e zbatueshme nga të dy Shtetet Kontraktuese përveç rasteve kur njëri prej tyre ka njoftuar Depozitarin në lidhje me shtetin tjetrin, në përputhje me paragrafin 2 ose 3 Në mungesë të një njoftimi të tillë, Konventa ka efekt mes dy Shteteve Kontraktuese nga dita e parë e muajit, në përfundim të periudhës gjatë së cilës mund të bëhen njoftimet.

408. Rezultati kryesor i nenit 29 është që Konventa ka efekt midis dy Shteteve kontraktuese vetëm nëse asnjëri prej tyre nuk ka depozituar një njoftim në lidhje me tjetrin në përputhje me paragrafin 2 ose 3. Paragrafi 1 e përcakton se në mungesë të një njoftimi të tillë, Konventa ka efekt midis dy Shtetesh nga dita e parë e muajit pas përfundimit të periudhës gjatë të cilës mund të bëhet njoftimi.
409. Sikundër shpjegohet më lart (shih, *supra*, para. 401-402), ka një lidhje të ngushtë midis hyrjes në fuqi të Konventës sipas nenit 28 dhe kushtit të efektivitetit në nenin 29. Efektiviteti është gjithashtu kusht funksional sipas nenit 16: Konventa do të zbatohet për çdo vendim të dhënë vetëm kur Konventa ka efekt midis dy Shteteve kontraktuese në momentin kur procesi ka nisur në Shtetin e origjinës (shih, *supra*, para. 328-330).
410. Mekanizmi i tërheqjes është i kufizuar në atë që është i disponueshëm një herë për marrëdhëniet dypalëshe midis çdo çifti Shtetesh. Paragrafi 3 parashikon tërheqjen nga ky njoftim për të lejuar vendosjen e marrëdhënieve të traktatit dhe efektivitetin e Konventës midis dy Shteteve.
411. **Sistemet ligjore të paunifikuara dhe ORIE-të.** Njoftimet sipas nenit 29 mund të bëhen vetëm nga një Shtet kontraktues në lidhje me një tjetër Shtet kontraktues. Opsioni i tërheqjes nuk është i mundur, as i zbatueshëm për njësi territoriale të veçanta të Shteteve të paunifikuara ose të Shteteve të veçanta anëtare të ORIE-ve (kur ORIE është një palë kontraktuese), *pra*, ai zbatohet për Shtetin e paunifikuar apo për ORIE-në në tërësi.

Paragrafi 2 – Një shtet kontraktues mund të njoftojë Depozitarin, brenda 12 muajve nga data e njoftimit nga Depozitari, që përmendet në nenin 32(a), se ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi i një shteti tjetër nuk ka efekt për vendosjen e marrëdhënieve mes të dy shteteve në përputhje me këtë Konventë.

412. Paragrafi 2 trajton njoftimin nga Shtetet kontraktuese për sa u takon Shteteve aderuese.²⁶⁸ Ai jep një periudhë 12-mujore për njoftimin e depozitarit se

²⁶⁸ Siç u vë në dukje në shënimin 266, për të lehtësuar leximin e kësaj pjese të Raportit, termat e

marrëdhëniet e traktatit nuk do të vendosen me një Shtet aderues. Periudha 12-mujore fillon të numërohet nga momenti që depozitari ka njoftuar Shtetet kontraktuese për aderimin. Nëse një Shtet kontraktues nuk vepron brenda periudhës 12-mujore, Konventa do të ketë efekt midis atij Shteti dhe Shtetit aderues, përveç kur Shteti aderues ka bërë njoftimin lidhur me Shtetin kontraktues sikundër lejohet sipas paragrafit 3.

Paragrafi 3 – Një shtet mund të njoftojë Depozitarin, me depozitimin e instrumentit të tij në përputhje me nenin 24(4), se ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi i tij nuk ka efekt për vendosjen e marrëdhënieve me një Shtet Kontraktues në përputhje me këtë Konventë.

413. Paragrafi 3 trajton njoftimin nga Shtetet aderuese për sa u takon Shteteve kontraktuese. Ai parashikon se Shtetet aderuese mund ta njoftojnë depozitarin se një aderim i tillë nuk do të vendosë marrëdhënie traktati me një apo më shumë Shtete kontraktuese të specifikuar. Ky njoftim është i mundur vetëm në kohën e depozitimit të instrumentit të aderimit sipas nenit 24(4). Ky dallim shpjegohet me faktin se identiteti i Shteteve ekzistuese kontraktuese është i njohur për Shtetet aderuese, duke kërkuar që këto të fundit ta marrin vendimin e tyre lidhur me tërheqjen përpara depozitimit të instrumentit të tyre të aderimit.

414. **Shembulli.** Konventa ka hyrë në fuqi në 1 maj 2022 pas aderimit të Shtetet A dhe B, asnjëri prej të cilëve nuk ka bërë një njoftim në lidhje me tjetrin. Shteti C atëherë aderon në Konventë në 14 maj 2022. Pikërisht në atë moment Shteti C lejohet të njoftojnë depozitarin se aderimi i tij nuk do të ketë efekt në vendosjen e marrëdhënieve të traktatit me Shtetin A ose Shtetin B ose të dyja shtetet (para. 3). Shtetet A dhe B, nga ana tjetër, kanë 12 muaj nga momenti që depozitari i njofton ata për aderimin e Shtetit C (të themi më 16 maj 2022) për të bërë njoftimin e tyre lidhur me marrëdhëniet e traktatit me Shtetin C (para. 2). Shtetet A dhe B do të kenë kohë deri në 16 maj 2023, duke përfshirë 16 majin, për ta bërë këtë dhe si pasojë Konventa nuk mund të bëhet efektive midis këtyre tre Shteteve përpara 1 qershorit 2023 (para. 1). Nëse Shteti A e bën një njoftim sipas nenit 29(2), ndërsa Shteti B nuk e bën, Konventa do të jenë efektive midis Shtetet B dhe C, por jo në Shtetet A dhe C, duke filluar nga 1 qershori 2023. Ajo nuk do të jetë e hapur as për Shtetin B as për Shtetin C për tërheqje nga marrëdhënia e traktatit me Shtetin tjetër në një moment të mëvonshëm.

Paragrafi 4 – Një Shteti Kontraktues mund të tërheqë në çdo kohë njoftimin që ka bërë sipas paragrafit 2 ose 3. Një tërheqje e tillë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit, në përfundim të tre muajve nga data e njoftimit.

përgjithshme “aderim” ose “Shteti aderues” përdoren me kuptimin që akti përmes të cilit një Shtet shpreh pëlqimin e tij për të qenë i detyruar nga Konventa dhe përfshijnë “ratifikimin”, “pranimin”, “miratimin” apo “aderimin” (shih, neni 24).

415. Nëse një Shtet e ka ushtruar opsionin e tij të tërheqjes, qoftë sipas paragrafit 2 or 3, ai mund ta tërheqë atë në çdo kohë. Kjo tërheqje do të ketë efekt në ditën e parë të muajit pas përfundimit të tre muajve pas datës së njoftimit. Sigurisht, kjo gjë nuk do të prekë marrëdhëniet e traktatit me Shtetin e përcaktuar nëse ai Shtet gjithashtu e kish bërë njoftimin sipas paragrafit 2 ose 3 dhe nuk është tërhequr.
416. **Shembulli.** Vazhdon nga shembulli i mëparshëm, nëse Shteti A vendos të tërhiqet nga njoftimi lidhur me Shtetin C dhe këtë e bën më 15 shtator 2024, ai do të jetë efektiv më 1 janar 2025 dhe si rrjedhojë Konventa do të jetë efektive midis Shteteve A dhe C që nga ajo kohë. Vendimet gjyqësore të dhëna në procese të nisura në secilin prej atyre Shteteve që nga 1 janari 2025 si pasojë do t'i plotësojnë kushtet për njohje apo zbatim në secilin Shtet. Sipas Konventës, asnjëri nga Shtetet nuk do të ketë mundësi të tërhiqet nga marrëdhëniet me Shtetin tjetër në çdo moment tjetër.

Neni 30
Deklarimet

1. Deklarimet e përmendura në nenet 14, 17, 18, 19 dhe 25 mund të bëhen me nënshkrimin, ratifikimin, pranimin, miratimin ose aderimin, ose në çdo kohë pas kësaj, dhe mund të modifikohen ose të tërhiqen në çdo kohë.
2. Deklarimet, modifikimet dhe tërheqjet i njoftohen Depozitarit.
3. Deklarimi i bërë në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit hyn në fuqi njëkohësisht me hyrjen në fuqi të kësaj Konvente për shtetin në fjalë.
4. Deklarimi i bërë në një kohë të mëvonshme, dhe çdo modifikim ose tërheqje e deklarimit, hyn në fuqi në ditën e parë të muajit, në përfundim të tre muajve, pas datës në të cilën njoftimi pranohet nga Depozitari.
5. Deklarimi i bërë në një kohë të mëvonshme, dhe çdo modifikim ose tërheqje e deklarimit, nuk zbatohen për vendime gjyqësore që rezultojnë nga procedura, që tashmë kanë filluar pranë gjykatës së origjinës, kur deklarata hyn në fuqi.

417. **Koha e bërjes së deklarimeve.** Deklarimet e përmendura në nenet 14, 17, 18, 19 dhe 25 mund të bëhen me nënshkrimin, ratifikimin, pranimin, miratimin apo aderimin apo në çdo kohë më pas dhe mund të modifikohen apo tërhiqen në çdo kohë. Ato i bëhen depozitarit (Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës).
418. **Hyrja në fuqi e deklarimeve në kohën e nënshkrimit apo aderimit.** Një deklaram i bërë në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit hyn në fuqi njëkohësisht me hyrjen në fuqi të Konventës për Shtetin në fjalë.
419. **Hyrja në fuqi e deklarimeve të bëra në një kohë të mëvonshme.** Një deklaram i bërë në një kohë të mëvonshme dhe çdo modifikim apo tërheqje e një deklarimi hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas mbarimit të tre muajve pas datës në të cilën njoftimi është marrë nga depozitari. Gjithsesi, një deklaram i tillë nuk zbatohet për vendimet gjyqësore që rrjedhin nga një proces që ndërkohë ka filluar përpara gjykatës së origjinës kur deklarimi hyn në fuqi. Si rrjedhojë, deklaramet nuk kanë efekt retroaktiv në lidhje me zbatimin e tyre për procese që kanë filluar përpara

hyrjes në fuqi të deklarimit. E njëjta gjë zbatohet për çdo modifikim apo tërheqje të një deklarimi. Kjo siguron parashikueshmëri më të madhe në veprimin e Konventës për të gjitha palët në proces.

420. **Rezervat.** Konventa nuk përmban asnjë dispozitë që i ndalon rezervat. Kjo do të thotë se rezervat lejohen, me kusht që t'u nënshtrohen rregullave të zakonshme të së drejtës ndërkombëtare zakonore (sikundër pasqyrohet në nenin 2(1)(d) dhe nenet 19-23 të Konventës së Vjenës së 1969).

Neni 31
Denoncimi

- 1. Një shteti kontraktues i kësaj Konvente mund ta denoncojë atë përmes njoftimit me shkrim, drejtuar Depozitarit. Denoncimi mund të kufizohet në njësi të caktuara territoriale të një sistemi ligjor të paunifikuar, për të cilin zbatohet kjo Konventë.**
- 2. Denoncimi hyn në fuqi në ditën e parë të muajit, në përfundim të 12 muajve, pas datës në të cilën njoftimi merret nga Depozitari. Kur në njoftim specifikohet një periudhë më e gjatë derisa denoncimi të hyjë në fuqi, denoncimi hyn në fuqi në përfundim të kësaj periudhe, pas datës në të cilën njoftimi merret nga Depozitari.**

421. Neni 31 parashikon se një Shtet mund ta denoncojë Konventën duke njoftuar me shkrim depozitarin. Denoncimi mund të jetë i kufizuar në disa njësi të caktuara territoriale të një sistemi ligjor të paunifikuar ku Konventa zbatohet. Denoncimi hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas përfundimit të 12 muajve pas datës në të cilën njoftimi merret nga depozitari. Kur një kohë më e gjatë për hyrjen në fuqi të denoncimit është përcaktuar në njoftim, denoncimi hyn në fuqi me mbarimin e periudhës më të gjatë të përcaktuar, pas datës në të cilën njoftimi është marrë nga depozitari.

Neni 32
Njoftimet nga Depozitari

Depozitari njofton Anëtarët e Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private, shtetet tjera dhe organizatat rajonale të integritit ekonomik që kanë nënshkruar, ratifikuar, pranuar, miratuar ose aderuar në këtë Konventë në përputhje me nenet 24, 26 dhe 27 për sa më poshtë:

- (a) nënshkrimet, ratifikimet, pranimet, miratimet dhe aderimet e përmendura në nenet 24, 26 dhe 27;**
- (b) datën në të cilën kjo Konventë hyn në fuqi sipas nenit 28;**
- (c) njoftimet, deklaramet, modifikimet dhe tërheqjet e përmendura në nenet 26, 27, 29 dhe 30; dhe**
- (d) denoncimet e përmendura në nenin 31.**

422. Neni 32 kërkon që depozitari të njoftojë anëtarët e Konferencës së Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private dhe Shtetet e tjera dhe Organizatat Rajonale të Integritit Ekonomik që kanë nënshkruar, ratifikuar, pranuar, miratuar ose aderuar në këtë Konventë për çështje të ndryshme që lidhen me Konventën, siç janë nënshkrimet, njoftimet, hyrja në fuqi, deklaramet dhe denoncimet.